

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**RAPORT AUDITIMI**

**PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE**

**“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË**  
**VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE” NË SPITALIN RAJONAL**  
**SHKODËR**

**QERSHOR 2018**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>Përmbajtja</b>	<b>faqe</b>
<b>RAPORT AUDITIMI</b> .....	<b>1</b>
<b>PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE</b> .....	<b>1</b>
<b>QERSHOR 2018</b> .....	<b>1</b>
<b>HYRJA</b> .....	<b>12</b>
<b>Objektivat</b> .....	<b>13</b>
<b>Qëllimi</b> .....	<b>13</b>
<b>Identifikimi i çështjes</b> .....	<b>13</b>
<b>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</b> .....	<b>13</b>
<b>Përgjegjësitë e audituesve</b> .....	<b>13</b>
<b>Kriteret e vlerësimit</b> .....	<b>14</b>
<b>Standardet e auditimit</b> .....	<b>14</b>
<b>I. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	<b>15</b>
Informacioni i përgjithshëm.....	15
Objekt i këtij auditimi.....	15
Qëllimi i auditimit.....	15
Fushëveprimi.....	15
<b>II. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> .....	<b>16</b>
<b>1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.</b> <b>16</b>	
<i>Sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.14, datë 30.03.2018</i> .....	<b>19</b>
<b>2. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative</b> .....	<b>25</b>
<i>Objekti i këtij akt verifikimi është:</i> .....	<b>25</b>
<b>Tabela përmbledhëse e 231</b> .....	<b>34</b>
<i>Investimet</i> .....	<b>40</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<i>Investimet</i> .....	47
<b>3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.</b>	<b>48</b>
<i>Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:</i> .....	48
<b>Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Drejtoreshën e SRSH znj.Dh. U.....</b>	<b>51</b>
<b>4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.....</b>	<b>55</b>
<i>Për vitin 2015;</i> .....	56
<i>Për vitin 2016;</i> .....	59
<i>Për vitin 2017;</i> .....	59
<i>Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi drejtuesin e SRSH z.V.M.</i> .....	60
<b>Në lidhje me gjendjen e inventarit për medikamentet e skaduara në SRSH .....</b>	<b>62</b>
<i>Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:</i> .....	63
<i>Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:</i> .....	63
<i>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:</i> .....	63
<i>Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:</i> .....	63
<b>Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme .....</b>	<b>65</b>
<i>Për pasqyrat financiare të vitit 2016 (Aktivi);</i> .....	68
<i>Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:</i> .....	74
<i>Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:</i> .....	74
<i>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:</i> .....	74
<b>5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike dhe lidhjen e kontratave. .</b>	<b>75</b>
5.1 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje shtypshkrime” .....	76
<b>Operatorë të kualifikuar: R.G.</b> .....	<b>78</b>
5.2 Procedura e prokurimit me objekt “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër” .....	79

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të tenderit u konstatuan këto problematika:.....</b>	<b>80</b>
<b>Zbatimi i kontratës: .....</b>	<b>80</b>
<b>Likuidimi deri datë 31.12.2017 rezulton si vijon:.....</b>	<b>81</b>
5.3 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”: .....	81
<b>I. Loti I “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”.....</b>	<b>81</b>
<b>I.1 Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 017” rezultoi si më poshtë vijon: Loti I.....</b>	<b>81</b>
<b>I.2 Zbatimi i kontratave: .....</b>	<b>83</b>
<b>II. Loti II “Blerje medikamente deri me 15 prill 017, e ndarë në lote, gjithsej 20 lote”.....</b>	<b>83</b>
5.4 Procedura e prokurimit me objekt “Projekt Preventiv zbatim për ri K.in e ambienteve të reaminacionit të kardiologjisë” dhe “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër ” .....	85
<b>Ankesat e OE:.....</b>	<b>88</b>
5.5 Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës janar-shkurt 2017” . .....	88
<b>Zbatimi i kontratës: .....</b>	<b>89</b>
5.6 Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner” rezultoi si më poshtë vijon: .....	91
<b>Zbatimi i kontratës: .....</b>	<b>92</b>
<b><i>Nga verifikimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës rezulton që: .....</i></b>	<b>93</b>
5.7 Procedura e prokurimit me objekt “Plan-Rilevimi, Plan-Vendosje dhe planimetritë për Spitalin Rajonal Shkodër” me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	94
<b>Operatorë të kualifikuar: .....</b>	<b>95</b>
<b><i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i></b>	<b>95</b>
<b><i>Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në .....</i></b>	<b>95</b>
<b>Zbatimi i kontratës: .....</b>	<b>95</b>
5.8 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale të buta për Spitalin Rajonal Shkodër” me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	96
<b>Operatorë të kualifikuar: .....</b>	<b>97</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<i>Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në .....</i>	<b>97</b>
5.9 Tenderi me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	97
<i>Objekti i këtij akt verifikimi është: .....</i>	<b>97</b>
<i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i>	<b>97</b>
<i>Janë kryer likuidimet e mëposhtëme: .....</i>	<b>98</b>
5.10 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	101
<i>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</i>	<b>101</b>
<i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i>	<b>101</b>
<b>Zbatimi i kontratës: .....</b>	<b>102</b>
5.11 Auditimi i zbatimit të kontratave të shërbimit të makinerive mjekësore të repartit të Hemo-Dializës në vite për Spitalin Rajonal Shkodër, me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	105
<i>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</i>	<b>105</b>
<i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i>	<b>105</b>
<i>Janë kryer likuidimet e mëposhtëme: .....</i>	<b>105</b>
5.12 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	109
<i>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</i>	<b>109</b>
<i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i>	<b>109</b>
<b>Konkretisht: .....</b>	<b>113</b>
5.13 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	115
<i>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</i>	<b>115</b>
<i>Nga verifikimi rezultoi që: .....</i>	<b>115</b>
<b>Tek pika 2.2.4, Përgjegjësitë e NJIK (Njësia e inxhinierisë klinike), citohet: .....</b>	<b>118</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

5.14 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje medikamente për kimioterapinë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	122
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</b>	<b>122</b>
<b>Nga verifikimi rezultoi që: .....</b>	<b>122</b>
5.15 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër për një periudhë 1 mujore, rast urgjent me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	126
<b>Nga verifikimi rezultoi që: .....</b>	<b>126</b>
5.16 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Kite dhe Reagente për ekzaminime specifike” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	130
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</b>	<b>130</b>
<b>Nga verifikimi rezultoi që: .....</b>	<b>130</b>
5.17 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	134
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore”, ku rezultoi që: .....</b>	<b>134</b>
5.18 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	144
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore”, ku rezultoi që: .....</b>	<b>145</b>
5.19 Tenderi me objekt “Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër, rezultoi si më poshtë vijon:	154
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</b>	<b>154</b>
5.20 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	155
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</b>	<b>155</b>
5.21 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	161
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: .....</b>	<b>161</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

5.22 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje paisje për kirurgjinë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	164
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Blerje paisje për kirurgjinë” ku rezultoi që:.....</b>	<b>164</b>
5.23 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:.....	168
<b>Objekti i këtij akt verifikimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”, ku rezultoi që:.....</b>	<b>168</b>
<b>6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.</b>	<b>170</b>
6.1 Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje karburant për automjete”. .....	170
<b>Lidhja e kontratës dhe zbatimi. ....</b>	<b>170</b>
6.2 Mbi zbatimin e procedurave në zbatimin e kontratave me objekt “Blerje lëndë djegëse”, rezultoi si më poshtë vijon:.....	171
<b>Lidhja e kontratës dhe zbatimi. ....</b>	<b>171</b>
6.3 Kontrata me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër” .....	172
<b>Sa më sipër konstatojmë se: .....</b>	<b>173</b>
<b>Situacioni nr. 1. ....</b>	<b>175</b>
<b>Situacioni nr. 2. ....</b>	<b>175</b>
<b>Situacioni nr. 3 dhe përfundimtar për kontratën bazë.....</b>	<b>176</b>
<b>Situacioni për kontratën shtesë.....</b>	<b>176</b>
6.4 Kontrata me objekt “Furnizim Vendorsje e një aparature Rezonance për Spitalin Rajonal Shkodër”	177
6.5 Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips”	178
<b>Nga verifikimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës rezultoi që: .....</b>	<b>179</b>
6.6 Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips”	180
6.7 Kontrata me objekt “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon: .....	181
<b>Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” ku rezultoi që:.....</b>	<b>181</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël. ....	188
<i>Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që: .....</i>	188
<i>Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi drejtorin e SRSH z. P.Ç.....</i>	189
<i>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: .....</i>	192
8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore. ....	192
Ambiente të dhëna me qira .....	193
Ambiente në katin e tretë të Spitalit Rajonal Shkodër 343.43 m <sup>2</sup> . ....	193
Ambient me sipërfaqe 12 m <sup>2</sup> . ....	194
Ish punti i gjakut-Arka- Pranimi, spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m <sup>2</sup> .....	195
<i>Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:.....</i>	197
<b>Së pari: Pretendemi se të ardhurat dytësore janë dy ose tre fishuar është jashtë objektit të gjetjes.</b>	<b>197</b>
<b>Së dyti: Ju kujtojmë se jeni emëruar Drejtor i SR Shkodër për periudhën 14.01.2014 deri me 31.03.2015, dhe ndërkohë Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2018 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucioneve shëndetësore” nuk parashikon pengesa për kontratat e lidhura që janë në vazhdim dhe aq më tepër për rastin konkret të kontratës së qirasë me nr. prot. 368/1, datë 07.08.2002 me afat deri me datë 01.12.2022. Pra sipërfaqja shtesë prej 138.7 m<sup>2</sup> i përket periudhës 2008 deri 14.04.2016. Për periudhën (14.01.2014 – 31.03.2015) në të cilën Ju keni Drejtuar SR Shkodër duhet të kishit arkëtuar qiranë për sipërfaqen shtesë aq më tepër që është konstatuar edhe nga grupi i punës në zbatim të UB nr. 105, datë 28.08.2014. ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2011. ....</b>	<b>197</b>
9. Auditim mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. ....	197
10. Të tjera që mund të dalin gjatë procesit të auditimit. ....	201
<i>Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë: .....</i>	202
A. MASA ORGANIZATIVE: .....	202
1.1 Rekomandimi: .....	203
1.2 Rekomandimi: .....	203

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>1.3 Rekomandimi:</b> .....	<b>203</b>
<b>Menjëherë dhe në vazhdim</b> .....	<b>203</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>203</b>
<b>3.1 Rekomandimi:</b> .....	<b>204</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>204</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>205</b>
<b>6.1 Rekomandimi:</b> .....	<b>206</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>206</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>206</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>207</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>207</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>208</b>
<b>Menjëherë dhe vazhdimësi</b> .....	<b>209</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>210</b>
<b>Menjëherë dhe në vazhdimësi</b> .....	<b>211</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>212</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>212</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>214</b>
<b>Vazhdimisht</b> .....	<b>214</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>215</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>216</b>
<b>Vazhdimisht</b> .....	<b>218</b>
<b>Menjëherë</b> .....	<b>219</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Menjëherë .....	220
<b>B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK.....</b>	<b>220</b>
<b>2.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>223</b>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>223</i>
<b>3.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>223</b>
<b>Nga Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të merren masa, që të rinovojnë kontratën e nënshkruar midis palëve, e cila të pasqyrojë sipërfaqen reale të shfrytëzimit dhe vlerën koresponduese konform rregullave të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.....</b>	<b>223</b>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>223</i>
<b>3.2 Rekomandimi: .....</b>	<b>223</b>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>224</i>
<b>4.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>224</b>
<i>Deri më datë 30.06.2018 .....</i>	<i>224</i>
<b>5.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>224</b>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>225</i>
<b>6.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>225</b>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>226</i>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>226</i>
<i>Deri më datë 31.07.2018 .....</i>	<i>227</i>
<i>Menjëherë.....</i>	<i>227</i>
<b>1.1 Rekomandimi: .....</b>	<b>229</b>
<b>Nga ana e Drejtorisë së Spitalit Shkodër, të merren masat e duhura për analizimin e shkaqeve dhe faktorëve të cilët kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme dhe akumulimin e medikamenteve të skaduara, të dalin personat përgjegjës dhe të mos përsëriten në të ardhmen këto problematika, duke synuar një menaxhim ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike.</b>	<b>229</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Gjithashtu të hartohet një planveprimi me afate të përcaktuara dhe të ngrihet komision i specializuar për të bërë të mundur evadimin/asgjësimin e këtyre medikamenteve në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe aktet e dala në funksion të tij, duke kryer në vijim dhe veprimet përkatëse kontabile. .... 229

Menjëherë ..... 229

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*..... 229

Opinion i kualifikuar ..... 230

*Baza për kualifikimin e Opinionit* ..... 230

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi. .... 230

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**..... 230

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**HYRJA**

Mbështetur në ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 40/1, datë 19.01.2018, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 22.01.2018 deri në datë 30.03.2018, në subjektin Spitali Rajonal Shkodër (Në vijim SRSH), u krye auditimi për periudhën prej 01.01.2015 deri ne 31.12.2017 me objekt “Përputhshërie e rregullshmërie mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare, ligjshmërisë financiare”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1. S.M., përgjegjës grupi;**
- 2. E.M., auditues,**
- 3. A.T., auditues,**
- 4. I.H., auditues.**

Në veprimtarinë tonë audituese jemi mbështetur në:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC
- Kushtetuta dhe ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
- Ligji nr. 96.43, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivar”;
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2017 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit , i ndryshuar;
- Ligji nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”
- Ligji nr.89/2014, “Për pajisjet Mjekësore”;
- VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”;

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; në Statutin dhe rregulloren e brendshme të spitalit si dhe akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.
- Urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 i Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri”.

### **Objektivat**

Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare në SR Shkodër . Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Zbulimi i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë, efikasë, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

### **Qëllimi**

Të vlerësojë dhe të evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me efikasë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve, dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të punës.

### **Identifikimi i çështjes**

Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie të marrëveshjes së zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve dhe kreditorëve, në menaxhimin e aktiveve të spitalit.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Bazuar në rregulloren e brendshme të funksionit nga ana e grupit të auditimit u përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë e stafit drejtues përkatëse të spitalit rajonal shkodër.

### **Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. Auditimi është kryer me zgjedhje, ku për kryerjen e tij grupi i auditimit është mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjekti i audituar, evidencat e ndryshme në format të printuar dhe elektronike, si dhe në ballafaqimin e problemeve nëpërmjet kontakteve verbale e shkresore me subjektin e audituar. Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar duke përfshirë testimet, komunikimin e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

vazhdueshëm me stafin dhe specialistët e subjektit objekt auditimi, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë për zbatimin e përputhshmërisë se në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore ku mbështet veprimtaria e spitalit.

**Kriteret e vlerësimit.**

Vërtetësia e përputhshmërisë, se në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- Procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- Nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- Anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- Ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
- Shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
- Vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i observacioneve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi aktverifikimet dhe aktkonstatimet e mbajtura nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për këtë u bazuam në bazën ligjore të përcaktuar në hyrjen e raportit përfundimtar.

**Standardet e auditimit**

Standartet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës, janë në përputhje ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 3, pika 5, me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, sipas përcaktimit të ISSAI 100, “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.”, duke përdorur gjykimin profesional specifikisht në ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në praktikat më të M.të fushës” si dhe manualin e përputhshmërisë botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

## **I. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **Informacioni i përgjithshëm.**

Auditimi u zhvillua në Spitalin Rajonal Shkodër, e cila është përgjegjëse për organizimin, funksionimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe të të ardhurave dytësore, për të gjetur mundësi aplikimi për mbështetjen financiare, në funksion të adresimit të nevojave strategjike afat-mesme dhe afat-gjata, si dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve. Gjithashtu, Drejtoria e SRSH është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë rajonin e Shkodrës, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.

Spitali Rajonal Shkodër, funksionon në bazë të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”. SRSH kryen shërbim shëndetësor spitalor publik në shkallë rajonale. Nëpërmjet shërbimit të urgjencës mjekësore, SRSH mundëson ndihmë dhe kujdes mjekësor të shpejtë dhe të sigurtë për personat që pësojnë përkeqësim të menjëhershëm të gjendjes shëndetësore, dëmtime apo sëmundje të paprituar. Struktura organizative organizativee SRSH përbëhet nga: Këshilli Administrativ; Drejtoria e cila përbëhet nga Drejtori ekzekutiv, z/Drejtori ekonomik, z/Drejtori Teknik, Kryinfermieri i përgjithshëm; Komisioni mjekësor Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut.

Rëndësia e kryerjes së këtij auditimi nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka të bëjë me dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

**Objekt i këtij auditimi** është përputhshmëria dhe rregullshmëria mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative, mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit, të prokurimeve publike dhe zbatimit të kontratave të mallra, shërbime e punë pun publike, në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore., mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Spitalit Rajonal Shkodër.

**Qëllimi i auditimit:** është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

**Fushëveprimi-** auditimi u shtri në periudhën kohore prej datës 01.01.2015 deri më 31.12.2017, gjatë së cilës dhe u auditua përdorimi i buxhetit si dhe zbatimi i kontratave të punëve civile.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

## **II. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.**

Drejtimi i SRSH nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore. Sipas ligjit organik, SRSH ka dy nivele drejtimi. Drejtimi kolegjal dhe ai ekzekutiv. Drejtimi kolegjal realizohet nga KA i cili rezultoi në pambledhur prej vitit 2008.

Pra, periudha 3-vjeçare e vleshmërisë së anëtarit të KA, për një pjesë të anëtarëve ka skaduar, kurdo të ketë qenë i filluar ajo. Konkretisht përfundimi i vleshmërisë së anëtarësisë në KA, vlen vetëm për 4 persona, përcaktuar sipas nenit 13 të ligjit 9106 që janë:

- 2 anëtarë nga Këshilli i Qarkut Shkodër.
- 1 anëtar nga Këshilli Bashkiak Shkodër,
- 1 anëtar i autorizuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

Por, përveç tyre, ligji 9106, neni 13 autorizon drejtëpërdrejtë 4 anëtar të tjerë, **që nuk kanë nevojë për rizgjedhje.** Konkretisht:

- Drejtori Ekzekutiv i SRSH.
- Presidenti i Urdhërit të Mjekut të Qarkut Shkodër.
- Kryeinfermieri i Përgjithshëm i SRSH.
- Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor të Qarkut Shkodër (DFSDKSHQSH) (ose një person i autorizuar prej tij). **Në këtë pikë, mos autorizimi nuk përjashton DFSDKSHQSH nga e detyrimi i tij ligjor të jetë anëtar i KA të SRSH.**

Prefekti i Qarkut Shkodër, ka detyrim të përcaktuar ligjor, për përmbushjen e detyrave të tij, për KA të SRSH. Por nuk vërtetohet në asnjë rast, që SRSH, t'i jetë drejtuar Prefektit për të përmbushur detyrimin e tij, për caktimin e një përfaqësuesi, për në KA të Autoritetit Spitalor të Qarkut Shkodër (ASQSH). Në periudhën audituese ka patur 22 korespondenca mes Prefekturës Shkodër dhe SRSH nga të cilat vetëm një është e SRSH drejtuar Prefekturës Prot. Nr. 917 datë 04.04.2017, dhe një shkresë e dytë drejtuar OSHEE, por për dijeni Prefekturës me Prot. Nr. 2507 datë 30.11.2017, për mosndërpreje energjie. **Duhet evidentuar shkresa Prot. Nr. 1306 datë 20.12.2017 të Prefektit Shkodër, ku ai i kërkon:**

- (1). Probleme e detyra të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e SRSH.
- (2). Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale që rregullojnëveprimtarinë e SRSH.
- (3). Zgjidhja e ankesave kërkesave të ndryshme.
- (4). Raport përmbledhës, lidhur me evidencat për:
  - a. Zbatim buxheti të SRSH.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- b. Struktura organizative në SRSH.
- c. Numri i punonësve në SRSH.

Në fakt, kërkesat e Prefektit përkojnë edhe me detyrat e KA, ku institucioni i Prefekturës, ka akses në këto informacione nëpërmjet përfaqësuesit të vet në KA të ASQSH, sipas ligjit nr. 9106. Sipas dokumentacionit mbi këtë shkresë nuk ka përgjigje nga SRSH, mbi specifikat e kërkuar nga Prefektura Shkodër, që janë fushë veprimi i KA të SRSH.

Këto mosveprime nga SRSH, krijojnë bindjen e arsyeshme, se SRSH nuk ka tentuar asnjëherë të realizoj mbledhje të KA. Ky fakt nënvizohet dhe me korespondencën ndaj Urdhërit të Mjekut të Qarkut Shkodër (UMQSH) ku janë vetëm gjashtë shkresa hyrëse në SRSH, nga UMQSH, por asnjë dalëse për UMQSH nga ana e SRSH.

Duke përmbledhur, mungesa e komunikimit për periudhën nën auditim, me Prefektin, Presidentin e UMQSH, DFSDKSHQSH për çështjen e mbledhjes së KA, krijon bindjen e arsyeshme se në çdo moment ka qenë mundësia për të mbledhur 5 nga 8 anëtarët e KA, të cilët përbëjnë mbi gjysmën e anëtarëve të KA, që mund të thërrisnin mbledhje të jashtëzakonëshme të këshillit. Në fakt, mosmbledhja për afro 10 vjet e KA, realisht është një situatë jo e zakonëshme.

Kjo mungesë komunikimi, vlen edhe në raport me Bashkinë Shkodër. Janë 14 korespondenca mes dy institucioneve. Është për t'u evidentuar se me prot. Nr. 45 datë 10.01.2017 në Kthim-Përgjigje ndaj Bashkisë Shkodër, evidentohet se kjo shkresë i adresohet për dijeni Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Kjo vërteton mungesën e theksuar të komunikimit, nga ana e SRSH, me një institucion i cili ka një përfaqësues në KA të ASQSH.

Institucioni i fundit që ka dy anëtarë në KA të ASQSH, që është Këshilli i Qarkut Shkodër (KQSH) nuk ka asnjë informacion reciprok me SRSH.

Kjo situatë nuk i është raportuar MSH, në korespondencat me të. Janë 361 shkresa nga SRSH drejt MSH dhe 361 shkresa nga MSH për SRSH, ku në asnjë prej tyre nuk relatohet për mosmbledhjen e KA, dhe kompetencën e MSH për të mbledhur sipas ligjit nr. 9106, KA, sipas nenit 15, pika 2.

Është detyrë funksionale e ZDE që si Sekretar i KA, të fillonte procedurat për të njoftuar anëtarët e përcaktuar nga ligji për në KA, dhe MSH, të kërkonin mbledhjen e jashtëzakonëshme. Çdo mbledhje, në kushtet e mosmbledhjes së këshillit, do të ishte mbledhje e parë. Mbledhja e parë sipas ligjit nr. 9106 thirret nga DE. Detyrat e ZDE, si sekretar i KA, përveç ligjit organik, përcaktohen edhe nga ligji i përgjithshëm ligji nr. 8480. Përmbledhur sqarojmë 3 mënyrat që duhej të ishte thirrur KA i ASQSH:

- Si mbledhje e parë nga Drejtori Ekzekutiv.
- Si mbledhje e jashtëzakonëshme nga Ministri i Shëndetësisë.
- Si mbledhje e jashtëzakonëshme nga më shumë se ½ e anëtarëve.

Të tre këto “thirrje zhbllokuese” të mbledhjes, pas konstatimit nga Sekretari i KA, dhe infomimi përkatës drejt institucioneve. Në çdo rast thirrja për mbledhje ju shkon institucioneve përbërës të KA, në rrugë zyrtare. Por, për aq kohë

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

ftesa për mbledhje nuk egziston, nuk mund të flitet për mosmbledhje të arsyeshme të KA në SRSH, për periudhën nën auditim Janar 2015 – Dhjetor 2017. Sipas strukturës së vitit 2016 të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorave. Në fakt, ligji organik specifikon përbërjen e Drejtorisë së SRSH, si më poshtë:

- Drejtori Ekzekutiv
- Zv. Drejtori Ekonomik.
- Zv. Drejtori Teknik.
- Kryeinfermieri i Përgjithshëm.

Ligji 9106, në nenin 18 pika 2 specifikon se, **Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.**

Ky ndryshim në emertesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet mund të hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emertesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese, të SRSH, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas ligjit të Menazhimit Financiar dhe Kontrollit, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, që në rastin e ndryshimit të emërtesave, pa VKM, ky pozicion nuk egziston. Dy emërtesat ZDE dhe ZDT janë ndryshuar respektivisht në Zëvendës Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Zëvendës Drejtor i Shërbimeve Klinike. Është evidentuar gjatë auditimit se për periudhën 10.02.2014 deri në 18.05.2015 janë paguar dy ZDT, sipas strukturës së MSH, por pa VKM. Sipas përcaktimit ligjor sipërcituar, struktura e administratës së SRSH, përcaktohet me VKM. Kjo gjë përforcohet edhe me nenin 52 pika 1 e ligjit nr. 9106. KMj si strukturë këshilluese e Drejtorisë së SRSH, nuk provon me shkresa zyrtare, të jetë mbledhur në periudhën nën auditim. Përbërja e tij përcaktohet sipas ligjit nr. 9106. Në të bëjnë pjesë Drejtorat e Spitaleve që funksionojnë brenda ASQSH dhe Shefat e Shërbimeve, ose të autorizuarit nga shërbimet e vetë spitaleve. Në këtë pikë, evidentohet se ASQSH, ka nën vartësinë e vet, nëpërmjet KA spitalet e Qarkut Shkodër. Këta spitale janë:

- SRSH.
- Spitali Bashkiak Koplík.
- Spitali Bashkiak Pukë.

Kjo vërtetohet si nga ligji nr.9106 në nenet 14 dhe 20, por edhe nga organigrama e vartësisë së spitaleve në MSH.

Arsye kjo që tregon, se KMj ka si anëtar të vet gjithë shefat e shërbimeve në të tre spitalet sipërcituar dhe drejtorat respektiv. Nga auditimi rezultoi se mosmbledhja e KA, reflekton negativisht edhe në emërimin e drejtuesve të Spitaleve Pukë e Koplík. Këtë detyrë a ka KA, me propozim të DE të SRSH. Në fakt, emërtesa e tyre është bërë nga MSH, sipas Udhëzimit Nr. 412 datë 12.10.2017 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (MSHMS), por në kundërshtim me ligjin nr. 9106.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

VKM-ve që MSHMS ju refrohet vlejnjë për shërbimet parësore dhe terciare në sistemin shëndetësor që sipas organogramës në MSHMS janë;

1. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë.
2. Instituti i Shëndetit Publik
3. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
4. Qendra Kombëtare e Mirërritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve
5. Klinika Stomatologjike Universitare
6. Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter
7. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
8. Oficina Elektro Mjekësore
9. Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
10. Klinika e Shërbimeve Shëndetësore (Qeveritare)
11. Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim
12. Drejtoritë e Shëndetit Publik (11 rajonale dhe 24 rrethi) 35 gjithsej
13. Spitalet psikiatrike (Vlorë, Shkodër, Elbasan)

Sipas organogramës së MSHMS, as SRSH Spitalet Bashkiak të Pukës dhe Koplikut, nuk janë organe vartësie të ministrisë së linjës. Ligji nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, e ezauron në formë shteruese këtë vartësi.

Rregullshmëria e emërimit nga MSHMS të dy drejtuesve të spitaleve Pukë e Koplík përcaktohet nga Kodi i Procedurës Administrative (i ndryshuar):

Kjo emërtesë, nuk i heq të drejtën pas mbledhjes, KA të rivendos ligjshmërinë në këto emërtesa.

Struktura këshillues e KA është Komiteti për Planifikimin Spitalor Publik të Qarkut Shkodër (KPSPQSH), përbërjen e të cilit e përcakton KA konform nenit 40 të ligjit nr. 9106, së bashku me detyrat dhe mënyrat e funksionimit.

***Sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.14, datë 30.03.2018.***

**Observacion 1.** Z T.M., në obsevacionin e tij me e-mail, sqaron se “Në lidhje me konstatimet e gjetura sqarojmë se në SRSH, ka shumë vite që ka funksionuar në këtë mënyrë, pa një Këshill Administrativ dhe pa një rregullore të miratuar nga Ministria. Për këtë problem janë bërë takime të shpeshta edhe në MSH dhe nga ana e tyre vazhdimisht na është thënë se do të zgjidhet ky problem, por siç e keni konstatuar edhe ju vetë ky problem nuk është zgjidhur dhe vazhdon edhe aktualisht të jetë i pazgjidhur. Kërkojmë që të mos ngarkoni me përgjegjësi ish-punonjës ose punonjës aktual të këtij spitali për një gjë të tillë pasi siç ju e dini kjo gjë është në kompetencë e MSH dhe i kalon caqet e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

mundësive të SRSH. Për sa më tepër, kërkojmë që të mbahet parasysh nga ana juaj në hartimin përfundimtar”

**Lidhur me observacionin 1.** Duke e vlerësuar maksimalisht pikëpamjen e Z.M. për të shfaqur këtë sqarim, me keqardhje pranojmë se ky observacion nuk merret parasysh. Personalisht, Z. ish-Drejtor nuk ka asnjë shkresë zyrtare mbështetëse, që të provoj për sa kërkon. Më konkretisht, nuk ka asnjë thirrje për mbledhje të KA, ose informacion zyrtar të periudhës në auditim, ose më herët, se ai ka komunikuar me MSH, për këtë problem. Nuk ka asnjë dokument provues se ju është drejtuar organeve përbërëse të këtij këshilli, siç janë Prefektura Shkodër, Këshilli i Qarkut Shkodër, Këshilli Bashkiak Shkodër, Predidentit të Urdhërit të Mjekut të Qarkut Shkodër, Drejtorit të FSDKSH Shkodër, të cilët janë përgjegjës për formimin e KA. Ndonëse ky mund të duket një problem formal, pasojat e tij janë jo të vogla. Z. ish-Drejtor, është në dijeni të Ligjit 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”, neni 19, pika e, ku thuhet se “(Drejtori) drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit ekonomik dhe financiar dhe i paraqet për miratim në KA buxhetin e zëbërthyer për çdo spital, shërbim e repart”. Pra mosmbledhja e KA, rrjedhimisht ka lënë pa buxhet të miratuar SRSH. Natyrshëm lind pyetja se si ka punuar SRSH, pa një buxhet të miratuar në formën dhe frymën e ligjit, në gjithë periudhën nën auditim, nga të gjithë drejtuesit?

I njëjti vlerësim jo pozitiv rezervohet edhe për pagesën e 2 nën Drejtorave teknik, mungesën e funksionimit të Këshillit Mjekësor si edhe mungesa e një rregullore të funksionimit të brendshëm, të cilën duhet ta hartonte SRSH, e më pas miratonte MSH. Mungesa e kësaj rregullore, krijonte mundësinë e një funksionimi kaotik të SRSH.

**Observacion 2.** Z. S.Y., ish-Drejtor, në observacionin e tij me Prot. Nr. 1243, datë 10.04.2018 të SRSH sqaron: - “Problemet e trajtuara në akt-konstatim nr. 14 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimet e tyre” dhe në akt-konstatimin nr. 15 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimet e tyre”, nuk duhen adresuar në adresën time, pasi afati kohor i ushtrimit të detyrës si Drejtor i Spitalit, ka qenë tepër e shkurtër dhe e pamundur t’ju jepet zgjidhje funksionale këtyre problemeve.

**Lidhur me observacionin 2.** Është e saktë që Z.Y. nuk ka ushtruar detyrën për një kohë të gjatë, por po aq e saktë është që dy prej detyrave të shumta të tij në funksion të vendim marrjes janë; 1. njohja e strukturës drejtuese dhe vartëse dhe 2. Përdorimi i buxhetit në kushtet e përputhshmërisë ligjore. Ky observacion merret me shumë rezervë në konsideratë, pasi nuk jep bindjen e qëndrueshme të pamundësisë kohore, për të përmbushur detyrat ligjore.

**Observacion 3.** Z. V.M., Drejtor Aktual në observacionin e tij Prot. nr. 1251, datë 10.04.2018 të SRSH, sqaron; -“Në lidhje me akt-konstatimin nr. 14, “Zbatimi i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese në SRSH”, për arsye të kohës së shkurtër të ushtrimit të detyrës në rolin e Drejtorit Ekzekutiv të SRSH, nuk ka qenë i mundur realizimi i detyrave të konstatuara në këtë dokument”

**Lidhur me observacionin 3.** Ky observacion ende nuk mund të merret në konsideratë, sepse nuk jep garanci për

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*krijimin e bindjes së arsyeshme, se ka qenë afati kohor pamundësia e funksionimit të organeve drejtuese. Fakti i vijueshmërisë së detyrës, edhe pas afatit auditues, në kushtet kur situata mbetet e pandryshuar, nuk jep siguri absolute se parregullsitë kanë ardhur për efekt kohor. Mosthirrja e mbledhjes së KA në një prej tre mundësive ligjore të evidentuara në akt-konstatim 14, rrjedhimisht lë përsëri për vitin 2018 SRSH, pa buxhet të miratuar, sikundër sqarohet në opinionin mbi observacionin 1, të Z. Y.*

Drejtorat Ekzekutiv kanë marrë vendime që ju takojnë Këshillit Administrativ (KA), në rastin e pranimin të donacioneve nga shoqëri tregëtare dhe organizata bamirëse, mbi dhurimet e ambulancave e medikamenteve, si edhe ushqimeve. Njëherazi kanë nisur procedura të vlerësimit të asetëve private, brenda territorit të SRSH, pa autorizim të ligjit.

Drejtoria për pranimin e donacioneve ka ngritur komision për ndihmat dhe dhurimet. Kjo e drejtë i takon KA. Lëvizja e medikamenteve të SRSH, sipas urdhërave të MSH, nga spitali drejt institucioneve shëndetësore, institucioneve shtetërore dhe në farmacitë e spitalit nuk provon të jetë administruar sipas nevojave të shprehura të SRSH.

Rregullat e funksionimit të brendshëm në SRSH, nuk janë të përcaktuara me një rregullore funksionimi të brendshëm. SRSH ka patur një rregullore funksionimit të spitalit, aprovuar në 06.01.1998. Rregullore e cila parashikonte që organet drejtuese të spitalit ishin:

- a. Këshilli administrativ i përbërë nga 11 persona.
  - b. Drejtoria, e përbërë nga Drejtori Ekzekutiv (DE), Zëvendës Drejtori Teknik (ZDT), Zëvendës Drejtori Ekonomik (ZDE), Kryeinfermieri i Përgjithshëm.
  - c. Komisioni Mjekësor (KMj) i Spitalit, i paspecifikuar në numër.
  - d. Këshilli Tekniko-Administrativ, i paspecifikuar.
- Më vonë me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në RSH” përcakton ndryshime të reja, për funksionimin e strukturave drejtues, e për rrjedhojë e bëjnë të papërdorëshme rregulloren e vitit 1998. Ligji 9106 përcakton:
- e. Këshilli Administrativ (KA) i përbërë nga 8 persona.
  - f. Drejtoria (e njëjtë si në rregulloren e miratuar në 06.01.1998).
  - g. Komisioni Mjekësor i spitalit i përbërë nga drejtorat e spitaleve, shefat e shërbimeve, ose përfaqësues të zgjedhur prej tyre, pra një numër i caktuar.
  - h. Komisioni i Planifikimit Spitalor të Qarkut.

SRSH hartoi një rregullore të re, me të cilën funksionon institucioni. Kjo rregullore e funksionimit teknik, mban prot. Nr. 882 datë 19.09.2011, hartuar nga Kryetari i Komisionit Mjekësor të SRSH.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Por, përcaktimi i ligjit 9106, është se rregullorja e funksionimit të brendshëm e SRSH, duhet të miratohet nga MSH. Për këtë arsye, kjo rregullore nuk është e zbatueshme. DE sipas rekomandimeve të KLSH, ka krijuar një grup pune për hartimin e rregullores së re të funksionimit. Duke qenë se ligji 9106, ngarkon me përgjegjësi KMj për këshillimet teknike, dhe në kushtet kur rregullorja teknike është akti më i lartë teknik i SRSH, ky grup është i paplotë. Në të nuk përfshihen të gjithë përfaqësuesit e KMj, të përcaktuar në ligj.

Ky organ, KMj, nuk ka një vendim nga ana e DE për një rregullore të funksionimit të këtij organi këshillues. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9106, DE miraton rregulloren e funksionimit të KMj. Ky këshill është konsultativ i Drejtorisë.

Organi konsultativ i ASQSH, është Komiteti i Planifikimit Spitalor Publik i Qarkut Shkodër (KPSPQSH), të cilit përberjen dhe rregullat e funksionimit të tij ja përcakton KA i ASQSH. Ky organ nuk funksionon në SRSH.

DE në përcaktimin e nëpunësit zbatues nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo detyrë i takon ZDE të SRSH, por aktualisht, detyra e nëpunësit zbatues i është caktuar Përgjegjësit të Sektorit të Financës.

Marrëdhëniet e punës konform ligjit nr. 9106 i përfaqëson DE i SRSH. Gjatë auditimit mbi respektimin e Urdhërit të MSH, për strukturat e SRSH, u **auditua me për zgjedhje vetëm një procedurë e pushimit nga puna, efektive datë 06.04.2016.**

**Në datën 21.03.2016** SRSH ka nisur njoftimin për 66 punonjës, përkatësisht me protokoll Nr. 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 472/1, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 487, 488, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517, 518, 519, 520.

Këta punonjës njoftohen se referuar neneve 143, 144, 153, 154 të Kodit të Punës, do t’ju ndërpriten marrëdhëniet e punës, sikundër citojnë shkresat me Prot. Nr. si mësipër.

Ministria e Shëndetësisë, krahas shkresës 253 që është Urdhëri i MSH, ka bashkëngjitur Udhëzimin Nr. 13, datë 15.01.2016 të Ministrisë të Shëndetësisë ku duhej të mbështetej SRSH lidhur me:

- Kryerjen e procedurave për ristukturimin.
- Kriteret bazë për ristukturimin.
- Arsimi.
- Performanca në punë.
- Sjellja e punonjësve në pozicionin përkatës.

**Sipas këtij udhëzimi, ngarkohej Drejtuesit e spitalit rajonal për zbatimin e këtij udhëzimi, dhe ata të raportojnë çdo javë në Ministrinë e Shëndetësisë.** Në ndjejeje të këtij udhëzimi, u verifikua Libër Protokollit i vitit 2016, ku nuk ka informacion javor për zbatimin e udhëzimit Nr. 13, nga **Drejtuësi i SRSH.** Nuk gjendet procedurë e ndërmjetme vlerësimi të

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

kritereve, arsimit, performancës të punonësve përgjatë procesit të ristrukturimit, mbledhje të protokolluara me punonjësit, apo sindikatës përfaqësuese të tyre.

Referuar Libër Protokollit të SRSH, nuk ka asnjë shënim mbi këto mbledhje, dhe as korespondencë ku të jetë njoftuar MMSR. Nuk gjendet asnjë korespondencë e mëvonëshme e SRSH me sindikatën, që t’ju bëjë me dije njoftimin ndaj MMSR, apo MSH për infomacionin javor të kërkuar nga ministria e linjës.

-Kjo krijon bindjen e arsyeshme se SRSH nuk ka njoftuar punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji. Bindja vërtetohet se, nuk gjendet asnjë dokument arshivor se si është proceduar me kriteret e kërkuara nga MSH, apo personat përgjegjës që duhej të merreshin me vlerësimin e punonjësve sipas kritereve, në kushtet kur SRSH, nuk ka një rregullore të brendëshme funksionimi, e cila mund të krijonte mundësinë e vetë funksionimit të SRSH, pa urdhëra të brendshëm.

-Pas daljes së 66 njoftimeve të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, u verifikua se në Libër Protokollin Mod. 1 e SRSH, nuk kishte firma të personave të njoftuar se kishin marrë njoftim.

U auditua protokollin i brendshëm mbi këta 66 persona dhe mënyrat e njoftimit. Protokollin i brendshëm, nuk përmbushte kushtet e Mod 4/1 për të treguar sektorin që niste dokumentacionin dhe kujt i adresohet. Në shumë raste, njoftimi për punonjësi i ishte dorëzuar personave epror të shërbimeve, apo reparteve të SRSH, që nuk përmbush kushtin e arsyeshëm se punonjësit janë njoftuar.

**Në datën 04.04.2016**, SRSH njofton me shkresë Prot Nr. 602 dhe 603 dy punonjës, që pas mbarimit të lejes së zakonëshme nuk janë paraqitur në punë. Kjo procedurë mund të konsiderohet si zgjidhje individuale e kontratës së punës, por sipas Kodit të Punës, këto pushime janë brenda periudhës 90 ditore, të një pushimi kolektiv, dhe janë përfitues të zgjidhjes së kontratës në mënyrë kolektive.

Në datën 06.04.2016 vijon shkëputja e marrëdhënieve të punës për 43 punonjës, nga 66 të njoftuar në datën 21.03.2016. Punonjësit njoftohen me shkresat: Prot 644, 645, 646, 647, 648, 649, 650, 651, 652, 653, 654, 655, 656, 658, 659, 660, 661, 662, 663, 664, 665, 666, 667, 669, 670, 671, 672, 673, 674, 675, 676, 677, 678, 679, 680, 681, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 689.

Në njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk është përdorur protokollin Mod. 1, por protokollin i brendshëm, i cili si në rastin e njoftimit të procedurës, është i firmosur disa herë nga i njëjti person për llogari të vartësve, firma të pakuptueshme, refuzim firme dhe vende të pafirmosura. Mungojnë procedurat e ndërmjetme që SRSH ka patur sipas Libër Protokollit dhe arshivës, se si ka njoftuar punonjësit, sindikatën, MMSR, MSH dhe si ka mbërritur në konkluzionin se nga 66 punonjës të njoftuar, vetëm 43 përmbushin kushtin për largim nga puna, ndërsa 23 të tjerë mund të vazhdojnë marrëdhëniet e punës.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**Afati prej 21.03.2016 deri në 06.04.2016, është 16 ditë** por ndryshimet në Kodin e Punës në vitin 2015 përcaktojnë të tjera afate. Ky afat njoftimi vlen vetëm për të punësuarit nën 6 muaj sipas nenit 143 pika 1, por afatet e njoftimit sipas vjetërsisë në punë shkojnë 1 muaj për 6 muaj deri në 2 vjet vjetërsi, 2 muaj për 2-5 vjet vjetërsi, dhe 3 muaj mbi 5 vjet vjetërsi në punë.

Pra SRSH, nuk argumenton në formë shkresore se ka njoftuar punëmarrësit, sindikatën, MSH, MMSR, por, dhe as ka zbatuar afatet minimale të njoftimit, as ka zbatuar Udhëzimin e ministrit për metodën e përzgjedhjes së punonjësve që ju ndërpritet marrëdhënia e punës.

Në përfundim të largimit të 45 punonjësve vetëm në datën 06.04.2016, SRSH nga Janar 2016 kur u njoftua për strukturën e re nga MSH, duhej të kishte numrin e punonjësve  $784 - 45 = 739$  në Prill 2016. Nga struktura e miratuar prej 711 punonjësish, por në Qershor 2016, SRSH në fondin e pagave ka 767 punonjës, ose  $767 - 739 = 28$  punonjës të rinj. Pra një institucion, që në reformim e sipër njëherazi heq dhe punëson punonjës, krijon bindjen e arsyeshme të selektivizmit të punonjësve, sipas normave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komunikimet e SRSH me Urdhërin e Infermierit, Qendrën Kombëtare të Urgjencës, Qendrën e Edukimit në Vazhdim, për trainimin e punonjësve, që është detyrë e DE, si për stafin me arsim të lartë dhe atë me arsim të mesëm, përbënin një korespondencë të rregullt.

Nga auditimi me përzgjedhje mbi pozicionet që përveç arsimit, kanë nevojë edhe për trainim specifik, u përzgjedh Shërbimi i urgjencës. Në këtë shërbim ka 10 mjek dhe 47 infermierë. Ky staf ka përballuar një ngarkesë mjeksore prej:

- 24365 pacientësh në vitin 2015.
- 64388 pacientësh në vitin 2016.
- 55773 pacientësh deri në tetor 2017.

Ky shërbim ka një specifik të veçantë në skemën e shërbimit spitalor, e cila rregullohet me një ligj të veçantë, “*Për shërbimin e urgjencës*”, i cili në Kreun III, specifikon “Profesionistët e shërbimit të urgjencës”. Në të, detajohen kushtet që duhet të përmbushi mjeku i shërbimit të urgjencës, infermieri i shërbimit të urgjencës, personeli ndihmës i shërbimit të urgjencës, paramedikalët, dhënësit e ndihmës së parë mjeksore.

Auditimi i ushtruar në shërbimin e urgjencës, për specialitetin “Infermier”, në materialin e SRSH, nuk gjeti në evidencë nënspecialitet të lidhur me urgjencën mjeksore. Për këtë arsye u audituan 2 dosje me përzgjedhje. Infermierët D.M. i datëlindjes 1957, me profesion infermier, arsim i lartë. V.V. i datëlindjes 1991 me profesion infermier dhe leje të ushtrimit të profesionit infermier, me arsim të lartë. Në dosjet e tyre nuk u gjet trainim apo kualifikim specifik për urgjencën mjeksore.

Nga ana tjetër SRSH nuk i është drejtuar me ndonjë dokument Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim të Punonjësve të Shëndetësisë (QKEVPSH). Kjo qendër është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 825 datë 14.05.2008 “Për krijimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare të edukimit në vazhdim të punonjësve të shëndetësisë dhe për një shtesë në

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Vendimin nr. 306 datë 27.06.2002 të Këshillit të Ministrave (QKEVPSH)” botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 108 viti 2008 faqja 4780.

Në materialin arshivor, në vitet 2015-2017, objekt auditimi, u vu re se trajtimi i personelit infermier i urgjencës mjekësore, nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 8480 “Për shërbimin e urgjencës”, por vetëm në lidhje më ligjin nr. 9106, “Për shërbimin spitalor”.

QKEVPSH përgjatë periudhës auditues ka patur korespondenca me SRSH, por nuk vërtetohet se nga ana e SRSH t’i jetë bërë me dije mungesa e trainimeve për këtë shërbim. E njëjta gjë vlen edhe për komunikimin me Urdhërin e Infermierit, ku nuk rezulton se nga ana e SRSH të jetë shtruar për diskutim mungesa e trainimit të infermierëve për shërbimin e urgjencës.

## **2. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.**

*Objekti i këtij akt verifikimi është:*

**A) Auditimi me zgjedhje i rregullshmërisë së kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda e jashtë vendit sponsorizime, etj).**

Nga auditimi mbi rregullaritetin e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare dhe magazinës, rezultoi se:

Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin përkatës të veprimeve të kryera me arkë rezultoi se ditari i arkës ishte i rakorduar dhe nënshkruar prej arkëtarit, regjistrimet janë bërë në mënyrë kronologjike, duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen në librin e arkës, gjithashtu për të ardhurat e arkëtuara janë prerë mandat arkëtimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës si dhe janë prerë mandat pagesat përkatëse. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për transaksionet bankare për shpenzimet e kryera për vitin 2015, për vitin 2016 si dhe per vitin 2017, rezultoi se Spitali Rajonal Shkoder ka kryer shpenzime me vlera të ndryshme, kryesisht për materiale kancelarie, shtypshkrime, shërbim interneti, mirëmbajtje, blerje medikamentesh, ushqime për nevoja të Spitalit Rajonal Shkoder etj. Gjithashtu rezultoi se shumica e shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës janë pagesat e stafit si dhe sigurimet shoqërore. Për sa i përket transaksioneve të sipër përmendura dhe veprimeve kontabël rezultoi se janë kryer në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 si dhe ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*-Nëpërmjet bankës nuk janë likuiduar shpenzime për udhëtime jashtë vendit.*

Nga auditimi konstatohet se Spitali Rajonal shkoder nuk ka likuiduar shpenzime per udhtime jashte vendit. Spitali rajonal Shkoder ka paguar, kryer shpenzime udhtimi brenda vendit ne vlera per vitin 2016, 136,172 leke , per vitin 2017, 535,075 leke. “Te gjitha shpenzimet e kryera nga Spitali Rajonal Shkoder per shpenzime udhëtimi e dieta për shërbime brenda vendit si edhe për periudhën, ku në të gjitha rastet veprimet janë në përputhje me VKM me nr. 329, datë 20.4.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit ”.

Për shpenzimin për karburant nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se pjesa më e madhe e lëvizjeve të autoambulancave dhe automjeteve janë lëvizje urbane ku në dosjen e përgjegjëses për karburantin është e dokumentuar çdo lëvizje dhe arsyeja e kryerjes së saj. Ka dhe lëvizje interurbane ku autoambulancat shkojnë në drejtim të Tiranës për shoqërim pacientësh në QSUT. Në dosje është kërkesa e mjekut përkatës për shoqërimin e pacientit, fletë udhëtimi i firmosur nga drejtuesi i mjetit, dhe urdhri i Drejtorit për autorizimin e kryerjes së kësaj lëvizjeje.

Mënyra e shpërndarjes së karburantit bëhet nëpërmjet sistemit elektronik dhe jo me tollona për naftën, pasi çdo shofer ka në dispozicion kartën elektronike. Pas kërkesës nga mjeku për kryerjen e shërbimit përgjegjësja për karburantin i furnizon me naftë në sistemin elektronik shoferit përkatës të automjetit. Sasia ndryshon në bazë të vendit të shërbimit dhe në bazë të normës së konsumit për çdo automjet.

*-Nëpërmjet bankës janë kryer pagesat mujore të telefonisë fikse.*

Spitali Rajonal Shkoder për periudhën e audituar ka lidhur kontratë me kompanine A. Kjo kompani kryen shërbimet e saj telefonike vetëm për telefonat fikse që ndodhen në SRSB ( si tek urgjenca, pediatria, patologjia etj ) ku më saktë jane shpenzuar per vitin 2015 ,221,911 leke per vitin 2016 195,756 leke per vitin 2017 100,607

Më poshtë janë paraqitur disa urdhër shpenzime të audituar :

-Urdhër shpenzimi nr.168, datë 15.05.2015 blerje materiale te ndryshme në vlerën 49,320 lekë për llogari të operatorit ekonomik “A” shpk. Disponohet faturë me TVSH nr.31 ,datë 28.04.2015 flete hyrje nr. 31 date 28.04.2015, procesverbali i marrjes ne dorezim me datë 28.04.2015 për llogaritjen e fondit limit, urdhër prokurimi nr.11 prot.916, datë 24.04.2015, procesverbal date 28.04.2015 për shpalljen e fituesit.

- Urdhër shpenzimi nr.222, datë 03.07.2015 për blerje medikamente per llogari te firmes “K” në vlerën 399,000 lekë. Disponohet autorizim per lidhje kontrate nr. 2486/1 date 22.05.2015, kontrate nr. 1225 date 05.06.2015, faturë me TVSH nr.113 më datë 05.06.2015, flete hyrje nr. 113 date 05.06.2015, Proces Verbali i marrjes ne dorezim 05.06.2015.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Urdhër shpenzimi nr.314, datë 10.09.2015 siguracion makinash në vlerën 25,000 lekë për llogari të operatorit ekonomik “Instituti i Sigurimeve” sh.a. Disponohet faturë me tvsh nr.13, datë 14.08.2015 dhe numër serial 09730063, proces verbal i marrjes ne dorezim date 14.08.2015, urdher prokurimi numer 1652 date 12.08.2015, njoftimi i fituesit date 15.08.2015.
- Urdhër shpenzimi nr.418 , datë 13.11.2015 për blerje materiale te ndryshme në vlerën 69,480 lekë për llogari të “Q e N” me nipt LB. Disponohet faturë nr.39, datë 27.10.2015, flete hyrje nr. 16,17 date 27.10.2015, kërkesë nga Sektori i Hotelerise për blerjen e materialeve te ndryshme, urdhër i brendshëm me nr.147 prot., datë 09.10.2015 për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike, urdhër prokurimi nr.41 prot., datë 26.10.2015, proces verbal i marrjes ne dorezim datë 27.10.2015, formulari nr. 5 date 27.10.2015.
- Urdhër shpenzimi nr.155, datë 18.05.2016 blerje pluhur lares në vlerën 390,000 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ S G” shpk. Disponohet faturë me TVSH nr.35, datë 20.04.2016, flete hyrje nr. 3 date 20.04.2016, proces verbal i datës 20.04.2016, kerkese e sektorit te hotelerise nr. 366 date 07.03.2016, urdher i brendshem per perlllogaritjen e fondit limit nr. 28, date 06.04.2016, urdher prokurimi nr. 30 date 12.04.2016, njoftimi i fituesit date 18.04.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.219 ,datë 06.07.2016, “Blerje filma per skaner” në vlerën 368,640 lekë për llogari të operatorit ekonomik “S M” shpk. Disponohet fatura nr. 177 date 17.06.2016, flete hyrja nr.122, datë 17.06.2016, proces i marrjes ne dorezim date 17.06.2016, urdher prokurimi nr. 39 date 12.05.2016, formulari i njoftimit te kontrates date 12.05.2016, formulari i njoftimit te fituesit nr. 1314 date 09.06.2016, formulari i njoftimit te fituesit ne “APP” date 13.06.2016.
- Urdhër shpenzimi nr. 220 ,datë 06.07.2016, “Blerje ushqime” në vlerën 624,016 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ L” sh.p.k. Disponohet udher prokurimi nr. 38 date 04.05.2016, njoftim fituesi date 09.05.2016, kontrata nr. 949 date 09.05.2016, fatura nr. 24 date 19.05.2016, flete hyrja nr. 6 date 19.05.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 19.05.2016, fatura nr. 31 date 31.05.2016, flete hyrja nr. 7 date 231.05.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 31.05.2016, fatura nr. 106 date 06.06.2016, flete hyrja nr. 8 date 06.06.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 06.06.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.284, datë 18.08.2016 ,”Inspektim i eneve nen presion” për vlerën 109,080 lekë për llogari të operatorit ekonomik “E P” sh.p.k. Disponohet kerkese e deges teknike per kontrollin teknik te eneve nen presion nr.1589 date 04.07.2016, urdher i brendshem nr. 109 date 04.07.2016, argumentim i fondit limit nr. 1658 date 11.07.2016, urdher prokurimi nr.56 date 12.07.2016, njoftimi i fituesit date 13.07.2016, fatura nr. 426 date 29.07.2016, situacioni date 29.07.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim 29.07.2016
- Urdhër shpenzimi nr.317, datë 20.09.2016, “Blerje doreza ekzaminimi” në vlerën 103,200 lekë për llogari të operatorit ekonomik “SLM” shpk me Nipt K B. Disponohet urdher i brendshem nr. 138 date 25.08.2016, perlllogaritje e fondit limit nr.2109 date 29.08.2016, urdher prokurimi nr.66 date 01.09.2016, njoftimi i fituesit date 02.09.2016, fatura nr. 966 date 06.09.2016, Fletë Hyrje me nr.195, datë 06.09.2016, proces i marrjes ne dorezim date 06.09.2016.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Urdhër shpenzimi nr.318, datë 20.09.2016, “Blerje medikamente” në vlerën 99,600 lekë për operatorin ekonomik “I” shpk. Disponohet urdheri i ministrit nr.36 date 29.01.2016, urdher prokurimi nr.61 date 15.08.2016, njoftimi i fituesit date 18.08.2016, fatura nr. 49655 date 29.08.2016, flete hyrja nr. 191 date 29.08.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 29.08.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.406, datë 09.11.2016 blerje lende djegese në vlerën 1,994,424 lekë për llogari të operatorit ekonomik “R” sh.p.k. Disponohet autorizim per lidhje kontrate nr.7/7 date 05.05.2016, kontrate nr.1535 date 30.06.2016, fature nr. 385 date 11.10.2016, flete hyrja nr.1 date 11.10.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 11.10.2016, fature nr. 336 date 12.10.2016, flete hyrja nr.2 date 12.10.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim 12.10.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.422, datë 23.11.2016 “Blerje ushqime” në vlerën 236,294 lekë për llogari të operatorit ekonomik “D SH” sh.p.k. Disponohet Fatura nr. 443 date 31.10.2016, flete hyrje nr.13, datë 31.10.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 31.10.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.482, datë 15.12.2016 “Blerje shiringa per skaner” në vlerën 111,000 lekë për llogari të operatorit ekonomik “S M” sh.p.k. Disponohet kerkesa e sherbimit te radiologjise nr. 2729 date 10.11.2016, urdher i brendshem per perllogaritjen e fondit limit nr. 181 date 11.11.2016, argumentim fondi nr. 2738 date 11.11.2016, urdher prokurimi nr. 96 date 13.12.2016, formulari nr. 5 date 13.12.2016, fatura nr. 341 date 13.12.2016, flete hyrja nr. 262 date 14.12.2016, proces verbal i marrjes ne dorezim date 14.12.2016
- Urdhër shpenzimi nr. 40 datë 16.02.2017 “Blerje medikamente” në vlerën 100,111 lekë. Disponohet urdher prokurimi nr. 89 date 13.01.2017, kontrata shtese nr. 117, 118 date 16.01.2017, faturat nr. 152, 153 date 16.01.2017, fletë hyrje me nr. 4, 5 date 16.01.2017, proces verbal i marrjes ne dorezim date 16.01.2017.
- Urdhër shpenzimi nr. 100, datë 20.03.2017 “Blerje shtypshkrime” në vlerën 257,606 lekë për llogari të operatorit ekonomik “R G” sh.p.k. Disponohet urdher prokurimi nr. 280 date 30.01.2017, kontrate shtese nr. 474 date 09.12.2017, fature nr. 18, 19 date 09.03.2017, flete hyrje nr. 1, 2 date 09.03.2017, proces verbal i marrjes ne dorezim 09.03.2017
- Urdhër shpenzimi nr. 178, datë 12.05.2017 për “Blerje tonera” në vlerën 53,200 lekë për llogari të operatorit ekonomik “TIM”. Disponohet urdher i brendshem nr. 25 date 20.02.2017, perllogaritje e fondit limit nr. 609, date 20.02.2017, urdher i prokurimit nr. 21 date 28.03.2017, njoftimi i fituesit date 13.04.2017, fature nr. 57 date 13.04.2017, flete hyrje nr. 2 date 13.04.2017, proces verbal i marrjes ne dorezim date 13.04.2017.
- Urdhër Shpenzimi nr. 479, datë 04.10.2017 “Blerje ushqime” në vlerën 345,019 lekë për llogari të operatorit ekonomik “N” sh.p.k. Disponohet fatura nr. 197, 198 me date 19.09.2017, flete hyrje nr. 18, 19 datë 18.09.2017, proces verbal i marrjes ne dorezim date 18.09.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.493, datë 09.10.2017 “Blerje medikamente” në vlerën 583,800 lekë për llogari të operatorit ekonomik “I” sh.p.k. Disponohet urdher prokurimi nr.70 date 03.07.2017, formular i njoftimit te fituesit nr. 2028, date 12.09.2017,

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

formular i njoftimit të fituesit në “APP” datë 18.09.2017, kontrata nr. 2159, datë 29.09.2017, fatura nr. 19173 datë 02.10.2017, flete hyrje nr. 167, datë 02.10.2017, proces verbal i marrjes në dorezim datë 02.10.2017.

-Urdhër shpenzimi nr. 579, datë 04.12.2017 “Blerje materiale mjekimi” në vlerën 221, 880 lekë për llogari të operatorit ekonomik “B A” shpk. Disponohet shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë nr.895/2 datë 09.03.2017, kërkesa nr. 2318 datë 31.10.2017, argumentimi i fondit nr.65 datë 08.11.2017, urdher prokurimi nr. 2305 datë 10.11.2017, njoftimi i fituesit me datë 15.11.2017, fatura nr. 809 datë 16.11.2017, flete hyrje nr. 183 datë 16.11.2017, proces verbal i marrjes në dorezim 16.11.2017.

**B) Auditimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit:**

**I. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit për vitin 2015, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.**

Projekt buxheti për vitin 2015, është hartuar konform legjisllacionit të mësipërm dhe në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale dhe janë dorëzuar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dërguar për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2015 - 2017 në mënyrë elektronike dhe shkresore me nr. 1498 prot, datë 30.07.2014, brenda afatit.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2015 - 2017, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm.

**1. Çeljen e buxhetit të vitit 2015, detajimi i planit fillestar, zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.**

Çelja e buxhetit për vitin 2015 i referohet VKM Nr. 932, datë 29.12.2014 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor Referuar për sa më lart çelja e buxhetit të për vitin 2015 ishte planifikuar për 711,332 mijë lekë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2015, janë në rritje për zërin 602 në vlerë totale për 30.000 mijë lekë, më shumë se plani fillestar i specifikuar si më poshtë vijon:

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 29.07.2015 për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr 932 datë 29.12.2014. Në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, nr.46, është bërë miratimi i paksimit në buxhetin e vitit 2015 për 7000 mijë lekë nga të cilat:

-Llogaria 600 - Pagat të personelit të përhershëm për -6000 mijë lekë

-Llogaria 601 - Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për -1000 mijë lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nga Spitali ka kërkesë për shtesë fondi në zërin 602 mallra dhe shërbime dhe kërkesë për paksim fondi në zërin 600 paga dhe në zërin 601 sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

-Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 3350/3, datë 02.05.2014 “Akordimi i fondeve në zbatim të Vendimit nr. 50, datë 05.02.2014 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura” bëhet miratimi i shtesës prej 12,186, mijë lekë. Ky fond është akorduar nga fondi i kontigjencës.

-Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 4883/3, datë 07.12.2015 “Akordimi i fondeve në zbatim të Vendimit nr. 15, datë 09.01.2015 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura”, bëhet miratimi i shtesës së fondeve për 3.516.986 mijë lekë. Ky fond, është akorduar nga fondi i kontigjencës.

Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e fondeve buxhetore për llogaritë e shpenzimeve paraqiten si në tabelë:

*Ne 000 leke*

LLOG.	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	VKM 685	FSDKSH	FONDI KONTIGJENCES	606	PLANI PERFUNDIMTAR
600	Paga	437,568	-6000			<b>-1474</b>	430,094
601	Sigurime	72.572	-1000				71,572
602	Mallra e shërbime	201,192	30,000		6182		237,374
606	Raste Fatkeqesish fond i vecante					<b>+1474</b>	1474
	<b>TOTALI</b>	<b>711,332</b>	<b>23,000</b>		<b>6,182</b>		<b>740,514</b>
	Nr. Punonjësve	795					790

*Janë paksuar* në krahasim me çeljen artikujt 600-601 “Paga & sigurime shoqërore”, në vlerë -7000 mijë lekë,. *Janë shtuar* në krahasim me çeljen artikujt 602 “Mallra dhe Shërbime”, në vlerë 30,000 mijë lekë,.” Eshtë bërë shtesë dhe nga fondi i kontigjencës në vlerë 6182 mijë lekë dhe janë përdorur nga Spitali Shkodër për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**2.** Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Monitorimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel programi.

Gjatë vitit 2015, Spitali Rajonal Shkodër ka pasur një buxhet total prej 851,453 mijë lekë, i financuar nga buxheti i shtetit i ndarë në zëra:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Llogaria 600- Paga për personel të përhershëm për 430,094 mijë lekë
- Llogaria 601- Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 71,572mijë lekë
- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 237,374 mijë lekë
- Llogaria 230 - Projektme për 0 mijë lekë
- Llogaria 230,231- Investime dhe Ndërtime për 110,939 mijë lekë

Çdo muaj, Spitali Shkoder ka dërguar pranë “Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor” dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, “Situacionin e shpenzimeve dhe situacionin e të ardhurave”, progresive të planifikuara dhe realizuara, konfirmuar kjo nga Dega e Thesarit Tiranë.

Me shkresën nr. 82, datë 18.01.2015, të Spitalit Shkoder, është dërguar pranë DRSKSH Shkoder “Situacioni i Shpenzimeve dhe Situacioni e të ardhurave për periudhën Janar - Dhjetor 2015, i rakorduar me Degën e Thesarit. Tabela e mëposhtme tregon si janë shpenzuar këto të ardhura te detajuara nga ana e Spitalit Shkoder për vitin 2015.

Nr.	EMERTIMI	PLAN	FAKT
<b>600</b>	<b>PAGA, SHPERBLIME E SHPENZ. TJERA PERSONELI</b>	<b>430,093,880</b>	<b>429,169,198</b>
<i>6001</i>	<i>PAGA TE PERSONELIT TE PERHERSHEM</i>	<i>427,693,880</i>	<i>426,769,198</i>
<b>601</b>	<b>KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE SHOQERORE E SHENDETESORE(30.7%)</b>	<b>71,572,000</b>	<b>71,077,080</b>
60100	KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE	64,202,000	63,836,429
60110	KONTRIBUTE PER SIGURIMET SHENDETESORE (1.7 %)	7,370,000	7,240,651
<b>602</b>	<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	<b>231,192,000</b>	<b>220,738,933</b>
<i>6020</i>	<i>MATERIALE DHE SHERBIME ZYRE DHE TE PERGJITHSHME</i>	<i>2,041,804</i>	<i>1,706,778</i>
60201	KANCELARI	404,040	404,040
60202	MATERIALE PER PASTRIM, DISINFECTIM, NGROHJE DHE NDRIÇIM	371,676	371,676
60209	FURNIZIME DHE MATERIALE TE TJERA ZYRE DHE TE PERGJITHSHME	1,266,088	931,062
<i>6021</i>	<i>MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE</i>	<i>134,490,472</i>	<i>127,078,391</i>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

60210	UNIFORMA DHE TE TJERA VESHJE SPECIALE	0.00	1,655,220.00
60210	ILAÇE DHE MATERIALE MJEKESORE	128,389,3 10	120,908,021
60210	FURNIZIME DHE SHERBIME ME USHQIM PER MENCAT	6,084,362	6,084,090
60210	TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE	86,280	86,280
<b>6022</b>	<b><i>SHERBIME NGA TE TRETE</i></b>	<b>69,589,76 5</b>	<b>69,471,592</b>
60220	ELEKTRICITET	29744200	29,744,111
60220	UJE	26,167,62 0	26,167,620
60220	SHERBIME TELEFONIKE	222,999	221,911
60220	POSTA DHE SHERBIMI KORRIER	21,610	21,400
60220	SHERBIM PER NGROHJE	3,279,984	3,279,434
60220	SHERBIME TE SIGURIMIT DHE RUAJTJES	7,290,540	7,290,540
60220	SHERBIME TE PASTRIMIT DHE GJELBERIMIT	2,862,812	2,746,576
60220	SHERBIME TE TJERA	0.00	495,392.00
<b>6023</b>	<b><i>SHERBIME TRANSPORTI</i></b>	<b>5,441,887</b>	<b>5,439,386</b>
60231	KARBURANT DHE VAJ	4,399,953	4,397,452
60232	PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI	588,000	588,000
60233	SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE TE TRANSPORTIT	0.00	239,217.00
60239	SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI	453,934	453,934
<b>6025</b>	<b><i>SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME</i></b>	<b>15,032,84 6</b>	<b>13,516,096</b>
60253	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE NDERTIMORE IMPIANISTIKE	2,665,656	2,665,656
60255	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE VEGLAVE TE PUNES	11,366,78 0	9,907,640
60256	SHPENZIMEVE PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT	1,000,410	942,800
<b>6027</b>	<b><i>SHPENZIME PER DETYRIMEDHE KOMPENSIME LEGALE</i></b>	<b>3,041,190</b>	<b>3,041,190</b>
60274	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE VENDIMEVE GJYQSORE PER LARGIM NGA PUNA	1,198,984	1198984
60275	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE DETYRIMEVE KONTRAKTUALE	1,842,206	1,842,206

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

	TE PAPAGUARA		
6029	SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE	485,500	485,500
60294	SHPENZIME PER SIGURIMINE NDERTESAVE	485,500	485,500
<b>606</b>	<b>RASTE FATKEQESIE FONDI VECANT</b>	<b>1,474,120</b>	<b>1,474,120</b>
		<b>732,857,8</b>	
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>80</b>	<b>720,985,211</b>
	<b>NUMRI I PUNONJESVE</b>		

Tabela permbledhese në vijim paraqet përqindjen e realizimit të secilit prej zërave të buxhetit.

*Në mijë lekë*

3. Mbi  
e  
dhe

LLOG	ZËRAT E SHPENZIMEVE	PLANI	REALIZIMI	DIFERENCA	% REALIZIMIT
600	Paga	430,093	429,169	924	99.7
601	Sigurime shoqerore dhe Shendetesore	71,572	71,077	495	99.3
<b>602</b>	<b>Mallra dhe Sherbime</b>	<b>237,374</b>	<b>225,543</b>	<b>10,454</b>	<b>95</b>
606	Raste fatkeqsish fond i vecante	1,474	1,474	0	100
230,23					
1	Projektme, investime	110,939	106,898	4,041	96.3
	<b>TOTALI</b>	<b>851,452</b>	<b>834,161</b>	<b>15,914</b>	<b>98</b>

zbatimin  
krihereve

procedurave të hartimit të buxhetit me destinacion fondet e investimeve për vitin 2015, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.

Plani fillestar, ndryshimet e pësura gjatë vitit (pakësuar apo shtuar) si dhe plani përfundimtar i investimeve të financuara nga buxheti i shtetit për Spitalin Shkoder, për vitin 2015 paraqiten si vijon:

-Plani Fillestar i Buxhetit për Investime 7,160 mijë lekë.

-Ndryshime (Shtesa) në planin e Investimeve + 110,000 mijë lekë.

-Ndryshime (pikësime) në planin e Investimeve – 6,221 mijë lekë.

-Plani Përfundimtar i Buxhetit për Investime 110,939 mijë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, çelja, ndryshimet, plani përfundimtar si dhe realizimi i investimeve për vitin 2015, paraqiten si në tabelën e mëposhtme te detajuar.

*Në mijë lekë*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Situacioni i investimeve per vitin 2015 Plan-Fakt		
Plan	Fakt	Emërtimi i Projektit
7,000	2,979	Ri K. i ambienteve ku do te instalohet aparatura e angiografisene spshkoder
160	12	Super+ rikonsksion i ambienteve ku do te instalohet aparaturae angiografit ne sp shkoder
95,791	95,520	Furnizim vendosje enje aparature rezonance ne sp shkoder
8,218	8,218	Paisje per reanimacionin e pediatriise

Tabela përmbledhëse e 231

Me	LLOG	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	NDRYSHIME	PLANI TOTAL	REALIZIMI	% REALIZIMIT
	231	Investime/Ndërtime	7,160	116,221	110,939	106,730	96.2
		<b>TOTALI</b>	7,160	116,221	110,939	106,730	96.2

shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 241/1, datë 20.01.2015 “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2015 për shpenzimet kapitale (artikullin,231) në fushën e shëndetësisë” është bërë çelja e buxhetit për investime dhe detajimi i tij,

- a. Çelja e buxhetit për zërin 231 investime është për vlerën 7,160 mijë lekë që i takon rikonstrosionit ku do te vendoset aparatura e angiografise si dhe supervizori përkete objekt.

Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 3688/1, datë 06.08.2015 “Mbi transferimin e fondeve buxhetore per investime per vitin 2015 bazuar ne aktin normativ me nr 1prot, date 29.07.2015 behencelje ne artikullin 231 me vlere 110,000 mije leke

- a. Çelja e buxhetit për zërin 231 investime është për vlerën 110,000 mijë lekë që i takon furnizim vendosje e nje rezonance per sp Shkoder si dhe paisje per reanimacionin e pediatriise spitali Shkoder.

**II. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit për vitin 2016, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.**

Projekt buxheti për vitin 2016, është hartuar konform legjisllacionit të mësipërm dhe në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale dhe janë

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

dorëzuar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor me shkresën nr 1723 datë 20.07.2016, dërguar për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2016-2018 në mënyrë elektronike

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2016-2018, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm.

**1. Çeljen e buxhetit të vitit 2016, detajimi i planit fillestar, zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.**

Çelja dhe detajimi mujor i buxhetit të Spitalit Shkoder i referohet VKM Nr. 33, datë 20.01.2016“Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor”, si dhe shkresës së FSDKSH nr. 620, datë 05.02.2016 “Detajimi i limitit mujor për vitin 2016”. Referuar për sa më lart çelja e buxhetit të Spitalin shkoder për vitin 2016 ishte planifikuar për 635,470 mijë lekë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2016, janë në rritje, në vlerë totale për 85,153mijë:

Me shkresën e FSDKSH-së nr. 874, datë 22.02.2016 në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, është bërë miratimi i shtesës në buxhetin e Spitalin shkoder për 43,953 mijë lekë nga të cilat:

- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 37,451 mijë lekë.
- Llogaria 600- Paga 5,571 mije leke
- Llogaria sigurime shoqerore dhe shendetesore 931 mije leke

Me VKM nr ,619date 31.08.2016 per nje ndryshimne VKM nr,33 date 20.01.2016, është bërë miratimi i shtesës në buxhetin per Spitalin shkoder për 11,000 mijë lekë nga të cilat:

- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 11,000 mijë lekë.

Me shkresën nr.563/1 datë 01.12.2016 “eshte bere shtese fondi ne vlere 30,200 mije leke nga te cilat :Llogaria 600- Paga për 26,000 Llogaria 601- 4200 mijë lekë.

*Ne 000 leke*

LLOG.	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	VKM 619	FSDKSH	606	PLANI PERFUNDIMTAR
600	Paga	380,000		31,571	-1,210	<b>410,361</b>
601	Sigurime	63,470		5,131		<b>68,601</b>
602	Mallra e shërbime	192,000	11,000	37,451		<b>240,451</b>
606	Raste fatkeqsish FV				+1,210	<b>1,210</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Janë shtuar  
krahësim  
artikujt

	<b>TOTALI</b>	<b>635,470</b>	<b>11,000</b>	<b>74,153</b>		<b>720,623</b>

në  
me çeljen  
600-601

“Paga e shtesa & sigurime shoqërore”, në vlerë 35,492 mijë lekë, më shumë se planifikimi, apo çelja e tyre. Janë shtuar në krahësim me çeljen artikujt 602 “Mallra dhe Shërbime”, në vlerë 11,000 mijë lekë, më shumë se planifikimi, apo çelja e tyre.

2. Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Monitorimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitoriit të performances së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel programi.

Gjatë vitit 2016 Spitali Shkoder, ka pasur një buxhet total prej 720,623 mijë lekë, i financuar nga buxheti i shtetit i ndarë në zëra:

- Llogaria 600- Paga për personel të përhershëm për 410,360 mijë lekë
- Llogaria 601- Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 68,601 mijë lekë
- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 240,451 mijë lekë

Çdo muaj, Spitali shkoder dërgon pranë “” DRSKSH Shkoder“Situacionin e shpenzimeve dhe situacionin e të ardhurave“, progresive të planifikuara dhe realizuara, konfirmuar kjo nga Dega e Thesarit Shkoder.

Me shkresën nr. 44 datë 15.01.2016, të Spitalit Shkoder, është dërguar prane DRSKSH Shkoder “Situacioni i Shpenzimeve dhe Situacioni e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2016 “Ky situacion të ardhurash dhe shpenzimesh është i rakorduar me Degën e Thesarit, Shkoder. Tabela e mëposhtme tregon si janë shpenzuar këto të ardhura nga ana e Spitalit Shkoder për vitin 2016

Analiza	E M E R T I M I	MUAJI	
		PLAN	FAKT
<b>600</b>	<b>PAGA, SHPERBLIME E SHPENZ. TJERA PERSONELI</b>	<b>410,360,010</b>	<b>410,341,407</b>
<b>6001</b>	<b>PAGA TE PERSONELIT TE PERHERSHEM</b>	<b>410,360,010</b>	<b>410,341,407</b>
6001001	PAGA BAZE	134,646,279	134,636,938
6001002	RAPORTE MJEKESORE TE PAGUARA NGA PUNEDHENESI	549,765	549,765
6001003	SHTESE PAGE PER VJETERSI NE PUNE	34,717,710	34,717,430
6001004	SHTESE PAGE PER VESHTIRESI DHE RREZIQE	18,969,335	18,969,331

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6001005	SHTESE PAGE PER FUNKSIONIN	180,144,713	180,142,116
6001006	SHTESE PAGE PER TURNE TE DYTA E TE TRETA	39,168,150	39,162,150
6001007	SHTESE PAGE PER LARGESI NGA QENDRA E BANIMIT	248,560	248,200
6001008	SHTESE PAGE PER KUALIFIKIM	0.00	0.00
6001012	SHTESE PAGE DHE PAGE E MENJEHERSHME PER FUNKSIONARET E LARTE	0.00	0.00
6001013	SHTESE PAGE PER PUNE JASHTE ORARIT	0.00	0.00
6001014	SHTESE PAGE PER PUNONJESIT QE RREGULLOHEN ME AKTE TE VEÇANTA	1,735,498	1,735,477
6001099	SHTESA PAGE TE TJERA	0.00	0.00
<b>6002</b>	<b><i>PAGA TE PERSONELIT TE PERKOHSEM</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6002100	PAGA ME KONTRATE PER KOHE TE KUFIZUAR	0.00	0.00
6002200	PAGA ME KONTRATE PER PUNE SEZONALE	0.00	0.00
6002900	TE TJERA PAGA ME KONTRATE	0.00	0.00
<b>6003</b>	<b><i>SHPERBLIME</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6003100	SHPERBLIME PER REZULTATE NE PUNE	0.00	0.00
6003900	TE TJERA SHPERBLIME PER PERSONELIN	0.00	0.00
<b>6009000</b>	<b><i>SHPENZIME TE TJERA PERSONELI</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>601</b>	<b>KONTRIBUTETESIGURIMEVESHOQEROR E SHENDETESORE(30.7%)</b>	<b>68,601,000</b>	<b>68601,000</b>
6010000	KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE	61,610,871	61,610,871
6011000	KONTRIBUTE PER SIGURIMET SHENDETESORE (1.7 %)	6,990,129	6,990,129
<b>602</b>	<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	<b>240,451,000</b>	<b>228,507,431</b>
<b>6020</b>	<b><u>MATERIALE DHE SHERBIME ZYRE DHE TE PERGJITHSHME</u></b>	<b>1,442,364</b>	<b>1,440,444</b>
6020100	KANCELARI	0.00	0.00
6020200	MATERIALE PER PASTRIM, DISINFKTIM, NGROHJE DHE NDRIÇIM	0.00	0.00
6020300	MATERIALE PER FUNKSIONIMIN E PAJISJEVE TE ZYRES	0.00	0.00
6020400	MATERIALE PER FUNKSIONIMIN E PAJISJEVE SPECIALE	0.00	0.00
6020500	BLERJE DOKUMENTACIONI	0.00	0.00
6020900	FURNIZIME DHE MATERIALE TE TJERA ZYRE DHE TE	1,442,364	1,440,444

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

	PERGJITHSHME		
<b>6021</b>	<b><u>MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE</u></b>	<b>131,736,314</b>	<b>127,802,875</b>
6021001	UNIFORMA DHE TE TJERA VESHJE SPECIALE	480,000	0.00
6021003	ILAÇE DHE MATERIALE MJEKESORE	126,129,794	122,676,361
6021004	FURNIZIME DHE SHERBIME ME USHQIM PER MENCAT	5,126,520	5,126,514
6021007	LIBRA DHE PUBLIKIME PROFESIONALE	0.00	0.00
6021009	MATERIALE DHE PAJISJE LABORATORIK E TE SHERBIMIT PUBLIK	0.00	0.00
6021010	SHPENZIME PER PRODHIM DOKUMENTACIONI SPECIFIK	0.00	0.00
6021099	TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE	0.00	0.00
<b>6022</b>	<b><u>SHERBIME NGA TE TRETE</u></b>	<b>72,173,031</b>	<b>72,173,031</b>
6022001	ELEKTRICITET	32,510,373	32,510,373
6022002	UJE	23,003,671	23,003,671
6022003	SHERBIME TELEFONIKE	195,756	195,756
6022004	POSTA DHE SHERBIMI KORRIER	22,535	22,535
6022005	SHERBIM PER NGROHJE	4,600,000	4,582,527
6022007	SHERBIME BANKARE	0.00	0.00
6022008	SHERBIME TE SIGURIMIT DHE RUAJTJES	9,699,221	9,699,221
6022009	SHERBIME TE PASTRIMIT DHE GJELBERIMIT	0.00	0.00
6022010	SHERBIME TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT	0.00	0.00
6022011	KOSTO E TRAINIMIT DHE SEMINAREVE	0.00	0.00
6022099	SHERBIME TE TJERA	2,141,472	2,067,850
<b>6023</b>	<b><u>SHERBIME TRANSPORTI</u></b>	<b>7,589,234</b>	<b>7,589,148</b>
6023100	KARBURANT DHE VAJ	7,099,570	7,099,484
6023200	PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI	0.00	0.00
6023300	SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE TE TRANSPORTIT	0.00	0.00
6023900	SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI	489,664	489,664
<b>6024</b>	<b><u>SHPENZIME UDHETIMI</u></b>	<b>360,000</b>	<b>136,172</b>
6024100	UDHETIM I BRENDSEHM	360,000	136,172

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6024200	UDHETIM JASHTË SHTETIT	0.00	0.00
<b>6025</b>	<b><u>SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME</u></b>	<b>16,600,312</b>	<b>15,535,954</b>
6025200	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE SPECIFIKE	0.00	0.00
6025300	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE NDERTIMORE	5,148,000	4,112,450
6025500	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE VEGLAVE TE PUNES	9,909,512	9,909,492
6025600	SHPENZIMEVE PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT	0.00	0.00
6025600	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT	1,542,800	1,514,012
<b>6026</b>	<b><u>SHPENZIME PER QIRAMARRJE</u></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6026100	SHPENZIME PER QIRAMARRJE AMBJENTESH	0.00	0.00
6026300	SHPENZIME PER QIRAMARRJE PER APARATE DHE PAJISJE TEKNIKE, MAKINERI	0.00	0.00
6026400	SHPENZIME PER QIRAMARRJE MJETESH TRANSPORTI	0.00	0.00
6026900	SHPENZIME TE TJERA QIRAJE	0.00	0.00
<b>6027</b>	<b><u>SHPENZIME PER DETYRIME DHE KOMPENSIME LEGALE</u></b>	<b>1,690,210</b>	<b>1,014,102</b>
6027400	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE VENDIMEVE GJYQESORE PER LARGIM NGA PUNA	1,690,210	1,014,102
6027500	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE DETYRIMEVE KONTRAKTUALE TE PAPAGUARA	0.00	0.00
6027900	SHPENZIME PER KOMPENSIME TE TJERA TE PAPAGUARA	0.00	326,400
<b>6029</b>	<b><u>SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE</u></b>	<b>2,906,800</b>	<b>2,906,800</b>
6029001	SHPENZIME PER PRITJE PERCJELLJE	0.00	0.00
6029002	SHPENZIME PER AKTIVITETE SOCIALE PER PERSONELIN	0.00	0.00
6029003	SHPENZIME GJYQESORE	0.00	0.00
6029004	SHPENZIME PER SIGURIMIN E NDERTESAVE DHE TE TJERA KOSTO SIGURIMI TE NGJASHME	0.00	0.00
6029005	SHPENZIME PER HONORARE	0.00	0.00

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6029007	SHPENZIME PER PJESEMARRJE NE KONFERENCA	0.00	0.00
6029008	SHPENZIME PER TATIME & TAKSA TE PAGUARA NGA INSTITUCIONI	0.00	0.00
6029009	SHPENZIME PER TERHEQJEN E LIMITIT TE ARKES	0.00	0.00
6029099	SHPENZIME PER TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE	0.00	0.00
	URDHERA TE BLOKUAR NE THESAR NGA VITET E KALUARA	4,280,007	
<b>606</b>	<b>RASTE FATKEQESIE FONDI VECANT</b>	<b>1,210,990</b>	<b>1,210,990</b>
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>720,623,000</b>	<b>708,660,828</b>
	<b>NUMRI I PUNONJESVE</b>	<b>711</b>	<b>708</b>

Tabela në vijim paraqet përqindjen e realizimit të secilit prej zërave të buxhetit.

*Në mijë lekë*

*Investimet*  
**III** Mbi  
 kritereve

LLOG	ZËRAT E SHPENZIMEVE	PLANI	REALIZIMI	DIFERENCA	%
600	Paga	410,341	410,341	18	100
601	Sigurime shoqerore dhe Shendetesore	68,601	68,601	0	100
<b>602</b>	Mallra dhe Sherbime	240,451	228,507	11,943	95
606	Raste fatkeqsish ndihme per pension	1,210	1,210	0	100
230,231	Projekte ,investime	19,260	18,512	748	96
	<b>TOTALI</b>	<b>739,863</b>	<b>727,171</b>	<b>12,692</b>	<b>98</b>

zbatimin e  
dhe

procedurave të hartimit të buxhetit me destinacion fondet e investimeve për vitin 2016, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.

Plani fillestar, ndryshimet e pësuara gjatë vitit (pakësuar apo shtuar) si dhe plani përfundimtar i investimeve të financuara nga buxheti i shtetit përSpitalin Shkoder për vitin 2016 paraqiten si vijon:

- Plani Fillestar i Buxhetit për Investime – 19,260 mijë lekë
- Ndryshime (Shtesa) në planin e Investimeve – 0 mijë lekë
- Ndryshime (Pikësime) në planin e Investimeve – 0 mijë lekë
- Plani Përfundimtar i Buxhetit për Investime – 19,260 mijelekë

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Në mënyrë të përmbledhur, çelja, ndryshimet, plani përfundimtar si dhe realizimi i investimeve për vitin 2013 paraqiten si në tabelën e mëposhtme.

*Në mijë lekë*

LLOG	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	NDRYSHIME	PLANI TOTAL	REALIZIMI	
a.Me						shkresën e
Ministrisë						së
Financave	231	Investime/Ndertime	19,260	-	19,260	18,512
datë		<b>TOTALI</b>	19,260	-	19,260	18,512

nr. 241/1

20.01.2016“Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2016 për shpenzimet kapitale (artikujt 231) në fushën e shëndetësisë” është bërë çelja e buxhetit për investime dhe detajimi i tij, për vlerën 19,260 mijë lekë dhe i takon:

- Ri K. i ambjenteve te reanimacionit me vlere 15,000 mije lek
  - Supervisor i ri K.it te ambjenteve te reanimacionit me vlere 100 mije lek
  - Ri K.i ambjenteve ku do te instalohet aparatura e angiografise 4,124 mije leke
- e rrugëve në projekt sipas tipeve si dhe planimetria e rregullimit dhe gjelberimit të teritorit.

**IV. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit për vitin 2017, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.**

Projekt buxheti për vitin 2017, është hartuar konform legjislacionit të mësipërm dhe në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale dhe janë dorëzuar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dërguar për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2018-2020 në mënyrë elektronike dhe shkresore me shkresën nr 1747 prot date 26.07.2017

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm.

**1. Çeljen e buxhetit të vitit 2017, detajimi i planit fillestar, zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.**

Çelja dhe detajimi mujor i buxhetit të Spitalit Shkoder i referohet VKM Nr. 18, datë 11.01.2017“Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor”. Referuar për sa më lart çelja e buxhetit të Spitalin shkoder për vitin 2017 ishte planifikuar për 675,400 mijë lekë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2017, janë në rritje, në vlerë totale për 73,684 mijë leke:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Me shkresën e FSDKSH-së nr. 698, datë 14.02.2017 në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së , është bërë miratimi i shtesës në buxhetin e Spitalin Shkodër për 18,984 mijë lekë nga të cilat:

- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 16,894mijë lekë.
- Llogaria 600- Paga 1,700 mije leke
- Llogaria 601 sigurimr shoqrore dhe shendetesore 300 mije keke

Me VKM nr ,614 date 27.10.2017 per nje ndryshim ne VKm nr,18 date 11.01.2017 , është bërë miratimi i shtesës në buxhetin per Spitalin shkoder për 54,700 mijë lekë nga të cilat:

- Llogaria 600- Paga për 47,000 mijë lekë.
- Llogaria 601 – sigurime shoqerore dhe shendetesore 7,700 mije leke

*Ne 000 leke*

LLOG.	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	VKM 614	FSDKSH	606	PLANI PERFUNDIMTAR
600	Paga	401,500	47,000	1,700	-1058	<b>449,142</b>
601	Sigurime	66,700	7,700	300		<b>74,700</b>
602	Mallra e shërbime	207,200		16,984		<b>224,184</b>
606	Raste fatkeqsish FV				+1058	<b>1,058</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>675,400</b>	<b>54,700</b>	<b>18,984</b>		<b>749,084</b>

*Janë shtuar* në krahasim me çeljen artikujt 600-601 “Paga e shtesa & sigurime shoqërore”, në vlerë 56,700 mijë lekë, më shumë se planifikimi, apo çelja e tyre. *Janë shtuar* në krahasim me çeljen artikujt 602 “Mallra dhe Shërbime ”, në vlerë 16,984 mijë lekë, më shumë se planifikimi, apo çelja e tyre.

**2.** Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Monitorimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitoriit të performances së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel programi.

Gjatë vitit 2016 Spitali Shkoder , ka pasur një buxhet total prej 749,084 mijë lekë, i financuar nga buxheti i shtetit i ndarë në zëra:

- Llogaria 600- Paga për personel të përhershëm për 449,142 mijë lekë

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Llogaria 601- Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 74,700 mijë lekë
- Llogaria 602- Mallra dhe shërbime për 224,184 mijë lekë

Çdo muaj, Spitali shkoder dërgon pranë “” DRSKSH Shkoder“Situacionin e shpenzimeve dhe situacionin e të ardhurave“, progresive të planifikuara dhe realizuara, konfirmuar kjo nga Dega e Thesarit Shkoder.

Me shkresën nr. 44 datë 15.01.2016, të Spitalit Shkoder, është dërguar pranë “DRSKSH Shkoder “Situacioni i Shpenzimeve dhe Situacioni e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2016 “Ky situacion të ardhurash dhe shpenzimesh është i rakorduar me Degën e Thesarit, Shkoder. Tabela e mëposhtme tregon si janë shpenzuar këto të ardhura nga ana e Spitalit Shkoder për vitin 2017

Analiza	E M E R T I M I	MUAJI	
		PLAN	FAKT
<b>600</b>	<b>PAGA, SHPERBLIME E SHPENZ. TJERA PERSONELI</b>	<b>449,141,010</b>	<b>449,141,010</b>
<b>6001</b>	<b><i>PAGA TE PERSONELIT TE PERHERSHEM</i></b>	<b>441,141,750</b>	<b>441,141,750</b>
6001001	PAGA BAZE	139,643,465	139,533,356
6001002	RAPORTE MJEKESORE TE PAGUARA NGA PUNEDHENESI	635,000	622,360
6001003	SHTESE PAGE PER VJETERSI NE PUNE	34,767,574	34,767,574
6001004	SHTESE PAGE PER VESHTIRESI DHE RREZIQE	26,458,662	26,458,181
6001005	SHTESE PAGE PER FUNKSIONIN	52,839,651	190,668,553
6001006	SHTESE PAGE PER TURNE TE DYTA E TE TRETA	386,000	52,839,651
6001007	SHTESE PAGE PER LARGESI NGA QENDRA E BANIMIT		
6001008	SHTESE PAGE PER KUALIFIKIM	0.00	0.00
6001012	SHTESE PAGE DHE PAGE E MENJEHERSHME PER FUNKSIONARET E LARTE	0.00	0.00
6001013	SHTESE PAGE PER PUNE JASHTE ORARIT	0.00	0.00
6001014	SHTESE PAGE PER PUNONJESIT QE RREGULLOHEN ME AKTE TE VEÇANTA	3,336,217	3,336,217
6001099	SHTESA PAGE TE TJERA	0.00	0.00
<b>6002</b>	<b><i>PAGA TE PERSONELIT TE PERKOHSHEM</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6002100	PAGA ME KONTRATE PER KOHE TE KUFIZUAR	0.00	0.00
6002200	PAGA ME KONTRATE PER PUNE SEZONALE	0.00	0.00

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6002900	TE TJERA PAGA ME KONTRATE	0.00	0.00
<b>6003</b>	<b><i>SHPERBLIME</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6003100	SHPERBLIME PER REZULTATE NE PUNE	0.00	0.00
6003900	TE TJERA SHPERBLIME PER PERSONELIN	0.00	0.00
<b>6009000</b>	<b><i>SHPENZIME TE TJERA PERSONELI</i></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>601</b>	<b><i>KONTRIBUTETESIGURIMEVESHOQEROR E SHENDETESORE(30.7%)</i></b>	<b>74,700,000</b>	<b>73,978,232</b>
6010000	KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE	66,851,846	66,351,846
6011000	KONTRIBUTE PER SIGURIMET SHENDETESORE (1.7 %)	7,848,154	7,626,386
<b>602</b>	<b><i>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</i></b>	<b>224,184,000</b>	<b>219,937,143</b>
<b>6020</b>	<b><i><u>MATERIALE DHE SHERBIME ZYRE DHE TE PERGJITHSHME</u></i></b>	<b>1,242,674</b>	<b>1,242,674</b>
6020100	KANCELARI	0.00	0.00
6020200	MATERIALE PER PASTRIM, DISINFEKTIM, NGROHJE DHE NDRIÇIM	0.00	0.00
6020300	MATERIALE PER FUNKSIONIMIN E PAJISJEVE TE ZYRES	0.00	0.00
6020400	MATERIALE PER FUNKSIONIMIN E PAJISJEVE SPECIALE	0.00	0.00
6020500	BLERJE DOKUMENTACIONI	0.00	0.00
6020900	FURNIZIMEDHEMATERIALE TE TJERAZYRE DHE TE PERGJITHSHME	1,242,674	1,242,674
<b>6021</b>	<b><i><u>MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE</u></i></b>	<b>115,836,026</b>	<b>115,765,414</b>
6021001	UNIFORMA DHE TE TJERA VESHJE SPECIALE	0.00	0.00
6021003	ILAÇE DHE MATERIALE MJEKESORE	107,221,501	107,221,361
6021004	FURNIZIME DHE SHERBIME ME USHQIM PER MENCAT	8,614,525	8,544,053
6021007	LIBRA DHE PUBLIKIME PROFESIONALE	0.00	0.00
6021009	MATERIALE DHE PAJISJE LABORATORIK E TE SHERBIMIT PUBLIK	0.00	0.00
6021010	SHPENZIME PER PRODHIM DOKUMENTACIONI SPECIFIK	0.00	0.00
6021099	TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE	0.00	0.00
<b>6022</b>	<b><i><u>SHERBIME NGA TE TRETE</u></i></b>	<b>73,497,678</b>	<b>73,492,584</b>
6022001	ELEKTRICITET	34,517,380	34,517,380

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6022002	UJE	19,219,516	19,219,516
6022003	SHERBIME TELEFONIKE	100,607	100,607
6022004	POSTA DHE SHERBIMI KORRIER	27,940	27,940
6022005	SHERBIM PER NGROHJE	4,895,626	4,895,004
6022007	SHERBIME BANKARE	0.00	0.00
6022008	SHERBIME TE SIGURIMIT DHE RUAJTJES	12,984,186	12,984,186
6022009	SHERBIME TE PASTRIMIT DHE GJELBERIMIT	0.00	0.00
6022010	SHERBIME TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT	0.00	0.00
6022011	KOSTO E TRAINIMIT DHE SEMINAREVE	0.00	0.00
6022099	SHERBIME TE TJERA	1,752,423	1,747,951
<b>6023</b>	<b><u>SHERBIME TRANSPORTI</u></b>	<b>6,549,586</b>	<b>6,549,402</b>
6023100	KARBURANT DHE VAJ	5,999,999	5,999,815
6023200	PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI	0.00	0.00
6023300	SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE TE TRANSPORTIT	51,627	51,627
6023900	SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI	497,960	497,960
<b>6024</b>	<b><u>SHPENZIME UDHETIMI</u></b>	<b>535,076</b>	<b>535,076</b>
6024100	UDHETIM I BRENDSEHEM	535,076	535,076
6024200	UDHETIM JASHE SHTETIT	0.00	0.00
<b>6025</b>	<b><u>SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME</u></b>	<b>17,216,379</b>	<b>17,209,659</b>
6025200	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE SPECIFIKE	0.00	0.00
6025300	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE NDERTIMORE	821,811	821,811
6025500	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE VEGLAVE TE PUNES	14,903,916	14,903,916
6025600	SHPENZIMEVE PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT	0.00	0.00
6025600	SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT	1,490,652	1,483,932
<b>6026</b>	<b><u>SHPENZIME PER QIRAMARRJE</u></b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
6026100	SHPENZIME PER QIRAMARRJE AMBJENTESH	0.00	0.00

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

6026300	SHPENZIME PER QIRAMARRJE PER APARATE DHE PAJISJE TEKNIKE, MAKINERI	0.00	0.00
6026400	SHPENZIME PER QIRAMARRJE MJETESH TRANSPORTI	0.00	0.00
6026900	SHPENZIME TE TJERA QIRAJE	0.00	0.00
<b>6027</b>	<b><u>SHPENZIME PER DETYRIME DHE KOMPENSIME LEGALE</u></b>	<b>4,177,234</b>	<b>4,177,234</b>
6027400	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE VENDIMEVE GJYQESORE PER LARGIM NGA PUNA	3,947,234	3,947,234
6027500	SHPENZIME PER EKZEKUTIM TE DETYRIMEVE KONTRAKTUALE TE PAPAGUARA	0.00	0.00
6027900	SHPENZIME PER KOMPENSIME TE TJERA TE PAPAGUARA	230,000	230,000
<b>6029</b>	<b><u>SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE</u></b>	<b>965,100</b>	<b>965,100</b>
6029001	SHPENZIME PER PRITJE PERCJELLJE	0.00	0.00
6029002	SHPENZIME PER AKTIVITETE SOCIALE PER PERSONELIN	0.00	0.00
6029003	SHPENZIME GJYQESORE	0.00	0.00
6029004	SHPENZIME PER SIGURIMIN E NDERTESAVE DHE TE TJERA KOSTO SIGURIMI TE NGJASHME	965,100	965,100
6029005	SHPENZIME PER HONORARE	0.00	0.00
6029007	SHPENZIME PER PJESEMARRJE NE KONFERENCA	0.00	0.00
6029008	SHPENZIME PER TATIME & TAKSA TE PAGUARA NGA INSTITUCIONI	0.00	0.00
6029009	SHPENZIME PER TERHEQJEN E LIMITIT TE ARKES	0.00	0.00
6029099	SHPENZIME PER TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE	0.00	0.00
	URDHERA TE BLOKUAR NE THESAR NGA VITET E KALUARA	4,164,247	
<b>606</b>	<b>RASTE FATKEQESIE FONDI VECANT</b>	<b>1,058,250</b>	<b>1,058,250</b>
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>749,084,000</b>	<b>743,585,516</b>
	<b>NUMRI I PUNONJESVE</b>	<b>718</b>	<b>705</b>

Tabela në vijim paraqet përqindjen e realizimit të secilit prej zërave të buxhetit.

*Në mijë lekë*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

LLOG	ZËRAT E SHPENZIMEVE	PLANI	REALIZIMI	DIFERENCA	%
600	Paga	449,142	448,612	530	99.8
601	Sigurime shoqerore dhe Shendetesore	74,700	73,978	722	99
<b>602</b>	Mallra dhe Sherbime	224,184	219,937	4247	98
606	Raste fatkeqsish ndihme per pension	1,058	1,058	0	100
230,231	Projekte ,investime	24,433	24,344	89	99.6
	<b>TOTALI</b>	<b>773,517</b>	<b>767,929</b>		<b>99.2</b>

**Investimet**

V. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit me destinacion fondet e investimeve për vitin 2017, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.

Plani fillestar, ndryshimet e pësuara gjatë vitit (pakësuar apo shtuar) si dhe plani përfundimtar i investimeve të financuara nga buxheti i shtetit për Spitalin shkodër, për vitin 2017 paraqiten si vijon:

Në mënyrë të përmbledhur, çelja, ndryshimet, plani përfundimtar si dhe realizimi i investimeve për vitin 2017 paraqiten si në tabelën e mëposhtme.

*Në mijë lekë*

LLOG	EMERTIMI	PLANI FILLESTAR	NDRYSHIME	PLANI TOTAL	REALIZIMI
231	Investime/Ndertime	24,433	-	24,433	24,344
	<b>TOTALI</b>	24,433	-	24,433	24,344

a.Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 78/2 datë 30.01.2017“Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2017 për shpenzimet kapitale (artikujt 231) në fushën e shëndetësisë” është bërë çelja e buxhetit për investime dhe detajimi i tij, për vlerën 24,433 mijë lekë dhe i takon:

- Ri K. i ambjenteve te reanimacionit me vlere 17,876 mije lek
- Supervisor+ kolaudim i ri K.it te ambjenteve te reanimacionit me vlere 100 mije lek
- Ri K.i ambjenteve te reanimacionit te Spitalit shkodër shtese kontrate 6,456 mije leke.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.**

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative marrëdhëniet e punës dhe pagave”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Vendimet e Ministrisë së Shëndetsisë mbi miratimin e strukturës organizative, për periudhën 01.05.2015-31.10.2017,
- 2) Vendimet e Drejtorisë për emërimet, largimet dhe zbatimin strukturave organizative, për periudhën 01.05.2015-31.10.2017 (me zgjedhje),
- 3) Dokumentacionin e dosjeve individuale (me zgjedhje) të punonjësve të Isntitucionit,
- 4) Listëpagesat mujore për periudhën 01.01.2015-31.12.2017 (me zgjedhje),

***Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:***

*Struktura organizative e shoqërisë është miratuar me vendime të ndryshme të Ministrisë së Shëndetsisë, e konkretisht:*

- 1) Me Shkresën nr. 3070, datë 12.04.2014, ku është përcaktuar numri i punonjësve 794,
- 2) Me Shkresën nr. 253/1, datë 18.01.2016, ku është përcaktuar numri i punonjësve 711,
- 3) Me Shkresën nr. 1306/1, datë 08.03.2017, ku është përcaktuar numri i punonjësve 718

Për periudhën objekt auditimi janë lidhur 2 kontrata kolektive të punës, e para në datë 25.02.2015 mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sidikatave të Punonjësve të Shëndetësisë së Shqipërisë me një afat kohor 3 vjeçar. Gjithashtu është lidhur për një periudhë 3 vjecare kontrata kolektive e punës mes Drejtorisë së Spitalit Rajonal Shkodër dhe Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë Shkodër me datë 15.09.2016.

Të dhënat e përmbledhura për shpenzimet e pagave paraqiten në tabelë dhe efekti rënës në 2016 ka ardhur pas Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetsisë nr. 244 prot, datë 15.01.2016, në të cilin struktura nga 794 punonjës që ka qënë është ulur në numrin total prej 711 punonjësish. Ndërkohë që në vitin 2017 referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 15.03.2017, janë rritur shpenzimet e pagave për institucionet Spitalore në Republikën e Shqipërisë.

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2015</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Viti 2017</b>
Shpenzime për pagat	433.195.457	413.841.699	457.674.415
Kontribute shoqërore & shëndetësore	72.277.725	69.066.215	75.399.714
Tatimi mbi të ardhurat personale	19.703.955	18.902.907	26.586.377
Shpërblime	2.400.000	0	0
Numri i miratuar i punonjësve	795	711	718

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Emërimet	42	26	30
Largime	36	80	33

***Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Shkodër***

Me shkresën nr. 6083 prot, datë 30.12.2015, urdhëri nr. 555, datë 29.12.2015, i Ministrisë së Shëndetsisë është dhënë një shpërblim me rastin e festave të fundvitit, për kategori të veçanta të punonjësve të disa shërbimeve në spitalet e vendit, të dalluar gjatë vitit 2015, në shumën 2,400,000 lekë për 60 persona për punonjësit e repartit të Kirurgjisë (mjek+infermierë), për 40,000 lekë secili.

Për periudhën 01.01.2015-31.12.2015, në Spitalin Rajonal Shkodër janë punësuar gjithsej 42 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme (dorëheqje, pension shkelje etj.) 36 punonjësve.

Për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, në Spitalin Rajonal Shkodër janë punësuar gjithsej 30 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme (dorëheqje, pension shkelje etj.) 33 punonjësve.

Nga punonjësit e larguar, disa prej të cilëve nuk kanë pranuar arsyet e largimit, u janë drejtuar gjykatave.

Gjatë vitit 2016 janë kryer gjithësej ndërprerje të Mardhënieve të Punës për 62 punonjës ndërkohë janë punësuar 26 punonjës. Konkretisht janë kryer ndërprerje e Mardhënieve të Punës për 4 punonjës në muajin prill, 11 punonjës në muajin Maj dhe 47 punonjës në muajin qershor 2016 (*vlen të theksohet se 43 punonjës janë larguar në datë 25.06.2016*), pra brenda 90 ditëve është kryer ndërprerje e mardhënieve të punës në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 148, pika 1, e cila citon se *“Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, .20 punëmarrës për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës.”* Kjo pasi ndërprerja mbi 20 punonjës konsiderohet pushim kolektiv dhe nuk është zbatuar procedura e njoftimit me shkrim të organizatave përfaqësuese për pushim kolektiv nga puna të këtyre punonjësve si dhe nuk është marrë miratimi i Ministrit për procedurën e largimit të këtyre punonjësve. *Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi drejtorin e SRSH, znj.Dh U.*

Tabela 4.1 Vendimet e gjykatës

Nr	Emër mbiemër	Vendimi i gjykatës së Apelit	Vlera e kërkuar	Shpenz përmbar	Vlera Totale
----	--------------	------------------------------	-----------------	----------------	--------------

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

1	Zamir Fatusha	Nr 468 date 04.03.2014	409332	38600	447932
2	Fitnet Pali	Nr. 2626 date 07.12.2015	510906	64800	575706
3	Dafina Drishti	Nr. 1801 date 21.07.2015	736345	14727	751072
4	Refik Dushi	Nr. 295 date 18.02.2016	956700	57402	1014102
5	Genti Karagjozi	Nr. 285 date 01.02.2017	560760	11215	571975
6	Sanije Nehani	Nr. 3307 date 11.07.2017	597646	32272	629918
7	Nazmi Muca	Nr. 430 date 08.02.2017	721476	86576	808052
8	Roze Paja	Nr. 2132 date 17.05.2017	1205565	149667	1355232
9	Tonini Trashani	Nr. 4359 date 25.10.2017	563692	30439	594131
	<b>Totali</b>		<b>6262422</b>	<b>485698</b>	<b>6,748,120</b>

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Për periudhën objekt auditimi janë larguar punonjës pa shkaqe të përligjura duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur SRSH në Gjykatë, nga të cilat 9 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit duke e detyruar Spitalin Rajonal Shkodër të paguajë vlerën **6,262,422 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.**

Gjithashtu nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përmbarimore për 9 punonjësit e larguar, në **shumën 485,698 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

**Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z. T.M., ish-drejtoreshen znj. Dh. U., dhe ish-drejtorin z. P.Ç.**

Njëkohësisht bazuar në të dhënat e SRSH konstatohet se nga largimet e punonjësve nga puna është paditur institucioni nga punonjësit si më poshtë vijon;

Nr	Emër Mbiemër	Vendimi i Gjyk. së shkallës së parë	Paga të pretenduara	Paga mujore	Vlera e pretenduar
1	S.LI	Nr. 83-2016-775/ datë 22.12.2016	22	33390	734580
2	N. B.	Nr. 83-2016-774/ datë 22.12.2016	23,5	24630	578805

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

3	M. D.	Nr. 83-2016-773/ datë 22.12.2016	18	32840	591120
4	E. B.	Nr. 510(609) / datë 17.07.2017	14,5	46450	673525
5	R. Sh.	Nr. 83-2016-772/ datë 22.12.2016	26,5	36068	955802
6	A. K.	Nr. 83-2016-754/ datë 19.12.2016	18	32840	591120
7	M. P.	Nr. 83-2016-40 / datë 30.01.2017	12,5	33190	414875
		Totali			<b>4,539,827</b>

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Në lidhje me të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Rajonal Shkodër është paditur në Gjykatë nga 7 punonjës të cilët janë në proces gjykimi dhe referuar Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër pretendohet se e kanë fituar këtë shkallë të gjykimit duke kërkuar nga SRSH një dëmshpërblim në vlerë totale **4,539,827 lekë, shumë e cila do të sjellë një efekt negative financiar të pritshëm për buxhetin e shtetit.**

**Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Drejtoreshen e SRSH znj.Dh. U.**

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, u konstatua tejkalim i numrit të punonjësve të miratuar për muajt sipas tabelës më poshtë.

Nr	Viti 2016 Muaji	Struktura e miratuar	Struktura e realizuar	Diferenca në nr
1	Shkurt	711	777	66
2	Mars	711	777	66
3	Prill	711	777	66
4	Maj	711	775	64
5	Qershor	711	771	60
6	Korrik	711	762	51

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Pra siç shihet edhe nga tabela e mësipërme konstatohet se është tejkaluar nr i punonjësve në muajt, shkurt-Korrik të vitit 2016 me një nr mesatarisht mbi 62 punonjës. Kjo ka ardhur si pasojë e strukturës së re të miratuar me Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetsisë nr. 244 prot, datë 15.01.2016, strukturë e cila është miratuar në numrin total prej 711 punonjësish. Por ajo që konstatohet në këtë analizë është se gjatë kësaj kohe janë kryer ndërprerje të mardhënieve të punës, por janë marrë njëkohësisht punonjës të rinj të cilët janë reth 8 punonjës gjatë muajve shkurt-korrik 2016, pra edhe pse struktura ka ardhur më pak se struktura faktike, nga ana e Drejtuesve të Spitalit janë kryer emërimet të reja. Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Drejtorin e SRSH znj.DH.U. dhe ish-drejtorin z.P Ç.

Për emërimet e reja janë krijuar komisionet me urdhërat e brendshëm me përbërje si më poshtë;  
 Urdhëri nr. 136, me shkresën nr. 1748 prot, datë 14.09.2015, me përbërje të komisionit znj. K.K. Shefe e Farmiacisë, z. B.B. Mjek Neurolog, z. H.G. Kryeinfermier i Përgjithshëm dhe znj. L.Gj. Specialiste e Burimeve Njerëzore.  
 Urdhëri nr. 69, me shkresën nr. 1167, datë 26.05.2016, me përbërje të komisionit z.Bashkim Bala Mjek kryetar dhe anëtarët znj.K.K. Shefe e Farmiacisë dhe z.H.G. Kryeinfermier i Përgjithshëm.  
 Në lidhje me emërimet e reja për periudhën objekt auditimi, u kërkuan me zgjedhje 23 dosje dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatuan të meta dhe mangësi sipas tabelës më poshtë;

Nr.	Punonjësi	Pozicioni i punës	Data e punësimit	Problematika në dosjen personale për marrjen në punë.
1	E. A.	Ekon/Audit	16.01.2015	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, nuk ka paraqitur Dëshmi penaliteti.
2	H. D.	Mjeke/alerg.	20.02.2015	Diploma dhe lista e notave janë fotokopje dhe jo të noterizuara, Nuk ka paraqitur çertifikatë familjare, nuk ka paraqitur vërtetim banimi, nuk ka paraqitur vërtetim që nuk merr ndihmë ekonomike, Leja e ushtrimit të profesionit është fotokopje dhe e pa noterizuar. Nuk ka paraqitur dokument identifikimi.
3	L. K.	Punonj/inform.	16.01.2015	Nuk është bërë shpallje në APP për pozicionin e punës, nuk ka Dëshmi penaliteti.
4	R. S.	Sekretar/drejt.	26.03.2015	Dëftesa e pjekurisë është fotokopje dhe e pa noterizuar, nuk ka paraqitur CV.
5	S.B.	Mjeke/Urgj.	06.02.2015	Nuk ka paraqitur Librezë pune, nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, nuk ka çertifikatë familjare, nuk ka vërtetim banimi, nuk ka vërtetim për trajtim me ndihmë ekonomike.
6	Xh. H.	Sp/Prokurim.	01.02.2015	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, nuk ka paraqitur CV, nuk ka paraqitur Dëshmi penaliteti,

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

7	A.K.	Nendrej/Ekon.	11.05.2015	Dokumentacioni kualifikimit, Diplome, Liste notash, Kualifikime, jane fotokopje dhe jo te noterizuara, nuk ka paraqitur CV, Nuk ka paraqitur vertetim banimi, nuk ka paraqitur vertetim qe merr ndihme ekonomike, Certifikata familjare eshte jo origjinale dhe e panoterizuar, Raport Mjeko-Ligjor nuk eshte origjinal.
8	B.G.	Mjek/kirurg	06.05.2015	Nuk ka paraqitur dokument Identifikimi, Nuk ka paraqitur Raport Mjekoligjor per aftesi ne pune, nuk ka paraqitur vertetim banimi.
9	B.M.	Mjek/ortoped	01.07.2015	Deshmia e Penalitetit nuk eshte e 3muajve te fundit eshte me date 20,05,2014, Nuk ka Raport Mjeko Ligjor, Nuk ka paraqitur vertetim qe nuk merr ndihme ekonomike
10	K.D.	Farmaciste	22.09.2015	Nuk ka te noterizuar Dilpomën është rtjhfotokopje, Nuk ka paraqitur çertifikatë familjare, Nuk ka paraqitur Vërtetim Banimi.
11	E.M.	Sp/prokurim.	24.06.2016	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, nuk ka dokument identifikimi, nuk ka paraqitur CV, nuk ka Librezë pune, nuk ka paraqitur Dëshmi Penaliteti.
12	Gj. B.	Sp/biomjek	22.06.2016	Referuar shpalljes për pozicionin e punës është Mjek peditër dhe Neonat, të ketë përfunduar arsimin e lartë në mjeksi dhe të ketë pëspecializim përkatës për Pediatri dhe neonatologji, ndërkohë që punonjësi ka përfunduar studimet e larta për Inxhinieri Mekanike, Lista e notave është fotokopje e panoterizuar, Nuk ka paraqitur vërtetim banimi, nuk ka paraqitur vërtetim që nuk merr ndihmë ekonomike. Për më tepër që pozicioni i kërkuar nuk përkon me kualifikimin e personit punëkërkuar
13	E.Dh.	Mjeke	06.09.2016	Ka lidhur kontratë me datë 01,07,2011, me Ministrinë e Shëndetsisë, me Spitalin Rajonal Shkodër dhe Urdhërin e Mjekut, bazuar në VKM nr. 1282, datë 23.12.2009, "Për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata në Fakultetin e Mjeksisë të Universitetit të Tiranës". Kontrata fillon nga vitit 2011 deri në vitin 2015, duke detyruar specializantën të zbatojë afatet. Punonjësjë është emëruar në Spitalin Rajonal Shkodër me shkresën nr. 2164 prot, datë datë 05.09.2016. Theksojmë se kontrata është e pa prokolluar, e pa noterizuar. fotokopje, dhe nuk duket qartë vula e përfaqësuesit të Ministrisë së Shëndetsisë. Në dosjen personale nuk ka dokumentacion mbi pajisjen me diplomë pasuniversitare për specializimin e kryer. Dilpoma e paraqitur për Mjeksi të Përgjithshme të cilin e ka përfunduar në vitin 2006 është fotokopje e panoterizuar, nuk ka paraqitur listë notash për ciklin e studimeve të kryera. Nuk ka Dëshmi Penaliteti, si dhe dokumentacion e nevojshëm për pranimin e punonjësit në vendin e punës. Nuk ka paraqitur Liçencë për ushtrimin e profesionit (Urdhëri i Mjekut).
14	E.D.	Infermier	19.12.2016	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, Dëshmia e penalitetit është lëshuar me datë 06,11,2014, ndërkohë që punësimi është bërë me datë 02,12,2016, pra nuk ka paraqitur dëshmi penaliteti të 3-muajve të fundit sikurse kërkohet në shpallje.
15	I.Ç.	Inxh/Elekt.	10.02.2017	Diploma e dorëzuar nuk përputhet me pozicionin e punës pasi, i punësuar ka

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

				përfunduar studimet e larta për Inxhinieri Elektronike ndërkohë që pozicioni i punës është shpallur për Inxhinieri Elektrike, Nuk ka dokument identifikimi, nuk ka parqitur çerfitikatë familjare, nuk ka paraqitur vërtetim banimi
16	J.K.j	Laborante	06.04.2017	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, Nuk ka paraqitur vërtetim banimi.
17	M.M.	Oper/Kosto	01.08.2017	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, Diploma është për ekonomi-financë ndërkohë që një shpallje është kërkuar arsimit të lartë për infermieri, nuk ka leje për ushtrimin e profesionit sikurse është kërkuar.
18	G.U.	Sp/Biomjeksie	02.08.2017	Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, ka aplikuar në postë për Dëshmi Penaliteti referuar mandatit postar, por ende nuk e ka paraqitur për plotësimin e dosjes personale.
19	B.L.	Op/Menxh/Tekno.	03.10.2017	Nuk ka paraqitur dokument të kryerjes së shkolles së lartë për Infermieri sikurse është vendosur në kriteret e kërkuara, po ka dilpome për Drejtësi, Nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, Nuk ka paraqitur dilpomën e shkollës së mesme, Nuk ka paraqitur në momentin e plotësimit të dokumentacionit Raportin Mjekoligjor, por e ka me datë 12,01,2018. Nuk ka paraqitur vërtetim banimi, nuk ka paraqitur CV.

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

-Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave sikurse referuar dhe konkluzioneve për problematikat e konstatuara në tabelën më sipër rezulton se për 19 prej punonjësve të punësuar gjatë periudhës objekt auditimi, dokumentacioni në dosjen e personelit nuk është i rregullt dhe i plotë, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit. Ka mangësi të theksuara elementare dhe thelbësore dokumentacionit në dosjet personelit, si mospërputhja e arsimimit me pozicionin e punës, dëshmia e penalitetit, raportet mjekoligjore, diploma dhe listë notash fotokopje të panoterizuara etj, si dhe nuk janë të inventarizuara në përmbajtjen e tyre bazuar në dispozitat ligjore për këtë qëllim. Nga ana e burimeve njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për plotësimin e dosjes së personelit për punonjësit e mësipërm.

*Të gjitha këto veprime nuk i përmbahen Urdhrit nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, si dhe kriterëve të vendosura për plotësimin e dokumenteve që duhet të dorëzojnë punëkërkuarit pranë SRSH.*

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtori z.T.M., ish-drejtorja znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Komente dhe shpjegime të subjektit:* Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 40/5 prot, datë 21.05.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Shkodër, nga ish-drejtori i SRSH z.P.Ç.dhe z. T. M., në të cilin përcaktohet se:

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:*

Në lidhje me observacionin e bërë në lidhje me këtë akt-konstatim, mbi pretendimin e likujdimit të pagesave të vendimeve gjyqsore, sqarojmë se:

Përgjigje: Përsa i përket observimit të bërë nga z.P. Ç., ritheksojmë edhe njëherë se përgjegjësia bie mbi faktin e momentit të njohjes së Vendimit të Gjykatës i cili është titull ekzekutiv, pra duhet të likujdohej menjëherë nga ana juaj pa nisur procedurat përmbartimore të cilat janë shpenzime të tepërta për buxhetin e shtetit. Sa i përket largimeve nga puna për kohën në të cilën keni drejtuar, referuar vendimeve të Gjykatave, largimi është bërë në mënyrë të padrejtë, çka ka sjellë pasoja financiare për buxhetin e shtetit.

Gjithashtu sa i përket observacionit të bërë nga z.T. M. në lidhje me emërimet në punë të kryera në kohën e drejtimit të institucionit, risjellim në vëmendje se problematikat janë trajtuar hollësisht në aktkonstatim për mangësitë e dokumentacionit për marrjen në punë, pra nuk është paraqitur asnjë dokument që bie ndesh me konstatimin e grupit të auditimit.

*Nisur nga sa më sipër argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.*

#### **4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.**

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në për menaxhimin e aktiveve të spitalit, inventarët”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve për vitin 2015, së bashku me urdhërat dhe relacionet përkatëse.
- 2) Dokumentacion për inventarët e magazinave për vitin 2016, së bashku me relacionet përkatëse.

*Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezultoi që:*

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 4 e nenit 11 dhe të pikës 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në të cilin përcaktohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, Spitali Rajonal Shkodër ka kryer;

***Për vitin 2015;***

Me Urdhrin nr. 2364, datë 16.12.2015 është ngritur komisioni i inventarizimit për Spitalin Rajonal Shkodër, i cili përbëhet nga 7 grupe komisionesh i cili fillon me datë 17.12.2015 dhe përfundon me datë 31.12.2015, me përbërje si më poshtë; Për Administratë, Patologji-Neurologji, Dermatologji, Infektiv (përgjegjëse materiali Z.N.), është caktuar komisioni me përbërje V.B., V.F., A.P., V.L. dhe X.H. Për Spital civil, senatorium (përgjegjës material F,T), është caktuar komisioni me përbërje N.G., P.M., N.B., D.M., dhe E.P. Për Pediatria, Materniteti (përgjegjës material S. B.), është caktuar komisioni me përbërje A.M., K.M., E.F., B. H. dhe P.G. Për Poliklinikën (përgjegjëse materiale B.M.), është caktuar komisioni me përbërje A.Sh., E.K. dhe Dh. K. Për Farmacinë e Spitalit është caktuar komisioni me përbërje, M. K., N. Th. dhe M.K. Për Depon farmaceutike është caktuar komisioni me përbërje S.K., L. P. dhe L.G. Për Magazinën e ushqimit, magazina e konsumit, magazina e inventarit është caktuar komisioni me përbërje A. B., A. M. dhe B.B. Dokumentacioni duhet ti dorëzohet brenda afatit të përcaktuar znj.N. B.i shoqëruar me relacionet dhe deklaratat përkatëse.

Referuar relacionit me nr. 149 prot, datë 01.02.2016 të z.A.K.në cilësinë e nëpunësit zbatues, rezulton se komisionet e ngritura për inventarizimin e aktiveve të SRSH-së, kanë kryer procesin e inventarizimit dhe kanë pasqyruar në evidencat përkatëse gjendjen kontabël dhe gjendjen fizike si dhe diferencat e konstatuara. Në këtë relacion z.K. shprehet se në evidencën përmbledhëse të inventarit nuk janë paraqitur gjendja fizike për repartin e Spitalit civil dhe Adminsitratës me përgjegjës z.Gj. I.dhe PoliKlinika me përgjegjës material znj.J. K. të cilat janë mbyllur vetëm me gjendje kontabël pasi nuk u janë nënshtruar kontrollit fizik si të gjithë repartet e tjerë. Në evidencën e këtij relacioni konstatohet se janë kryer edhe asgjesime gjatë vitit 2015 në këto reparte me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr	Reparti	Përgjegjës reparti	Asgjesime në vlerën
1	Pediatria	S.B.	415,597
2	Materniteti	S.B.	531,628
3	Administrata	Zh.N.	783,098
4	Patologji-Neu-Dermat	Zh.N.	571,325
5	Infektivi	Zh.N.	210,017
6	Senatoriumi	F.T.	413,481
	Totali		2,927,146

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Në lidhje me të dhënat e mësipërme nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër është krijuar komision i posaçëm për asgjësimin e këtyre aktiveve, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me urdhërin nr. 1624 prot., datë 06.08.2015 janë krijuar komisioni i vlerësimit dhe komisioni i asgjësimit për disa materiale të cilat janë jashtë përdorimit. Komisioni i vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit përbëhet nga z.A.K. kryetar, si dhe anëtarët znj.A.M., znj.M. K., znj.J. Zh., znj.N. Gj., z.A.P., znj.S.K., znj.N.B. dhe znj.V. B. Ndërsa komisioni i asgjësimit përbëhet nga z.A. B. kryetar dhe anëtarët znj.B. B., znj.E. K., znj.A.Sh., znj.N. Th., znj.K. M.dhe z.D. Ll.

Gjatë vitit 2015 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive të imëta të cilat kanë përbërje material metal si shina perdeshe, reflektor me gaz, lugë inoksi, kazan alumini, thika, hanxharë, lugë, pirunj, brava dere, tenxhere 25litra, tepsi, tabake, aspirator, tenxhere alumini, kazanë alumini, stativ serumi, tuba bakri, rekorde bakri, tub shkarkimi, mbajtëse kondicioneri, kondicionerë, frigoriferë, peshore analitike, shtretër vizite, shtrat metalik, të cilat mund të vlerësoheshin dhe të nxirreshin në ankand për shitje skrap, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 102 dhe 109 i cili citon se;

*“Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose djegur”.*

***Veprime të cilat ngrakojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit z.A.K.dhe komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit.***

-Për vitin 2015 Spitali Rajonal Shkodër nuk ka hartuar regjistrë kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet), si dhe të gjitha objektet që në kontabilitet janë regjistruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33, i cili citon se;

*“Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

-Komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arësyet e gjendjes së tyre, si dhe për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, në kundërshtim me nenin 85 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

*“Komisioni i Inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës.”*

Nga sa më sipër rezulton, se nga drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër nuk janë marrë masat e duhura për kryerjen e procedurave të inventarit që duhet të kryhet në fund të vitit për të gjitha aktivitetet që ka në dispozicion SRSH, gjithashtu nga N/drejtori ekonomik nuk është marrë asnjë iniciativë për hartimin e të gjitha regjistrave kontabël në dispozicion, kryerjen e inventarit ekonomik dhe vlerësimit të të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktivitet afatshkurtra dhe detyrimeve dhe të drejtave, veprime në kundërshtim të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtori i SRSH znj.Dh. U. dhe z.A.K.N/Drejtor Ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues.***

Gjithashtu (sipas informacionit të vënë në dispozicion) konstatohet se z. Gj.I. është larguar nga puna me shkresën nr. 1053 prot, datë 24.10.2012, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga kontrolli i ushtruar nga KLSH për kontrollin e Ministrisë së Shëndetsisë për Projektin Rehabilitimi i Spitalit të Shkodrës Faza e III-të, për të cilin është dhënë masë disiplinore “Largim nga Puna”, punonjës me detyrë Përgjegjës Material pranë degës së hotelerisë në SRSH. Pasi është larguar nga puna z.I. nuk ka bërë dorëzimet për materiale të cilat i ka patur në ngarkim e cila sipas të dhënave të SRSH është në shumën totale prej 341,643,568 lekë, dhe për këtë fakt në korrik të vitit 2017 është hapur një procedim penal nga Drejtori i SRSH z.P.Ç.dhe ky proces është ende në hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

***Për vitin 2016;***

Me shkresën nr. 243 prot, datë 25.01.2017, urdhër i brendshëm, nga drejtori i SRSH janë krijuar komisione për kryerjen e inventarit fizik të magazinave në varësi të këtij institucioni dhe konkretisht për magazxinën e inventarit me përgjegjëse B.K. dhe komision J.Zh., N.Th.dhe L.G., magazina e ushqimeve me përgjegjës material H.P. dhe komision E. H., N.B. dhe A. G., magazina e konsumit me përgjegjës material A.M.dhe komision V. B.G. K.i dhe B. B., Puntë i Gjakut me përgjegjës material A.K. me komision F. Z., S.T.dhe P., Depoja Farmaceutike me përgjegjës material Zija M. dhe komision A.Sh., E. A. dhe L. P., Farmacia me komision inventarizimi z.A.V., Dh.K.dhe K.M. Komisionet inventari fizik do të fillojë me datë 25.01.2017 dhe do të përfundojë me datë 06.02.2017, inventarët do të dorëzohen brenda afatit të specialistja A.M.e cila do të hartojë dhe relacionin përfundimtar.

Me shkresën nr 553, datë 16.02.2017 është hartuar relacioni përfundimtar për inventarin fizik dhe kontabël të magazinave nga A.M.dhe M.N. Në këtë relacion drejtuar titullarit të SRSH janë krahasuar gjendja fizike dhe kontabël dhe nuk konstatohen diferenca.

Nga sa më sipër rezulton, se nga drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër nuk janë marrë masat e duhura për kryerjen e procedurave të inventarit që duhet të kryhet në fund të vitit për të gjitha aktivet që ka në dispozicion SRSH, gjithashtu nga N/drejtori ekonomik nuk është marrë asnjë iniciativë për kryerjen e inventarit ekonomik dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktivet afatshkurtra dhe detyrimeve dhe të drejtave, veprime në kundërshtim të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

***Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin e SRSH z.P.Ç., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z.A.K.në cilësinë e nëpunësit zbatues.***

***Për vitin 2017;***

Me shkresën nr. 2634 prot, urdhëri nr. 137, datë 18.12.2017, të drejtorit të SRSH janë krijuar komisionet për kryerjen e inventarizimit të institucionit me komision qëndror z.A.M. kryetare dhe anëtarët znj.S.K.dhe z.L.M. Afati i përfundimit të kryerjes së inventarit dhe dhe hartimi i relacionit përfundimtar është caktuar data 20.01.2018. Në lidhje me kryerjen e inventarit konstatohet se edhe gjatë fazës së auditimit procesi i inventarizimit nuk ka përfunduar dhe se nga ana e SRSH nuk është vënë asnjë dokumentacion në dispozicion për arësyet e mosrrespektimit të afatit të kryerjes së këtij procesi.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nga drejtuesi i SRSH z.V.M.nuk është kërkuar informacion dhe nuk janë marrë masat e duhura për përfundimin e këtij procesi, si dhe arësyet e mos përfundimit në afat të kryerjes së inventarizimit si dhe nuk janë nxjerrë shkaqet e vonës së tij nga personat përgjegjës.

Në komisionin qëndror të inventarizimit nuk është vendosur nëpunësi zbatues për ndjekjen e këtij procesi, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 87 dhe 93.

Gjithashtu në urdhërin e krijuar është vendosur znj.S.K. e cila është në pozicionin e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Shkodër, veprim ky i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 17, gërma a).

***Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi drejtuesin e SRSH z.V.M.***

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se Spitali Rajonal Shkodër, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet), si dhe të gjitha objektet që ka në kontabilitet janë regjistruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.

Nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë.

***Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin znj.Dh. U., ish-drejtorin z.P.Ç. dhe drejtorin aktual z.V.M.***

Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

*“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

Komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arësyet e gjendjes së tyre, si dhe për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, në kundërshtim nenin 85 gërma c, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*“Komisioni i Inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës.”.*

Në ambientet e Spitalit Rajonal Shkodër u konstatuan 5 autoambulanca të cilat nuk përdorehin dhe janë në gjendje të amortizuar, por nga drejtuesit e SRSH sipas secilës periudhë nuk është marrë ansjë masë për vlerësimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë bilancit si dhe shitjen nëpërmjet ankandit për skrap të tyre në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.

***Për këto veprime dhe mosveprime mban përgjegjësi ish-drejtori z.T.M., ish-drejtorja znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar.***

Për automjetet në dispozicion të SRSH, të cilat referuar kontabilitetit janë 19 mjete, rezultoi se disa prej tyre nuk kanë paguar taksat vjetore si dhe kolaudimin e tyre, çka përbën përveç gjenerimit të gjobave në sistemin e Drejtorive Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, dhe një rrezik për drejtimin e tyre pasi nuk janë certifikuar për të qarkulluar nga kompania e cila verifikon, teston dhe kolaudon fizikisht/teknikisht automjetet. Pra krahas mospagesës së taksave vjetore të cilat janë të detyrueshme, nuk janë kryer dhe kontrollet teknike, të cilat gjenerojnë gjithashtu gjoba në vetvete. Më poshtë jepen të dhënat për disa prej automjeteve të SRSH të cilat nuk kanë kryer këto detyrime;

Nr	Lloji i mjetit	Targa	Vlera e pa paguar	Gjobë	Totali
1	Autoveturë Benz Mercedes	SH 0635 C	63072	10964	74036
2	Autoambulancë Benz Sprinter	SH 9255 D	37590	7867	45457
3	Autoambulancë Benz Sprinter	SH 9094 D	45645	9881	55526
4	Autoambulancë Volkswagen T5	AA 380 KR	22765	3384	26149
5	Autoambulancë Volkswagen	SH 0172 E	81829	18428	100257
	<b>Totali</b>		<b>250901</b>	<b>50524</b>	<b>301425</b>

*Burimi të dhënave:; Spitali Rajonal Shkodër*

Gjithashtu nga informacione të SRSH konstatohet se këto automjete për periudhën objekt auditimi, dhe deri në datën e marrjes së këtij informacioni, nuk i kanë paguar detyrimet vjetore për arsye se disa automjete kanë dalë nga përdorimi

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

ndërkohë që rezultojnë në sistem të DRSHTRR se kanë detyrime për tu paguar. Pra nga ana e instucionit nuk janë marrë masat e duhura çdo vit për përmbushjen e këtyre detyrimeve, pra ç’rregjistrimin e mjeteve të cilat nuk janë në përdorim, çka ka sjellë si pasojë dhe pengesë për automjetet e tjera, pasi për kryerjen e taksave të automjeteve duhet që të mos ketë detyrime të automjeteve të tjera në dispozicion të të njëjtit Subjekt/Pronar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 8, dhe shuma prej 50,524 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

*Ngarkohen me përgjegjësi për veprime dhe mosveprime drejtori aktual z.V.M., ish-drejtori z.T.M., ish-drejtorja znj.Dh.U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar.*

**Në lidhje me gjendjen e inventarit për medikamentet e skaduara në SRSH**

-Referuar fletëve të inventarit të vitit 2015 konstatohet se ka medikamente të skaduara të akumuluar ndër vite të cilat u ka kaluar afati i përdorimit. Nga verifikimi fizik këto medikamente të skaduara ndodhen në ish-godinën e spitalit psikiatrik, shuma totale e tyre deri në dhjetor të vitit 2015 është 45,613,583 lekë. Ndërsa në farmaci ndodhen edhe medikamente dhe materiale mjekimi të tjera të evidentuara gjithashtu në inventarin këtij viti të cilat paraqiten në shumën 965,149 lekë.

-Referuar relacionit të inventarit të magazinave për vitin 2016 konstatohet një gjendje kontabël dhe fizike e barnave të skaduara të cilat janë në vlerën 47,692,636 lekë. Në lidhje me këtë konstatim nuk është kryer asnjë veprim për të nxjerrë arësyet e rritjes se kësaj shume nga gjendja e vitit 2015 e cila ishte në shumën 45,613,583 lekë, pra kemi një rritje në shumën 2,079,053 lekë me medikamente të skaduara vetëm për vitin 2016.

Në lidhje me gjendjen e medikamenteve të akumuluar, u kërkua nga grupi i auditimit të konkludohej për saktësuar shumën totale të mbartur ndër vite dhe të akumuluar gjatë periudhës objekt auditimi.

-Gjithashtu nga informacioni i kërkuar në lidhje me këtë fakt konstatohet se medikamentet e skaduara në depo të akumuluar për vitin 2017 janë në shumën 1,117,558 lekë.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për medikamentet e skaduara dhe të akumuluar ndër vite rezulton se nga ana e drejtuesve të SRSH nuk janë marrë masat e duhura për analizimin e rritjes ndër vite të kësaj sasive, shkaqet e skadimit dhe mospërdorimit të tyre, *si dhe nuk janë marrë masat për evadimin/asgjesimin e tyre, pasi mbeturinat farmaceutike përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut, dhe ky rrezik vjen si rezultat i materieve të ndryshme helmuese që përmbajnë ato dhe që përbejnë një rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut por edhe për ambientin në tërësi, pasi si rrjedhojë e ekspozimit ato mund të sjellin pasojë alergjike, efekte anësore, ndotje të ambientit dhe rezistencë ndaj antibiotikëve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Funkcionimit Teknik të Spitalit Rajonal Shkodër.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Si përfundim në lidhje me medikamentet e skaduara konstatohet se shuma totale deri në 31.12.2017 është në **49,775,343 lekë**, e cila përbën një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe një përdorim të fondeve në mospërputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efektivitetit në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.*

*Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi për veprime dhe mosveprime drejtorin aktual z.V.M., ish-drejtorja znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., dhe z.A. K.*

**Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:**

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

- 1) Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar,
- 2) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe
- 3) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- 1) Z. V.M. me detyrë, Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 2) Znj.Dh.U.me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 3) Z.P.Ç. me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 4) Z.A. K.me detyrë N/Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.

➤ *Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:*

- 5) Pasqyrat Financiare për vitin 2015,
- 6) Pasqyrat Financiare për vitin 2016, shkresat përcjellëse të tyre si dhe informacione shpjeguese në lidhje me to.

**Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:**

Spitalin Rajonal Shkodër, gjatë periudhës objekt auditimi ka zhvilluar një aktivitet normal në menaxhimin e fondeve publike. Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë regjistruar në regjistrat kontabël dhe në programin excel.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Bilancet e çdo viti janë përgatitur brënda datës së fundit të muajit shkurt të vitit pasardhës dhe janë dërguar brenda afatit ligjor në degën e Thesarit Shkodër, shoqëruar me shkresat përcjellëse rrespektive për secilin vit dhe janë dërguar gjithashtu Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht me shkresën nr. 299 prot, datë 29.02.2016 janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2015, dhe me shkresën nr. 621 prot, datë 27.02.2017 janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2016.

Të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin excel pasi insitucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nëvojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar duke vazhduar duke vepruar në mospërputhje dhe kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar.

***Për këto veprime dhe mosveprime mbajnë përgjegjësi ish-drejtori z.T.M., ish-drejtorja znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe nëpunësit zbatues për secilin vit përkatës.***

*Për pasqyrat financiare të vitit 2015 (Aktivi);*

Aktivët e qëndrueshme paraqiten në bilanc në vlerën 2,047,273,691 lekë e cila përbëhet nga:

Aktive të qëndrueshme të trupëzuara në vlerën 2.047.273.691 lekë të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

*Burimi*

Nr	Aktive të qëndrueshme	Gjendja me 31.12.2014	Hyrje	Dalje	Gjendja me 31.12.2015	Ndryshimi
202	Studime	390,000			390,000	0
210	Toka,troje, Terene	22,786,720			22,786,720	0
212	Ndertime e K.e	1,100,905,775	3,769,057	0	1,104,674,832	3,769,057
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	586,134,550	108,099,411	0	694,233,961	108,099,411
215	Mjete transporti	47,196,423	7,972,000	0	55,168,423	7,972,000
218	Inventar ekonomik	169,072,902	946,853	0	170,019,756	946,853
	Totali	1,926,486,370	120,787,321	0	2,047,273,691	120,787,321

*të*

*dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Ndërtime me vlerë 1.104.674.832 lekë,ka një shtesë prej 3,769.057 lekë nga viti 2014 e cila ka të bëjë me- ri K. e ambienteve të angiografissi, projektin në vlere 3.411.756 lekë, si dhe hapje hapsire për parking në vlere 357.301 lekë 2.Inst.teknike,makineri,paisje,vegla pune me vlerë 694.233.961 lekë.Në krahasim me vitin 2014 ka pasur rritje në vlerën 108,099,411 lekë, blerje nga buxheti i shtetit 103.738.411 lekë.furnizim vendosje rezonance me vlere 95.520.000 lekë Blerje paisje për reanimacionin e pediatrie 8.218.411 lekë 2,121,000 lekë Blerje nga të ardhurat dytesore ,2,138,000 lekë ndima. Mjete transporti me vlere 55.168.423 lekë shumë e cila është shtuar për 7.972.000 si rezultat i dhurimit të nje autoambulance nga “Traveland help” dhe nje autoambulance të sjelle nga Ministria e Shendetesise me vlere 7.482.000. Zëri Inventar ekonomik paraqitet me vlerë 170.019.756 lekë. Në krahasim me vitin 2014 inventari ekonomik ka pasur shtesë në vlerën 946,854 lekë që ka ardhur si rezultat i blejeve nga të ardhurat dytesore në vlerën 901,354 lekë nga ndihmat në vlerën 45.500 lekë.

Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme

Nr	Amortizimi i akumuluar	Gjendja me 31.12.2014	Shtese	Pakësim	Gjendja me 31.12.2016	Ndryshimi
	Llog 219	625,536,249	57,534,202	0	683,070,451	57,534,202

*Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Shkodër*

Llogaritja e normave vjetore të amortizimit të aktiveve të qëndrueshme është bërë sipas udhëzimit të MF nr.14, datë 28/12/2006, “Procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2006”

Aktivet Qarkulluese.

Nr llog	Aktive qarkulluese	Gjendja me 31.12.2015	Gjendja me 31.12.2014	Ndryshimi
31	Materiale	96,137,629	86,550,520	9,587,109
32	Objekt inventari	17,800,531	20,567,131	-2,766,600
	Totali	113,938,160	107,117,651	6,820,509

*Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Shkodër*

Evidenca analitike e llogarisë Kërkesë arkëtimi mbi debitorët.

Nr	Nr.Llog	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2014	Gjendja.31.12.2015	Ndryshimi
1	411,418	Klientë e llogari të	189,296	189,296	0

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

		ngjashme			
2	423,429	Personeli paradhenje defiçite dhe gjoba	4,009,909	3,659,333	-350,576
3	4342	Te tjera operacione me shtetin	105,405,135	96.260.906	-9,144,229
4	468	Debitorë të ndryshëm	14,614	14.614	0
		T o t a l i	109,618,954	100,124,149	-9,494,805

***Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Shkodër***

Llogaria 4342 të tjera operacione me shtetin(Debitor) paraqiten me vlerën 96,124, lekë kjo shumë ka lidhje me pasivin e bilancit, klasa 4 dhe përbën financimin e pritshëm me kundraparti llogaritë e pasivit 401,421,431,435,436. Llogaria 429 është debituar për shtesat që janë bërë gjatë vitit 2015 dhe kredituar për pagesat. Kjo llogari përfshin detyrimin e punonjësve kundrejt institucionit dhe ka pësuar ulje në krahasim me vitin paraardhës në vlerën 350,576 lekë si rrjedhojë e ndalesave të kryera në vazhdimësi. Këto detyrime i përkasin vitit 2013 shuma 129,100l lekë, pra janë detyrime të prapambetura të lëna nga kontrolli i DRSKSH Shkodër ndërsa vlera 3,530,233 janë detyrime të lëna nga kontrolli i Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 2014. Shuma e detyrimit prej 3.659.333 lekë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr	E m ë r t i m i	Detyrimi
1	M.Q.	17.100
2	S.N.	18.000
3	S.M.	18.000
4	S.Z.	18.000
5	Gj.I.	19.000
6	E.G.	20.000
7	N.H.	19.000
8	B.	60.000
9	R.D.	97.687
10	S.N.	22.050
11	M.N.	48.284
12	Z.F.	81.834
13	A.D.	3.000

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

14	E. G.	1.240.432
15	I.H.	47.360
16	N.K.	1.929,586
	<b>T o t a l i</b>	<b>3.659,333</b>

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Llogaria 468 nuk ka shtesë me vitin paraardhës. Llogari të tjera aktive grupi 50, i cili paraqitet me vlerën 19,100,013 lekë dhe pasqyron llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” shumë e cila do përdoret për vitin pasardhës. Shuma prej 19,100,013 lekë janë të ardhura dytësore të pa përdorura të cilat trashëgohen për vitin pasardhës si dhe llogaria 466 mjete në ruajtje. Kjo llogari ka lidhje me pasivin e bilancit, klasa e 4 detyrimi afatshkurtër, e cila paraqitet në bilanc me vlerë 104,159,446 lekë pasi në të është përfshirë llog 466 kreditore përjetë në ruajtje me vlerë 8,246,510 lekë dhe shuma prej 310,391 lekë paga nga të ardhurat dytësore për punonjësit me kontratë cila do të likujdohet vitin pasardhës. Totali i aktivitet është 1,593,479,960 lekë.

Fondet e veta (Pasivi)

Ky grup përfshin pasurinë e institucionit të trashëguar dhe të krijuar nga aktiviteti i vitit ushtrimor si kapitalizim fondesh të përdorura për investime të përfunduara dhe të papërfunduara dhe për aktivet e veta qarkulluese. Vlera prej 1,477,520,619 lekë në pasiv të bilancit shpreh vlerën e llogarise “Fonde të veta”. Krahasuar me vitin 2014 ka patur shtesë të fondeve në vlerën 63,527,569 lekë.

Detyrimet.

Evidenca e llogarive të klasës 4 “Detyrime afatshkurtër” në pasiv të bilancit paraqitet si më poshtë:

Nr.llog	E m ë r t i m i	Gjendje më 31.12.2014	Gjendje më 31.12.2015	Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	17.593.616	12.788.342	-4.805.274
421	Personeli e llogari të lidhur me to	29.834.471	29.288.290	-546.181
431	Detyrime ndaj shtetit tatim-taksa	1.631.031	2.019.486	388.455
4341	Të tjera operacione me shtetin(kredit)	4.213.831	3.863.245	-350.586
435	Sigurime shoqërore	8.873.229	8.910.926	37.697
436	Sigurime Shëndetsore	1.232.592	1.239.965	7.373
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	3.303657	8.246.510	4.942.853
467	Kreditorë të ndryshëm	38.027.894	37.802.682	-225.212

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

	Totali	104.710.321	104.159.446	-550.875
--	--------	-------------	-------------	----------

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Llogaria 401 furnitorë në fund të vitit praqitet në vlerën 12,788,342 lekë duke pesuar ulje në vlere 4,805,274, nga 17,593,616 që ishte në 31.12.2014, kjo ka ardhur si rezultat i likujdimit të detyrimeve të prapambetura për të cilat janë akorduar fonde nga Komiteti i detyrimeve të prapambetura. Detyrimi prej 12,788,342 janë detyrime të prapambetura që datojne nga viti 2004 deri në vitin 2011 pjesa me e madhe e ketyre detyrimeve janë me mungese dokumentacioni. Llogaritë 421,431,435,436 përfaqësojnë detyrimet e institucionit ndaj punonjësve të tij për paga, tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2015 të cilat do të likujdohen në fillim të vitit 2016 likuidim. Llogaria 4341 është kundërparti e llogarisë 429 në aktiv në vitin parardhës. Llogaria 467 në shumën 37.802.682 lekë përfaqëson detyrime të muajit dhjetor për energji elektrike, uji, shërbimet postare, telefonin etjer në vlere 5,831,623 lekë që do të likujdohen në vitin në vazhdim ndersa shuma 32,163,228 lekë janë detyrime të prapambetura ndaj ujsjellsit që iu përkasin viteve 2010, 2011 dhe 2013 për të cilat nuk janë akorduar asnjehere fonde nga komiteti i detyrimeve të prapambetura. Llogaria 466 përfaqëson 5% të ngurtësimit të investimeve, me kundraparti llogarinë 520-Disponibilitete në thesar. Totali i pasivit është i barabartë me totalin e aktivitet në vlerën 1,593,479,960 lekë.

*Për pasqyrat financiare të vitit 2016 (Aktivi):*

Aktivitet e qëndrueshme paraqiten në bilanc në vlerën 2,108,522,417 lekë të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Ndërtime	Nr	Aktive të qëndrueshme	me vlerë				
			Gjendje me 31.12.2015	Hytje	Dalje	Gjendja me 31.12.2016	Ndryshimi
	210	Toka,troje,terene	22,786,720			22,786,720	0
	212	Ndërtime e K.e	1,104,674,832	19,718,600	0	1,124,393,432	19,718,600
	214	Instalime, teknike, makineri,paisje,vegla pune	694,233,961	3,812,067	0	698,046,028	3,812,067
	215	Mjete transporti	55,168,423	2,000,000	0	57,168,423	2,000,000
	218	Inventar ekonomik	170,019,755	36,447,658	339,599	206,127.814	36,10,059
		Totali	2,046,883,691	61,978,325	339,599	2,108,522,417	61,638,726

1,124,393,432 lekë në të cilat ka një shtesë prej 19,718,600 lekë nga viti 2015 e që ka të bëjë me ri K. e ambienteve të angjografisë në vlerën 3,541,992 lekë, gjithashtu është kryer rikonstuksioni i ambienteve të reanimacionit në vlerën

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

14,970,608 lekë, projekt zbatimi për reanimacionin në vlerën 816,000 lekë, si dhe studime e projektme për shumën 390,000 lekë lëvizje brenda aktiveve.

Zëri ndërtesa dhe troje sipas kontabilitetit të SRSH evidentohet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i Pasurisë			
	Ndërtesa	Vlera kontabël	Troje	Vlera kontabël
1	Spitali i Ri	696,868,945	Spitali Civil	2,499,920
2	Lavanderia e Spitalit	3,646,000	Spitali Pediatrik	7,570,000
3	Magazina Zyra Biblioteka	1,734,000	Spitali Psikiatrik	4,148,000
4	Pediatria	97,219,192	Materniteti	3,228,000
5	Psikiatriku	74,278,098	Senatoriumi	1,996,800
6	Morgu	380,000	Spitali Civil	2,645,000
7	Materniteti	31,198,200	PoliF.T.	699,000
8	Senatoriumi	18,097,745		
9	Infektivi	16,316,000		
10	PoliF.T. Qytet	14,926,000		
11	PoliF.T. Dergut	7,965,000		
12	Kirurgjia	38,062,030		
13	Muri rethues i Spitalit	14,400,000		
14	Shtepia Mimoza 1	10,108,286		
15	Shtepia Mimoza 3	52,623,120		
16	Shtepia Mimoza 2012	9,175,885		

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Në lidhje me zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRSH, rezultojnë se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie, nga ana e drejtuesve të këtij institucioni për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për ti regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

***Për këto veprime e mosveprime ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtorja znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar.***

Zëri Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune paraqiten me vlerën 698,046,028 lekë. Në krahasim me vitin 2015 ka pasur rritje në vlerën 3,812,067 lekë, blerje nga buxheti i shtetit në vlerën 178,080 lekë. Nga dhurimet kemi një shtesë në vlerën totale prej 3,633,987 lekë, të cilat përfaqësojnë pajisje mjeksore në vlerën 3,285,126 lekë donacion nga Koperacioni Presilding Bishop Kisha Jezu Krishti, pajisje spitalore në vlerën 37,000 lekë nga Shoqata Sh. , monitor në vlerën 274,660 nga Shoqata The DOOR, dhe pjesë pajisjesh të Pediatrisë në vlerën 37,200 lekë nga subjekti MED-FAU. Mjete transporti me vlerën 57,168,423 lekë, shumë e cila është shtuar për 2,000,000 si rezultat i ndihmave të tjera të ardhura për Spitalin Rajonal Shkodër. Inventar ekonomik me vlerë 206,127,814 lekë. Në krahasim me vitin 2015 inventari ekonomik ka pasur shtesë në vlerën 36,447,658 lekë nga të cilat 414,000 lekë blerje paisje e mobilje për zyrat nga të ardhurat dytësore, pjesa tjetër prej 36,033,658 lekë i përket Sistemit të informatizimit nga Ministria e Shëndetësisë. Në lidhje me daljet në inventarin ekonomik në shumën 339,599 lekë kjo vlerë është material inventar i imët të cilat kanë dalë jashtë përdorimi, për të cilat është krijuar dhe Komisioni përkatës.

Llogaria 468 nuk ka shtesë me vitin paraardhës. Llogari të tjera aktive, grupi 50, paraqitet me vlerën 26,066,938 lekë e që pasqyrojnë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” shumë e cila do përdoret për vitin pasardhës. Shuma prej 26,066,938 lekë janë të ardhura dytësore të pa përdorura të cilat trashëgohen për vitin pasardhës dhe llogaria 466 mjete ne ruajtje. Totali i aktivitetit është 1,614,584,268 lekë. Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nr	Amortizimi i akumuluar	Gjendje me 31,12,2015	Shtese	Paksim	Gjendja me 31,12,2016	Ndryshimi
	Llog 219	683,070,451	64,733,636	339,599	747,464,488	64,394,037

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Për aktivet të cilat janë aktualisht në përdorim të Spitalit Rajonal Shkodër nuk ekziston regjistri i aktiveve sipas Udhëzimit nr 30, kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes tyre” pika 30 citon: “*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia*”. Për këto aktive është llogaritur dhe regjistruar norma përkatëse e amortizimit vjetor dhe amortizimit të akumuluar, mbështetur në normat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Udhëzimit të MF nr.14, datë 28/12/2006, “Procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2006”.

**Aktivët Qarkulluese.**

Nr llog	Aktive qarkulluese	Gjendja me 31.12.2016	Gjendja me 31.12.2015	Ndryshimi
31	Materiale	114,735,881	96,137,629	18,598,252
32	Objekt inventari	19,202,802	17,800,531	1,402,271
	<b>Totali</b>	<b>133,938,683</b>	<b>113,938,160</b>	<b>20,000,523</b>

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

**Evidenca analitike e llogarisë Kërkesa arkëtimi mbi debitorët.**

Nr	Nr.Llog	Emërtimi	Gjendje me 31.12.2015	Gjendje me 31.12.2016	Ndryshimi
1	411,418	Klientë e llogari të ngjashme	189,296	189,296	0

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

2	423,429	Personeli paradhenje deficiente dhe gjoba	3,659,333	3.484.083	-175,.250
3	4342	Te tjera operacione me shtetin	91,739,300	89,196,722	-2,542,578
4	468	Debitorë të ndryshëm	14,614	14,614	0
		T o t a l i	95,602,545	92,884,717	-2,717,828

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Llogaria 4342 Të tjera operacione me shtetin (Debitor) me vlerën 89,196,722 lekë ka lidhje me pasivin e bilancit, klasa 4 dhe përbën financimin e pritshëm me kundraparti llogaritë e pasivit 401,421,431,435,436. Llogaria 429 është debituar për shtesat që janë bërë gjatë vitit 2016 dhe kredituar për pagesat. Kjo llogari përfshin detyrimin e punonjësve kundrejt institucionit dhe ka pësuar ulje në krahasim me vitin paraardhës në vlerën 175,250 lekë si rrjedhojë e ndalesave të kryera në vazhdimësi. Këto detyrime i përkasin vitit 2013 shuma 129,100 lekë, pra janë detyrime të prapabitura të lëna nga kontrolli i DRSKSH Shkodër ndërsa vlera 3,354,983 janë detyrime të lëna nga kontrolli i Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 2014. Shuma e detyrimit prej 3,484,083 lekë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr	E m ë r t i m i	Detyrimi
1	M.Q.	17.100
2	S.N.	18.000
3	S.M.	18.000
4	S.Z.	18.000
5	Gj.I.	19.000
6	E. G.	20.000
7	N.H.	19.000
8	B.	60.000
9	R.D.	97.687
10	S.N.	22.050
11	M.N.	48.284
12	Z.F.	81.834
13	A.D.	3.000
14	E.G.	1.240.432
15	I.H.	47.360

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

16	N.K.	1.754.336
	T o t a l i	3.484.083

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Lista e debitorëve është lista e personave të cilët kanë një detyrim të caktuar ndaj institucionit, e cila është pasqyruar edhe në bilancin e vitit 2015 dhe në fund të vitit 2016 ka një vlerë prej 3,484,083 lekë të krijuara nga kontrollet e ushtruara nga Ministria e Shëndetsisë dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetsor. Kjo shumë është ulur në krahasim me detyrimet e paraqitura në bilancin e vitit 2015, si rezultat i një likujdimi në shumën prej 175,250 lekë nga z.N.K. Në fund të vitit 2016 janë 16 persona/subjekte të debitorë. Në lidhje me këto detyrime debitore institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin dhe menaxhimin e debitorëve dhe nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite. Institucioni u ka dërguar personave debitorë urdhër për arkëtim por nuk e ka vazhduar më tej me ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre. Gjithashtu nga drejtuesi aktual dhe titullarët sipas secilës periudhë përkatëse nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e këtyre vlerave. Përpos urdhrave të hartuar, institucioni nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar në mospërputhje me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011, Pika IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, dhe *shuma prej 3,484,083 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.*

***Për këto veprime e mosveprime ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtorin znj.Dh. U., ish-drejtori z.P.Ç., sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar.***

Llogaria 468 nuk ka shtesë me vitin paraardhës. Llogari të tjera aktive, grupi 50, paraqitet me vlerën 26,066,938 lekë e cila pasqyron llogarinë 520” Disponibilitete në thesar” shumë e cila do përdoret për vitin pasardhës. Shuma prej 26,066,938 lekë janë të ardhura dytësore të pa përdorura të cilat trashëgohen për vitin pasardhës dhe llogaria 466 mjete ne ruajtje. Totali i aktivitet është 1,614,584,268 lekë.

Fondet e veta (Pasivi)

Ky grup përfshin pasurinë e institucionit të trashëguar dhe të krijuar nga aktiviteti i vitit ushtrimor si kapitalizim fondesh të përdorura për investime të përfunduara dhe të papërfunduara dhe për aktivet e veta qarkulluese. Vlera prej 1,494,996,614 lekë në pasiv të bilancit shpreh vlerën e llogarise “Fonde të veta”. Krahasuar me vitin 2015 ka patur shtesë të fondeve në vlerën 17,475,995 lekë.

-Detyrimet.

Evidenca e llogarive të klasës 4 “Detyrime afatshkurtër” në pasiv të bilancit paraqitet si më poshtë:

Nr.llog	E m ë r t i m i	Gjendje më	Gjendje më	Ndryshimi
---------	-----------------	------------	------------	-----------

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

		31.12.2015	31.12.2016	
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	12.788.342	12.788.342	0
421	Personeli e llogari të lidhur me to	29.288.290	28.357.419	-930.871
431	Detyrime ndaj shtetit tatim-taksa	2.019.486	1.577.650	-441.836
4341	Të tjera operacione me shtetin(kredit)	3.863.245	3.687.995	-175.250
435	Sigurime shoqërore	8.910.926	8.282.455	-628.471
436	Sigurime Shëndetsore	1.239.965	1.150.894	-89.071
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	8.246.510	1.713.911	-6.532.599
467	Kreditorë të ndryshëm	37.802.682	38.163.228	360.546
	<b>T o t a l i</b>	<b>104.159.446</b>	<b>95.721.894</b>	<b>-8.437.552</b>

*Burimi të dhënave: Spitali Rajonal Shkodër*

Llogaria 401 në fund të vitit praqitet në vlerën 12,788,342 lekë. Detyrimet në shumën prej 12,788,342 lekë janë detyrime të prapambetura që datojnë nga viti 2004 deri në vitin 2011, dhe pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve janë me mungesë dokumentacioni. Llogaritë 421,431,435,436 përfaqësojnë detyrimet e institucionit ndaj punonjësve të tij për paga, tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2016 të cilat do të likujdohen në fillim të vitit 2017 likuidim. Llogaria 4341 është kundërparti e llogarisë 429 në aktiv në vitin parardhës.

Llogaria 467 në shumën 38,163,228 lekë përfaqëson detyrime te muajit dhjetor per energjinë elektrike, uji, shërbimet postare, shërbime telefonike, etj., në vlerën 5,831,623 lekë që do të likujdohen vitin pasardhës.

Shuma 32,163,228 lekë janë detyrime të prapambetura ndaj Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha., Shkodër që i përkasin viteve 2010, 2011, 2013 për të cilat nuk janë akorduar asnjëherë fonde nga komiteti i detyrimeve te prapambetura. Llogaria 466 përfaqëson 5% të ngurtësimit të investimeve, me kundraparti llogarinë 520-Disponibilitete në thesar. Totali i pasivit është i barabartë me totalin e aktivitetit, në shumën 1,614,584,268 lekë.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

- 4) Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar,
- 5) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- 6) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- 5) Z. T.M.me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 6) Znj.Dh.U.me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 7) Z.P.Ç. me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 8) Z.A. K.me detyrë N/Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.

Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 40/5 prot, datë 21.05.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Shkodër, nga ish-drejtori i SRSH z.P.Ç.në lidhje me akt-konstatimin nr.2, në të cilin citohet se;

Në lidhje me observacionin e bërë në lidhje me këtë akt-konstatim, mbi pretendimin e procesit të inventarizimit, sqarojmë se:

Përgjigje: Përsa i përket observimit të bërë, sqarojmë se nga ana juaj nuk është vënë asnjë dokumentacion apo bazë ligjore i cili bie ndesh me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit.

*Argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.*

#### **5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike dhe lidhjen e kontratave.**

Për periudhën objekt auditimi 2015-2017 rezulton se janë realizuar **84** procedura prokurimi me vlerë **725,094,398** lekë me TVSH dhe **20** procedura me blerje të vogël me vlerë **7,262,472 lekë me TVSH**. Të ndara sipas viteve rezultojnë si vijon:

**Për vitin 2015;** Janë zhvilluar në total 23 procedura prokurimi, përfshirë këtu edhe ato të përqëndruara. Nga këto, 15 procedura prokurimi, janë zhvilluar dhe realizuar nga SRSH. Pjesa tjetër, 5 procedura nga Ministria e Shëndetësisë, 3 procedura të mbartura nga vitet parardhëse që kanë të bëjnë me mirëmbajtje aparaturash dhe kontratat shtesë të cilat paraqiten si shpenzim në total (siç janë vënë në dispozicion nga SR Shkodër) dhe jo sipas objekteve të tyre dhe që janë audituar të gjitha por nga grupi i auditimit, në projekt-raport dhe në raportin përfundimtar, janë pasqyruar vetëm ato procedura prokurimi për të cilat janë konstatuar mangësi. Tek lista bashkangjitur, procedurat e prokurimit të selektuara, janë audituar të gjitha. Në total, nga 23 procedura prokurimi të zhvilluara nga SR Shkodër, janë audituar 9 procedura prokurimi (pa përfshirë kontratat shtesë) ose 39.1 % e tyre. Nga grupi i auditimit, kanë rezultuar me mangësi 26 % e procedurave të realizuara pa përfshirë kontratat shtesë.

**Për vitin 2016;** Janë zhvilluar në total 31 procedura prokurimi, përfshirë këtu edhe ato të përqëndruara. Nga këto, 19 procedura prokurimi janë zhvilluar dhe realizuar nga SR Shkodër. Pjesa tjetër, 7 procedura nga Ministria e Shëndetësisë dhe 5 procedura janë të mbartura nga vitet parardhëse që kanë të bëjnë me mirëmbajtje aparaturash, blerje medikamentesh dhe kontratat shtesë të cilat paraqiten si shpenzim në total (siç janë vënë në dispozicion nga SR Shkodër) dhe jo sipas objekteve të tyre dhe që janë audituar të gjitha por nga grupi i auditimit, në projekt-raport dhe në raportin përfundimtar, janë pasqyruar

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

vetëm ato procedura prokurimi për të cilat janë konstatuar mangësi. Tek lista bashkangjitur, procedurat e prokurimit të selektuara, janë audituar të gjitha. Në total, nga 31 procedura prokurimi të zhvilluara nga SR Shkodër, janë audituar 19 procedura prokurimi (pa përfshirë kontratat shtesë) ose 61 % e tyre. Nga grupi i auditimit, kanë rezultuar me mangësi 45 % e procedurave të realizuara pa përfshirë kontratat shtesë.

**Për vitin 2017;** Janë zhvilluar në total 27 procedura prokurimi, përfshirë këtu edhe ato të përqëndruara. Nga këto, 17 procedura prokurimi janë zhvilluar dhe realizuar nga SR Shkodër. Pjesa tjetër, 4 procedura nga Ministria e Shëndetësisë dhe 6 procedura janë të mbartura nga vitet parardhëse që kanë të bëjnë me mirëmbajtje aparaturash, blerje medikamentesh dhe kontratat shtesë të cilat paraqiten si shpenzim në total (siç janë vënë në dispozicion nga SR Shkodër) dhe jo sipas objekteve të tyre dhe që janë audituar të gjitha por nga grupi i auditimit, në projekt-raport dhe në raportin përfundimtar, janë pasqyruar vetëm ato procedura prokurimi për të cilat janë konstatuar mangësi. Tek lista bashkangjitur, procedurat e prokurimit të selektuara, janë audituar të gjitha. Në total, nga 27 procedura prokurimi të zhvilluara nga SR Shkodër, janë audituar 17 procedura prokurimi (pa përfshirë kontratat shtesë) ose 62.9 % e tyre. Nga grupi i auditimit, kanë rezultuar me mangësi 37 % e procedurave të realizuara pa përfshirë kontratat shtesë.

**Nga auditimi me zgjedhje për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, u audituan procedurat e prokurimit, të cilat u gjykuan si më të rëndësishme që lidhen me objektin e veprimtarisë kryesore të Spitalit Rajonal Shkodër, ku rezultoi që:**

U audituan gjithsej procedura prokurimi me vlerë (në total) të fondit limit 125,368,890 lekë të kryera nga SRSB, pa përfshirë te kjo vlerë, procedurat e prokurimit të përqëndruara të cilat, janë audituar pothuajse të gjitha për sa i përket zbatimit të kontratave. Shuma e kontratave të nënshkruara nga Ministria e Shëndetësisë për llogari të SRSB është 328,129,082 lekë me TVSH.

*Për periudhën 14 janar 2014 deri 06 Dhjetor 2017, konstatohet se Titullarët e Spitalit Rajonal Shkodër nuk kanë nxjerrë Urdhër të Brendshëm “Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit” në fillim të vitit, në kundërshtim me LPP. Për vitin 2017 nga Titullari i SRSB është nxjerrë Urdhër i brendshëm “Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit” me nr. prot. 182, datë 19.01.2017.*

Nga auditimi me zgjedhje mbi zbatimin e procedurave të prokurimit, rezulton si vijon:

### **5.1 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje shtypshkrime”**

Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “Blerje shtypshkrime” me të dhënat e paraqitura në tabelë rezultoi si më poshtë vijon:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje shtypshkrime”.		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.27 datë 3.5.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>  Xh.H. E.H. B.L., sipas urdhrit nr.27, datë 3.5.2017	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Sipas Urdhrit Administrativ nr. 142 prot, datë 14.06.2017 1. G.N. (Kryetar) 2. H.G. (Anëtar) 3. N.B. (Anëtar)
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Procedurë elektronike, Këkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,000,000 Lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>820,890 Lekë pa TVSH</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> <b>179,110 lekë pa TVSH</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 19.06.2017 Ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>3 OE</b> b)S’kualifikuar – 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 4.7.2017, nr.prot. 1593.	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 985,068 lekë	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - 120,000 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 102, datë 28.08.2017 - 174,000 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 103, datë 28.08.2017 - 87,108 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 101, datë 28.08.2017 - 44,160 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 79, datë 6.07.2017 - 231,960 lekë me TVSH, sipas fatures tat. *, datë 28.07.2017 - 307,080 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 116, datë 13.10.2017 - 20,760 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 117, datë 13.10.2017 Për marrjen në dorëzim të materialeve Titullari i SRSH ka nxjerrë urdhëra të brendshëm për ngritjen e komisionit për lëvrimet e mësipërme.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Titullari i Ak, P.Ç. sipas urdhrorit të brendshëm nr. 52, datë 06.04.2017 ka ngritur komisionin për llogaritjen e fondit limit të përbërë nga: H.G. kryetar dhe anëtarët J.ZH. dhe B.L.

Njësia e prokurimit sipas procesverbalit me nr. 47 prot, datë 05.06.2017 ka njoftuar 5 operatore ekonomik si dhe ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar nr. 49, datë 19.06.2017 hyri në sistemin elektronik ku rezultoi se janë paraqitur operatorët teknik:

1. SH.B.
2. T.
3. R.G.

KVO sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit vendosi:

**Operatorë ekonomik të skualifikuar: 1. SH.B., 2. TIM.**

**Operatorë të kualifikuar: R.G.**

- Sipas Raportit Pëmbledhës me nr. prot. 163, datë 03.07.2017 KVO bën përshkrimin e tenderit dhe i propozon për miratim Titullarit të AK.

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me datë 03.07.2017, nr. prot. 1568 dhe njoftimi në Buletinin e APP është bërë me datë 27.07.2017.

- Kontrata e furnizimit me objekt “Blerje shtyp shkrime” është bërë me datë 04.07.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe nga Kontraktuesi shoqëria “R.G.” përfaqësuar nga znj. L.J. Vlera e kontratës është 985,068 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10% është bërë me datë 1.07.2017 në Kompaninë I.

*Nga verifikimi rezultoi që: Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, në VKM Nr. 914, datë 12.4.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, por u konstatuan edhe këto parregullsi:*

**1. Titullari i AK**, nuk ka ngritur grup pune për hartimin e specifikimeve teknike, veprim ky në kundërshtim me nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**2. Sipas urdhrorit administrativ** nr. 142 prot, datë 14.06.2017, është ngritur Komisioni i Vlerësimit Ofertave (KVO) i përbërë nga:

- G.N. (Kryetar)
- H.G. (Anëtar)
- N.B. (Anëtar)

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Vihet re se kryetari i KVO-së znj. G.N. nuk figuron ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor. Sipas strukturës organizative është specialiste për edukimin në vazhdim. Emrimi si kryetare e KVO është bërë në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**5.2 Procedura e prokurimit me objekt “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër”**

**A.** Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër” rezultoi si më poshtë vijon:

Tender i zhvilluar me objekt “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër” ka këto të dhëna:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.87 datë 14.11.2017	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> -E.M. -P.N. -V.F., sipas urdhrit nr.87, datë 14.11.2017	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. I.Ç. (Kryetar) 2. N.L. (anëtar) 3. M.K. (Anëtar) Sipas Urdhrit 2456, datë 17.11.2017
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,335,000 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> 2294300 lekë pa tvsh 2753160 lekë me tvsh	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 40700 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 27.11.2017 (anuluar) Ora 11:00 30.11.2017 ora 11 sipas VKM datë 23.11.2017	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhura dytësore të SRSH	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 19.12.2017 me nr. prot. 2655	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 2,753,160 lekë me tvsh	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - vlera 2753160 lekë me tvsh sipas fatures tatimore me nr. 14, datë 29.12.2017 (Aktualisht nuk është bërë pagesa)

- Me shkresën nr. prot. 2070, datë 20.09.2017, z. A.B. në cilësinë e K/Degës së Hotelerisë, i ka kërkuar Drejtorisë së SRSH pajisjen e spitalit me tratë elektronik.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Kryetari AK, z. P.Ç. me shkresën nr. prot. 2245, datë 17.10.2017, ka urdhëruar sipas UB nr. 117, datë 17.10.2017 ngritjen e komisionit të përbërë nga (I.Ç., kryetar dhe V.F dhe E.A., anëtarë), për përlllogaritjen e fondit limit.
- Ministria e Shëndetësisë ka miratuar përdorimin e fondit të planifikuar nga të ardhurat dytësore për vitin 2017 dhe konkretisht edhe për “Tratët automatik elektromekanik për përdorimin intensiv deri në 3,600,000 lekë”.
- Njësia e prokurimit sipas nr. prot. 79, datë 14.11.2017 ka mbajtur procesverbal mbi hartimin dhe miratimin e DT, si dhe ka ftuar 5 OE referuar në faqen e QKB.
- KVO me datë 30.11.2017, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave në sistemin elektronik ku janë paraqitur OE si mëposhtë:

- P. me ofertë ekonomike 1,855,000 lekë pa TVSH
- A.P. me ofertë ekonomike 2,294,300 lekë pa TVSH

dhe bazuar në kriteret e vlerësimit sipas procesverbalit datë 06.12.2017, KVO propozon:

- OE “P.” skualifikohet
- OE “A.P.” kualifikohet

Sipas raportit përmbledhës Kryetari i AK, ka miratuar propozimin e KVO-së.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të tenderit u konstatuan këto problematika:

**A.** Sipas urdhrit administrativ nr. 2456 prot, datë 17.11.2017, është ngritur Komisioni i Vlerësimit Ofertave (KVO) i përbërë nga: ( I.Ç. (Kryetar); N.L. (anëtar); M.K. (Anëtar)).

Vihet re se kryetari i KVO-së znj. I.Ç., nuk figuron ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor. Sipas strukturës organizative është specialist në sektorin teknik. Emërimi si kryetar i KVO është bërë në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**B.** Në kundërshtim me nenin 64 (Hapja e ofertave), pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ” Oferta ekonomike e operatorit ekonomik “A.P.” sh.p.k sipas shtojcës 1, të DST, nuk është nënshkruar në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

**Zbatimi i kontratës:**

Kontrata me objekt “F.V Trarë rrugore (elektronik) për Spitalin Rajonal Shkodër” është lidhur me datë 19.12.2017 me nr. prot. 2655, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. V.M. në cilësinë e Drejtorit të SRSH dhe Operatorit Ekonomik “A.P.” sh.p.k. Vlera e kontratës është 2,753,160 lekë me TVSH. Data e përfundimit të kontratës do të jetë data 31.12.2017. Siguracioni në masën 10% është kryer me datë 15.12.2017 në kompaninë “A.” me NIPT: K42108801C.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Titullari i SRSH me nr.prot. 2713, datë 27.12.2017 ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, të përbërë nga (Gj.B.; Dh.K. dhe M.K.).

Akti teknik i marrjes në dorëzim të F.V Trarë rrugore (elektronike) për SRSH, 3 copë, është kryer sipas nr.prot. 2787, datë 29.12.2017.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës në terren, u konstatua se sistemi i parkimit në 3 pika ( 2 hyrje dhe 1 dalje) funksionon normal.

Likuidimi deri datë 31.12.2017 rezulton si vijon:

Është prerë fatura tatimore me nr. 14, datë 29.12.2017 me vlera 2753160 lekë me TVSH, por aktualisht pagesa është në proces.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Sqarim mbi observacionin e bërë nga Drejtori i SR Shkodër z. V.M., me nr. Prot. 1872, datë 23.05.2018 dhe protokolluar në KLSH me nr. Prot. 40/6, datë 28.05.2018 në lidhje me akt konstatimin nr. 6, të mbajtur me datë 30.03.2018 për procedurën e prokurimit “F.V Trarë rrugorë (elektronik) për spitalin rajonal Shkodër” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në observacionin e paraqitur (pika 2) pretendohet se :” . fatura tatimore nr. 8, datë 17.12.2014 i shoqërisë “A.P.” sh.p.k është konsideruar dokument i saktë duke qenë kopje e faturës tatimore e firmosur (Por jo e vulosur) sepse nuk janë vënë re korrigjime , shtesa dhe fshirje. ”.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes këtë observacion sqaron se: Merr në konsideratë observacionin sepse nga KVO është kërkuar libri i shitjes (ky libër nuk u vu në dispozicion gjatë periudhës së auditimit) për të verifikuar deklarin e kësaj fature në organet tatimore dhe ka rezultuar se kjo faturë është deklaruar dhe prandaj është miratuar kualifikimi i OE “A.P.” sh.p.k. (Libri i shitjeve është pjesë e observacionit).

### **5.3 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”:**

Nga auditimi i procedurave për dy fazat u konstatua si vijon:

#### **I. Loti I “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”.**

**I.1** Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 017” rezultoi si më poshtë vijon: Loti I.

Tender i zhvilluar me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017” ka këto të dhëna:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.06 datë 03.02.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> -Xh.H. Kryetare -E.H. Anëtare -B.K., sipas urdhrorit nr. 06, datë 03.02.2017	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. B.L. (Kryetar) 2. H.G. (anëtar) 3. V.B. (Anëtar) Sipas nr. prot. 419, datë 06.02.2017
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar në Shkresën nr. 264, datë 27.01.2017		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>12,100,000 lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1875701 lekë pa tvsh 6757553.5 lekë pa tvsh	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 3466745 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 08.02.2017 ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhura nga buxheti	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> b)S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> <b>Loti I:</b> Datë 16.02.2017 me nr. prot. 548 Datë 16.02.2017 me nr. prot. 549	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>Loti I:</b> 1875701 lekë pa tvsh (A.F.) 6757553.5 lekë pa tvsh	<b>16.Likuiduar deri datë 15.04.2017</b> - Vlera 1,425,098 lekë (kontrata me nr.prot. 48) - Vlera 450,602 lekë (kontrata me nr.prot. 48) - vlera 4,041,774 lekë (kontrata me nr, prot. 549) - vlera 126,928 lekë (kontrata me nr, prot. 549) - vlera 1,541,083 lekë (kontrata me nr, prot. 549)

- Titullari i AK dhe Njësia e prokurimit sipas nr. prot. 07, datë 03.02.2017 kanë mbajtur procesverbal mbi hartimin dhe miratimin e DT, si dhe ka ftuar 3 OE referuar në faqen e QKB.

- Sipas Raportit përmbledhës me nr. prot. 520, datë 1.02.2017, për procedurën e prokurimit publik me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pas kualifikimit anëtarët e KVO-së i propozojnë titullarit të AK të shpallë fitues OE për lotet e mëposhtme:

- **OE “A.F.”** për Lotet

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

2/4/5/13/14/16/17/18/19/20/21/27/29/30/32/33/34/36/37/38/39/40/42/44/47/48/49/50/51/53/54/57/58/60/62/63/64/65 /66/67/68/69/73/74 dhe loti 75

- **OE “F.F.”** për Lotet 3/6/8/9/10/24/46/59/72

Nuk ka pasur asnjë ankim mbi vlerësimin e OE.

Konstatohet se; nga 75 lote për 21 lote në vlerën 3,398,558 lekë nuk është paraqitur asnjë ofertues dhe Titullari i AK me shkresën me nr. prot. 523, datë 13.02.2017 ka proceduar me vendim anulimi.

Sipas raportit përmbledhës Kryetari i AK, ka miratuar propozimin e KVO-së.

**I.2 Zbatimi i kontratave:**

- Kontrata me objekt “Blerje medikamente për mbulimin e nevojave spitalore deri me datë 15 prill 2017 e ndarë në lote, gjithsej 75 lote” është lidhur me datë 16.02.2017 me nr. prot. 548, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. në cilësinë e Drejtorit të SRSH dhe Operatorit Ekonomik “F.F.” sh.p.k përfaqësuar nga A.T. Vlera e kontratës është 1,875,701 lekë pa TVSH.

Data e përfundimit të kontratës do të jetë data 15.04.2017.

- Kontrata me objekt “Blerje medikamente për mbulimin e nevojave spitalore deri me datë 15 prill 2017 e ndarë në lote, gjithsej 75 lote” është lidhur me datë 16.02.2017 me nr. prot. 549, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. në cilësinë e Drejtorit të SRSH dhe Operatorit Ekonomik “A.F.” sh.p.k., përfaqësuar nga A.H. Vlera e kontratës është 6,757,553.5 lekë pa TVSH.

Data e përfundimit të kontratës do të jetë data 15.04.2017.

**II. Loti II “Blerje medikamente deri me 15 prill 017, e ndarë në lote, gjithsej 20 lote”.**

**II.1** Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 017, e ndarë në lote, gjithsej 20 lote” rezultoi si më poshtë vijon: Loti II.

Tender i zhvilluar me objekt “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017, e ndarë në lote, gjithsej 20 lote” ka këto të dhëna:

<b>c. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje medikamente deri me 15 prill 2017”. Loti II</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.15/1 datë 16.02.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> -Xh.H. Kryetare -E.H. Anëtare	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. B.L. (Kryetar) 2. H.G. (anëtar) 3. V.B. (Anëtar) Sipas nr. prot. 620, datë 24.02.2017
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar në Shkresën nr. 558 prot, 16.02.2017	-B.K., sipas urdhrit nr. 15/1, datë 16.02.2017 me nr. prot. 558, datë 16.02.2017	

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,966,620 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> 347460 lekë pa tvsh 250200 lekë pa tvsh	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 1368960 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 27.02.2017 ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhura nga buxhetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> b)S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> <b>Loti II:</b> Datë 09.03.2017 me nr. prot. 724 Datë 10.03.2017 me nr. prot. 733	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>Loti II:</b> 347460 lekë pa tvsh 250200 lekë pa tvsh	<b>16.Likuiduar deri datë 15.04.2017</b> -347460 lekë pa tvsh 250200 lekë pa tvsh

- Titullari i AK dhe Njësia e prokurimit sipas nr. prot. 18/1, datë 16.02.2017 kanë mbajtur procesverbal mbi hartimin dhe miratimin e DT, si dhe ka ftuar 3 OE referuar në faqen e QKB.

- Sipas Raportit përmbledhës me nr. prot. 665, datë 03.03.2017, për procedurën e prokurimit publik me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit të kontratës, pas kualifikimit anëtarët e KVO-së i propozojnë titullarit të AK të shpallë fitues OE për lotet e mëposhtme:

- **OE “R.F.”** për Lotet 22/28/70
- **OE “I.”** për Lotin 61

Nuk ka pasur asnjë ankim mbi vlerësimin e OE. Konstatohet se; nga 20 lote për 16 lote nuk është paraqitur asnjë ofertues dhe Titullari i AK me shkresën me nr. prot. 668, datë 03.03.2017 ka proceduar me vendim anulimi.Sipas raportit përmbledhës Kryetari i AK, ka miratuar propozimin e KVO-së.

## **II.2 Zbatimi i kontratave:**

- Kontrata me objekt “Blerje medikamente për mbulimin e nevojave spitalore deri me datë 15 prill 2017 e ndarë në lote, gjithsej 20 lote” është lidhur me datë 09.03.2017 me nr. prot. 724, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. në cilësinë e Drejtorit të SRSH dhe Operatorit Ekonomik “R.F.” sh.p.k përfaqësuar nga M.Sh. Vlera e kontratës është 347,460 lekë pa TVSH.

Data e përfundimit të kontratës do të jetë data 15.04.2017. Siguracioni në masën 10% ose në vlerën 34746 lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Kontrata me objekt “Blerje medikamente për mbulimin e nevojave spitalore deri me datë 15 prill 2017 e ndarë në lote, gjithsej 20 lote” është lidhur me datë 10.03.2017 me nr. prot. 733, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. në cilësinë e Drejtorit të SRSH dhe Operatorit Ekonomik “I.” sh.p.k përfaqësuar nga P.M. Vlera e kontratës është 250,200 lekë pa TVSH.

Data e përfundimit të kontratës do të jetë data 15.04.2017.

*Likuidimi deri datë 15 prill 2017 është realizuar 100% për të dy lotet sipas urdhër shërbimeve; rezulton si vijon: 89, 90, 124, 171, 176, 128, 129, 146, dhe 147.*

**Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të tenderit dhe zbatimit të kontratës u konstatuan këto problematika:**

*Dokumenti i sigurimit të kontratës “Blerje medikamente për mbulimin e nevojave spitalore deri me datë 15 prill 2017 e ndarë në lote, gjithsej 75 lote” i bërë në kompaninë A. në masën 10% ose në vlerën 187,570 lekë, konstatohet se formulari i sigurimit të kontratës nuk ka datë.*

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Sqarim mbi observacionin e bërë në mënyrë elektronike, me datë 18.05.2018 nga znj. Xh.H., znj. E.H. dhe z. B.K. anëtarë të njësisë së prokurimit në procedurën e prokurimit “Blerje medikamente deri me datë 15 prill 2017” e ndarë në lote e zhvilluar në dy fazanë lidhje me akt konstatimin nr. 07, datë 30.03.2018.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes këtë observacion sqaron se:

Së pari; Me argumentet e paraqitura në lidhje me problematikën e parë, vërtetohet se kopja e procesverbalit të njësisë së prokurimit është nënshkruar nga të tre anëtarët, ndërsa DST janë firmosur nga dy anëtarë faqe për faqe kurse anëtari i tretë ka firmosur vetëm në faqen e parë dhe të fundit, prandaj grupi i auditimit merret në konsideratë observacionin.

**Së dyti:** Në lidhje me përcaktimin e fondit limit observacioni merret në konsideratë, sepse nga përllogaritja r fondit limit të hartuar nga Njësia e Prokurimit, çmimet janë paraqitur me shifra pas presjes dhjetore dhe si të tilla mund të konsiderohen gabime për shkak të veprimeve aritmetike.

#### **5.4 Procedura e prokurimit me objekt “Projekt Preventiv zbatimi për ri K.in e ambienteve të reaminacionit të kardiologjisë” dhe “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër ”.**

**1. Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit (Blerje e vogël) me objekt “Projekt Preventiv zbatimi për ri K.in e ambienteve të reaminacionit të kardiologjisë”.**

- Me urdhrin e brendshëm nr. 37, datë 14.04.2016 është ngritur komisioni për llogaritjen e FL dhe specifikimeve përkatëse, i përbërë nga: [D.K. (Ing) kryetare; D.H. dhe K.M. (anëtarë)].

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Titulari i AK me UP nr. 45, datë 30.05.2016 dhe nr. prot. 1208, ka urdhëruar zhvillimin e tenderit me prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit është 01.06.2016, ora 16:00.
- Sipas shkresës me nr. prot. 1209, datë 30.05.2016 është bërë ftesë për ofertë.
- Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, i përbërë nga: [D.H. Kryetar, A.M. dhe A.M. anëtarë.] pasi hyri në sistem bëri hapjen e ofertave të paraqitura nga OE, rezultoi se morën pjesë këta operatorë ekonomik:
  - E.M. me ofertë 500,000 lekë pa TVSH
  - T.M.me ofertë 500,000 lekë pa TVSH
  - N. me ofertë 588,000 lekë pa TVSH
  - D.E. me ofertë 598,000 lekë pa TVSH
  - T. sh.p.k me ofertë 680,000 lekë pa TVSH
- Me shkresën nr. prot. 1432, datë 20.06.2016, KBVV përfaqësuar nga z. D.H. për vitin 2016 ngritur me UB nr. 08, datë 09.02.2016 paraqet kërkesën Titullarit të AK, për përfshirjen në komision specialist për marrjen në dorëzim bazuar në kontratën nr. 1379 prot, datë 15.06.2016
- Kontrata e shërbimit është lidhur me datë 15.06.2016 me OE “T.” sh.p.k përfaqësuar me autorizim nga Z. Erjona Qatipi, me objekt **“Projekt preventiv zbatimi për ri K.in e ambienteve të repartit të reaminacionit të Spitalit Shkodër”** me vlerë **816,000 lekë me TVSH**. Afati i dorëzimit të projektit është 5 ditë kalanderike nga data e lidhjes së kontratës. Disbursimi i realizimit të kontratës është bërë sipas faturës tatimore nr. 49, datë 27.06.2016, me vlerë 816,000 lekë me TVSH.

**2. Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër” rezultoi si më poshtë vijon:**

Tender i zhvilluar me objekt **“Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër”** ka këto të dhëna:

<b>d. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 60/1 datë 05.08.2016	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> -D.H. Kryetar -E.H. Anëtarë -D.S., Sipas urdhrit të prokurimit Nr. 60/1 datë 05.08.2016(Nr. 1960 prot, datë 05.08.2016)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. E.M. (Kryetar) 2. V.B. (anëtar) 3. F.Sh. (Anëtar) Sipas Urdhrit nr. prot. 2106, datë 26.08.2016
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Procedurë e hapur		

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 28,709,513 lekë - 4,166,666 lekë për vitin 2016 - 24,542,847 për vitin 2017	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>27,372,487 lekë pa tvsh</b> <b>32,846,98 lekë pa tvsh</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 1,337,026 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 31.08.2016 Ora 10:00	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit, vënë në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë.	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>6 OE</b> b) S’kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Datë 21.11.2016 me nr. prot. 2826	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>32,846,598 lekë me tvsh</b> - për vitin 2016 janë të lëvrueshme <b>15,000,000 lekë me tvsh</b> - për vitin 2017 janë të lëvrueshme <b>17,846,985 lekë me tvsh</b>	<b>16. Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - 14222078 leke -12091585 leke -4890605 lekë -6133537 leke (shtesë kontrate)

- Bazuar në relacionin argumentues të punimeve, makinerive dhe fuqisë punëtore për objektin: “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit Spitali Shkodër” është përcaktuar Fondi Limit pa TVSH në vlerën 28,709,513 lekë.

- Sipas urdhrorit të prokurimit nr. 60/1 me nr. prot. 1960, datë 05.08.2016 lloji i procedurës është përcaktuar e hapur dhe prokurimi i fondit limit në shumën 28,709,513 lekë pa TVSH është bazuar në kontratën nr. 1379 prot, datë 15.06.2016.

- Njësia e prokurimit sipas nr. prot. 80/11, datë 05.08.2016 ka mbajtur procesverbal mbi hartimin dhe miratimin e DT.

- KVO me datë 31.08.2016, ka mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave në sistemin elektronik ku janë paraqitur OE si më poshtë:

- K. pa me ofertë ekonomike.
- A.K. me ofertë ekonomike 26,092,544 lekë pa TVSH
- A. K. me ofertë ekonomike 22,865,399 lekë pa TVSH
- Gj. me ofertë ekonomike 27,372,487 lekë pa TVSH
- K. me ofertë ekonomike 24,500,519 lekë pa TVSH
- N. me ofertë ekonomike 26,426,346 lekë pa TVSH

dhe sipas procesverbalit me nr. prot. 88, datë 09.09.2016, bazuar në kriteret e vlerësimit sipas procesverbalit datë 06.12.2017, KVO ka bërë vlerësimin e ofertave si vijon:

- Gj. kualifikuar

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- K., skualifikuar.
- A.K. skualifikuar
- A. K. skualifikuar
- K. skualifikuar
- N. skualifikuar

**Ankesat e OE:**

OE “N.” sh.p.k dhe OE “A.K.” sh.p.k kanë bërë ankesë pranë AK. Kërkesa e tyre nuk është marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor, Operatori Ekonomik “N.” sh.p.k me datë 27.09.2016 është ankuar në Komisionin e Prokurimit Publik (Në vijim, KPP).

- KPP me vendim nr. prot. 204/1, datë 28.09.2016 ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin në themel.

- KPP me vendim K.P.P. 788/2016 (nr. prot. 788/1, datë 12.10.2016) nuk ka pranuar ankesën e paraqitur nga OE “N.” sh.p.k dhe Autoriteti Kontraktor është lejuar të vazhdojë në vijim me zhvillimin e procedurës së tenderit.

- Me datë 31.10.2016 (nr. prot. 2615) KVO ka hartuar Raportin përmbledhës dhe e ka paraqitur për miratim tek titullari i AK.

**5.5 Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës janar-shkurt 2017”.**

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të tenderit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës janar-shkurt 2017” rezultoi si më poshtë vijon:

e. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës janar-shkurt 2017”.		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.08 datë 06.02.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> -Xh.H., kryetar -E.H., anëtare -A.H., anëtar	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> - A.D., kryetar - R.K., anëtar - A.M., anëtare Sipas Urdhrit 503, datë 10.02.2017
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,360,000 lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>952,000 lekë pa tvsh</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> - 408,000 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 13.02.2017 Ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Nga FSDKSH	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b)S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 20.02.2017 me nr. prot. 580	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>1,142,400 lekë me tvsh</b>	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - vlera 1,142,400 lekë me tvsh sipas USH nr. 126, datë 11.04.2017
<b>Titullari i AK:</b> <b>P.Ç.</b>		

- Më datë 21.12.2016, Ministri i Shëndetësisë, z. I.B., me urdhërin nr. 568, datë 21.12.2016
- Më datë 04.01.2017, Përgjegjësja e Sektorit të Menaxhimit të Teknologjisë znj. A.B. ka bërë kërkesë Drejtorit të SR Shkodër, për sigurimin e mbulimit të shërbimit të mirëmbajtjes së paisjes së Rezonancës për vitin 2017.
- Më datë 31.01.2017, Titullari i AK me Urdhër të Brendshëm nr. 15, datë 31.01.2017 (Nr. prot. 330, datë 31.01.2017) ka ngritur komisionin për përllogaritjen e FL dhe specifikimet teknike përkatëse për procedurën e prokurimit “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjes së rezonancës” të përbërë nga: (1. A.B., kryetare; 2. Sh.D., anëtar; 3. A.Ç., anëtar). Anëtarët e komisionit kanë nënshkruar formularin e deklaramit, se nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.
- Më datë 02.02.2017, dhe nr. prot. 357, komisioni për llogaritjen e FL ka përcaktuar vlerën 1,360,000 lekë pa TVSH ose 1,632,000 lekë me TVSH si dhe ka hartuar specifikimet teknike.
- Më datë 06.02.2017, Titullari i AK, z. P.Ç. ka nxjerrë Urdhër Prokurimi me nr. 8, datë 06.02.2017 ku ndër të tjera përcakton: Llojin e procedurës, negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, Fondin limit në vlerën 1,360,000 lekë pa tvsh si dhe përbërjen e njësisë së prokurimit nga: (1. Xh.H., kryetare; 2. E.H., anëtare dhe 3. A.H., anëtar).
- Më datë 06.02.2017, njësia e prokurimitka hartuar procesverbalin, mbi hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kriteret e vecanta të kualifikimit si dhe zhvillimin e tenderit me datë 13.02.2017, ora 11:00.
- Më datë 07.02.2017 (nr. prot. 456), Titullari i AK i bën ftesë për ofertë shoqërisë “M.” SHPK shoqëruar me dokumentet: formulari i ofertës; kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit; kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike.
- Më datë 10.02.2017 (nr. prot. 503), Titullari i AK harton Urdhërin Administrativ për ngritjen e komisionit të hartimit të ofertave, të përbërë nga: ( 1. A.D., kryetar; 2. R.K., anëtar dhe 3. A.M., anëtare).
- Më datë 13.02.2017 (nr. prot. 16), KVO-ja harton procesverbalin e hapjes së ofertave. Në tender mori pjesë vetëm 1 OE, shoqëria “M.” SHPK, me INPT J R me ofertë ekonomike 1,360,000 lekë pa tvsh.
- Më datë 13.02.2017 (nr. prot. 517), KVO harton raportin përmbledhës dhe ia paraqet për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.

**Zbatimi i kontratës:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Më datë 20.02.2017 (nr. prot. 580), është lidhur Kontratë shërbimi “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës” ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Operatorit Ekonomik “M.” sh.p.k me NIPT J93610823R, përfaqësuar nga z. L.K. Vlera e kontratës është 952,000 lekë pa TVSH ose 1,142,400 lekë me TVSH. Afati i ekzekutimit, nga lidhja e kontratës deri me 31.03.2017.

Bashkëlidhur kontratës janë:

- Ankes kontrate me ofertën ekonomike.
- Formularin e sigurimit të kontratës në masën 10%, kryer tek kompania S.U.G.A.

**Grupi i auditimit, pasi verifikoi procedurën e ndjekur bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, konstaton si më poshtë vijon:**

1. Kontrata e shërbimit me nr. prot. 580, datë 20.02.2017 midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga Z. P.Ç. dhe shoqërisë “M.” sh.p.k, nuk është e plotësuar me shtojcën 20 (Kushtet e veçanta) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Juristi i NjP znj. Xh.H. dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P.Ç.
2. Referuar faturës tatimore nr. 67, datë 31.03.2017, procesverbalit të mbajtur me datë 31.03.2017 si dhe raportit teknik, janë kryer 43 shërbime në vlerën 1,142,400 lekë me TVSH. Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se, *nuk është kryer asnjë njoftim i defekteve nga Autoriteti Kontraktor në rrugë elektronike (me e-mail), në kundërshtim me nenin 8, pika 8.1 ku citon “. Njoftimi për defektet do të kryhet rrugë elektronike” dhe 8.2 ku citon se: “Kontraktuesi do të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje” të kontratës së nënshkruar.*

Sipas nenit 11 (Detyrimet e Autoritetit Kontraktor) të kontratës së nënshkruar është cituar se: Pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra , pas zëvendësimit me të reja, do t’i kthehen Kontraktuesit. Grupi i auditimit konstaton se citimi i mësipërm nuk është parashikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në kushtet e hartimit të kontratës duke favorizuar operatorin ekonomik, është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit dhe Titullarin e AK.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Sqarim mbi observacionin e bërë nga znj. E.H. në mënyrë elektronike , me datë 18.05.2018 në lidhje me akt konstatimin nr. 10, datë 30.03.2018 për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e pajisjes së rezonancës janar – shkurt 2017” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacion sqaron se, merr në konsideratë argumentimin e trajtuar në observacion, dhe si ekonomiste e njësisë së prokurimit nuk ngarkoheni me përgjegjësi për hartimin e kontratës.

**5.6 Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner” rezultoi si më poshtë vijon:**

<b>f. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner për Spitalin Rajonal Shkodër”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr. 03 datë 19.01.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Lloji i procedurës: Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.	E.M., kryetar P.N., anëtare A.B., Anëtare Sipas urdhrit Nr. 03 datë 19.01.2017	1. Gj.B. (Kryetar) 2. R.K. (Anëtar) 3. M.C. (Anëtar) Sipas Urdhrit Administrativ nr. 187 prot, datë 19.01.2017
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>954,000 Lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>954,000 Lekë pa TVSH</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> - lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 24.01.2017 Ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>1 OE</b> b)S’kualifikuar – OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 24.01.2017, nr.prot. 233. Shoqëria “H&L.” sh.p.k	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> - 1,144,800 lekë	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - 563,856 lekë sipas USH nr. 86, datë 10.03.2017.

Me datë 04.01.2017, përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Teknologjisë, znj. A.B. i drejtohet titullarit të SRSH me shkresë për sigurimin e mbulimit të shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore Skaner e prodhimit Philips/16sl.

- Për pajisjen Skaner, kontrata përkatëse me objekt “ Mirëmbajtje e pajisjes skaner ka përfunduar me datë 31.12.2016: Titullari i Ak, P.Ç. sipas urdhrit të brendshëm nr. 02, datë 09.01.2017 (nr. prot. 37) ka ngritur komisionin për llogaritjen e fondit limit të përbërë nga: A.B. kryetar dhe anëtarët Gj.B. dhe E. .

Grupi i përllogaritjes së fondit limit me shkresën nr. prot. 38, datë 09.01.2017, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 1,281,237.5 lekë pa TVSH bazuar në kontratën e vitit të mëparshëm (kontratë datë 15.09.2014), si dhe ka hartuar specifikimet teknike.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Titullari i AK me urdhrin e prokurimit nr. 3, datë 19.01.2017, ka urdhëruar që të kryhet prokurimi me fond limit 954,000 lekë pa TVSH të tenderit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner (Për Spitalin Rajonal Shkodër) e prodhuesit Philips 16/sl”. Grupi i auditimit konstaton se titullari ka përzgjedhur llojin e procedurës : negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar në UMSH nr. 568, datë 21.12.2016. Në fakt në UMSH, pika 2, është shprehur se: “. institucionet spitalore lejohen të përdorin procedurën e prokurimit me negociim” pra vihet re se jo domosdoshmërisht nga titullari i AK duhet të përzgjidhet lloji i negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pra për sa më sipër titullari duhet të kishte përzgjedhur llojin e procedurës: me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, bazuar në nenin 32 të LPP, dhe të nenit 35 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Njësia e prokurimit sipas procesverbalit me nr. 03 prot, datë 19.01.2017 ka hartuar dhe miratuar DST, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit si dhe ka caktuar datën e tenderit me 24.01.2017.

Nga AK me datë 19.01.2017, janë njoftuar operatorët ekonomik: “H&L.” sh.p.k; “B.A.” sh.p.k; “S.M.” sh.p.k.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar procesverbalit të hapjes së ofertave nr. 04, datë 24.01.2017 konstatoi se është paraqitur 1 (një) operator ekonomik:

- OE “H&L.” sh.p.k me ofertë 954,000 lekë pa TVSH.

KVO sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit vendosi: **Operatorë të kualifikuar:**

- OE “H&L.” sh.p.k me ofertë 954,000 lekë pa TVSH.

- Sipas Raportit Përmbledhës me nr. prot. 221, datë 24.01.2017 KVO bën përshkrimin e tenderit dhe i propozon për miratim Titullarit të AK.

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me datë 24.01.2017, nr.prot. 222 dhe njoftimi në Buletinin e APP është bërë me datë 13.02.2017.

**Zbatimi i kontratës:**

Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner (Për Spitalin Rajonal Shkodër) e prodhuesit Philips/16sl” është lidhur me datë 24.01.2017 dhe nr. prot. 223, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSB, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe nga Kontraktuesit shoqëria “H&L.” sh.p.k përfaqësuar nga z. E.M. Vlera e kontratës është 1,144,800 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10% është bërë me datë 24.01.2017 në Kompaninë S.U.G.A. Data e përfundimit të kontratës 31 mars 2017. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë 12 muaj pas datës së vendosjes së saj në pajisjet përkatëse.

Likuidimi i kryerjes së shërbimit sipas objektit të kontratës është bërë:

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 86, datë 10.03.2017 në vlerën 563,856 lekë me TVSH (Fat tatimore nr. 20, datë 25.02.2017).
- Sipas urdhër shpenzimit nr. 125, datë 11.04.2017 në vlerën 580,944 lekë me TVSH (Fat tatimore nr. 34, datë 31.03.2017).

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Më datë 16.02.2017 (Nr. prot. 562), titullari i AK, me urdhër të brendshëm ka ngritur komisionin për verifikimin dhe kolaudimin e shërbimeve të kryera mbi bazën e kontratës së lidhur, të përbërë nga: A.D., Gj.B., A.B. dhe N.Th.

*Nga verifikimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës rezulton që:*

- 1 Kontrata e shërbimit me nr. prot. 233, datë 24.01.2017 midis Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga Z. P.Ç. dhe shoqërisë “**H&L.**” sh.p.k, nuk është e plotësuar me shtojcën 20 (Kushtet e veçanta) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Juristen si konceptuese e kontratës znj. E.M. dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.
- 2 Referuar faturës tatimore nr. 20, datë 25.02.2017, procesverbalit të mbajtur me datë 25.02.2017 (pa nr. protokoll) si dhe urdhër shpenzimit nr. 86, datë 10.03.2017, janë kryer 33 ditë shërbime në vlerën 563,856 lekë me TVSH. Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se, *nuk është kryer asnjë njoftim i defekteve nga Autoriteti Kontraktor në rrugë elektronike (me e-mail), në kundërshtim me nenin 8, ku citon “. Njoftimi për defektet do të kryhet rrugë elektronike” dhe “Kontraktuesi do të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje” të kontratës së nënshkruar.*

Sipas nenit 11 (Detyrimet e Autoritetit Kontraktor) të kontratës së nënshkruar është cituar se: Pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra , pas zëvendësimit me të reja, do t’i kthehen Kontraktuesit. Grupi i auditimit konstaton se citimi i mësipërm nuk është parashikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në kushtet e hartimit të kontratës, neni 11, paragrafi 4 është favorizuar operatorin ekonomik. Ky veprim është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik (DST), dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit dhe Titullarin e AK.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Sqarim mbi observacionin e bërë nga ish Drejtori i SR Shkodër z. P.Ç., me datë 21.05.2018 në lidhje me akt konstatimin nr. 11, datë 30.03.2018 për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtjen e pajisjes skaner” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në observacionin e paraqitur thuhet:” . është parashikuar shkelje parashikimi në kontratë se pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra, pas zëvendësimit me të reja do ti kthehen kontraktuesit”.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes këtë observacion sqaron se: Nga Autoriteti Kontraktor nuk është bërë përcaktimi i saktë për pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra, pas zëvendësimit me të reja, sepse sipas DST pjesët duhet t’i mbaj Autoriteti Kontraktor dhe sipas kontratës pjesët e zëvendësuara duhet ti kthehem kontraktuesit, pra për zëvendësimin e pjesëve janë përdorur dy standarde interpretimi. Për sa mësipërm observacioni nuk merret në konsideratë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**5.7 Procedura e prokurimit me objekt “Plan-Rilevimi, Plan-Vendosje dhe planimetritë për Spitalin Rajonal Shkodër” me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Plan-Rilevimi, Plan-Vendosje dhe planimetritë për Spitalin Rajonal Shkodër”		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr. 63 datë 18.08.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Sipas Urdhrit Administrativ nr. 2122 prot, datë 31.08.2016 1. E.H. (Kryetar) 2. A.B. (Anëtar) 3. Dh.K. (Anëtar)
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Këkesë për propozim	E.M. P.N. F.Sh., sipas urdhrin nr. 63, datë 18.08.2016	
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,627,000 Lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>1,389,000 Lekë pa TVSH</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> <b>238,000 lekë pa TVSH</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 02.09.2016 Ora 12:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> b)S’kualifikuar – 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 26.09.2016, nr.prot. 2337. Shoqëria “Lorenc & CO” sh.p.k	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> - 1,666,800 lekë	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - 1,666,800 lekë me TVSH sipas USH nr. 372, datë 25.10.2016.

Titullari i Ak, P.Ç. sipas urdhrin të brendshëm nr. 129, datë 09.08.2017 (nr. prot. 1974) ka ngritur komisionin për llogaritjen e fondit limit të përbërë nga: F.Sh. kryetar dhe anëtarët V.F dhe P.M.

Grupi i përlllogaritjes së fondit limit me shkresën nr. prot. 2002, datë 11.08.2016, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 1,626,500 lekë pa TVSH si dhe relacionin teknik.

Njësia e prokurimit sipas procesverbalit me nr. 82 prot, datë 18.08.2016 ka hartuar procesverbal mbi hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit si dhe ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar procesverbalit të hapjes së ofertave nr. 89, datë 08.09.2016 hyri nën sistemin elektronik ku rezultoi se janë paraqitur operatorët teknik:

1. BOE “L&C.” & “XH.”
2. OE “L. & CO”

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

KVO sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit vendosi: **Opertorë ekonomik të skualifikuar**

- BOE “L&C.” & “XH.” me ofertë ekonomike 1,350,100 lekë pa TVSH

**Operatorë të kualifikuar:**

- OE “L. & CO” me ofertë ekonomike 1,389,000 lekë pa TVSH.
- Sipas Raportit Pëmbledhës me nr. prot. 2264, datë 16.09.2016 KVO bën përkrahimin e tenderit dhe i propozon për miratim Titullarit të AK.
- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me datë 16.09.2016, nr.prot. 2265 dhe njoftimi në Buletinin e APP është bërë me datë 27.07.2017.

***Nga verifikimi rezultoi që:***

*Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, në VKM Nr. 914, datë 12.4.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, por u konstatuan edhe kjo parregullsi:*

**Zbatimi i kontratës:**

Kontrata e furnizimit me objekt “Plan-rilevimi, Planvendosja dhe planimetritë për Spitalin Rajonal Shkodër” është bërë me datë 26.09.2016 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe nga Kontraktuesi shoqëria “L. & CO” përfaqësuar nga z. L.Z. Vlera e kontratës është 1,666,800 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10% është bërë me datë 26.09.2016 në Kompaninë A. Data e përfundimit të kontratës do të jetë 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës (përfundon me datë 15 tetor 2016). Likuidimi i kryerjes së shërbimit sipas objektit të kontratës është bërë sipas urdhër shpenzimit nr. 372, datë 25.10.2016 në vlerën 1,666,800 lekë me TVSH (Fat tatimore nr. 32, datë 14.10.2016). shërbimi sipas kontratës është kryer brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Më datë 11.10.2016 (Nr. prot. 2512), titullari i AK, me urdhër të brendshëm nr. 171, datë 11.10.2016 ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit mbi bazën e kontratës së lidhur, të përbërë nga: P.M. Kryetar, V.F dhe K.M. anëtarë.

- Operatori ekonomik “L. & CO” sh.p.k me procesverbal dorëzimi me nr. prot. 2526, datë 14.10.2016 në formë shkresore dhe 3 CD rilevimet topografike, plan-rilevimet, planimetritë sipas objektit të kontratës.

- Titullari i SRSH me shkresën nr. prot. 2598, datë 27.10.2016, në përgjigje të shkresës nr. 2138/1 prot, datë 19.04.2016 me lëndë, Dërgim i Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 158, datë 15.04.2016 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë” ka dërguar dokumentacionin e kërkuar si vijon:

1. Plani rilevim për të gjithë territorin e zonës spitalore të SRSH
2. Planvendosje për të gjithë territorin e zonës spitalore të SRSH

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

3. Planimetritë e çdo kati për secilin objekt të SRSH  
 4. Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore.

*Sqarim mbi observacionin e bërë nga ish Drejtori i SR Shkodër z. P.Ç., me datë 21.05.2018 në lidhje me akt konstatimin nr. 12, datë 30.03.2018 për procedurën e prokurimit “Plan rievimi, planvendosje dhe planimetritë për SR Shkodër” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

*Në observacionin e paraqitur pretendohet se :” . pavarësisht se në kontratë nuk është vendosur shtoja për kushtet e veçanta të kontratës (KVK) janë vendosur elementet e saj si pjesë integrale të kontratës”.*

*Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes këtë observacion merr në konsideratë argumentimin e trajtuar në observacion.*

**5.8 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale të buta për Spitalin Rajonal Shkodër” me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të tenderit me objekt “**Blerje materiale të buta**”. rezultoi si më poshtë vijon:

Nga auditimi i tenderit të zhvilluar me objekt “Blerje shtypshkrime” rezultoi:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ <b>Blerje materiale të buta</b> ”.		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.22 datë 11.4.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Sipas Urdhrit Administrativ nr. 1130 prot, datë 03.05.2017 1. A.B. (Kryetar) 2. J.ZH. (Anëtar) 3. A.M. (Anëtar)
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Procedurë elektronike, Këkesë për propozim	Xh.H. P.N. B.K., sipas urdhrin nr.22, datë 11.4.2017	
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,600,000 Lekë</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>1,538,400 Lekë</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> <b>61,600 lekë pa TVSH</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 03.05.2017 (anulluar, ndryshim kriteri) 09.05.2017 Ora 11:00	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhura dytësore nga SRSH	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender <b>4 OE</b> b)S’kualifikuar – 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Datë 29.05.2017, nr.prot. 1279.	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 1,846,080 lekë	<b>16.Likuiduar deri datë 31.12.2017</b> - 1,846,080 lekë me TVSH, sipas fatures tat. 589, datë 16.06.2017

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Titullari i Ak, P.Ç. sipas urdhrit të brendshëm nr. 31 prot, datë 03.04.2017 ka ngritur komisionin për llogaritjen e fondit limit të përbërë nga: M.K. kryetar dhe anëtarët B.T. dhe S.T.

- Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave me nr. prot. 3 datë 09.05.2017, në sistem kishin hyrë:

( A. 3; B.K.; E. 2001; M-P.-2L) dhe sipas procesverbalit me nr. prot. 37, datë 09.05.2017 në SRSH ka paraqitur mostrat “B.K.”.

-KVO sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit vendosi: **Operatorë ekonomik të skualifikuar**

1. “A.” me ofertë ekonomike 1500000 lekë pa TVSH
2. “E. 2001” me ofertë ekonomike 1295000 lekë pa TVSH
3. “M-P.-2L” me ofertë ekonomike 1482100 lekë pa TVSH

**Operatorë të kualifikuar:**

1. **B.K.** me ofertë ekonomike 1538400 lekë pa TVSH

- Sipas Raportit Përmbledhës me nr. prot. 1243, datë 19.05.2017 KVO ka bërë përshkrimin e tenderit dhe propozimin për miratim Titullarit të AK.

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me datë 03.07.2017, nr. prot. 1568 dhe njoftimi në Buletinin e APP është bërë me datë 27.07.2017.

- Kontrata e furnizimit me objekt “Blerje materiale të buta” është bërë me datë 29.05.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe nga Kontraktuesi znj. B.K. Vlera e kontratës është 1,846,080 lekë me TVSH.

*Nga akt verifikimi rezultoi që:*

*Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në*

*Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.*

**5.9 Tenderi me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

***Objekti i këtij akt verifikimi është:***

Auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit me objekt “**Mirëmbajtje të paisjeve të dializës**” **Full-Risk, Loti 1.** Kontrata është me nr. 915 prot, datë 24.04.2015 me afat deri 31.12.2015. Kontrata është lidhur midis SRSH dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues “B.A.” sh.p.k. me vlerë 1,798,800 lekë me tvsh.

***Nga verifikimi rezultoi që:***

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

***Janë kryer likuidimet e mëposhtëme:***

-Lot-1 “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës”.

-Urdhër-shpenzimi nr.246, datë 03.08.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.24, datë 24.06.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.333, datë 22.09.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.29, datë 25.08.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.409, datë 13.11.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.41, datë 26.10.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.502, datë 22.12.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.515, datë 22.12.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Vlera totale e likuiduar është 1,798,800 lekë me tvsh.

-Nga kontrolli i dokumentacionit të dorëzuar dhe procesverbaleve përkatëse, rezultoi se:

***-Makineria mjekësore me numër serial: PH-0662:***

-Është riparuar më 05/05/2015 për zërin: Ndërrim i bordit të pompës.

-Është riparuar më 15/05/2015 për zërin: Ndërrim i bordit të pompës.

-Është riparuar më 04/08/2015 për zërin: Ndërrim i bordit të pompës.

-Sa më sipër, ky zë është likuiduar ose zëvendësuar/mirëmbajtur 3 herë, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe konkretisht me nenin 12 ku citohet se periudha e garancisë për pjesët e furnizuara do të jetë 1 vit. Kjo pjesë është ndërruar 3 herë brenda 4 muajve.

***-Makineria mjekësore me numër serial: PH-11771:***

-Është riparuar më 05/05/2015 për zërin: Ndërrim rotor i pompës.

-Është riparuar më 19/05/2015 për zërin: Ndërrim rotor i pompës.

-Është riparuar më 20/07/2015 për zërin: Ndërrim rotor i pompës.

-Sa më sipër, ky zë është likuiduar ose zëvendësuar/mirëmbajtur 3 herë, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe konkretisht me nenin 12 ku citohet se periudha e garancisë për pjesët e furnizuar do të jetë 1 vit. Kjo pjesë është ndërruar 3 herë brenda 2 muajve.

***-Makineria mjekësore me numër serial: PH-11765:***

-Është riparuar më 16/08/2015 për zërin: Ndërrim i rregullatorit të presionit.

-Është riparuar më 30/09/2015 për zërin: Ndërrim i rregullatorit të presionit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sa më sipër, ky zë është likuiduar ose zëvendësuar/mirëmbajtur 2 herë, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe konkretisht me nenin 12 ku citohet se periudha e garancisë për pjesët e furnizuar do të jetë 1 vit. Kjo pjesë është ndërruar 2 herë brenda 1 muaji.

-Makineria mjekësore me numër serial: PH-1083:

-Është riparuar më 17/06/2015 për zërat: Ndërrim i bllokut të ushqimit; Ndërrim i rotorit të pompës; Ndërrim i bordit të motorit.

-Është riparuar më 17.06/2015 për zërin: Mirëmbajtje.

-Sa më sipër, ky zë është likuiduar ose zëvendësuar/mirëmbajtur 2 herë, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe konkretisht me nenin 12 ku citohet se periudha e garancisë për pjesët e furnizuar do të jetë 1 vit. Kjo makineri, është mirëmbajtur 2 herë brenda 1 dite.

-Si rezultat, në pamundësi për të kalkuluar diferencat e sakta ose shërbimet e kryera dy herë, pasi kontrata nuk ka një aneks të qartë për sa i përket zërave ose shërbimeve që do të kryhen, kalkulimi i zërave të shërbimit të kryera në kundërshtim me kushtet e kontratës, do të bëhet në përpjestim të drejtë me numrin e makinerive që janë mirëmbajtur ashtu siç edhe komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka përllogaritur fondin limit.

Konkretisht:

-Me urdhër shpenzimin me nr.246, datë 03.08.2015, sipas procesverbaleve bashkangjitur, janë riparuar 5 makineri në shumën totale prej 449,700 lekë. Janë mbajtur 8 procesverbale tek të cilat janë kryer 3 riparime për makinerinë me nr.PH-0662. 3 riparime për makinerinë me nr.PH-11771. 1 riparim për makinerinë PH-11765. 2 riparime për makinerinë me nr.PH-1083 dhe 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11682. Rrjedhimisht, situacioni i dorëzuar, ka 9 makineri dialize dhe 2 makineri ëater-reverse të cilat nuk janë riparuar të paktën sipas procesverbaleve. Si rezultat, vlera e faturuar më tepër është  $(4 \times 28.750) + (1 \times 50.000) + (1 \times 66.000) = 115,000 + 50.000 + 66.000 = 277,200$  lekë me tvsh.

-Me urdhër shpenzimin me nr.333, datë 22.09.2015, sipas procesverbaleve bashkangjitur, janë riparuar 4 makineri në shumën totale prej 449,700 lekë. Janë mbajtur 4 procesverbale tek të cilat janë kryer 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11682. 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11771. 1 riparim për makinerinë PH-0662 dhe 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11765. Rrjedhimisht, situacioni i dorëzuar, ka 9 makineri dialize dhe 2 makineri ëater-reverse të cilat nuk janë riparuar të paktën sipas procesverbaleve. Si rezultat, vlera e faturuar më tepër është  $(5 \times 28.750) + (1 \times 50.000) + (1 \times 66.000) = 143,750 + 50.000 + 66.000 = 311,700$  lekë me tvsh.

-Me urdhër shpenzimin me nr.409, datë 13.11.2015, sipas procesverbaleve bashkangjitur, janë riparuar 5 makineri në shumën totale prej 449,700 lekë. Janë mbajtur 5 procesverbale tek të cilat janë kryer 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11774. 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11682. 1 riparim për makinerinë PH-11765. 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11763 dhe 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11772. Rrjedhimisht, situacioni i dorëzuar, ka 9 makineri dialize dhe 2

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

makineri ëater-reverse të cilat nuk janë riparuar të paktën sipas procesverbaleve. Si rezultat, vlera e faturuar më tepër është  $(4 \times 28.750) + (1 \times 50.000) + (1 \times 66.000) = 115.000 + 50.000 + 66.000 = 277.200$  lekë me tvsh.

-Me urdhër shpenzimin me nr.502, datë 22.12.2015, sipas procesverbaleve bashkangjitur, është riparuar 1 makineri në shumën totale prej 449,700 lekë. Është mbajtur 1 procesverbal tek i cili është kryer 1 riparim për makinerinë me nr.PH-11766.

Si rezultat, vlera e faturuar më tepër është  $(8 \times 28.750) + (1 \times 50.000) + (1 \times 66.000) = 230.000 + 50.000 + 66.000 = 415.200$  lekë me tvsh.

-Në total, vlera e likuiduar tepër nga SRSH për llogari të operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k., është **1,281,300 lekë**. Kjo vlerë, konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe i duhet kërkuar operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k.

-Për veprimet e mësipërme, duke miratuar shërbime të operatorit ekonomik të cilat nuk korespondojnë me procesverbalet e mbajtura, duke miratuar shërbime të kryera më shumë se njëherë por mbi të gjitha, për mos mbajtjen dhe ruajtjen e pjesëve të ndërrimit ose pjesëve të hequra/dëmtuara, **mban përgjegjësi, përgjegjësi i sektorit të inxhinierisë klinike A.B. pasi ka vepruar në kundërshtim me urdhrin nr. 3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë por dhe në kundërshtim me nenin 12 së kontratës së lidhur midis palëve.**

-Për miratimin e likuidimeve në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, pa marrë më parë relacionin ose raportin nga inxhinieria klinike, **mban përgjegjësi drejtori i SRSH, zj. Dh. U.**

-Në vazhdim, shqyrtohet kontrata shtesë me nr.378 prot, datë 07.03.2016 me afat deri 31.03.2016.

-Konstatohet se është lidhur një kontratë shtesë me nr.378, Prot-datë 07.03.2016, objekti i të cilës është *“Mirëmbajtja e paisjeve të dializës”*. Konstatohet se kjo kontratë shtesë, në asnjë rresht të saj, nuk i referohet kontratës bazë. Gjithashtu, vlera e kontratës bazë, është 1,798,800 lekë. Vlera e shtesës, është 360,000 lekë.

Kontrata shtesë e lidhur, nuk i referohet aspak zërave të përcaktuar që duhen mirëmbajtur por i referohet në përgjithësi makinerive të njëjta që i referohet dhe kontrata bazë. Si e tillë, kjo shtesë kontrate, është bërë për të njëjtat zëra që është bërë dhe kontrata bazë duke bërë mbivendosje të shërbimit ose në rastin më të keq, duke e kryer atë dy herë në të njëjtën kohë që ekzekutimi i zërave në kontratën bazë, ka 1 vit garanci. Pra, kontrata shtesë, nuk është e specifikuar nëse është Full-Risk apo jo, nëse është lidhur për zëra shërbimesh të përcaktuar apo për të njëjtat zëra por për më tepër, nuk i referohet kontratës bazë as me nr.Prot, as me datë dhe as në vlerë. Veçanërisht, nëse i referohemi zbatimit të kësaj kontrate dhe konkretisht, urdhër shpenzimit nr.108, datë 14.04.2016, konstatohet se tek procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit, nuk specifikohet në asnjë rresht lloji i shërbimit të kryer, pjesa e zëvendësuar (nëse ka patur) apo edhe orët e punës së makinerisë duke e bërë të pamundur të paktën vërtetësinë e kryerjes së shërbimit bazuar edhe tek urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 i Ministrit të Shëndetësisë. Konkludojmë se vlera e shpenzuar është e pa justifikuar, e pa argumentuar që në nisje pasi nuk ka asnjë kërkesë ose relacion nga sektori i inxhinierisë klinike për nevoja për shërbime shtesë aq më tepër

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

duke mos specifikuar zërat e shërbimeve e vërtetuar kjo me procesverbalet e pa sakta dhe të pa detajuara. Si e tillë, vlera **360,000 lekë**, përbën dëm ekonomik për SRSH-në dhe ngarkon me përgjegjësi, Titullarin e SRSH-së, zj. Dh. U. dhe kryetarin e njësisë së prokurimit, njëkohësisht si konceptues i kontratës, z. D.H.

**5.10 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është:*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për vitin 2017.

*Nga verifikimi rezultoi që:*

g. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim dhe Mirëmbajtje aparaturash (Laparoskopi – Orologji)”.		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.86 datë 08.11.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H. E.H. Paolo Kaceri	<b>4.Komisioni i Vlerësimit</b> J.ZH. R.K. B.T.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,609,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>M. sh.p.k me ofertë: 1,609,000 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>0 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 24.11.2017.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, FDSKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë</b> <b>pjesëmarrës në tender: M. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së mirëmbajtjes</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>Dt.27.12.2017</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,930,800 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.2535, Prot të datës 01.12.2017 mbajtur nga KVO e SRSH, ka tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 1 operator ekonomik i cili ka paraqitur ofertën për konkurim. Është kualifikuar “M.” sh.p.k me ofertën me vlerë 1,609,000 lekë pa tvsh.

-Kontrata e lidhur me nr.2711, Prot-datë 27.12.2017, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “M.” sh.p.k, me vlerë 1,930,800 lekë me tvsh, ka afat të kryerjes së shërbimeve deri më 31.12.2017.

-Me shkresën nr.1763, Prot-datë 27.07.2017, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, i dërgon sektorit të prokurimeve dhe planifikimit, përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Vlera e përllogaritur është 1,609,000 lekë pa tvsh.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.2382, Prot-datë 08.11.2017, titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.86 dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe Paolo Kaceri për të ndjekur procedurat e tenderit.

-Me shkresën nr.77, Prot-datë 08.11.2017, njësia e prokurimit miraton DST dhe në vazhdim me shkresën nr.78, Prot-datë 08.11.2017, autorizohet punonjësja Xh.H. njëkohësisht kryetare e njësisë së prokurimit, për krijimin e dosjes elektronike të tenderit.

-Sa më sipër, konstatohet se njësia e prokurimit, ka miratuar dokumentat e tenderit dhe konkretisht specifikimet teknike për furnizim-vendosje në të njëjtën kohë që objekti i tenderit është riparim ose shërbim. Njësia e prokurimit, nuk i është përmbajtur aspak nenit 57, pikës 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

-Me shkresën nr.2432, Prot-datë 15.11.2017, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga J.ZH., B.T. dhe R.K.

-Me shkresën nr.84, Prot-datë 24.11.2017, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e vlerësimit të ofertave dhe konstaton vetëm një ofertë e konkretisht nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k., i cili ka paraqitur ofertën me vlerë 1,609,000 lekë pa tvsh.

-Raporti përmbledhës është mbajtur me shkresën nr.2535, Prot-datë 01.12.2017 dhe është miratuar nga titullari i SRSH-së, z.P.Ç.

-Kontrata është lidhur më 27.12.2017 dhe protokolluar me nr.2711. Afati i kontratës është deri më 31.12.2017. Kontrata është firmosur nga drejtori i spitalit rajonal Shkodër z.V.M. dhe konceptuar nga juristja Xh.H.

-Nga shqyrtimi i termave dhe neneve të kontratës, konstatohet se tek neni 12, specifikimet teknike, dhe tek neni 13, të drejtat dhe detyrimet e palëve, i referohen kryerjes së një shërbimi ose riparimi. Tek specifikimet teknike, neni 12, tek lista e paraqitur, janë zërat e prokuruar dhe kushtet e shërbimit. Konstatohet se afati i shërbimit është i papërfillshëm, pra vetëm 3 ditë.

-Sa më sipër, për miratimin e një kontratë me objekt “*Riparim dhe shërbim të aparaturave laparoskopio-orologji*” për vetëm 3 ditë, mban përgjegjësi drejtori i SRSH-së z.V.M.

**Zbatimi i kontratës:**

-Urdhër-shpenzimi nr.634, datë 28.12.2017, me vlerë 1,930,800 lekë me tvsh, është i shoqëruar me faturën nr.10988, datë 27.12.2017. Procesverbali përkatës, është mbajtur nga Sh.Y., G.U., Gj.B. dhe N.Th.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me procedurat që janë ndjekur për zbatimin e kontratës, nuk u evidentua asnjë fletë-hyrje por edhe asnjë fletë-dalje nga magazina e SRSH. Në këtë mënyrë, të gjitha pajisjet e blera sipas kësaj procedure, nuk janë pasqyruar në kontabilitet pasi procedura ka qenë me objekt riparim dhe jo furnizim-vendosje. Pajisjet e blera, nuk kanë kaluar procedurat ligjore për tu quajtur investim. Vlera e mësipërme, nuk figuron në asnjë regjistër për vetë faktin se është quajtur si shpenzim mirëmbajtjeje dhe jo si investim. Si të tilla, materialet e furnizuara, nuk janë të dokumentuara si materiale me vlerë por janë të dokumentuara si shpenzim mirëmbajtjeje. Si e tillë,

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

kjo procedurë prokurimi, do të konsiderohet si procedurë me objektin që është shënuar në urdhrin e prokurimit pra “*Riparim Aparaturash*” e si e tillë do të arsyetohet bazuar tek urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.3272, datë 11.09.2007, mbi Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Paisjeve Mjekësore, urdhër i cili është përmendur tek neni 13 i kontratës së lidhur midis palëve por edhe specifikimet teknike dhe termat e referencës, kanë kushte që i përkasin mirëmbajtjes së makinerive dhe jo një furnizimi materialesh apo instrumentash.

-Sa më sipër, konstatohet se nuk ka asnjë kërkesë ose njoftim me shkrim nga SRSH-ja, drejtuar operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k. ku të kërkohej nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k. të paraqitej pranë SRSH-së për të riparuar defektin konform nenit 12-të të kontratës së lidhur ku citohet tek paragrafi i III se: “*I Porosituri është i detyruar të dërgojë personelin teknik dhe të japë asistencën e nevojshme për riparimin e defektit **brenda 48 orëve nga momenti i njoftimit**”.* Në këtë mënyrë është e pa mundur të vlerësohet nëse është plotësuar kushti sipas paragrafit të IV-të të së njëjtit nen të kontratës së lidhur ku citohet se: “*I porosituri është i detyruar të lëvrojë pjesët e këmbimit të nevojshme për riparimin e paisjes **jo më pak se 7 ditë pune nga marrja e njoftimit**”.* Mos kryerja e njoftimit kundrejt operatorit ekonomik, është në kundërshtim edhe me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, kapitulli III, pika 3.5.14 ku tek gërma b) citohet se për të ndjekur shërbimet e kryera ose riparimit të një paisjeje, duhet regjistruar edhe: “*Emri i personit që ka raportuar një problem me paisjen mjekësore*”. Pra, nuk ka asnjë shkresë ose dokument zyrtar ku të vërtetohet se është raportuar për një problem referuar procesverbaleve të mbajtura, akteve të ndryshme, të firmosura nga punonjësit e institucionit ose nuk ka asnjë formular raportimi sipas shtojcës 6.3, të formularit të raportimit të ngjarjeve të padëshiruara lidhur me paisjet, të urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të nxjerr nga Ministri i Shëndetësisë, ku përcaktohen hapat që duhen ndjekur në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të paparashikuar.

-Gjithsesi, në asnjë nga procesverbalet e mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer, nuk përmendet fakti që pjesët e ndërruara ose të riparuarra janë brenda garancisë ose që të paktën janë të vlefshme deri më 31.12.2017, kusht i kërkuar ky tek neni 14 i kontratës së lidhur midis palëve. Nuk u konstatua asnjë dokument zyrtar ku të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u konstatua nga asnjë akt apo procesverbal të mbajtur se pjesët e sjella dhe të vendosura si të reja, janë ose kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet europiane mbi aparaturat mjekësore dhe janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese. Tek kjo kontratë, në ndryshim nga kontrata me të njëjtin objekt të lidhur një vit më parë, nuk citohet në asnjë rresht urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 i Ministrit të Shëndetësisë mbi Politikat kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri. Mos citimi i këtij urdhri, është shkas për të anashkaluar të gjitha përgjegjësitë që ka sektori i inxhinierisë klinike ose sektori i menaxhimit të teknologjisë. Është shkak për të anashkaluar të gjitha përgjegjësitë e Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër por për më tepër, është shkas për të kryer një procedurë prokurimi pa asnjë garanci dhe siguri pasi në çdo rast tjetër, do të quhej një procedurë prokurimi normale që mund ti përkiste çfarëdo lloji apo natyre

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

institucioni por jo institucioneve Spitalore të cilat janë të detyruara të ndjekin politikat e Ministrisë së Shëndetësisë e sidomos direktivat e KE për menaxhimin e pajisjeve mjekësore. Gjithsesi, një fakt tjetër, që këtë procedurë e bën të papranueshme llogjikisht, është fakti se është e pamundur të lidhet një kontratë mirëmbajtjeje për vetëm tre ditë. Të paktën të ishte për një afat llogjik më shumë se 3 apo 4 muaj. Të kryhesh mirëmbajtjen vetëm në tre ditë kur mirëmbajtja është një term që i përket shtrirjes në kohë të shërbimit, është jo vetëm e pa mundur por mbi të gjitha, zbatimi i kësaj kontrate, bëhet i dyshimtë.

-Sa më sipër, argumentimi i fondit limit është i pa bazuar e i pa mbështetur në rregulla dhe urdhra por dhe prokurimi i procedurës, është bërë në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë. Afatet e ekzekutimit të kontratës, janë shumë të shkurtra duke e bërë të pa mundur kryerjen e shërbimit. Gjithashtu, fakti i mos argumentimit me dokumenta zyrtare dhe procedura ligjore ku të vërtetohej kryerja e shërbimit duke dokumentuar dhe pjesët rezervë të dëmtuara, tregojnë se likuidimi i operatorit ekonomik “M.” sh.p.k., është bërë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi aq më tepër që mungon dhe dokumenti financiar që vërteton kryerjen e procedurës. Procesverbalet e mbajtura e të pa protokolluara, mund të bindin këdo por nuk mund të vërtetojnë ligjërisht se procedura është ekzekutuar konform rregullave. Vërtetësia e kryerjes së shërbimeve, nuk justifikohet me dokumentacion ligjor dhe me procedura të ndjekura sipas urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” por edhe në konformitet me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve.

-Për veprimet e mësipërme: Për mos respektim të urdhrin nr. 3237, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, mban përgjegjësi, përgjegjësi i sektorit të menaxhimit të teknologjisë.

-Gjithashtu, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Paisjeve Mjekësore), konform urdhrin të mësipërm, kapitulli II, pika 2.3.1. Pa pasur më parë një informacion të detajuar sipas kapitullit III të urdhrin të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6, por edhe duke filluar një procedurë prokurimi me fond limit të paracaktuar kur faktikisht nuk mund të parashikohen se sa defekte do të ndodhin, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, ku citohet se: “*Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet se diçka e paplanifikuar*”. Sa më sipër, mban përgjegjësi, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, z.P.Ç. (reflektuar pas observacionit me nr.40/6, datë 28.05.2018 protokolluar pranë KLSH-së).

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr.1872, Prot-datë 23.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/6, Prot-datë 28.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së, nga z.V.M., sqarojmë se merret në konsideratë heqja e përgjegjësisë që i është lënë në akt-konstatimin nr.17, datë 30.03.2018, lidhur me shkeljet në procedurën e prokurimit pasi keni sjellë urdhrin e prokurimit të nxjerrë nga ish titullari z.P.Ç.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Lidhur me pretendimin se nuk keni përgjegjësi për lidhjen e kontratës edhe pse keni qenë ju titullari që e keni firmosur atë, ju sqarojmë se nuk qëndron pasi kjo (që nuk keni marrë pjesë në procedurën e prokurimit) nuk mund tju japi shkas që të miratoni dhe firmosni kontrata pa u informuar më parë për historikun e procedurës së prokurimit. Nuk është e drejtë të pretendoni se nuk keni përgjegjësi në të njëjtën kohë që keni firmosur kontratën. Si i tillë, ky pretendim, nuk merret në konsideratë.

**5.11 Auditimi i zbatimit të kontratave të shërbimit të makinerive mjekësore të repartit të Hemo-Dializës në vite për Spitalin Rajonal Shkodër, me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

***Objekti i këtij akt konstatimi është:***

Auditimi i zbatimit të kontratave të shërbimit të repartit të Hemo-Dializës në vite duke shqyrtuar dhe faktet e evidentuara gjatë inspektimeve në ambientet e Hemo-Dializës së vjetër tek godina e kirurgjisë në katin e tretë. Kontratat e shërbimit kanë qenë me objekt **“Mirëmbajtje të paisjeve të dializës”** dhe konkretisht do të trajtohen kontratat me nr.1627, Prot-datë 25.08.2014, me nr. 248 prot, datë 05.02.2015 shtesë kontrate, me nr. 915, Prot-datë 24.04.2015 dhe kontrata shtesë me nr.378 prot, datë 07.03.2016.

***Nga verifikimi rezultoi që:***

***Janë kryer likuidimet e mëposhtëme:***

-Lidhur me kontratën e vitit 2014, atë me nr.prot 1627, konstatohet se kontrata ka si objekt *“Mirëmbajtjen e Aparaturave të Hemo-Dializës”*. Vlera e kontratës është 1,197,360 lekë me tvsh. Kjo kontratë, është me afat ekzekutimi deri në fund të vitit 2014 dhe makineritë e mirëmbajtura që i përkasin repartit të Hemo-Dializës, ose më saktë shërbimet e kryera përta i përket pjesëve të këmbimit të furnizuara por edhe mirëmbajtjes në përgjithësi, kishin garanci 1 vit, të paktën sipas nenit 13 të kontratës së lidhur. Pra, garancia për pjesët e furnizuara dhe për mirëmbajtjen e makinerive dhe paisjeve të Hemo-Dializës, mbulonte periudhën nga data e fillimit të mirëmbajtjes pra nga data 24.10.2014 (referuar faturës së parë) deri më 24.10.2015. Pra, mirëmbajtja ka qenë e garantuar të paktën për pjesët e furnizuara për një periudhë një vjecare.

-Lidhur me shtesën e kontratës, atë me nr. 248 prot, datë 05.02.2015, konstatohet se tek kjo shtesë me të njëjtin objekt pra për mirëmbajtje të aparaturave të Hemo-Dializës, janë vendosur pjesë këmbimi të reja që sipas faturës i përkasin të gjitha makinerive. Konform nenit 3 të kësaj shtese, afati i garancisë së pjesëve të furnizuara është 1 vit nga data e furnizimit. Pra me këtë shtesë, periudha që mbulon garancia shtyhet deri në muajin shkurt të vitit pasardhës pra të vitit 2016. Si rezultat, deri në këtë moment, mirëmbajtja e aparaturave të repartit të Hemo-Dializës, figuron e mbuluar 100 % me asistencë për mirëmbajtje madje edhe të mbivendosur.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Lidhur me kontratën e vitit 2015, atë me nr.prot 915, konstatohet se kontrata ka si objekt “*Mirëmbajtjen e paisjeve të Hemo-Dializës*”. Vlera e kontratës është 1,798,800 lekë më tvsh. Kjo kontratë, është me afat ekzekutimi deri në fund të vitit 2015 dhe makineritë e mirëmbajtura që i përkasin repartit të Hemo-Dializës, ose më saktë shërbimet e kryera përta përta pjesëve të këmbimit të furnizuara por edhe mirëmbajtjes në përgjithësi, kishin garanci 1 vit të paktën sipas nenit 12 të kontratës së lidhur. Pra, garancia për pjesët e furnizuara dhe për mirëmbajtjen e makinerive dhe paisjeve të Hemo-Dializës, mbulonte periudhën nga data e fillimit të mirëmbajtjes pra nga data 24.06.2015 (referuar faturës së parë) deri më 24.06.2016. Pra, mirëmbajtja ka qenë e garantuar të paktën për pjesët e furnizuara për një periudhë një vjeçare.

-Lidhur me shtesën e kontratës, atë me nr. 378, Prot-datë 07.03.2016, konstatohet se tek kjo shtesë me të njëjtin objekt pra për mirëmbajtje të aparaturave të Hemo-Dializës, janë vendosur pjesë këmbimi të reja që sipas faturës, situacionit dhe procesverbalit i përkasin të gjitha makinerive. Konform nenit 11 të kësaj shtese, afati i garancisë së pjesëve të furnizuara është 1 vit nga data e furnizimit. Pra me këtë shtesë, periudha që mbulon garancia shtyhet deri në muajin mars të vitit pasardhës pra të vitit 2017. Si rezultat, deri në këtë moment, mirëmbajtja e aparaturave të repartit të Hemo-Dializës, figuron e mbuluar 100 % me asistencë për mirëmbajtjeje madje edhe të mbivendosur. **Si rezultat, reparti i Hemo-Dializës (ekzistuese), figuron se është mirëmbajtur dhe madje mirëmbajtja është e likuiduar nga SRSH edhe për periudhën deri në mars të vitit 2017.**

Si rrjedhojë, referuar të dhënave që u vunë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se regjistri i pacientëve që merrnin shërbimin e Hemo-Dializës (së vjetër) në Spitalin Rajonal të Shkodrës që prej vitit 2005 deri në Qershor të vitit 2016 kur nga Ministria e Shëndetësisë u investua për Hemo-Dializën e re, ishte i plotësuar deri më datë 02.07.2016. Shkresa me nr.1267, prot, datë 06.06.2016, i referohet procedurës së prokurimit për blerje materiale për Hemo-Dializën (e vjetër) deri në 30.06.2016, citon se: “*shërbimi i hemodializës nuk është dhënë akoma me koncesion siç pritet, mbetemi të zbuluar para nevojave të këtij shërbimi për muajin Qershor 2016*”. Në vazhdim, me shkresën nr. 3190/1 prot, datë 14.06.2016, Drejtori i Drejtorisë së Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, i miraton SRSH-së kërkesën për kryerjen e procedurave për blerje materiale për hemodializën por nuk përmend në këtë se shkresë se arsyeja e kryerjes së procedurës së prokurimit të blerjes së materialeve mjekësore për repartin e vjetër të hemo-dializës vetëm për një muaj, është se ky shërbim do të jepet me koncesion. Në vazhdim, urdhri i prokurimit me nr.1299 prot, datë 08.06.2016, citon se: “*sipas Ministrisë së Shëndetësisë, më 01.06.2016, ky shërbim do të privatizohet*”. Si rrjedhojë, të vetmet shkresa zyrtare që përmendin faktin se shërbimi i Hemo-Dializës do të privatizohet, janë shkresat e mësipërme të nxjerra nga SRSH. Si rezultat, nuk ka asnjë korespondencë zyrtare midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe SRSH-së ku të kërkohet se pajisjet e Hemo-Dializës ekzistuese në Spitalin e Shkodrës të cilat janë mirëmbajtur për vite me rradhë që prej vitit 2005 vit në të cilin është kryer investimi, duhej të lireshin në mëshirë të fatit ose të shkëputeshin nga funksionimi dhe të abandonoheshin tek reparti i vjetër i Hemo-Dializës. Grupi i auditimit, në datën 30.01.2018 dhe jo vetëm, ka kryer inspektime të ambienteve të

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

repartit të Hemo-Dializës së vjetër dhe ka konstatuar 9 makineri/pajisje të markës Innova-Hospital. Tek këto pajisje, u konstatua se ekranet e tyre, funksiononin normalisht. U konstatua në gjendje pune edhe impianti i ujit të dializës së vjetër. Makineritë e Hemo-Dializës së vjetër, kishin numrat e tyre të inventarit dhe u identifikuan lehtësisht duke u bazuar edhe tek procesverbali i mbajtur në periudhën e investimit, në vitin 2005. Konkretisht sipas procesverbalit të mbajtur në datën 27.07.2005, ku jepet vlera e investimit dhe makineritë e Hemo-Dializës. Ky procesverbal, është i firmosur nga komisioni me përfaqësues Gj.I., Sh.L., A.B., A.F. dhe Dh.G. Në vazhdim, është edhe fatura me datë 27.07.2005 e firmosur nga B.K. Gjithsesi, ekzistenca e këtij reparti, vërtetohet edhe nga shërbimet e kryera gjatë periudhës që është shfrytëzuar por sidomos nga fakti se janë blerë materiale për repartin e Hemo-Dializës gjatë gjithë kohës deri në Qershor 2016 (sqsuar më lart). Ekzistenca e këtij reparti, vërtetohet edhe nga shërbimet e mirëmbajtjes së tyre të kryera gjatë periudhës që është shfrytëzuar por sidomos nga fakti se janë blerë materiale/pjesë këmbimi për pajisjet e repartit të Hemo-Dializës gjatë gjithë kohës deri në Qershor 2016. Ministria e Shëndetësisë, përpara se të kryente një investim për një repart të ri Hemo-Dialize në Spitalin Rajonal të Shkodrës duke ja kaluar atë me koncesion (PPP) kompanisë private “D.” sh.p.k, duhej që të paktën të kërkonte zyrtarisht nga SRSH, sqarime për nevojat e Spitalit pasi Hemo-Dializa ekzistuese, ishte në punë, ishte e siguar me mirëmbajtje deri në Mars të 2017 e si e tillë, nuk mund të lihej jashtë funksionit aq më tepër që pacientët, janë shërbyer për vite me rradhë. Ministria e Shëndetësisë, duhej të inspektonte me specialistët e ASHPM, ambientet dhe makineritë mjekësore të repartit të Hemo-dializës ekzistuese të SRSH-së për të vërtetuar nëse ky Spital ka pasur apo jo nevojë për një repart të ri Hemo-Dialize. Fakti që makineritë mjekësore të reja janë më të M.se ato të vjetrat, nuk do të thotë aspak se nuk duhej bërë më parë një analizë e mirëfillte e kostos së investimit që do të kryhej nga Ministria e Shëndetësisë duke e krahasuar me atë ekzistues e sidomos duke menduar se është mirëmbajtur gjatë gjithë kohës për më tepër që pjesët ose makineritë kishin garancinë e mirëmbajtjes deri në Mars të vitit 2017 pra pothuajse 1 vit akoma. Vlera e makinerive të repartit të Hemo-Dializës ekzistuese të SRSH-së, prej **11,629,695 lekë** (e llogaritur deri në Qershor 2016), e amortizuar në vite, **konsiderohet dëm i parikuperueshëm dhe humbje me efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit** por mbi të gjitha aspak në interes të shëndetit publik duke mos i shërbyer më pacientëve të Spitalit Rajonal Shkodër pas Qershorit 2016 por as ndonjë Spitali tjetër në Republikën e Shqipërisë si p.sh Spitalit të Kukësit i cili nuk e ka pasur komoditetin e këtyre investimeve apo shërbimeve të Dializës.

-Referuar urdhrin nr. 3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.5 lidhur me inventarizimin e paisjeve mjekësore, citohen qartazi hapat që duhen ndjekur për të bërë të mundur administrimin me efektivitet të procesit të mirëmbajtjes së paisjes mjekësore por edhe të pasqyrimin të historikut të defekteve të ndodhura gjatë përdorimit. Në vazhdim, tek 3.5.6 dhe 3.5.7, pasqyrohen përgjegjësitë e Agjencisë Shqiptare të Paisjeve Mjekësore. Në vazhdim deri tek 3.5.18, sqarohen hapat që duhen ndjekur për mirëadministrimin e pajisjeve mjekësore, për menaxhimin sa më të mirë të fondeve për mirëmbajtjen e tyre, për mirëmbajtjen parandaluese të paisjeve mjekësore por mbi të gjitha për administrimin e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

një sistemi qëndror informacioni mbi të dhënat e makinerive mjekësore në rang kombëtar. Deri këtu, është absolutisht përgjegjësia e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë që nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë kërkuar informacion paraprak nga SRSH për gjendjen e Hemo-Dializës ekzistuese të paktën nga dokumentacioni ligjor që ka grupi i auditimit.

-Sa më sipër, nëse SRSH, do të kishte plotësuar kushtet sipas urdhrit nr.3 272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, pra nëse do të kishte një data-base të dhënash për pajisjet mjekësore që ka në administrim SRSH, mund të kryente dhurimin e këtyre pajisjeve për spitale të tjera që nuk i kanë. Nëse do të bëhej një analizë e tillë, SRSH, do ta kishte të lehtë të plotësonte kushtet e përcaktuara në pikën 3.2 e në vazhdim mbi politikat e dhurimit të pajisjeve mjekësore. SRSH, jo vetëm që nuk ka ndërmarrë asnjë masë në vitin 2016 ose më saktë me vënien në punë të hemo-dializës së re pra Qershor 2016, por ka vazhduar me të njëjtin indiferentizëm deri në fund të vitit 2017 madje edhe gjatë kohës që grupi i auditimit po kryente auditimin, Mars 2018.

Duke ditur që vlera fillestare e investimit të kryer në vitin 2005, për repartin e Hemo-Dializës së Spitalit Rajonal Shkodër është **22,308,195 lekë** (sipas pasqyrave financiare të vitit 2005) dhe njëkohësisht duke ditur se norma e amortizimit vjetor të makinerive e pajisjeve operacionale është 5.8% referuar UMF nr.14, datë 28.12.2006, konkludojmë se vlera e makinerive mjekësore të Hemo-Dializës së vjetër, **në momentin e abandonimit të tyre**, deri në fund të muajit Qershor 2016, (koha kur u vendos në funksion reparti i Hemo-Dializës së re me koncesion (PPP) nga Ministria e Shëndetësisë) **pa llogaritur vlerat e investuara në vite për mirëmbajtjen e makinerive**, është **11,629,695 lekë**. Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Shqiptare e Pajisjeve Mjekësore (ose QKBPM-Qendra Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore), Drejtoria e SRSH-së, Sektori i Inxhinierisë Klinike të SRSH, Sektori i Menaxhimit të Teknologjisë, Sektori i Kostos, duhet të kishin bërë një analizë profesionale tekniko-ekonomike në interes të buxhetit të shtetit e të shëndetit publik për vetë faktin se makineritë e vjetra (në kohë) mund të vazhdonin të funksiononin (ose të dhuroheshin në Spital tjetër) edhe pse u investua për të reja nga Ministria e Shëndetësisë pasi të vjetrat kishin garanci për mirëmbajtje edhe 1 vit akoma pas momentit të investimit të ri (PPP) të Hemo-Dializës. Nga grupi i auditimit, jo vetëm që nuk u evidentua një analizë e tillë por nuk u evidentua as ndonjë korespondencë midis SRSH-së dhe MSH-së ose anasjelltas ku të përmendej fakti se Spitali Rajonal Shkodër, kishte në përdorim dhe në funksion të plotë 9 makineri Hemo-Dialize të Markës Innova-Hospital, të mirëmbajtura gjatë gjithë kohës. Nuk ka dokument ose relacion nga Sektori i Inxhinierisë Klinike të SRSH, ku të citohet se investimi i ri, për një repart të ri Hemo-Dialize, është bërë pasi është analizuar gjendja teknike e makinerive mjekësore të repartit të Hemo-Dializës së vjetër të SRSH-së konform Urdhrit nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi *“Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore”*. Lënia në mëshirë të fatit, e makinerive mjekësore të repartit të Hemo-Dializës ekzistuese të SRSH-së, me rëndësi jetike për shëndetin publik, është në kundërshtim të hapur me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit të investimeve publike.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Vlera e makinerive të repartit të Hemo-Dializës ekzistuese të SRSH-së, prej **11,629,695 lekë** (e llogaritur deri në Qershor 2016), **përbën dëm ekonomik të parikuperueshëm duke ngarkuar me përgjegjësi, drejtorin e SR Shkodër, z. P.Ç. për periudhën nga data 05.05.2016 deri në datën 06.12.2017.**

**Kjo vlerë, do të konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin që 9 makineritë e markës Innova-Hospital të Hemo-Dializës së vjetër, do të përdoren nga SR Shkodër duke u shërbyer pacientëve, ose do të transferohen në një Spital tjetër (p.sh SR Kukës) për tu shërbyer pacientëve të atij Spitali.**

*(Sqarim: Në raportin përfundimtar, u konsiderua dëm ekonomik vlera e mësipërme për arsye se SR Shkodër, në ballafaqimin përfundimtar, nuk solli asnjë dokumentacion ligjor ose argumenta bindëse për të vërtetuar të kundërtën).*

**5.12 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është:*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”.

***Nga verifikimi rezultoi që:***

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Evadim i mbeturinave spitalore”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.04 datë 30.01.2017	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H. E.H. A.B.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> F.Sh. D.K. M.K.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,075,500 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>1,025,779 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>49.721 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 01.03.2017.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>FSDKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës në tender: “P.S.” sh.p.k &amp; “R-94.” sh.p.k., “D.I.” sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së shërbimit</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>15.03.2017.</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,230,935 lekë.</b>	

U konstatuan:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.26, Prot të datës 01.03.2017 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 2 operatorë ekonomik dhe konkretisht “D.I.” sh.p.k. dhe bashkimi i operatorëve ekonomik “R-94.” sh.p.k. & “P.S.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.3024, Prot-datë 14.12.2016, A.D., dërgon specifikimet teknike të procedurës së prokurimit dhe fondin limit.

-Me shkresën nr.231, Prot-datë 25.01.2017, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, dërgon vlerën e fondit limit 1,075,500 lekë pa tvsh, tek drejtorja e SRSH-së. Tek kjo shkresë, komisioni i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, ka specifikuar se: Për zërin “*Grumbullim, sistemim i mbetjeve urbane e spitalore jo të rrezikshme 3m<sup>3</sup>/ditë*” për 300 ditë, me çmim 245 lekë për m<sup>3</sup>, vlera e përlllogaritur del 220,500 lekë. Pra, nuk jepet sasia totale e mbetjeve urbane në m<sup>3</sup>. Komisioni, citon se i është referuar kontratave të mëparshme dhe çmimeve të tregut por një gjë e tillë nuk vërtetohet me asnjë dokument zyrtar. Si rrjedhojë, ka vazhduar me të njëjtën llogjikë për të gjithë zërat e tjerë. Nëse bëjmë kalkulimet e sasive të preventivuara, konkludojmë se sasia e mbetjeve për zërin “*Grumbullim, sistemim i mbetjeve urbane e spitalore jo të rrezikshme 3m<sup>3</sup>/ditë*” është 900 m<sup>3</sup>. Sasia për zërin “*Evadim i mbetjeve urbane spitalore jo të rrezikshme 3m<sup>3</sup>/ditë*” është 900 m<sup>3</sup>. Sasia e për zërin “*Dizinfektim vendgrumbullim të mbetjeve urbane 1.5 kg/ditë*” është 450 kg. Sipërfaqja që do të pastrohet, është llogaritur për 300 ditë duke pastruar 12 m<sup>2</sup> në ditë, pra në total dalin 300 ditë x 12 m<sup>2</sup>/ditë = 3600 m<sup>2</sup> kur në fakt nga kontratat e mëparshme, sipërfaqja e pastruar është 3445 m<sup>2</sup>. Sa më sipër, komisioni i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, nëse do ti referohej kontratës së mëparshme pra asaj të vitit 2016, nuk do të kishte këto vlera por të tjera madje më të vogla. Konkretisht, për zërin e parë, vitin e kaluar, janë preventivuar 876 m<sup>3</sup> dhe jo 900 m<sup>3</sup>. Për zërin e dytë, njësoj. Për zërin e tretë, janë preventivuar 292 kg dhe jo 450 kg. Pra, argumentimi i nxjerrjes së fondit limit nuk ka asnjë dokument apo analizë teknike të mbështetur në fakte dhe shkresa zyrtare. Sa më sipër, nxjerrja e fondit limit është bërë në kundërshtim me vendimin nr.914, datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 59, përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, pika 2. Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga A.D., D.Ll. dhe Nermina Bekteshi.

-Me shkresën nr.273, Prot-datë 30.01.2017, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.04, për fillimin e procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe A.B.

-Me shkresën nr.274, Prot-datë 30.01.2017, titullari i SRSH, miraton njoftimin e kontratës, publikuar në APP më 06.02.2017.

-Me shkresën nr.05, Prot-datë 30.01.2017, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe në vazhdim, me shkresën nr.06, autorizohet nëpunësja Xh.H. për të krijuar dosjen elektronike.

-Me shkresën nr.413, Prot-datë 06.02.2017, pranë SRSH-së, mbrin një ankesë nga operatori ekonomik pjesëmarrës në tender “D.I.” sh.p.k., lidhur me DST-në dhe konkretisht me kriteret e kualifikimit të publikuara nga SRSH. Në ankesë, citohet si më poshtë vijon:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Lidhur me ankesën, sqarohet se;

1) “OE të ketë leje për shesh të hedhjes së mbeturinave të miratuar nga Autoriteti përkatës”. Ky kriter, mendoj se duhet hequr sepse nuk është operatori ekonomik që merr leje dhe përcakton vendin e hedhjes së mbeturinave por është Autoriteti Kontraktor që përcakton këto. Njëkohësisht, referuar specifikimeve teknike nga ana juaj thuhet “Mbetjet spitalore të asgjësohen me djegie. Mbetjet e tjera të dërgohen në vendet e caktuara nga Bashkia për gjithë qytetin”. Atëhere referuar sa më sipër, automatikisht kërkesa juaj bie ndesh si AK dhe nuk ka pse OE të ketë leje për shesh hedhjes mbeturinash. Prandaj kjo pikë të hiqet.

2) “OE të ketë licensë nga QKL në lidhje me fushën e mbetjeve spitalore”. Edhe ky kriter, është i pa bazuar dhe pa sens sepse po ta marrim të mirëqenë këtë pikë, AK detyrimisht duhet të përcaktojë kodin e licensës që kërkon dhe jo ta lerë evazive pa adresë, prandaj kërkojë të hiqet si pikë.

3) “OE të jetë i paisur me leje mjedisore të tipit C për transport, largim të mbetjeve urbane dhe spitalore jo të rrezikshme”. Referuar udhëzimit nr.3, datë 02.12.2013 të Ministrisë së Mjedisit lidhur me dokumentacionin e nevojshëm që duhet për të nxjerrë leje të tipit A, B dhe C, në asnjë pikë apo udhëzim që bën fjalë për leje mjedisoretë tipi C për transport dhe largim mbetjesh urbane dhe spitalore jo të rrezikshme. Këto tipe licensash jepen për aktivitete prodhuese apo ndërtues që kanë ndikim në mjedis dhe jo për një kamion mbeturinash që ngarkohet dhe transportohet për në lanfill. Prandaj kërkojë që ky kriter të hiqet si i pa bazuar në llogjik ose prova.

4) “OE të ketë çertifikatë ISO 9001-2008, mbledhje dhe evadim i mbetjeve spitalore”. Lidhur me këtë pikë, ju sqarohet se nuk është çertifikata ISO që përcakton aftësitë apo mundësitë që një firmë ka për të pastruar një territor por janë disa faktorë të tjerë që përcaktojnë aftësitë e OE siç janë punët e ngjashme, stafi-fuqia punëtore, kualifikimet, makineritë, etj. Prandaj mjafton të kesh 300 euro dhe 24 orë dhe paisesh me këtë ISO, si etillë kërkojë që të hiqet.

-Me shkresën nr.431, Prot-datë 06.02.2017, Titullari i SRSH-së, z.P.Ç., nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesës së ardhur nga “D.I.” sh.p.k., të përbërë nga B.B., J.ZH. dhe S.T.

-Me shkresën nr.432, Prot-datë 06.02.2017, Titullari i SRSH-së, urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit për arsye të ankesës së ardhur deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

-Me shkresën nr.458, Prot-datë 08.02.2017, komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës, i kërkon sektorit të planifikimit të prokurimeve, vënien në dispozicion sa më parë të bazës ligjore mbi të cilën njësia e prokurimit është bazuar në vendosjen e kritereve.

-Me shkresën nr.458/1, Prot-datë 08.02.2017, njësia e prokurimit, i kthen përgjigje komisionit të shqyrtimit të ankesës ku e informon për bazën ligjore ku njësia është mbështetur dhe njëkohësisht e vë në dijeni se data 08.02.2017, është afati përcaktuar për kthimin e përgjigjes ndaj ankimesit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.467, Prot-datë 08.02.2017, komisioni i shqyrtimit të ankesës, i dërgon Titullarit të SRSH-së, përgjigjen e ankesës ku i citon midis të tjerash se: “ ..*Meqenëse komisioni i ngritur nuk ka në përbërje të tij specialistë të fushës për tenderin me objekt evadim i mbeturinave spitalore, ju drejtua sektorit të planifikimit dhe prokurimeve për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës sipas legjislacionit në fuqi*”.

-Me shkresën nr.481, Prot-datë 09.02.2017, Titullari i SRSH-së, i dërgon përgjigje ankimesit ku e informon se pas shqyrtimit të ankesës, SRSH, vendos që të merret në konsideratë vetëm një pretendim por jo të gjitha pikat e ankesës.

-Me shkresën nr.509, Prot-datë 10.02.2017, njësia e prokurimit, cakton datën e zhvillimit të tenderit duke kalkuluar afatet ligjore për pritjen e ankimimit në KPP të ankimesit.

-Me shkresën nr.613, Prot-datë 23.02.2017, Titullari i SRSH-së, vendos heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Evadim i mbeturinave spitalore*” për arsye të përfundimit të afatit të ankimesit.

-Me shkresën nr.21/1, Prot-datë 23.02.2017, mban procesverbalin e ndryshimit të dokumentave standarde të tenderit.

-Me shkresën nr.614, Prot-datë 23.02.2017, Titullari i SRSH-së, miraton ndryshimet e DST-së.

-Me shkresën nr.629, Prot-datë 27.02.2017, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga F.Sh., D.K. dhe M.K.

-Me shkresën nr.26, Prot-datë 01.03.2017, komisioni i vlerësimit të ofertave, kryen procesin e verifikimit të ofertave të ardhura dhe konstaton një ofertë të rregullt nga operatori ekonomik “R-94.” & “P.S.” sh.p.k. dhe deklaron se operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor.

-Me shkresën nr.766, Prot-datë 13.03.2017, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin përmbledhës së procedurës së prokurimit dhe propozon që të shpallet fitues operatori ekonomik i vetëm “R-94.” & “P.S.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.767, Prot-datë 13.03.2017, Titullari i SRSH-së, miraton formularin e njoftimit të fituesit dhe shpall fitues operatorin ekonomik “R-94.” & “P.S.” sh.p.k., me ofertën me vlerë 1,048,900 lekë pa tvsh. Ky formular është publikuar në faqen e APP-së më 20.03.2017.

-Me shkresën nr.27, Prot-datë 13.03.2017, sektori i planifikimeve dhe prokurimeve i përbërë nga P.N., E.H. dhe Vinjola Berthanza, ribëjnë përlogaritjen e vlerës së kontratës në varësi të datës që lidhet kontrata duke kalkuluar ditët e mbetura deri në fund të vitit 2017 dhe konkludojnë se vlera e kontratës duhet të jetë 1,225,079 lekë pa tvsh.

-Kontrata e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “R-94.” & “P.S.” sh.p.k., mban datën 15.03.2017 dhe nr.Prot 780. Afati i ekzekutimit është deri në fund të vitit 2017 ose 291 ditë.

-Sa më sipër, konstatohet se:

Aneksi i kontratës, tek i cili pasqyrohet grafiku i ekzekutimit të kontratës, i referohet 293 ditëve shërbim. Nëse kalkulojmë ditët e mbetura deri në fund të vitit 2017, konstatojmë se nga data e lidhjes së kontratës deri në fund të vitit ose në afatin e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

përfundimit të kontratës, ngelen 291 ditë dhe jo 293 ditë shërbimi siç citohet tek aneksi i kontratës së firmosur. Gjithashtu, konstatohet se sasitë e mbetjeve dhe sipërfaqja që do të pastrohet, nuk ka asnjë lidhje me të dhënat e DST.

**Konkretisht:**

**a)** Për zërin “*Grumbullim e sistemim i mbetjeve urbane e spitalore jo të rrezikshme 3m<sup>3</sup>/ditë*” vlera e shërbimit duhet të ishte 291 ditë x 3m<sup>3</sup>/ditë = 873 m<sup>3</sup> x 260 lekë/m<sup>3</sup>(referuar formularit të ofertës) = 226,980 lekë. Vlera e këtij shërbimi, është ulur me 2.835 lekë.

**b)** Për zërin “*Evadim i mbetjeve urbane 3m<sup>3</sup>/ditë*” vlera e shërbimit duhet të ishte 291 ditë x 3m<sup>3</sup>/ditë = 873 m<sup>3</sup> x 665 lekë/m<sup>3</sup> = 580,545 lekë. Ky shërbim është rritur me 3.990 lekë.

**c)** Për zërin “*Dizifektimi i vend grumbullimit të mbetjeve urbane 1.5 kg/ditë*” vlera e shërbimit duhet të ishte 291 ditë x 1 kg/ditë = 291 kg x 180 lekë/kg = 52.560 lekë. Vlera e këtij shërbimi, është rritur me 22.115 lekë.

**d)** Për zërin “*Pastrim i territorit*” vlera e shërbimit duhet të ishte 3445 : 291 ditë = 11.8 m<sup>2</sup>/ditë x 30 lekë/m<sup>2</sup> = 103,014 lekë. Vlera e këtij shërbimi, është ulur me 18.630 lekë.

-Si rezultat, në total, vlera e kontratës, duhet të ishte:

Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi	Çmimi/Total	Afati Ekzekutimit
Grumbullim e sistemim.3m <sup>3</sup> /ditë.	m <sup>3</sup>	873	260	226,980	291
Evadim i mbetjeve. 3m <sup>3</sup> /ditë.	m <sup>3</sup>	873	665	580,545	291
Dizifektim i vendgrumbullimit.1kg/ditë.	kg	292	180	52.560	291
Pastrim i territorit	m <sup>2</sup>				291
Mirëmbajtje e kontenierëve	herë	15	5100	76.500	291
Shuma (lekë)				936,585	
T.V.SH				187,317	
Shuma Totale (lekë)				1,123,902	

-Si rezultat, kontrata e lidhur, është me vlerë 1,230,935 lekë me tvsh. Duhet të ishte me vlerë 1,123,902 lekë me tvsh. Pra, vlera e kontratës, është rritur me 107,033 lekë.

-Sa më sipër, diferenca e konstatuar prej 107,033 lekë, është vlerë e rritur fiktivisht nga SRSH e cila nuk korrespondon me vlerën e shërbimit që do të kryhej. Si rrjedhojë, për rritjen e vlerës së kontratës, mbi atë të duhurën në masën e 107,033 lekë, mban përgjegjësi Titullari i SRSH-së, z.P.Ç.

**-Zbatimi i kontratës:**

-Gjatë zbatimit të kontratës, janë mbajtur akt-rakordimet për çdo pagesë vlerat e të cilave me tvsh, jepen më poshtë:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Urdhër-shpenzimi nr.148 datë 25.04.2017 me vlerë 67,381 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.18, datë 31.03.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.182 datë 16.05.2017 me vlerë 118,908 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.23, datë 30.04.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.261 datë 21.06.2017 me vlerë 122,770 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.27, datë 31.05.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.316 datë 13.07.2017 me vlerë 118,908 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.37, datë 30.06.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.379 datë 09.08.2017 me vlerë 122,770 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.47, datë 31.07.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.437 datë 11.09.2017 me vlerë 122,770 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.53, datë 31.08.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.508 datë 13.10.2017 me vlerë 118,908 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.59, datë 30.09.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.561 datë 13.11.2017 me vlerë 122,770 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.75, datë 31.10.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.596 datë 05.12.2017 me vlerë 118,908 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.77, datë 30.11.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.631 datë 28.12.2017 me vlerë 192,370 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.95, datë 28.12.2017.
- Sa më sipër, konstatohet se operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k., është likuiduar në vlerën e 1,107,555 lekë dhe jo në vlerën e kontratës së lidhur pra 1,230,935 lekë.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr.40/5, Prot-datë 21.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së nga z.P.Ç., sqarojmë se:

-Nuk kemi konstatuar asnjë dëm ekonomik në procedurën e mësipërme e si rrjedhojë nuk jeni ngarkuar me asnjë përgjegjësi për humbje ose abuzim me vlerat. Konstatimi ka të bëjë me shkelje administrative.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Observacioni juaj, i referohet në fakt akt-konstatimit nr.20 kur realisht, në arsyetimet tuaja, kundërshtoni gjetjet e akt-konstatimit nr.19. Gjithashtu, pretendoni dhe citoni kundërshtime që nuk kanë lidhje me shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit e si i tillë, ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

**5.13 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është:*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore”.

*Nga verifikimi rezultoi që:*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim dhe Mirëmbajtje aparaturash (Laparoskopi – Orologji)”.		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.1451 datë 22.06.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H. P.N. G.G.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit</b> D.H. E.H. Gj.B.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>3,060,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>M. sh.p.k me ofertë: 3,046,500 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>13,500 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 15.07.2016.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, FDSKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë</b> <b>pjesëmarrës në tender: M. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së mirëmbajtjes</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>Dt.29.07.2016</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,655,800 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.66, Prot të datës 15.07.2016 mbajtur nga KVO e SRSH, ka tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 1 operator ekonomik i cili ka paraqitur ofertën për konkurim. Është kualifikuar “M.” sh.p.k me ofertën me vlerë 3,046,500 lekë pa tvsh.

-Raporti përmbledhës është mbajtur më 26.07.2016 dhe ka nr.prot, 1784.

-Formulari i njoftimit të fituesit, mban datën 26.07.2016.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Kontrata e lidhur me nr.1803, Prot-datë 29.07.2016, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “M.” sh.p.k, me vlerë 3,655,800 lekë me tvsh, ka afat të kryerjes së shërbimeve deri më 31.12.2016.
- Me shkresën nr.1217, Prot-datë 30.05.2016, urdhër i brendshëm, titullari i SRSH, ngre komisionin e përlogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje për laparoskopji-orologji*” për vitin 2016, të përbërë nga A.B., Sh.Y. dhe E. F.
- Me shkresën nr.1256, Prot-datë 03.06.2016, komisioni i ngritur me shkresën e mësipërme, i dërgon sektorit të prokurimeve dhe planifikimit, përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Vlera e përlogaritur është 3,060,000 lekë pa tvsh. Komisioni i është referuar kërkesave të ardhura nga repartet përkatëse dhe testimit të tregut.
- Me shkresën nr.1451, Prot-datë 22.06.2016, titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.51 dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., P.N. dhe G.G. për të ndjekur procedurat e tenderit.
- Me shkresën nr.54, Prot-datë 22.06.2016, njësia e prokurimit miraton DST dhe në vazhdim me shkresën nr.55, Prot-datë 22.06.2016, autorizohet punonjësja Xh.H. njëkohësisht kryetare e njësisë së prokurimit, për krijimin e dosjes elektronike të tenderit.
- Sa më sipër, konstatohet se njësia e prokurimit, ka miratuar dokumentat e tenderit dhe konkretisht specifikimet teknike për furnizim-vendosje në të njëjtën kohë që objekti i tenderit është riparim ose shërbim. Njësia e prokurimit, nuk i është përmbajtur aspak nenit 57, pikës 2 të vkm nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.
- Me shkresën nr.1602, Prot-datë 04.07.2016, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga D.H., E.H. dhe Gj.B.
- Me shkresën nr.66, Prot-datë 15.07.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e vlerësimit të ofertave dhe konstaton vetëm një ofertë e konkretisht nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k., i cili ka paraqitur ofertën me vlerë 3,046,500 lekë pa tvsh.
- Raporti përmbledhës është mbajtur me shkresën nr.1784, Prot-datë 26.07.2016 dhe është miratuar nga titullari i SRSH-së, z.P.Ç.
- Me shkresën nr.1787, Prot-datë 26.07.2016, miratohet formulari i njoftimit të fituesit.
- Kontrata është lidhur më 29.07.2016 dhe protokolluar me nr.1803. Afati i kontratës është deri më 31.12.2016. Kontrata është firmosur nga drejtori i spitalit rajonal Shkodër z.P.Ç. dhe konceptuar nga juristja Xh.H.
- Nga shqyrtimi i termave dhe neneve të kontratës, konstatohet se tek neni 11, të drejtat dhe detyrimet e palëve, i referohen kryerjes së një shërbimi ose riparimi. Tek specifikimet teknike, neni 13, tek lista e paraqitur, janë zërat e prokuruar dhe kushtet e shërbimit por tek aneksi i kontratës së lidhur, konstatohet se zërat e prokuruar janë për furnizim-vendosje dhe jo për shërbim. Pra kontrata, edhe pse ka si objekt, riparim/shërbimin e aparaturave laparoskopji-orologji, është lidhur për furnizim mallrash/paisjesh dhe jo për shërbim.

**-Zbatimi i kontratës:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Urdhër-shpenzimi nr.335, datë 03.10.2016, me vlerë 1,656,480 lekë me tvsh, është i shoqëruar me faturën nr.9329, datë 23.08.2016 dhe me faturën nr.9388, datë 16.09.2016. Procesverbalet përkatëse, janë mbajtur nga A.B., G.G., P.M. dhe N.Th.

-Urdhër-shpenzimi nr.468, datë 13.12.2016, me vlerë 1,999,320 lekë me tvsh, është i shoqëruar me faturën nr.9656, datë 05.12.2016 dhe me procesverbalin e mbajtur nga A.B., G.G., P.M. dhe N.Th.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me procedurat që janë ndjekur për zbatimin e kontratës, nuk u evidentua asnjë fletë-hyrje por edhe asnjë fletë-dalje nga magazina e SRSH. Në këtë mënyrë, të gjitha paisjet e blera sipas kësaj procedure, nuk janë pasqyruar në kontabilitet pasi procedura ka qenë me objekt riparim dhe jo furnizim-vendosje. Paisjet e blera, në vlerën e 3,655,800 lekë, nuk kanë kaluar procedurat ligjore për tu quajtur investim. Vlera e mësipërme, nuk figuron në asnjë regjistër për vetë faktin se është quajtur si shpenzim mirëmbajtjeje dhe jo si investim. Si të tilla, materialet e furnizuara, nuk janë të dokumentuara si materiale me vlerë por janë të dokumentuara si shpenzim mirëmbajtjeje. Si e tillë, kjo procedurë prokurimi, do të konsiderohet si procedurë me objektin që është shënuar në urdhrin e prokurimit pra “*Riparim Aparaturash*” e si e tillë do të arsyetohet bazuar tek urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.3272, datë 11.09.2007, mbi Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Paisjeve Mjekësore, urdhër i cili është përmendur tek neni 13 i kontratës së lidhur midis palëve por edhe specifikimet teknike dhe termat e referencës, kanë kushte që i përkasin mirëmbajtjes së makinerive dhe jo një furnizimi materialesh apo instrumentash.

-Sa më sipër, konstatohet se nuk ka asnjë kërkesë ose njoftim me shkrim nga SRSH-ja, drejtuar operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k. ku të kërkohej nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k. të paraqitej pranë SRSH-së për të riparuar defektin konform nenit 11-të të kontratës së lidhur ku citohet tek paragrafi i III se: “*I Porosituri është i detyruar të dërgojë personelin teknik dhe të japë asistencën e nevojshme për riparimin e defektit **brenda 48 orëve nga momenti i njoftimit**”*. Në këtë mënyrë është e pa mundur të vlerësohet nëse është plotësuar kushti sipas paragrafit të IV-të të së njëjtit nen të kontratës së lidhur ku citohet se: “*I porosituri është i detyruar të lëvrojë pjesët e këmbimit të nevojshme për riparimin e paisjes **jo më pak se 7 ditë pune nga marrja e njoftimit**”*. Mos kryerja e njoftimit kundrejt operatorit ekonomik, është në kundërshtim edhe me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, kapitulli III, pika 3.5.14 ku tek gërma b) citohet se për të ndjekur shërbimet e kryera ose riparimit të një paisjeje, duhet regjistruar edhe: “*Emri i personit që ka raportuar një problem me paisjen mjekësore*”. Pra, nuk ka asnjë shkresë ose dokument zyrtar ku të vërtetohet se është raportuar për një problem referuar procesverbaleve të mbajtura, akteve të ndryshme, të firmosura nga punonjësit e institucionit ose nuk ka asnjë formular raportimi sipas shtojcës 6.3, të formularit të raportimit të ngjarjeve të padëshiruara lidhur me paisjet, të urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të nxjerr nga Ministri i Shëndetësisë, ku përcaktohen hapat që duhen ndjekur në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të paparashikuar.

-Gjithsesi, në asnjë nga procesverbalet e mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer, nuk përmendet fakti që pjesët e ndërruara ose të riparuar janë brenda garancisë ose që të paktën janë të vlefshme deri më 31.12.2016, kusht

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

i kërkuar ky tek neni 13 i kontratës së lidhur midis palëve, paragrafi i IV. Nuk u konstatua asnjë dokument zyrtar ku të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u konstatua nga asnjë akt apo procesverbal i mbajtur se pjesët e sjella dhe të vendosura si të reja, janë ose kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet europiane mbi aparaturat mjekësore dhe janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese. Sipas kontratës së lidhur midis palëve, dhe konkretisht të nenit 13, faqja 6 e kontratës, citohet se: *“Organizimi, realizimi, dokumentacioni i blerjes së pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve për aparaturat/paisjet mjekësore, do të realizohet në përputhje me urdhërin nr.3272, Prot-datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, me objekt Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri”*. Si rrjedhojë, më poshtë do të pasqyrohet hap pas hapi se si duhej të kryhej kjo procedurë por edhe se si do të duhej të dokumentohej kryerja e saj.

-Tek urdhri i mësipërm, nr.3272, Prot-datë 11.09.2007, Përcaktohen Politikat Kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri. Konkretisht, tek kapitulli i II, 2.2, Njësitë e Inxhinierisë Klinike (NJIK), citohet *“Me qëllim që spitalet të kenë në dispozicion këto kapacitete profesionale, në nivel spitali ngrihen dhe funksionojnë Njësitë e Inxhinierisë Klinike”*. Tek pika 2.2.3, objektivat, përcaktohet objektivi kryesor i njësisë së inxhinierisë klinike që është *“Mbështetja e cila përfshin kontributin e drejtpërdrejtë në procesin e blerjes, përdorimit, shërbimit, mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së paisjeve mjekësore”*.

**Tek pika 2.2.4, Përgjegjësitë e NJIK (Njësia e inxhinierisë klinike), citohet:**

-*“Në shërbimet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore përfshihen”*:

- *“Mirëmbajtja periodike e planifikuar (parandaluese)”*
- *“Kontrollet e sigurisë”*
- *“Kontrollet e cilësisë lidhur me performancën dhe funksionimin e tyre”*
- *“Shërbimet dhe riparimet”*
- *“Kontaktet me kompanitë e jashtme dhe menaxhimi i kontratave të shërbimit”*
- *“Modifikime dhe përshtatje të pajisjeve mjekësore”*

-Tek pika 2.2.5, Detyrat e NJIK, citohet:

**a.** *NJIK përfaqëson njësinë kompetente të pajisjeve mjekësore brenda spitalit dhe konsultohet nga personeli tjetër i spitalit për gjithçka lidhet me përdorimin, blerjen si dhe me shpërndarjen e pajisjeve mjekësore.*

**b.** *NJIK mbështet procesin e prokurimit të pajisjeve mjekësore për çështje lidhur me specifikime teknike; vlerësimin e kostos gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës; vlerësimin e ofertave të pjesëmarrësve në tender për blerjen e pajisjeve mjekësore.*

**c.** *NJIK për pajisjet e reja mjekësore zbaton testet e pranimit, bën verifikimet e sigurisë, të funksionimit të tyre dhe përputhjen me kërkesat e blerjes.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*d. NJIK zotëron, përditëson dhe forcon njohuritë e nevojshme lidhur me kuadrin rregullator (ligjet, rregulloret, standardet) si dhe ruan dhe zhvillon aftësitë për të dhënë këshilla dhe zhvilluar rekomandime në fushën e inxhinierisë klinike për të funksionuar si një burim këshillimi për çështjet e lidhura me pajisjet mjeksore.*

*e. NJIK kujdeset për të gjitha pajisjet mjeksore që janë në përdorim në spital dhe të regjistruara në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore.*

*ë. NJIK merret në mënyrë aktive me trajtimin e aksidenteve dhe incidenteve me pajisjet mjekësore. Përgjegjësi i NJIK raporton tek autoriteti përkatës në përputhje me procedurën e miratuar të raportimit të këtyre ngjarjeve.*

*f. NJIK është përgjegjëse për trainimin në punë të personelit mjekësor mbi përdorimin dhe sigurinë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore. Kjo kërkon që personeli i NJIK të ketë marrë trainimin e përgjithshëm në fushën e inxhinierisë klinike si dhe kualifikimet dhe trajnimet e duhura për disa pajisje të veçanta për të rritur në mënyrë të vazhdueshme njohuritë dhe aftësitë brenda njësisë.*

*g. NJIK është përgjegjëse për administrimin e Sistemit të Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (sistemit të inventarit të pajisjeve mjeksore si dhe të regjistrit të ngjarjeve të padëshërueshme me pajisjet mjeksore). Sistemi i inventarit është baza për planifikimin e riinvestimeve, për planifikimin e mirëmbajtjes periodike si dhe për krijimin e dosjeve të historisë së pajisjeve mjekësore.*

*-Tek pika 2.3, faqja 12, Agjencia Shtetërore e Paisjeve Mjekësore, citohet: Aktualisht në Shqipëri ekziston Qendra Kombëtare Biomjekësore (QKB), e cila është një punishte kombëtare për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Ajo mbështet të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. **Kur një spital nuk arrin të riparojë një pajisje mjekësore me specialistët e vet atëherë pajisja dërgohet në këtë qendër për riparim ose një specialist i kësaj qendre dërgohet të riparojë pajisjen në vend.** Shumica e të punësuarëve në sektorin e mirëmbajtjes në spitale nuk janë të trajnuar në inxhinieri klinike dhe kanë nevojë të mbështeten nga QKB. Në Shqipëri kanë hyrë dhe vazhdojnë të hyjnë në shumë rrugë pajisje mjekësore të llojeve e markave të ndryshme. Në spitalet tona mund të gjinden pajisje të reja të nënpërdorura, të papërdorura ose që përdoren në mënyrë të papërshtatshme për shkak të shumë faktorëve si mungesa e materialeve të konsumit, mungesë e mirëmbajtjes dhe mungesë e kompetencës nga ana e përdoruesve.*

*-Sa më sipër, SRSH, përpara se të fillonte një procedurë prokurimi me objekt “Riparim Aparaturash”, duhet ti dërgonte një kërkesë, Agjencisë Shtetërore të Paisjeve Mjekësore (ASHPM), pasi të konkludonte se vet SRSH, nuk ishte në gjendje të riparonte vetë defektet, dhe në të njëjtën kohë, ASHPM, duhet të dërgonte pranë SRSH një specialist të fushës ose të udhëzonte për kryerjen e procedurës së prokurimit, gjithmonë konform ligjit dhe këtij urdhëri. Gjithashtu, paracaktimi i vlerës së fondit limit të një procedure mirëmbajtjeje, është në kundërshtim me kapitullin 3 të urdhrit nr.3272, datë 11.09.2007, ku citohet se: **“Prokurimi i pjesëve të këmbimit duhet të shihet si dicka e paplanifikuar,** pasi nuk mund të*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*parashikohet se çfarë pjese këmbimi mund të priset në të ardhmen”. Pra paracaktimi i fondit limit për mirëmbajtje në të njëjtën kohë që nuk dihet defektet që mund të ndodhin është i dyshimte aq më tepër që SRSH, njësisia e inxhinierisë klinike, nuk ka një historik defektesh ose më saktë nuk ka respektuar as pikën 3.5.13 të udhrit të mësipërm mbi të dhënat që duhen regjistruar ku citohet midis të tjerash se “Çdo spital, duhet të regjistrojë ose në letër ose në kompjuter historinë e plotë të paisjes, përfshirë:…g) Të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes”. Gjithashtu, nuk është respektuar as pika 3.8.5 e kapitullit III të urdhrimit të mësipërm, mbi Rregullat për raportimin në nivel spitali lidhur me ndodhjen e defekteve. Konkretisht, midis të tjerash, citohet se “Është e detyrueshme për të raportuar gjithashtu çdo incident tjetër të lidhur me paisjet mjekësore, defektet e vogla dhe mospërputhje me SIPM (Sistemi i Informacionit të Paisjeve Mjekësore), përderisa ato incidente mund të marrin një domethënie më të madhe të bashkuara me ngjarje të tjera të ngjashme duke shprehur prirje ose duke përcaktuar një sistem sigurie të përshtatshëm nga ana e prodhuesit apo furnizuesit”. Njëkohësisht, tek shtojca 6 e urdhrimit nr.3272, datë 11.09.2007, Sistemi i raportimit të ngjarjeve të padëshiruara, shpjegohet qartazi mënyra e raportimit nga çdo i punësuar në institucionet e kujdesit shëndetësor (publik apo privat) i cili ka përgjegjësinë për të raportuar me shkrim tek shefi/përgjegjësi i drejtëpërdrejtë i tij.”. Në vazhdim, tek pika 3.8.9, Si të veprohet me pjesët me defekt ose të kontaminuara, citohet qartazi se: : **“Pjesët me defekt duhet të izolohen kur është e mundur dhe nuk duhet të riparohen (në spital ose me kontraktim) ose t’i kthehen prodhuesit pa marrë paraprakisht miratimin nga SMPM (Sektorit të Menaxhimit të Paisjeve Mjekësore). Gjithashtu ato nuk duhet të hidhen përpara se t’i jepet mundësia SMPM t’i përdorë për hetim të mëtejshëm. Prodhuesi ose furnizuesi duhet të informohen menjëherë dhe të lejohen të kqyrin pjesët vetëm nën mbikqyrjen e një personi të përshtatshëm. Për të lehtësuar hetimin mundet që prodhuesit t’i vihet në dispozicion një mostër e pajisjes me defekt e papërdorur (nga grupi i rezervës). Nëse spitali këshillohet nga SMPM për të kundërtën e asaj që është thënë më sipër, prodhuesi nuk duhet lejuar të këmbëjë, ndërhyjë ose të heqë ndonjë pjesë nga pajisja e përfshirë në aksident nëse kjo do të paragjykonte hetimin e SMPM ose të ndonjë organizmi tjetër. Kur SMPM ka përcaktuar që pjesa me defekt mund t’i kthehet prodhuesit, ky i fundit duhet kontaktuar për t’u siguruar që dokumentacioni dhe transporti janë organizuar siç duhet. Nëse pajisja kërkohet për përdorim, hiqet pjesa me defekt dhe pajisja mund të riparohet. Cdo pjesë e hequr në të tilla rrethana duhet të mbahet e veçuar në një ambient të posaçëm dhe të ruhet për t’u përdorur për hetimet e mëvonshme”.***

-Sa më sipër, argumentimi i fondit limit është i pa bazuar e i pa mbështetur në rregulla dhe urdhra por dhe prokurimi i procedurës, është bërë në kundërshtim me urdhrin e mësipërm pasi nuk janë ndjekur hapat e duhur përpara fillimit të procedurës. Gjithashtu, fakti i mos argumentimit me dokumenta zyrtare dhe procedura ligjore ku të vërtetohej kryerja e shërbimit duke dokumentuar dhe pjesët rezervë të dëmtuara, tregojnë se likuidimi i operatorit ekonomik “M.” sh.p.k., është bërë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi aq më tepër që mungon dhe dokumenti financiar që vërteton kryerjen e procedurës. Procesverbalet e mbajtura e të pa protokolluara, mund të bindin komisionin dhe operatorin ekonomik por në

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

asnjë rast nuk mund të vërtetohet ligjërisht se procedura është ekzekutuar konform rregullave. Fakti që, shërbimet e deklaruara si të ekzekutuara, vërtetësia e të cilave, nuk justifikohet me dokumentacion ligjor dhe me procedura të ndjekura sipas urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” por edhe konform kushteve të kontratës së lidhur midis palëve, përbën shkas për aludime mbi shërbimet reale të kryera dhe ato të pa kryera.

-Për veprimet e mësipërme:

-Për mos respektim të urdhrin nr.3237, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, mban përgjegjësi A.B. me detyrë Inxhinierë Klinike.

-Gjithashtu, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Paisjeve Mjekësore), konform urdhrin të mësipërm, kapitulli II, pika 2.3.1. Pa pasur më parë një informacion të detajuar sipas kapitullit III të urdhrin të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6, por edhe duke filluar një procedurë prokurimi me fond limit të paracaktuar kur faktikisht nuk mund të parashikohen se sa defekte do të ndodhin, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, ku citohet se: “*Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet se diçka e paplanifikuar*”. Sa më sipër, mban përgjegjësi, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, z.P.Ç.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1577, Prot-datë 04.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/3, Prot-datë 07.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së, shoqëruar me observacionin e shkresës me nr.1753/4, Prot-datë 16.05.2018 nga zj.A.B., sqarojmë se: Në ndryshim nga observacioni juaj i mëparshëm i sjellë për projekt-raportin e KLSH ku ju citonit “*Në lidhje me mangësitë e evidentuara nga ana e grupit të auditimit, nuk janë përgjegjësi direkt e imja...*”, ky observacion, i sjellë nga ju, për të njëjtat shkelje, ka si pretendim se paskeni zbatuar pikë për pikë urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë por përsëri nuk keni sjellë asnjë dokument ligjor që të vërtetohet të paktën se keni komunikuar me QKB-në. Për më tepër, devijoni të vërtetën kur citoni se: “*Pjesët me defekt vazhdojnë të jenë të ruajtura në një ambient të veçantë dhe i paskemi evidentuar ne si grup se paskan qenë të izoluar*”. Zj.B., në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë ambient i posaçëm për ruajtjen e pjesëve me defekt. Kryeinfermierja e repartit, është e vërtetë se na tregoi pjesët e vjetra por harroni se ato u nxorrën nga salla e operacionit me tavolinën e posaçme të punës (pra përdreshin edhe pse të vjetra). Mos pretendoni qëllimisht se paskeni ambient të veçantë, kur ju vet keni dekluar se keni kërkuar një ambient të tillë dhe nuk ju është miratuar kërkesa. Izolimi ose ruajtja, nuk vërtetohet duke na thënë se “*e kam bërë*” thjesht me fjalë. Vërtetohet me dokumenta financiarë hyrës dhe dalës tek ambienti. Vërtetohet me firmat e personit të autorizuar që ka përgjegjësinë ligjore të mbajtjes në ruajtje të pjesëve të defektuara. Mos pretendoni sot pas afro 1.5 muaj nga afati i përfundimit të auditimit, që të

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

vërtetoni se paskeni dokumentuar të gjithë historikun e defekteve duke na cituar se paskeni akses në sistem (SIPM) me username dhe passëord. Të paktën, nëse është kështu, përse nuk sollët të njëjtat pretendime edhe tek observacionet e mëparshme të dërguara me shkresën me nr.1249/3, datë 10.04.2018 për projekt raport kur dihet se natyra e shkeljes është e njëjtë?

Sa më lart, observacioni juaj, nuk merret në konsideratë.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

-Lidhur me observacionin e sjellë nga z.P.Ç., me shkresën me nr.40/5, Prot-datë 21.05.2018, sqarojmë se është mëse e argumentuar në akt-konstatim. Pretendimet tuaja se nuk kemi të bëjmë me devijim, janë verbale. Devijimi i konstatuar në aktin e mbajtur, është i bazuar në ligj dhe nuk po diskutojmë se është bërë me vetëdije pasi kjo do të ishte e rëndë për ju. Po diskutojmë se është vepruar (ndofta nga pa dija) në kundërshtim me ligjin.

**5.14 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje medikamente për kimioterapinë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është:*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt **“Blerje medikamente për kimioterapinë e ndare ne lote, gjithsej 11 lote”**.

*Nga verifikimi rezultoi që:*

<b>h. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje medikamente për kimioterapinë e ndarë në lote, gjithsej 11 lote”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.83 datë 20.10.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> G.N.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> E hapur.	E.H. D.B.	J.ZH. G.B.
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>9,991,357 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>S. sh.p.k me ofertë: 2,239,160 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>3840 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 03.11.2016.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, FDSKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës</b> <b>në tender.</b> <b>B.P. sh.p.k. dhe S. sh.p.k</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës</b>		

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>Dt.15.11.2016</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,686,992 lekë.</b>
--	---

U konstatuan:

-Nga kontrolli dhe sipas procesverbalit Nr.122, Prot të datës 18.11.2016 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet:

-Për lotin e parë, me fond limit 2,358,288 lekë pa tvsh “I.F.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “I.F.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 1,380,000 lekë pa tvsh.

-Për lotin e dytë, me fond limit 318,234 lekë pa tvsh “I.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “I.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 318,150 lekë pa tvsh.

-Për lotin e tretë, me fond limit 662,386 lekë pa tvsh “T.” sh.p.k. S’kualifikohet për mungesë dokumentacioni.

-Për lotin e katërt, me fond limit 330,160 lekë pa tvsh “R.F.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “R.F.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 330,000 lekë pa tvsh.

-Për lotin e pestë, me fond limit 783,482 lekë pa tvsh “I.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “I.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 767,200 lekë pa tvsh.

-Për lotin e gjashtë, me fond limit 83,572 lekë pa tvsh “I.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. S’kualifikohen të dy për mungesë dokumentacioni.

-Për lotin e shtatë, me fond limit 2,569,608 lekë pa tvsh “I.F.” sh.p.k., “R.F.” sh.p.k dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “I.F.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 2,512,800 lekë pa tvsh dhe “R.F.” sh.p.k me ofertën me vlerë 2,482,128 lekë pa tvsh.

-Për lotin e tetë, me fond limit 16950 lekë pa tvsh “I.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “I.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 16950 lekë pa tvsh.

-Për lotin e nëntë, me fond limit 461,750 lekë pa tvsh “R.F.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. Kualifikohet “R.F.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 16950 lekë pa tvsh.

-Për lotin e dhjetë, me fond limit 2,347,970 lekë pa tvsh “R.F.” sh.p.k., “F.F.” sh.p.k. dhe “T.” sh.p.k. S’kualifikohen të tre për mungesë dokumentacioni.

-Për lotin e njëmbëdhjetë, me fond limit 58957 lekë pa tvsh “T.” sh.p.k., s’kualifikohet për mangësi.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan si më poshtë vijon:

-Në dosjen e procedurës së mësipërme, u evidentua një e-mail drejtuar drejtorit të SRSH nga Ministria e Shëndetësisë ku i citohet se SRSH ka në dispozicion vlerën e 10,000,000 lekë për të blerë kimiopreparate. E-mail i mban datën 06.09.2016.

-Me shkresën nr.2508, Prot-datë 11.10.2016, drejtori i SRSH-së, P.Ç., nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit të përlogaritjes së fondit limit të përbërë nga D.B. Kryetar, V.T. dhe E.A. antarë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Me shkresën nr.2525, Prot-datë 14.10.2016, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, përlllogarit fondin limit në vlerën e 9,991,356.21 lekë pa tvsh.
- Me shkresën nr.2555, Prot-datë 20.10.2016, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit për procedurën e mësipërme me fond limit 9,991,357 lekë pa tvsh. Cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe D.B. për vazhdimin e procedurës së prokurimit. Në vazhdim me shkresën nr.108, Prot-datë 20.10.2016, autorizohet Xh.H. për krijimin e dosjes elektronike të procedurës së mësipërme.
- Njësia e prokurimit, ka miratuar DST-të me shkresën me nr.107, Prot-datë 20.10.2016.
- Me shkresën nr.2757, Prot-datë 14.11.2016, drejtori i SRSH, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga G.N., J.Xh. dhe G.B.
- Me shkresën nr.122, Prot-datë 18.11.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e hapjes së ofertave dhe evidenton 22 oferta të ardhura për 11 lotet të marra sëbashku (trajtuar më lart).
- Me shkresën nr.2829, Prot-datë 22.11.2016, operatori ekonomik “F.F.” sh.p.k., depoziton një ankesë pranë SRSH lidhur me s’kualifikimin e padrejtë nga KVO. Në vazhdim me shkresën me nr.2837, Prot-datë 22.11.2016, Anullim për rishqyrtim ankese dhe me shkresat me nr.2862, nr.2863 dhe nr.123, Prot-datë 25.11.2016, merret në konsideratë ankesa e operatorit ankimues dhe vazhdon procesi i vlerësimit.
- Me shkresën nr.2856, Prot-datë 25.11.2016 dhe nr.2916, Prot-datë 05.12.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave mban procesverbalet përmbledhëse të procedurës së mësipërme dhe propozon fituesit e loteve.
- Kontrata e lidhur me nr.2937, Prot-datë 06.12.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “R.F.” sh.p.k, me administrator z.N.Sh., është lidhur në vlerën e 3,273,128 lekë për lotin 4-Oxaliplatine, lotin 7-Trastuzumab dhe lotin 9-Oxaliplatine. Afati i kontratës është nga data 06.12.2016 deri më 15.12.2016.
- Kontrata e lidhur me nr.2927, Prot-datë 06.12.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “I.” sh.p.k, me administrator z.G.K., është lidhur në vlerën e 335,100 lekë për lotin 2-Cyclophosphamid dhe lotin 8-Methotrexat. Afati i kontratës është nga data 06.12.2016 deri më 15.12.2016.
- Kontrata e lidhur me nr.2977, Prot-datë 09.12.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “I.F.” sh.p.k, me administrator z.I.M., është lidhur në vlerën e 1,380,000 lekë për lotin 1-Docetaxel. Afati i kontratës është nga data 09.12.2016 deri më 15.12.2016.
- Kontrata e lidhur me nr.2987, Prot-datë 09.12.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “F.F.” sh.p.k, me administrator zj.A.T., është lidhur në vlerën e 1,545,000 lekë për lotin 10-Paclitaxel. Afati i kontratës është nga data 09.12.2016 deri më 15.12.2016.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Kontrata e lidhur me nr.3015, Prot-datë 14.12.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “I.” sh.p.k, me administrator z.P.M., është lidhur në vlerën e 767,200 lekë për lotin 5-Filglastrim. Afati i kontratës është nga data 14.12.2016 deri më 15.12.2016.

**Zbatimi i kontratave.**

-Urdhër-shpenzimi nr.477, datë 15.12.2016 me vlerë 3,180,928 lekë për medikamente, është i shoqëruar me faturën dhe fletë-hyrjen nr.260, datë 10.12.2016.

-Nga verifikimi i zërave të faturës së dorëzuar por edhe të procesverbalit të mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim, u konstatua një vlerë e pa likuiduar e cila i përket zërit të lotit 9-Oxaliplatine (5mg/ml-10ml). Vlera në total e likuiduar është 3,180,928 lekë. Kontrata, është lidhur për vlerën e 3,273,128 lekë. Bazuar tek neni 8 i kontratës së lidhur midis palëve, operatori ekonomik “R.F.” sh.p.k., duhej të penalizohej me 25% të vlerës së kontratës pasi nuk ka sjellë të gjitha medikamentet sipas listës referuar kontratës së lidhur. Si rrjedhojë, vlera e penalitetit është 818,282 lekë. Kjo vlerë prej 818,282 lekë, i duhej kërkuar operatorit ekonomik “R.F.” sh.p.k., si vlerë që i përket penalitetit për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

-Urdhër-shpenzimi nr.478, datë 15.12.2016 me vlerë 335,100 lekë për medikamente, është i shoqëruar me faturën dhe fletë-hyrjen nr.257, datë 09.12.2016. Likuidimi është bërë për 350 doza 500mg të medikamentit Cyclophosphamid të lotit të dytë dhe për 50 doza 50mg/5ml të medikamentit Methotrexat të lotit të tetë konform kontratës me nr.2927, Prot-datë 06.12.2016, të lidhur midis SRSH dhe operatorit ekonomik “I.” sh.p.k.

-Urdhër-shpenzimi nr.492, datë 23.12.2016 me vlerë 306,880 lekë për medikamente, është i shoqëruar me faturën dhe fletë-hyrjen nr.263, datë 14.12.2016. Likuidimi është bërë për 80 doza 300mg/0.5ml të medikamentit Filgrastrim të lotit të pestë.

-Urdhër-shpenzimi nr.507, datë 29.12.2016 me vlerë 460,320 lekë për medikamente, është i shoqëruar me faturën dhe fletë-hyrjen nr.264, datë 14.12.2016. Likuidimi është bërë për 120 doza 300mg/0.5ml të medikamentit Filgrastrim të lotit të pestë. Likuidimet e mësipërme janë bërë konform kontratës me nr.3015, Prot-datë 14.12.2016, të lidhur midis SRSH dhe operatorit ekonomik “I.” sh.p.k.

-Urdhër-shpenzimi nr.501, datë 28.12.2016 me vlerë 1,380,000 lekë për medikamente, është i shoqëruar me faturën dhe fletë-hyrjen, datë 15.12.2016. Likuidimi është bërë për 250 doza 80mg të medikamentit Docetaxel të lotit të parë konform kontratës me nr.2977, Prot-datë 09.12.2016, të lidhur midis SRSH dhe operatorit ekonomik “I.F.” sh.p.k.

-Shpenzimi me vlerë 1,545,000 lekë, është i shoqëruar me faturën nr.3672, datë 09.12.2016, fletë-hyrjen nr.259, datë 09.12.2016 dhe procesverbalin e mbajtur nga komsioni i marrjes në dorëzim. Likuidimi është bërë për 250 doza 100mg/16.67ml të medikamentit Paclitaxel të lotit të dhjetë konform kontratës me nr.2987, Prot-datë 09.12.2016, të lidhur midis SRSH dhe operatorit ekonomik “F.F.” sh.p.k.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**5.15 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër për një periudhë 1 mujore, rast urgjent me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**  
 Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për një periudhë 1 mujore, rast urgjent.

*Nga verifikimi rezultoi që:*

<b>i. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për një periudhë 1 mujore, rast urgjent.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.47 datë 08.06.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> D.H.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> H.G.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Negocim pa shpallje.	P.N. Dh.G.	A.M. A.M.
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,153,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>B.A. sh.p.k me ofertë: 1,152,420 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>500 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 10.06.2016.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, FDSKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës në tender.</b> <b>B.A. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së Mallrave</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>Dt.13.06.2016</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,382,904 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli dhe sipas procesverbalit Nr.48, Prot të datës 10.06.2016 mbajtur nga KVO e SRSB, ka tërhequr dokumentet 1 operator ekonomik “B.A.” sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertën me vlerë 1,152,420 lekë pa tvsh. Me raportin përmledhës të mbajtur nga KVO me nr.1342, Prot-datë 10.06.2016, i propozohet Autoritetit Kontraktor, të shpalli fitues, operatorin ekonomik të vetëm të kualifikuar “B.A.” sh.p.k.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan si më poshtë vijon:

-Me shkresën pa numër protokollit dhe pa datë, K.K., liston materialet që nevojiten për dializën për periudhën 01.06.2016 deri 30.06.2016.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.1267, Prot-datë.06.06.2016, drejtori i SRSH, z.P.Ç., i dërgon MSH-së dhe konkretisht drejtorit të drejtorisë së administrimit spitalor, një kërkesë tek e cila kërkon sygjerim nga MSH-ja për të mbuluar nevojat e dializës për muajin Qershor.

-Me shkresën nr.1278, Prot-datë 06.06.2016, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit.

-Me shkresën nr.1279, Prot-datë 07.06.2016, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga K.K., M.H. dhe A. Sh., përlllogarisin fondin limit në vlerën e 1,152,420 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.1299, Prot-datë 08.06.2016, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit për procedurën e mësipërme dhe ngarkon njësinë e prokurimit për vazhdimin e procedurave.

-Me shkresën nr.3190/1, Prot-datë 14.06.2016-MSH dhe nr.1383, Prot-datë 15.06.2016-SRSH, drejtori i drejtorisë së administrimit spitalor pranë MSH-së, miraton dhe autorizon SRSH-në për të filluar procedurat për blerje materiale mjekimi për dializën.

-Sa më sipër, konstatohet se drejtori i SRSH-së z.P.Ç., ka nxjerr urdhrin e prokurimit më 08.06.2016 kur në fakt miratimi nga MSH ka ardhur 7 ditë me vonesë, më 15.06.2016 . Si rrjedhojë, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa autorizimin përkatës, mban përgjegjësi, titullari i Autoritetit Kontraktor, z.P.Ç. pasi ka vepruar në kundërshtim me: nenin 60 të vendimit nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

-Kontrata e lidhur me nr.1357, Prot-datë 13.06.2016 midis SRSH dhe “B.A.” sh.p.k, me vlerë 1,152,420 lekë pa tvsh, ka afat ekzekutimi deri më 30.06.2016.

#### **Zbatimi i kontratës.**

-Urdhër-shpenzimi nr.226, datë 12.07.2016 me vlerë 1,382,904 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.134, datë 13.06.2016, fletë-hyrjen nr.113, datë 13.06.2016, me vlerë 1,343,244 lekë me tvsh dhe me faturën nr.135, datë 13.06.2016, fletë-hyrjen nr.114, datë 13.06.2016, me vlerë 39.660 lekë me tvsh, me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudit, i cili ka zërat e materialeve të konsumit të blera.

-Nga auditimi i dosjes së zbatimit dhe konkretisht, nga kontrolli i kryer në farmacinë e Spitalit Rajonal Shkodër, lidhur me sasinë e materialeve mjekësore të tërhequra nga farmacia për repartin e hemodializës, u konstatua sa më poshtë vijon:

-Për periudhën 01/06/2016 deri 30/06/2016, u evidentuan në total 34 fletë-dalje. Konkretisht, fletë-daljet me nr dhe datë si vijon:

01. Nr.1292, datë 01.06.2016, 02. Nr.1196, datë 02.06.2016, 03. Nr.365, datë 02.06.2016, 04. Nr.1305, datë 03.06.2016, 05. Nr.1306, datë 03.06.2016, 06. Nr.1320, datë 06.06.2016, 07. Nr.1326, datë 07.06.2016, 08. Nr.1332, datë 08.06.2016, 09. Nr.1339, datë 09.06.2016, 10. Nr.1348, datë 10.06.2016, 11. Nr.1348, datë 10.06.2016, 12. Nr.1353, datë 10.06.2016, 13. Nr.1354, datë 10.06.2016, 14. Nr.1356, datë 10.06.2016, 15. Nr.1366, datë 13.06.2016, 16. Nr.0767, datë 13.06.2016, 17.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nr.1371, datë 14.06.2016, 18. Nr.1374, datë 14.06.2016, 19. Nr.1378, datë 15.06.2016, 20. Nr.1379, datë 15.06.2016, 21. Nr.1391, datë 15.06.2016, 22. Nr.0019, datë 16.06.2016, 23. Nr.0805, datë 17.06.2016, 24. Nr.0828, datë 20.06.2016, 25. Nr.0696, datë 21.06.2016, 26. Nr.0241, datë 21.06.2016, 27. Nr.0703, datë 22.06.2016, 28. Nr.0702, datë 22.06.2016, 29. Nr.0852, datë 23.06.2016, 30. Nr.1393, datë 24.06.2016, 31. Nr.1416, datë 27.06.2016, 32. Nr.1432, datë 29.06.2016, 33. Nr.1433, datë 29.06.2016 dhe 34. Nr.1442, datë 30.06.2016. Nga kalkulimet dhe kontrollet e fletë-daljeve, rezulton se janë tërhequr nga farmacia për gjithë muajin Qershor, 525 Solucion Acidi, 596 Set Bicart, 596 Set linja Art-Venoze, 593 Filtra Polysulfoni, 3 Filtra Pambuku dhe 100 kg Krip.

-Si rezultat, janë kërkuar që të prokurohen me urgjencë për muajin Qershor 2016, 280 trajtime Acetati por në fakt janë nevojitur 525 të tilla pra janë prokuruar 245 trajtime Acetati më pak. Janë kërkuar urgjent 110 trajtime Bicard por në fakt janë nevojitur 596 të tilla pra janë prokuruar 486 trajtime Bicardi më pak. Janë kërkuar urgjent 90 Sete linjash arteriale-venoze kur në realitet, janë nevojitur 596 linja pra janë prokuruar 506 linja më pak. Janë kërkuar të prokurohet me urgjencë për 310 Filtra kur në realitet janë përdorur 593 të tillë pra janë prokuruar 283 filtra më pak. Është prokuruar me urgjencë për 350 kg kripë kur në fakt është tërhequr nga farmacia vetëm 100 kg. Këto diferenca nga prokurimi në realitet tregojnë qartazi se nuk është bërë asnjë analizë e sasisë që në fakt nevojitet dhe e sasisë që gjendet në farmaci. Nuk ka pasur që në fillim të procedurës së prokurimit një analizë të tillë për të bërë të mundur prokurimin e sasive të nevojshme për muajin Qershor ose të paktën me diferenca të llogjikshme. Të kërkosh të blihen materiale mjekimi ose përdorimi për Hemo-Dializën, krahasuar me repartet e tjera, është më e lehtë të parashikosh nevojat pasi ishte e qartë se numri i pacientëve në muaj varionte nga 50 deri në 60 pacientë. Tek shkresa me nr.1267, Prot-datë 06.06.2016, nuk është aspak e qartë se përse nuk është parashikuar ndonjë fond për periudhën Qershor 2016 ose të paktën përse SRSH, nuk ka marrë masat që të ketë në dispozicion që prej fillimit të vitit 2016, sasinë e nevojshme të materialeve mjekësore që do të nevojiteshin për repartin e Hemo-Dializës. SRSH, jo vetëm që nuk ka parashikuar që në fillim të vitit, mbulimin me nevoja për materiale mjekësore për këtë repart (duke ditur numrin e saktë të pacientëve) por as nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për gjendjen e farmacisë pra që nuk ka materiale për një muaj. Të kryesh një procedurë prokurimi, në emergjencë sepse ke ngelur pa materiale mjekimi, do të thotë se nuk ke kryer sic duhet parashikimet në fillim të vitit. Të kërkosh materiale për muajin pasardhës, të kërkosh në datën 06/06 të fillojë prokurimi për nevojat e muajit dhe njëkohësisht të lidhësh kontratën për periudhën e mbetur pra vetëm për 17 ditë dhe jo për 30 sic kërkohet në fillim, do të thotë se SRSH, vetëm një gjë nuk ka bërë, llogaritjen me profesionalizëm të nevojave të repartit të Hemo-Dializës. Procedurat e prokurimit për blerje materiale mjekimi, ndjekin njëra tjetrën përse i përket datave. Pra, prokurohet në datën 01.06.2016 për periudhën deri 01.05.2016 dhe si rrjedhojë vazhdohet pas këtij prokurimi me prokurimin e rradhës nga 01.05.2016 e në vazhdim. Duket sikur urdhrat e prokurimit janë ata që përcaktojnë nevojat për materiale mjekimi dhe jo analizat e sasive që ka në realitet spitali dhe e sasive që nevojiten aq më tepër për

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

materiale që i referohen reparteve si Hemo-Dializa që dihet saktësisht ose me përafërsi numri i seancave në muaj dhe i pacientëve referuar muajve ose viteve të kaluara.

-Konkretisht, mos kryerja e analizave me profesionalizëm e seriozitet përpara kryerjes së procedurave të prokurimit, bën të mundur kryerjen ose ekzekutimin e kontratave për materiale mjekësore duke rënduar buxhetin e shtetit dhe duke prokuruar më tepër se nevojat. Më poshtë, bëhet analiza për nevojat reale të repartit të Hemo-Dializës. Në vitin 2015, konkretisht në datën 20.03.2015, është lidhur kontrata me nr.687, Prot. Kjo kontratë, ka pasur si objekt “*Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo-Dializës*” dhe vlera e kontratës ka qenë 37,470,250 lekë pa tvsh me afat ekzekutimi deri 31.12.2015. Fatura e parë që vërteton se ka filluar ekzekutimi i kësaj kontrate, është fatura me nr.89, datë 24.03.2015. Fletë-Hyrja e materialeve mjekësore, është me nr.86 dhe datë 24.03.2015. Tek kjo kontratë, janë prokuruar materiale mjekësore për Hemo-Dializën për nevojat e vitit 2015 që llogjikisht, pas datës së faturës së parë pra pas datës 24.03.2015, duhej që kjo kontratë (përlllogaritja është bërë për një vit), të mbulonte nevojat për 12 muaj duke filluar që nga muaji Prill 2014. Pra, sipas kalkulimeve, kjo kontratë, do të bënte të mundur që reparti i Hemo-Dializës të mbulohej me materiale mjekësore detyrimisht deri në muajin Mars 2016 ose më saktë për 12 muaj. Nëse analizojmë sasinë e prokuruar nga SRSH për muajin Qershor 2016, do të konkludojmë si më poshtë: Cituar dhe më lart, për muajin Qershor 2016 që Hemo-Dializa i ka shërbyer 59 pacientëve dhe janë bërë 627 seanca, janë nevojitur 525 copë Solucion Acidi pra vetëm për një muaj. Tek kontrata e vitit 2015, janë prokuruar 8100 copë Solucion Acidi. Nëse bëjmë kalkulimet do të kemi:  $8100 \text{ copë(vit)} / 525 \text{ copë(muaj)} = 15.4$  muaj ose 15 muaj e 4 ditë. Nëse llogarisim 15 muaj e 4 ditë nga muaji që SRSH ka marrë furnizimin e parë të kontratës së vitit 2015 pra nga muaji Prill-2015 deri në muajin Qershor-2016, konkludojmë se janë plot 15 muaj. Pra materiali Solucion Acidi, ka qenë gjendje nga kontrata e mëparshme dhe nuk kishte përse të prokurohej në muajin Qershor 2016.

-Nëse analizojmë një material tjetër mjekësor të prokuruar në vitin 2015 p.sh Set Bicard, do të shofim se për vitin 2015 është prokuruar 8500 copë. Si rrjedhojë:  $8500 \text{ copë(vit)} / 596 \text{ copë(muaj)} = 14.2$  muaj. Po njësoj edhe për materialet e tjera.

-Sa më sipër, SRSH, ka pasur gjendje në farmaci, sasi të konsiderueshme të Solucion Acidit duke mbuluar nevojat e muajit Qershor 2016 dhe nuk kishte asnjë arsye përse të kërkonte këtë material. Vlera e këtij materiali e prokuruar mbi nevojat e SRSH është 194,880 lekë dhe konsiderohet si dëm ekonomik pasi nga verifikimi rezultoi se është investim i pa justifikuar. Për blerjen e materialeve mjekësore me pasoja negative për SRSH në vlerën e mësipërme, mban përgjegjësi Titullari i SRSH-së z.P.Ç. dhe konceptuesi i kontratës njëkohësisht kryetar i njësisë së prokurimit D.H.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr.40/5, Prot-datë 21.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së nga z.P.Ç.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Lidhur me pretendimin se një gjendje emergjence të jep automatikisht të drejtën ligjore që të nisësh një procedurë prokurimi, është e vërtetë por paraprakisht duhet argumentuar nevoja e nisjes së procedurës me analiza tekniko-ekonomike që kanë të bëjnë me gjendjen në magazinë. Konstatimi i kryerjes me nxitim të një procedure prokurimi pa verifikuar më parë nevojat, është i argumentuar pasi në fund, konstatohen diferenca në sasi të prokuruar.

-Sa më lart trajtuar, observacioni juaj për këtë pikë, nuk qëndron.

**5.16 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Kite dhe Reagente për ekzaminime specifike” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është:*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt **“Blerje Kite dhe Reagente për ekzaminime specifike”**.

*Nga verifikimi rezultoi që:*

<b>j. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kite dhe reagente për ekzaminime specifike”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.82 datë 20.10.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> E.M. P.N. B.B.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> V.B. K.M. M.S.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për Propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,243,000 lekë.	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> S. sh.p.k me ofertë: 2,239,160 lekë.	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 3840 lekë.
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 03.11.2016.	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit, FDSKSH.	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës në tender.</b> B.P. sh.p.k. dhe S. sh.p.k
<b>b.Zbatimi i Kontratës</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> Dt.15.11.2016	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,686,992 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli dhe sipas procesverbalit Nr.2734, Prot të datës 11.11.2016 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet 2 operator ekonomik “B.P.” sh.p.k. dhe “S.” sh.p.k., nga të cilët, vetëm operatori ekonomik “S.” sh.p.k., ka paraqitur ofertën me vlerë 2,239,160 lekë pa tvsh. Autoritetit Kontraktor, i propozohet, të shpalli fitues operatorin ekonomik të vetëm të kualifikuar “S.” sh.p.k.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan si më poshtë vijon:

-Me shkresën me nr.2497, Prot-datë 10.10.2016, shefi i shërbimit laboratorik, B.B., formulon një kërkesë drejtuar drejtorisë së spitalit rajonal Shkodër, ku citon: *“Duke parë gjendjen e vështirë përsa i përket furnizimit me kite-reagente si në laboratorin e spitalit edhe atë të poliklinikës, ju lutemi të na krijoni mundësinë të na furnizoni me materialet e poshtë shënuara. Nëpërmjet kësaj, ne do të mund të realizojmë ekzaminime mjaft të domosdoshme dhe specifike si matja e gazeve në gjak, dozimi i hormoneve, markuesit tumoral, dozimi i disa medikamenteve apo dhe realizimi brenda të gjithë parametrave bashkëkohorë i analizës së gjakut komplet për laboratorin e poliklinikës. Në këtë mënyrë do na krijoni mundësinë që të rrisim si nga ana sasiore ashtu edhe ajo cilësore gamën dhe cilësinë e analizave në raport me kohën dhe kërkesat në rritje që ka spitali”.*

-Sa më sipër, nga verifikimi i *“Pasqyrave të aktivitetit mjekësor për shërbimet e ofruara për pacientët e shtruar në spital”* për vitin 2014, konstatohet se tek evidenca e ekzaminimeve klinike lidhur me analizat e laboratorit klinik-biokimik, janë kryer në total 32117 ekzaminime. Nëse kontrollojmë pasqyrat e vitit 2015, konstatojmë se numri i ekzaminimeve për të njëjtin laborator, është ulur. Ky numër ka shkuar në 29883 ekzaminime. Nëse vazhdojmë më tej pra me pasqyrat e vitit 2016, do të konstatojmë se numri i ekzaminimeve është ulur në mënyrë drastike deri në 1934 ekzaminime. Pra, deri këtu, duket qartazi se kërkesa e Sh. të shërbimit laboratorik është e pa bazuar në argumenta dhe fakte. Ajo është e pa vërtetë përsa i përket shprehjeve për rritje në numër të ekzaminimeve të analizës së gjakut komplet që ka Spitali. Për më tepër, kjo kërkesë, duke qenë e pabazuar në fakte dhe argumenta, nuk duhej të merrej në konsideratë thjesht sepse është e firmosur nga shefi i shërbimit laboratorik aq më tepër që sasi të listuara, nuk janë të faktuara pra nuk janë marrë nga ndonjë data-base e laboratorit duke e krahasuar me nevojat e viteve të kaluara ose me ekzaminimet e viteve të kaluara. Gjithashtu, tek specifikimet teknike, cilësohet se operatori ekonomik i shpallur fitues, duhet të sjelli dhe paisje mjekësore si analizator hematologjik apo analizator hormonal-imunologjik ose dhe ai i gazeve, pa marrë në konsideratë urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë atë me nr.3272, datë 11.09.2007, tek i cili specifikohet qartazi se makineritë mjekësore që përdoren në Spital, duhet të plotësojnë standardet për tu përdorur dhe nuk mund të kërkohen nga një operator që shpallet fitues pa u certifikuar më parë nga Agjencia Shqiptare e Paisjeve Mjekësore por mbi të gjitha pa u inventarizuar. Pra, kërkesa për vënie në dispozicion të pajisjeve mjekësore pa marrë më parë mendimin e ASHPM, është e gabuar dhe e pa bazuar. Veprimet e mësipërme, ngarkojnë me përgjegjësi shefin e shërbimit të laboratorit, z.B.B.

-Me shkresën nr.2501, Prot-datë 11.10.2016, drejtori i SRSH-së, P.Ç., nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit të përbërë nga B.B. Kryetar, J.ZH. dhe K.K. Antare.

-Me shkresën nr.2519, Prot-datë 13.10.2016, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga B.B., K.K. dhe J.Zh., përlllogarisin fondin limit në vlerën e 2,242,700 lekë pa tvsh.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sa më sipër, nga verifikimet e dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit, në dosjen e procedurës së prokurimit, u konstatuan tre oferta të pa protokolluara dhe madje pa data, përkatësisht nga operatori ekonomik “L.” sh.p.k., nga operatori ekonomik “S.” sh.p.k dhe nga operatori ekonomik “E.” sh.p.k. Nga verifikimi, rezulton se: Operatori ekonomik “L.” sh.p.k. dhe operatori ekonomik “S.” sh.p.k., kanë të njëjtin ortak të vetëm me aksione 100% i cili është V.Ll. Verifikimi është shumë i thjeshtë. Nga konstatimet, rezulton se V.Ll., ka në administrim dy nipte, konkretisht Niptin K92317014S dhe Niptin K81323024. Si rrjedhojë, fakti që ofertat nuk mund të vërtetohen nëse janë dorëzuar pranë SRSH-së, përpara nxjerrjes së fondit limit pra përpara datës 13.10.2016, por mbi të gjitha, edhe sikur të merrej e mirëqenë një ofertë pa datë edhe pa numër protokolli, nuk duhej kursesi të nxirrej një fond limit nga dy ofertues por nga tre. Pra, dhënia e ofertës nga i njëjti person edhe pse ai ka në administrim dy kompani të ndryshme, e kompromentojnë procesin e nxjerrjes së fondit limit.

-Me shkresën nr.2549, Prot-datë 20.10.2016, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit për procedurën e mësipërme me fond limit 2,243,000 lekë pa tvsh dhe jo aq sa e ka nxjerrë komisioni i nxjerrjes së fondit limit. Nga kalkulimet, fondi limit është rritur me 300 lekë.

-Sa më sipër, mban përgjegjësi drejtori i SRSH-së P.Ç. pasi ka vepruar në kundërshtim me nenin 60 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar duke mos marrë parasysh aspak vlerën e fondit limit të nxjerrë nga komisioni i nxjerrjes së fondit limit por ka nxjerr një urdhër prokurimi me fond limit të rritur fiktivisht me 300 lekë.

-Për miratimin e vlerës së fondit limit, jo konform parimeve dhe rregullave të prokurimit publik, pa vërtetuar më parë dokumentacionin e dorëzuar nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 57 dhe 61 të Vkm nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga E.M., P.N. dhe B.B.

-Me shkresën nr.106, Prot-datë 20.10.2016, nga drejtori i SRSH-së, autorizohet E.M., të krijojë dosjen elektronike të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kite dhe reagente për ekzaminime specifike” për Spitalin Rajonal Shkodër.

-Me shkresën nr.2602, Prot-datë 27.10.2016, drejtori i SRSH, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga V.B., E.J. dhe K.M.

-Në dosjen e prokurimit, u evidentua një shkresë nga APP dhe konkretisht nga drejtori i përgjithshëm me nr.12359, Prot-datë 31.10.2016, ku citohet se për shkak të disa problemeve, procedurat e prokurimit me datë zhvillimi 31.10.2016, shtyhen për në datën 01.11.2016.

-Me shkresën nr.2634, Prot-datë 31.10.2016, drejtori i SRSH, zëvendëson antarin e komisionit të vlerësimit të ofertave, E.J. me M.S.

-Me shkresën nr.113, Prot-datë 01.11.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga V.B., K.M. dhe M.S., mbajnë procesverbalin e hapjes së ofertave dhe evidentojnë 2 oferta të ardhura e përkatësisht nga operatori ekonomik “B.P.” sh.p.k. me ofertën pa vlerë dhe nga operatori ekonomik “S.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 2,239,160 lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.116, Prot-datë 03.11.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e vlerësimit të ofertave dhe kualifikon vetëm operatorin ekonomik “S.” sh.p.k. e në vazhdim me shkresën nr.2734, Prot-datë 11.11.2016, propozon fitues të procedurës operatorin ekonomik “S.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.2734/1, Prot-datë 11.11.2016, titullari i SRSH, shpall fitues të procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm, operatorin ekonomik “S.” sh.p.k.

-Kontrata e lidhur me nr.2763, Prot-datë 15.11.2016 midis SRSH e përfaqësuar nga drejtori z.P.Ç. dhe “S.” sh.p.k, me administrator z.A.Sh. dhe ortak të vetëm z.V.Ll., është me vlerë 2,239,160 lekë pa tvsh, ka afat ekzekutimi deri më 25.12.2016.

**Zbatimi i kontratës.**

-Urdhër-shpenzimi nr.447, datë 06.12.2016 me vlerë 2,609,352 lekë me tvsh për blerje kite reagente specifike, është i shoqëruar me faturën nr.127, datë 15.11.2016, fletë-hyrjen nr.237, datë 16.11.2016 dhe me faturën nr.128, datë 24.11.2016, fletë-hyrjen nr.248, datë 24.11.2016.

-Urdhër-shpenzimi nr.499, datë 27.12.2016 me vlerë 66840 lekë me tvsh për blerje kite reagente specifike, është i shoqëruar me faturën nr.137, datë 15.12.2016, fletë-hyrjen nr.237, datë 15.12.2016.

-Urdhër-shpenzimi nr.511, datë 29.12.2016 me vlerë 10800 lekë me tvsh për blerje kite reagente specifike, është i shoqëruar me faturën nr.06 dhe fletë-hyrjen nr.271, datë 23.12.2016.

-Vlera e likuiduar në total është 2,686,992 lekë me tvsh.

-Gjithsesi, nga auditimi i procesverbaleve të mbajtura nga D.Ll., R.S. dhe I.T., nuk citohet në asnjë rresht data e prodhimit të materialeve mjekësore si kusht i kërkuar tek neni 13 i kontratës së lidhur ku citohet se : *“Çdo artikull duhet të ketë skadencë ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës në ditën e lëvrimin të mallit”*. Si rrjedhojë, është e pamundur të verifikohet nëse ky kusht është plotësuar pasi nuk ka asnjë të dhënë për datën e prodhimit. Veprimet e mësipërme, ngarkojnë me përgjegjësi grupin e marrjes në dorëzim.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1577, Prot-datë 04.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/3, Prot-datë 07.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së nga zj.R.S., në të cilin citohet se:

1. *“Në lidhje me reagentin Cfas.HbA1c, 3x2 ml i marrë në dorëzim nga komisioni që unë kryesoja, korrespondon me reagentin Cfas Hb1c, 3x2 ml, i cilësuar në specifikimet teknike të kontratës së lidhur dt.15.11.2016.”*

2. *“Në lidhje me reagentin S2 Fluid Pack, i cili i referohet një reagenti me datë skadimi 09/2017, më vjen keq nëse jeni keqkuptuar, por ky reagent ka një datë skadimi rreth 10 muaj pas datës së marrjes në dorëzim.”*

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Lidhur me pretendimin e parë, citoni se emërtimi “Cfas.HbA1c” është njësoj me emërtimin “Cfas.Hb1c”. Pra mungesa e gërmës A tek emërtimi i dytë, nuk paska rëndësi? Atëherë, përse është kërkuar në procedurën e prokurimit një gjë e tillë? Konkluzioni ynë është se zërat e materialeve mjekësore të marra në dorëzim, duhet të jenë identike me zërat e materialeve mjekësore të preventivit. Ndryshe, nëse është prokuruar për zëra materiale që nuk kanë lidhje me nevojat tuaja, atëherë logjikisht, i bie që procedura e prokurimit është kryer me zëra të tjerë dhe përgjegjësia i përket komisionit të nxjerrjes së specifikimeve teknike dhe fondit limit. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë, nuk qëndron.

-Lidhur me pretendimin e dytë, ku citoni se nëse materiali mjekësor skadon pas 10 muajsh nga data e marrjes në dorëzim, do të thotë se është konform specifikimeve të kërkuara në kontratë, ju sqarojmë se fakti që materiali mjekësor skadon pas 10 muajsh nga data e marrjes në dorëzim, nuk do të thotë domosdoshmërisht se data e prodhimit është 10 muaj para datës së marrjes në dorëzim. Pra, e thënë ndryshe, data e prodhimit, është një kusht i kërkuar në kontratë dhe duhej të specifikohet tek aktet e marrjes në dorëzim por mbi të gjitha tek etiketat e materialeve mjekësore. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë, nuk merret në konsideratë.

**5.17 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore”, ku rezultoi që:*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim i Aparaturave Mjekësore”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.572</b> datë 09.03.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr.572, dt.09.03.2015 Xh.H. E.H. R.K.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr.700, dt.24.03.2015 A.M. B.K. A.M.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>4,135,500 lekë.</b>	<b>6. Lot-1. “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës”. Fond limit 1,500,000 pa tvsh.</b>	<b>7. Lot-2. “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestizi-ventilator”. Fond limit 2,635,500 pa tvsh.</b>
	<b>8.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>Lot-1 : 1,499,000 lekë.</b>	<b>9.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <b>Lot-2 : 2,612,400 lekë.</b>
	<b>10.Diferenca me fondin limit (pa tvsh). Lot-1: 1,000 lekë</b>	<b>11.Diferenca me fondin limit (pa tvsh). Lot-2: 23,100 lekë</b>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>12. Data e hapjes së ofertave</b> 30.03.2015.	<b>13. Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, FSDKSH.</b>	<b>14. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 Operator. b) Lot-1, fitues “B.A.” sh.p.k. c) Lot-2, fitues “M.” sh.p.k.
<b>b. Zbatimi i Kontratës Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës për Lot-1.</b> Datë 24.04.2015 me nr. prot. 915.	<b>16. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,798,800 lekë.</b>	
<b>17. Lidhja e kontratës për Lot-2.</b> Datë 04.05.2015 me nr. prot. 973.	<b>18. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,134,880 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.50.Prot të datës 30.03.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 2 operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat për konkurrim. Lot-1, me objekt “Mirëmbajtja e paisjeve të dializës”, është fituar nga operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k. Lot-2, me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestizi-ventilator”, është fituar nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan 3 shkresa me të njëjtin numër protokoli, (nr.459), me të njëjtën datë (23.02.2015), drejtuar drejtorit të SRSH z.T.M. por me përmbajtje të ndryshme nga nëpunës të ndryshëm dhe konkretisht:

-Tek kërkesa e Dr.Dh.G., shefe e shërbimit të hemodializës, drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: *“Në shërbimin e hemodializës kemi **9 aparatura të tipit Innova-Hospal** që përdoren çdo ditë me turne. Në kushtet e mbipërdorimit dhe mbarimit të kohës korrekte të punës (orëve të punës), bëjnë difekte të shpeshta, pothuajse çdo ditë. Kërkohet servisi i zakonshëm i tyre si dhe riparimi i tyre. Prandaj kërkohet nga spitali të bëhet kontratë mirëmbajtjeje dhe servis të aparaturave. Gjithashtu kërkohet të pajisemi me aparatura të reja për të përballuar numrin e pacientëve në rritje”.*

-Tek kërkesa e Sh. të shërbimit të kirurgjisë, z.Sh.Y., drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: *“Reparti i kirurgjisë ka nevojë urgjente për paisjen me Hand Seitch Handle Cable (copë 30) për aparatet Elektrobistri Alsa pasi janë të amortizuara për shkak të volumit të punës dhe kohës së gjatë që nuk janë ndërruar. Gjithashtu sallat e operacionit kanë nevojë për **riparim të aparateve të anestezisë copë 3, Model fabius, prodhues Drager, viti i investimit 2001. Ju kujtojmë që mirëmbajtja e fundit e tyre është bërë në vitin 2009 dhe nga kjo kohë nuk është bërë asnjë mirëmbajtje tjetër dhe për këtë arsye aparatet***

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**e narkozës nuk japin rregjimet e rregjistruara, nuk japin volume të sakta.** Ky përbën një problem serioz pasi gjendja e të sëmurve është shumë kritike dhe difektet e aparaturave mund të na shkaktojnë ngjarje të pa dëshiruara. Ju lutem merrni sa më shpejt në konsideratë kërkesën tonë”.

-Tek kërkesa e Sh. të shërbimit të reanimacionit, z.B.K., drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: “Reparti i reanimacionit ka nevojë urgjente për riparimin e respiratorëve copë 3, Model Savina, prodhues Drager, viti i investimit 2001. **Ju kujtojmë që mirëmbajtja e fundit e tyre është bërë në vitin 2009 dhe nga kjo kohë nuk është bërë asnjë mirëmbajtje tjetër dhe për këtë arsye respiratorët nuk japin rregjimet e rregjistruara, nuk japin volume të sakta.** Ky përbën një problem serioz pasi gjendja e të sëmurve është shumë kritike dhe difektet e aparaturave mund të na shkaktojnë ngjarje të pa dëshiruara. Ju lutem merrni sa më shpejt në konsideratë kërkesën tonë”.

-Me shkresat nr.29, Prot-datë 07.01.2015 dhe nr.32, Prot-datë 08.01.2015, A.B., A.M. dhe Dh.G., dërgojnë specifikimet teknike tek drejtori i SRSH-së lidhur me paisjet dhe aparaturat mjekësore që duan shërbim por dhe për pjesët që duhen ndërruar dhe që i përkasin repartit të hemodializës.

-Me shkresën nr.71, Prot-datë 13.01.2015, A.B., dërgon listën e pjesëve dhe makinerive që duhen riparuar apo edhe ndërruar dhe përveç zërave të makinerive mjekësore apo pjesëve të tyre për ndërrim ose riparim, liston dhe çmimet përkatëse. Në fund të preventivit, citohet se çmimet janë marrë nga tregu por dhe nga kontrata e mëparshme. Konstatohet se ofertat e tregut të dorëzuara pranë grupit të auditimit përkatësisht nga “S.” sh.p.k., “S.M.” sh.p.k. dhe “B.A.” sh.p.k., janë të pa protokolluara pranë SRSH-së dhe si të tilla nuk mund të merren në konsideratë si të vërteta përsa i përket datave të tyre.

-Me shkresën nr.484, Prot-datë 26.02.2015, ngrihet komisioni i përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga A.B., E.K. dhe L.B.

-Me shkresën nr.530, Prot-datë 04.03.2015, komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga A.B., L.B. dhe E. K., kanë dërguar specifikimet teknike dhe fondin limit për procedurën e prokurimit.

-Tek kjo shkresë, është përcaktuar fondi limit për mirëmbajtjen e paisjeve të dializës Gambro/Hospital në vlerën e 1,500,000 lekë pa tvsh dhe fondi limit për riparim dhe shërbim të aparaturave Anestezi-Ventilator në vlerën e 2,635,495 lekë pa tvsh. Tek arsyetimi i nxjerrjes së vlerës së kontratës, në faqen e dytë të shkresës, paragrafi i dytë, citohet “*Vlera e kontratës ka ndryshuar duke e krahasuar me vitet e kaluara sepse ka ndryshuar lloji i kontratës nga kontratë në të cilën kemi parashikuar difektet (viti 2014) që mund të ndodhnin dhe problemet e aparaturave, në Kontratë Full Risk*”.

-Me shkresën nr.572, Prot-datë 09.03.2015, Titullari i SRSH-së, z.T.M., nxjerr urdhrin e prokurimit nr.07, datë 09.03.2015 me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” të ndarë në 2 lote. Loti i I me objekt “Mirëmbajtje të paisjeve të Dializës” me vlerë 1,500,000 lekë pa tvsh dhe loti i II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” me vlerë 2,635,500 lekë pa tvsh.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Procesverbali për miratimin e dokumentave të tenderit, është mbajtur me shkresën nr.39, Prot datë 13.03.2015 dhe është i firmosur nga njësia e prokurimit e cila në të njëjtën datë, me shkresën nr.40, Prot, autorizon zj.Xh.H., të ngarkojë në sistemin e APP-së, dosjen e prokurimit.

-Me shkresën nr.700, Prot-datë 24.03.2015, drejtori i SRSH, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.M., B.K. dhe A.M.i.

-Në datën 30.03.2015, me shkresën nr.50, komisioni i vlerësimit të ofertave kryen verifikimin e ofertave të ardhura. Në datën 09.04.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave me anë të procesverbalit të mbajtur nr.791, vërteton se është paraqitur një ofertë për secilin lot dhe konkretisht: Për Lotin I me objekt “Mirëmbajtje e paisjeve të Dializës” nga “B.A.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 1,499,000 lekë pa tvsh dhe për Lotin II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” nga “M.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 2,612,400 lekë pa tvsh. Të dyja ofertat janë kualifikuar.

-Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 915, Prot-datë 24.04.2015 midis SRSH dhe operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k për Lotin I me objekt “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës” në vlerën 1,499,000 lekë pa tvsh dhe me afat ekzekutimi deri më 31.12.2015 sipas nenit 8 të kontratës.

-Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 973, Prot-datë 04.05.2015 midis SRSH dhe operatorit ekonomik “M.” sh.p.k për lotin II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” në vlerën 2,612,400 lekë pa tvsh dhe me afat ekzekutimi deri më 31.12.2015 sipas nenit 8 të kontratës.

-Konstatohet se: Operatori ekonomik “M.” sh.p.k., ka dorëzuar një akt-rakordim të miratuar nga Drejtori i SRSH, z.T.M. Tek ky akt-rakordim, i cili mban datën 08.01.2015 dhe i referohet një kontrate të vitit paraardhës ku pranohet mos-ekzekutimi i kontratës së nënshkruar. KVO, ka shpallur fitues këtë operator edhe pse ky operator nuk ka përbushur detyrimet e tij në një kontratë paraardhëse të lidhur me SRSH. Në të njëjtën kohë, Drejtori i SRSH, z.T.M., ka miratuar formularin e fituesit kur vet z.Marku, ka firmosur akt-rakordimin e ndërprerjes së kontratës së mëparshme.

Drejtori i SRSH-së, z.T.M., ka qenë në dijeni të dështimit të kontratës së mëparshme me operatorin ekonomik “Medafu” sh.p.k., duke e shfajësuar atë, pasi ka firmosur një akt-rakordim dhe konkretisht sipas shkresës me nr.38, Prot-datë 08.01.2015, akt-rakordim, ku citohet se; *“operatori ekonomik M. sh.p.k., nuk ka asnjë pretendim në lidhje me diferencën e pa likuiduar në vlerën e 3,164,998 lekë, vlerë e cila i përket zërave të punimeve/shërbimeve të pa ekzekutuara”*. Tek ky akt-rakordim, nuk jepet asnjë arsye ose argumentim lidhur me mos ekzekutimin e zërave të kontratës ose për mos respektimin e kushteve të kontratës së lidhur me nr.2487, Prot-datë 10.12.2014. Përsa më sipër, mban përgjegjësi Drejtori i SRSH-së, z.T.M.

-Konkretisht, kontrata me nr.2487, Prot-datë 10.12.2014, është likuiduar vetëm në vlerën e 1,834,000 lekë dhe jo në vlerën totale të saj që ishte 4,998,998 lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Në vazhdim, trajtohet Loti II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparturave anestezi-ventilator” sipas kontratës midis SRSH dhe “M.” sh.p.k., në vlerën e 2,612,400 lekë pa tvsh, e lidhur më 04.05.2015 me afat deri më 31.12.2015.

**Zbatimi i kontratës LOT II.**

-Lot-2 “Riparim të Aparaturave anestezi-ventilator”.

-Urdhër-shpenzimi nr.313, datë 03.09.2015 me vlerë 1,591,080 lekë me tvsh për “*Riparim të aparaturave anestezi-ventilator*”, është i shoqëruar me faturën nr.06, datë 06.08.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.404, datë 13.11.2015 me vlerë 84.720 lekë me tvsh për “*Riparim të aparaturave anestezi-ventilator*”, është i shoqëruar me faturën nr.67, datë 04.11.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Vlera totale e likuiduar është 1,675,800 lekë me tvsh dhe jo aq sa është vlera e kontratës pra 3,134,880 lekë.

-Sa më sipër, konstatohet se procesverbalet e mbajtura, janë të pa protokolluara pranë SRSH-së duke mos vërtetuar kohën e mbajtjes së tyre. Nuk jepet asnjë specifikim për paisjet e sjella në lidhje me numrat serial të tyre apo kodet e identifikimit ku të dukej qartazi se këto pjesë ndërrimi janë sipas kërkesave të kompanisë prodhuese ose konform specifikimeve teknike të pjesëve origjinale dhe me afat skadimi 1 vit nga momenti i furnizimit sipas nenit 12 të kontratës me nr.973, Prot-datë 04.05.2015 të lidhur midis palëve. Thjesht shprehjet të tipit “*U ndërrua motor encoder*”, “*U ndërrua sensori i prurjes*”, “*Zëvendësimi i qarkut të pacientit*” ose edhe shprehje si “*Paisja u la në gjendje funksionale të rregullt*” pa specifikuar parametrat e paisjes lidhur me specifikimet e tyre teknike apo pa krahasuar parametrat e paisjes mjekësore përpara se të bëhej zëvendësimi i pjesës së dëmtuar me parametrat e paisjes mjekësore pasi është bërë zëvendësimi i pjesës së dëmtuar me pjesën e re, duke e përdorur paisjen. Procesverbale të tilla, pa sqarimet përkatëse dhe pa përmendur hapat e kryerjes së një testimi nëse paisja është vërtet në rregull, nuk vërtetojnë aspak se është kryer ekzekutimi i zërave të përmendur sipas situacioneve përkatëse. Nuk u konstatua asnjë dokument zyrtar ku të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u konstatua nga asnjë akt apo procesverbal i mbajtur se pjesët e sjella dhe të vendosura si të reja, janë ose kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet dhe direktivat përkatëse të KE për pajisjet mjekësore, nëse janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese.

-Me shkresën nr.27, Prot-datë 11.01.2016, drejtori i SRSH-së, zj.Dh.U., mban një akt-rakordim me operatorin ekonomik “M.”sh.p.k. tek i cili citohet në mënyrë eksplicite sa më poshtë vijon: “*Me cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë M. sh.p.k., me Nipt-J93610823R, adresë Rruga Mihal Duri 17/5, në bazë të kontratës midis Spitalit Rajonal Shkodër dhe kompanisë M. sh.p.k., për kontratën me numër 973 datë 04.05.2015 me objekt Riparimi i Aparaturave Anestezi-Reanimacion me vlerë totale 3,134,880 lekë me tvsh, konfirmojmë që kompania jonë ka kryer riparimet dhe shërbimet sipas kontratës me vlerën prej 1,675,800 lekë me tvsh. Vlera prej 1,459,080 lekë me tvsh ka mbetur e pa realizuar dhe do të mbetet e pa realizuar sepse paisjet Respirator Savina e kompanisë prodhuese Draeger janë i një viti prodhimi jashtë suportit nga kompania*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Draeger. Si e tillë nuk mund të kemi suport në pjesë këmbimi dhe në një riparim sa më cilësor. Kompania M. sh.p.k., nuk ka pretendim për shumën e sipërpërmendur”. Në vazhdim, me shkresën nr.205, Prot-datë 11.02.2016, drejtori i SRSH-së, i dërgon një kërkesë shoqërisë së sigurimeve SIGAL, ku i kërkon të konfiskojë vlerën e 313,488 lekë si vlerë që i përket sigurimit të kontratës si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktuesit “M.” sh.p.k., në plotësimin e detyrave të tij sipas kontratës për vlerën e pa realizuar e cila është 1,459,080 lekë me tvsh.*

-Sa më sipër, në rradhë të parë është mëse llogjike që kompania M. sh.p.k., nuk mund të kishte pretendime për likuidimin e një shume që i përket zërave të pa ekzekutuar sipas kontratës pra nuk kishte përse të shprehej në këtë akt të mbajtur. Pra, ky akt-rakordimi, nuk ka asnjë vlerë sepse nuk mund të deklarohet diçka që është mëse normale dhe e kuptueshme. Në rradhë të dytë, arsyeja e përmendur në këtë akt-rakordim se paisjet “*Respirator Savina e kompanisë prodhuese janë i një vit prodhimi jashtë suportit nga kompania Draeger*”, është një pretendim i cili nuk ka asnjë lidhje me objektin e kontratës së lidhur midis palëve aq më tepër që tek neni 24 i kontratës, citohet qartazi se: “*Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit*”. Si rrjedhojë, për mos nxjerrjen e konkluzioneve lidhur me pasojat që mund të ketë sjellë për SRSH mos ekzekutimi i kushteve të kontratës së lidhur, duke e miratuar atë, mban përgjegjësi Drejtori i SRSH-së zj.Dh.U.

-Gjithsesi, lidhur me fillimin deri në ekzekutimin e Lotit të II të kontratës së mësipërme me nr.973, Prot-datë 04.05.2015, me afat deri më 31.12.2015, me objekt “*Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator*” të lidhur midis operatorit ekonomik “M.” sh.p.k dhe SRSH, konstatohet si vijon:

-Referuar shkresës me nr.71, Prot-datë 13.01.2015, fondi limit i nxjerr, i referohet zërave të paracaktuar për riparimin e makinerive të aparaturave anestezi-ventilator. Në fakt, sipas preventivit të kontratës së lidhur, edhe pse Loti i II, citon se objekti është “*Riparim dhe shërbim.*”, lista e preventivit, nuk ka asnjë riparim por ka sasinë dhe çmimet e pjesëve të këmbimit. Pra, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, në vetvete i referohet një shërbimi ose riparimi dhe në fakt, liston zërat e pajisjeve apo pjesëve që duhen ndërruar. Pra kontrata është lidhur me objekt shërbim dhe riparim por ekzekutimi i saj do të bëhet për furnizim-vendosje pasi çmimet, u përkasin zërave të paisjeve dhe jo shërbimit të tyre. Si rrjedhojë, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, nuk mund të nxirrte çmime për zëra shërbimesh pasi nuk mund të parashikonte vlerën e shërbimit por ka nxjerr vlera që i përkasin pjesëve të furnizuara. Kjo duket edhe nga fakti se tek procesverbalet e mbajtura, komisioni i marrjes në dorëzim, i referohet ndërrimit ose zëvendësimit të pjesëve dhe jo riparimit të tyre.

-Sa më sipër, konstatohet se është lidhur një kontratë, me objekt shërbim/riparim paisjesh, kur në fakt, preventivi është për zëvendësim pjesësh. Në këtë mënyrë, gjatë procesit të kryerjes së procedurës së tenderimit, kanë konkuruar ose kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit, llogjikisht ata operatorë që mund të kryenin vetëm mirëmbajtje ose riparim aparaturash kur në fakt, duhet të konkuronin ata që mund të kryenin furnizimin me pjesët e kërkuara por që mund të kishin aftësinë për ti zëvendësuar, kjo vetëm nëse SRSH, nuk do kishte kapacitetet e duhura për kryerjen e zëvendësimit të pjesëve. Urdhri i

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

prokurimit, duhej nxjerrë me objekt *“Furnizim-Vendosje pjesësh këmbimi për aparaturat e anestezi-ventilator”* dhe jo riparim apo shërbim aq më tepër që për një riparim ose shërbim, nuk mund të paracaktosh fondin limit pasi nuk mund të dish se cilat defekte do ndodhin. Gjithsesi, drejtori i SRSH, i cili ka firmosur ose ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik “M.” sh.p.k., përpara se të jetë emëruar në pozicionin e drejtorit të SRSH, ka qenë me detyrë mjek pranë SRSH. Pikërisht, në kohën që nuk ka qenë drejtor i SRSH, ka formuluar vetë kërkesën për nevojat e riparimit të aparateve të anestezi-së. Tek kjo kërkesë (përmendur më lart), drejtuar ish-drejtorit të SRSH, z.T.M., citohet: *“Reparti i kirurgjisë ka nevojë urgjente për pajisjen me Hand Seitch Handle Cable (copë 30) për aparatet Elektrobistri Alsa pasi janë të amortizuara për shkak të volumit të punës dhe kohës së gjatë që nuk janë ndërruar. Gjithashtu sallat e operacionit kanë nevojë për riparim të aparateve të anestezi-së copë 3, Model fabius, prodhues Drager, viti i investimit 2001. Ju kujtojmë që mirëmbajtja e fundit e tyre është bërë në vitin 2009 dhe nga kjo kohë nuk është bërë asnjë mirëmbajtje tjetër dhe për këtë arsye aparatet e narkozës nuk japin rregjimet e rregjistruara, nuk japin volume të sakta. Ky përbën një problem serioz pasi gjendja e të sëmurve është shumë kritike dhe difektet e aparaturave mund të na shkaktojnë ngjarje të pa dëshiruara. Ju lutem merrni sa më shpejt në konsideratë kërkesën tonë”*. Si rrjedhojë, vet z.Sh.Y., ka bërë një kërkesë për mirëmbajtje aparaturash nga pozicioni i mjekut të SRSH dhe në vazhdim, si drejtor i SRSH-së, ka lidhur një kontratë për furnizim-vendosje pjesësh këmbimi pamvarësisht se objekti është konform kërkesës së tij. Gjithashtu, është nisur një procedurë prokurimi, e cila ka të bëjë me menaxhimin e paisjeve mjekësore të një rëndësie të veçantë ashtu siç përmendet tek kërkesa e mësipërme pasi ka të bëjë me ngjarje të pa dëshiruara që mund të ndodhin. Tek kontrata e lidhur, neni 13, faqja 6, citohet: *“Organizimi, realizimi, dokumentacioni i blerjes së pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve për aparaturat/pajisjet mjekësore, do të realizohet në përputhje me urdherin nr.3272, Prot-datë 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë, me objekt Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri”*. Si rrjedhojë, referuar këtij urdhri, tek pika 2.3, faqja 12, Agjencia Shtetërore e Paisjeve Mjekësore, citohet: *“Aktualisht në Shqipëri ekziston Qendra Kombëtare Biomjekësore (QKB), e cila është një punishte kombëtare për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Ajo mbështet të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Kur një spital nuk arrin të riparojë një pajisje mjekësore me specialistët e vet atëherë pajisja dërgohet në këtë qendër për riparim ose një specialist i kësaj qendre dërgohet të riparojë pajisjen në vend”*.

-Sa më sipër, SRSH, përpara se të fillonte një procedurë prokurimi me objekt Riparim dhe Shërbim i Paisjeve Mjekësore, duhet ti dërgonte një kërkesë, Agjencisë Shtetërore të Pajisjeve Mjekësore (ASHPM), pasi të konkludonte se vet SRSH, nuk ishte në gjendje të riparonte vetë defektet, dhe në të njëjtën kohë, ASHPM, duhet të dërgonte pranë SRSH një specialist të fushës ose të udhëzonte për kryerjen e procedurës së prokurimit, gjithmonë konform këtij urdhëri. Gjithashtu, fakti që është paracaktuar vlera e fondit limit të një procedure mirëmbajtjeje, është në kundërshtim me kapitullin 3 të urdhrit nr.3272, datë 11.09.2007, ku citohet se: *“Prokurimi i pjesëve të këmbimit duhet të shihet si diçka e paplanifikuar, pasi nuk mund të*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*parashikohet se çfarë pjese këmbimi mund të prishet në të ardhmen*”. Pra paracaktimi i fondit limit për mirëmbajtje në të njëjtën kohë që nuk dihet defektet që mund të ndodhnin është i dyshimte aq më tepër që SRSH, njësisia e inxhinierisë klinike, nuk ka një historik defektesh ose më saktë nuk ka respektuar as pikën 3.5.13 të udhrit të mësipërm mbi të dhënat që duhen regjistruar ku citohet midis të tjerash se “Çdo spital, duhet të regjistrojë ose në letër ose në kompjuter historinë e plotë të paisjes, përfshirë:...g) Të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes”. Për aparaturat e anestezi-ventilator, SRSH, duhet të ngrinte një komision për kryerjen e një vlerësimi fillestar nëse do të kishte leverdi ekonomike riparimi i tyre ose do të ishte më mirë blerja e paisjeve të reja pasi siç citohet tek kërkesa e përmendur më sipër nga mjeku Sh.Y., mirëmbajtja e fundit e kryer (por e pa faktuar) është bërë në vitin 2009 pra dy vjet më parë. Drejtori i SRSH, mund të respektonte në këtë rast, kapitullin III, të urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, ku jepen shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për ciklin e jetës së një pajisjeje mjekësore aq më tepër që pajisjet e mësipërme që kërkohet të riparohen, kanë qenë pa shërbim për afro 2 vite. SRSH, në asnjë rast nuk disponon një regjistër ku të pasqyroheshin defektet e ndodhura gjatë viteve ose më sakt, nuk disponon një sistem të informacionit të menaxhimit të pajisjeve mjekësore konform urdhrin të mësipërm. Si e tillë, fillimi ose nisja e një procedure prokurimi, për riparimin e pajisjeve që nga të dhënat dhe përshkrimet e mjekëve mund të nxirreshin jashtë përdorimit sipas rregullave dhe kushteve të urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, kapitulli III, pika 3.9, është një veprim që mund të shmangej ose të vlerësohej me profesionalizëm nga ana e SRSH duke zbatuar me rigozitet urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë.

-Në vazhdim, konstatohet se nuk është respektuar as pika 3.8.5 e kapitullit III të urdhrin të mësipërm, mbi rregullat për raportimin në nivel spitali lidhur me ndodhjen e defekteve. Konkretisht, midis të tjerash, citohet se “*Është e detyrueshme për të raportuar gjithashtu çdo incident tjetër të lidhur me pajisjet mjekësore, defektet e vogla dhe mospërputhje me SIPM (Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore), përderisa ato incidente mund të marrin një domethënie më të madhe të bashkuara me ngjarje të tjera të ngjashme duke shprehur prirje ose duke përcaktuar një sistem sigurie të përshtatshëm nga ana e prodhuesit apo furnizuesit*”. Njëkohësisht, tek shtojca 6 e urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, Sistemi i raportimit të ngjarjeve të padëshiruara, shpjegohet qartazi mënyra e raportimit nga çdo i punësuar në institucionet e kujdesit shëndetësor (publik apo privat) ka përgjegjësinë për të raportuar me shkrim tek shefi/përgjegjësi i drejtëpërdrejtë i tij.”. Në vazhdim, tek pika 3.8.9, Si të vepohet me pjesët me defekt ose të kontaminuara, ku citohet qartazi se: : “***Pjesët me defekt duhet të izoloohen kur është e mundur dhe nuk duhet të riparohen (në spital ose me kontraktim) ose t’i kthehen prodhuesit pa marrë paraprakisht miratimin nga SMPM (Sektorit të Menaxhimit të Paisjeve Mjekësore). Gjithashtu ato nuk duhet të hidhen përpara se t’i jepet mundësia SMPM t’i përdorë për hetim të mëtejshëm. .... Nëse pajisja kërkohet për përdorim, hiqet pjesa me defekt dhe pajisja mund të riparohet. Çdo pjesë e hequr në të tilla rrethana duhet të mbahet e veçuar në një ambient të posaçëm dhe të ruhet për t’u përdorur për hetimet e mëvonshme*”.**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sa më sipër, prokurimi i procedurës, është bërë në kundërshtim me urdhrin e mësipërm pasi nuk janë ndjekur hapat e duhur përpara fillimit të procedurës. Gjithashtu, fakti i mos argumentimit me dokumenta zyrtare dhe procedura ligjore ku të vërtetohej kryerja e shërbimit duke dokumentuar dhe pjesët rezervë të dëmtuara, tregojnë se likuidimi i operatorit ekonomik “M.” sh.p.k., është bërë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi. Fakti që, shërbimet e deklaruara si të ekzekutuara, vërtetësia e të cilave, nuk justifikohet me dokumentacion ligjor dhe me procedura të ndjekura sipas urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë, sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik por edhe konform kushteve të kontratës së lidhur midis palëve, përbën shkas për aludime mbi shërbimet reale të kryera dhe ato të pa kryera.

-Tek urdhri i mësipërm, nr.3272, Prot-datë 11.09.2007, Përcaktohen Politikat Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri. Konkretisht, tek kapitulli i II, 2.2, Njësitë e Inxhinierisë Klinike (NJIK), citohet *“Me qëllim që spitalet të kenë në dispozicion këto kapacitete profesionale, në nivel spitali ngrihen dhe funksionojnë Njësitë e Inxhinierisë Klinike”*. Tek pika 2.2.3, objektivat, përcaktohet objektivi kryesor i njësisë së inxhinierisë klinike që është *“Mbështetja e cila përfshin kontributin e drejtpërdrejtë në procesin e blerjes, përdorimit, shërbimit, mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së pajisjeve mjekësore”*. Tek pika 2.2.4, Përgjegjësitë e NJIK, citohet: *“Në shërbimet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore përfshihen”*:

- *“Mirëmbajtja periodike e planifikuar (parandaluese)”*
- *“Kontrollet e sigurisë”*
- *“Kontrollet e cilësisë lidhur me performancën dhe funksionimin e tyre”*
- *“Shërbimet dhe riparimet”*
- *“Kontaktet me kompanitë e jashtme dhe menaxhimi i kontratave të shërbimit”*
- *“Modifikime dhe përshtatje të pajisjeve mjekësore”*

-Tek pika 2.2.5, Detyrat e NJIK, citohet:

**a.** *NJIK përfaqëson njësinë kompetente të pajisjeve mjekësore brenda spitalit dhe konsultohet nga personeli tjetër i spitalit për gjithçka lidhet me përdorimin, blerjen si dhe me shpërndarjen e pajisjeve mjekësore.*

**b.** *NJIK mbështet procesin e prokurimit të pajisjeve mjekësore për çështje lidhur me specifikime teknike; vlerësimin e kostos gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës; vlerësimin e ofertave të pjesëmarrësve në tender për blerjen e pajisjeve mjekësore.*

**c.** *NJIK për pajisjet e reja mjekësore zbaton testet e pranimit, bën verifikimet e sigurisë, të funksionimit të tyre dhe përrputhjen me kërkesat e blerjes.*

**d.** *NJIK zotëron, përditëson dhe forcon njohuritë e nevojshme lidhur me kuadrin rregullator (ligjet, rregulloret, standardet) si dhe ruan dhe zhvillon aftësitë për të dhënë këshilla dhe zhvilluar rekomandime në fushën e inxhinierisë klinike për të funksionuar si një burim këshillimi për çështjet e lidhura me pajisjet mjekësore.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*e. NJIK kujdeset për të gjitha pajisjet mjeksore që janë në përdorim në spital dhe të regjistruara në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore.*

*ë. NJIK merret në mënyrë aktive me trajtimin e aksidenteve dhe incidenteve me pajisjet mjeksore. Përgjegjësi i NJIK raporton tek autoriteti përkatës në përputhje me procedurën e miratuar të raportimit të këtyre ngjarjeve.*

*f. NJIK është përgjegjëse për trainimin në punë të personelit mjekësor mbi përdorimin dhe sigurinë gjatë përdorimit të pajisjeve mjeksore. Kjo kërkon që personeli i NJIK të ketë marrë trainimin e përgjithshëm në fushën e inxhinierisë klinike si dhe kualifikimet dhe trajnimet e duhura për disa pajisje të veçanta për të rritur në mënyrë të vazhdueshme njohuritë dhe aftësitë brenda njësisë.*

*g. NJIK është përgjegjëse për administrimin e Sistemit të Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (sistemit të inventarit të pajisjeve mjeksore si dhe të regjistrimit të ngjarjeve të padëshërueshme me pajisjet mjeksore). Sistemi i inventarit është baza për planifikimin e riinvestimeve, për planifikimin e mirëmbajtjes periodike si dhe për krijimin e dosjeve të historisë së pajisjeve mjeksore.*

Për veprimet e mësipërme, mbajnë përgjegjësi:

Për mos respektim të urdhrin nr.3237, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, për mos respektim të rregullave të prokurimit publik (të përcaktuara edhe tek ky urdhër), mban përgjegjësi A.B. me detyrë Inxhinier Klinike.

-Gjithashtu, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Pajisjeve Mjekësore), konform urdhrin të mësipërm, kapitulli II, pika 2.3.1. Pa pasur më parë një informacion të detajuar sipas kapitullit III të urdhrin të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6, por edhe duke filluar një procedurë prokurimi me fond limit të paracaktuar kur faktikisht nuk mund të parashikohen se sa defekte do të ndodhin, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, ku citohet se: “.Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet se diçka e paplanifikuar”. Sa më sipër, mban përgjegjësi, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, z.Sh.Y.

-Për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera; Në kundërshtim me nenin 28 të kontratës së lidhur me nr.973, Prot-datë 04.05.2015. Në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, pikat 6,7,8,10 dhe 14, por mbi të gjitha, në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, faqe 24, pika 3.8.9, faqe 41, duke mos përshkruar me detaje pjesët e zëvendësuara, duke mos cituar kodet apo numrat serial të pjesëve të vendosura si të reja, duke e bërë të pa mundur evidentimin nëse këto pjesë janë origjinale të kompanisë prodhuese të makinerive mjeksore, duke mos evidentuar dhe saktësuar vendndodhjen e pjesëve të dëmtuara ose të hequra, duke mos cituar në procesverbalin e mbajtur, afatin e skadimit të pjesës së re të vendosur, mban përgjegjësi, sektori i inxhinierisë klinike.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1753, Prot-datë 16.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/4, Prot-datë 18.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së nga zj.A.B., në të cilin citohet se: *“Nuk ka përgjegjësi lidhur me marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera (duke pranuar se përgjegjësia thjesht adresohet diku tjetër por nuk është se nuk ekziston) pasi ka qenë me leje lindjeje”*, sqarojmë si vijon: Ju, e nderuara zj.A.B., në asnjë rresht të Projekt-Raportit të mësipërm, nuk ngarkoheni me përgjegjësi për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera. Është absurd fakti që kundërshtoni diçka që nuk ka lidhje fare me përgjegjësini tuaj. Përgjegjësia e marrjes në dorëzim për shkeljet e konstatuara, i përket *“Sektorit të inxhinierisë klinike”* pa cituar emra. Pra, mesa duket, kërkoni që të penalizohet zëvendësuesja juaj zj.Dh.K. JO zj.B., nga konstatimet, është evidentuar përgjegjësia juaj në fillimin ose më saktë në startimin e procedurës së prokurimit dhe jo në marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera. Gjithsesi, fakti që jeni zëvendësuar, nuk do të thotë se përgjegjësia (në rastin konkret) duhet ti ngelet zëvendësuesit pasi ju keni qenë me leje lindje dhe jo e pa vetëdijshme për komunikim me zëvendësuesin tuaj. Gjithashtu, shkresa që keni dërguar përse i përket zëvendësimit, nuk citon se zëvendësuesi merr përgjegjësitë e pozicionit të inxhinierit klinik. Citohet se ju zëvendëson për riparimin e aparaturave mjekësore.

-Lidhur me observacionin me nr.1753/5, Prot-datë 16.05.2018, të ardhur nga zj.A.B., sqarojmë se trajtohen dhe citohen pretendime të pabazuara me dokumentacion ligjor siç është p.sh. pretendimi lidhur me nxjerrjen e fondit limit duke kundërshtuar dokumentacion e gjetur në dosjen e prokurimit se paska qenë jo në përputhje me procedurën dhe duke pretenduar se e keni nxjerrë vlerën e fondit limit bazuar tek ofertat e tregut, të cilat nuk i keni bashkangjitur me këtë observacion. Pra, kundërshtoni konstatimet tona tek faqja e 4-t e observacionit, paragrafi i 2-të dhe i pranoni ato tek paragrafi i 4-t. Gjithashtu, pretendimet tuaja lidhur me mosfunksionimin e ASHPM-së, janë të pa baza. Edhe sikur të ishte e vërtetë, ju e keni cituar në çdo kontratë se do procedoni sipas urdhrat të Ministrit për pajisjet mjekësore. Po kështu tek faqja zyrtare e QKB-së dhe konkretisht tek <http://ëëë.akbpm.gov.al/>, do të konstatooni se aty ndodhet gjithçka lidhur me bazën ligjore, rregullat dhe urdhrat për politikën që duhet të ndiqnit për pajisjet mjekësore. Gjithsesi, jeni kontradiktore në deklaratat tuaja pasi në të gjitha observacionet e tjera, pretendoni se keni punuar sipas urdhrat të Ministrit për politikën kombëtare të menaxhimit të pajisjeve mjekësore por në të njëjtën kohë, ky urdhër qenka i shfuqizuar. Zj.B., nuk mund të përdorni standarde të ndryshme pretendimesh dhe arsyetimesh kur bëhet fjalë për të njëjtin fenomen.

-Si i tillë, observacioni juaj, nuk merret në konsideratë.

**5.18 Procedura e prokurimit me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore”, ku rezultoi që:*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim i Aparaturave Mjekësore”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.572 datë 09.03.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr.572, dt.09.03.2015 Xh.H. E.H. R.K.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit</b> Ofertave Urdhër nr.700, dt.24.03.2015 A.M. B.K. A.M.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 4,135,500 lekë.	<b>6. Lot-1. “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës”. Fond limit 1,500,000 pa tvsh.</b>	<b>7. Lot-2. “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestizi-ventilator”. Fond limit 2,635,500 pa tvsh.</b>
	<b>8.Oferta fituese (pa tvsh)</b> Lot-1 : 1,499,000 lekë.	<b>9.Oferta fituese (pa tvsh)</b> Lot-2 : 2,612,400 lekë.
	<b>10.Diferenca me fondin limit (pa tvsh). Lot-1: 1,000 lekë</b>	<b>11.Diferenca me fondin limit (pa tvsh). Lot-2: 23,100 lekë</b>
<b>12. Data e hapjes së ofertave</b> 30.03.2015.	<b>13.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit, FSDKSH.</b>	<b>14.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender 2 Operator. b) Lot-1, fitues “B.A.” sh.p.k. c) Lot-2, fitues “M.” sh.p.k.
<b>b.Zbatimi i Kontratës Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>15.Lidhja e kontratës për Lot-1.</b> Datë 24.04.2015 me nr. prot. 915.	<b>16.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,798,800 lekë.</b>	
<b>17.Lidhja e kontratës për Lot-2.</b> Datë 04.05.2015 me nr. prot. 973.	<b>18.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,134,880 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.50.Prot të datës 30.03.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 2 operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat për konkurrim. Lot-1, me objekt

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

“Mirëmbajtja e paisjeve të dializës”, është fituar nga operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k. Lot-2, me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestizi-ventilator”, është fituar nga operatori ekonomik “M.” sh.p.k.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatuan 3 shkresa me të njëjtin numër protokoll, (nr.459), me të njëjtën datë (23.02.2015), drejtuar drejtorit të SRSH z.T.M. por me përmbajtje të ndryshme nga nëpunës të ndryshëm dhe konkretisht:

-Tek kërkesa e Dr.Dh.G., shefe e shërbimit të hemodializës, drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: *“Në shërbimin e hemodializës kemi **9 aparatura të tipit Innova-Hospital** që përdoren çdo ditë me turne. Në kushtet e mbipërdorimit dhe mbarimit të kohës korrekte të punës (orëve të punës), bëjnë difekte të shpeshta, pothuajse çdo ditë. Kërkohej servisi i zakonshëm i tyre si dhe riparimi i tyre. Prandaj kërkohej nga spitali të bëhet kontratë mirëmbajtjeje dhe servis të aparaturave. Gjithashtu kërkohej të pajisemi me aparatura të reja për të përballuar numrin e pacientëve në rritje”.*

-Tek kërkesa e Sh. të shërbimit të kirurgjisë, z.Sh.Y., drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: *“Reparti i kirurgjisë ka nevojë urgjente për paisjen me Hand Seitch Handle Cable (copë 30) për aparatet Elektrobistri Alsa pasi janë të amortizuara për shkak të volumit të punës dhe kohës së gjatë që nuk janë ndërruar. Gjithashtu sallat e operacionit kanë nevojë për **riparim të aparateve të anestezisë copë 3, Model fabius, prodhues Drager, viti i investimit 2001. Ju kujtojmë që mirëmbajtja e fundit e tyre është bërë në vitin 2009 dhe nga kjo kohë nuk është bërë asnjë mirëmbajtje tjetër dhe për këtë arsye aparatet e narkozës nuk japin rregjimet e rregjistruara, nuk japin volume të sakta.** Ky përbën një problem serioz pasi gjendja e të sëmurve është shumë kritike dhe difektet e aparaturave mund të na shkaktojnë ngjarje të pa dëshiruara. Ju lutem merrni sa më shpejt në konsideratë kërkesën tonë”.*

-Tek kërkesa e Sh. të shërbimit të reanimacionit, z.B.K., drejtuar drejtorit të SRSH, citohet: *“Reparti i reanimacionit ka nevojë urgjente për riparimin e respiratorëve copë 3, Model Savina, prodhues Drager, viti i investimit 2001. **Ju kujtojmë që mirëmbajtja e fundit e tyre është bërë në vitin 2009 dhe nga kjo kohë nuk është bërë asnjë mirëmbajtje tjetër dhe për këtë arsye respiratorët nuk japin rregjimet e rregjistruara, nuk japin volume të sakta.** Ky përbën një problem serioz pasi gjendja e të sëmurve është shumë kritike dhe difektet e aparaturave mund të na shkaktojnë ngjarje të pa dëshiruara. Ju lutem merrni sa më shpejt në konsideratë kërkesën tonë”.*

-Me shkresat nr.29, Prot-datë 07.01.2015 dhe nr.32, Prot-datë 08.01.2015, A.B., A.M. dhe Dh.G., dërgojnë specifikimet teknike tek drejtori i SRSH-së lidhur me paisjet dhe aparaturat mjekësore që duan shërbim por dhe për pjesët që duhen ndërruar dhe që i përkasin repartit të hemodializës.

-Me shkresën nr.71, Prot-datë 13.01.2015, A.B., dërgon listën e pjesëve dhe makinerive që duhen riparuar apo edhe ndërruar dhe përveç zërave të makinerive mjekësore apo pjesëve të tyre për ndërrim ose riparim, liston dhe çmimet përkatëse. Në fund të preventivit, citohet se çmimet janë marrë nga tregu por dhe nga kontrata e mëparshme. Konstatohet se ofertat e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

tregut të dorëzuara pranë grupit të auditimit përkatësisht nga “S.” sh.p.k., “S.M.” sh.p.k. dhe “B.A.” sh.p.k., janë të pa protokolluara pranë SRSH-së dhe si të tilla nuk mund të merren në konsideratë si të vërteta përsa i përket datave të tyre.

-Me shkresën nr.484, Prot-datë 26.02.2015, ngrihet komisioni i përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga A.B., E.K. dhe L.B.

-Me shkresën nr.530, Prot-datë 04.03.2015, komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga A.B., L.B. dhe E. K., kanë dërguar specifikimet teknike dhe fondin limit për procedurën e prokurimit.

-Tek kjo shkresë, është përcaktuar fondi limit për mirëmbajtjen e paisjeve të dializës Gambro/Hospital në vlerën e 1,500,000 lekë pa tvsh dhe fondi limit për riparim dhe shërbim të aparaturave Anestezi-Ventilator në vlerën e 2,635,495 lekë pa tvsh. Tek arsyetimi i nxjerrjes së vlerës së kontratës, në faqen e dytë të shkresës, paragrafi i dytë, citohet *“Vlera e kontratës ka ndryshuar duke e krahasuar me vitet e kaluara sepse ka ndryshuar lloji i kontratës nga kontratë në të cilën kemi parashikuar difektet (viti 2014) që mund të ndodhnin dhe problemet e aparaturave, në kontratë Full Risk”*.

-Sa më sipër, konstatohet se: Referuar shkresës me nr.71, Prot-datë 13.01.2015, fondi limit i nxjerr, i referohet zërave të paracaktuar për riparimin e makinerive të hemodializës dhe jo thjesht makinerive. Pra, është e vërtetë se në shkresën me nr.530, Prot-datë 04.03.2015 (*cituar më sipër*) jepet fondi limit për makineri në total copë 9 dhe jo sipas zërave të defekteve, por kjo nuk e justifikon aspak llojin e kontratës si të paracaktuar “FULL-RISK” për vetë faktin se kërkesat për specifikime teknike që i kanë paraprirë nxjerrjes së fondit limit, i referohen zërave të defekteve të mundshëm dhe jo makinerive. Pra, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, e ka përcaktuar vetë që kontrata të jetë “FULL-RISK” dhe nuk e ka aspak të bazuar. E para, kërkesat që i paraprijnë nxjerrjes së fondit limit, i referohen zërave të defekteve (*sqaruar më lart dhe konkretisht shkresa me nr.71, Prot-datë 13.01.2015 të firmosur nga vetë A.B.*) dhe jo makinerive në numër pra siç citohet, copë 9 makineri. Gjithashtu, shkresa me nr.32, Prot-datë 08.01.2015, ka në përbërje të saj zërat e paisjeve që duhen mirëmbajtur. Njësoj dhe kërkesa për riparim të paisjeve të hemo dializës e bërë nga A.M. dhe Dh.G. citon se **“kërkohet servisi i zakonshëm”** por edhe kërkesa nga z.Dh.U. Si rrjedhojë, komisioni nuk i është përmbajtur aspak kërkesave të mëparshme. E dyta, tek arsyetimi i nxjerrjes dhe përcaktimit të kontratës pra që duhet “FULL-RISK”, citohet: *“Vlera e kontratës ka ndryshuar duke e krahasuar me vitet e kaluara sepse ka ndryshuar lloji i kontratës nga kontratë në të cilën kemi parashikuar difektet (viti 2014) që mund të ndodhnin dhe problemet e aparaturave, në Kontratë Full Risk”*. Ky pretendim, nuk është aspak i vërtetë pasi vitin e kaluar, pra në vitin 2014, SRSH ka pasur një kontratë me operatorin ekonomik “B.A.” sh.p.k dhe konkretisht kontratën me nr.1672, Prot-datë 25.08.2014, me objekt *“Mirëmbajtje e Aparaturave Mjekësore të Hemo Dializës”*. Tek kjo kontratë, kërkohet të mirëmbahen 9 makineri mjekësore të repartit të Hemo Dializës dhe bashkangjitur, tek aneksi i kontratës, jepet lista shërbimit e detajuar për çdo zë të paisjeve që duhen mirëmbajtur. Mbi të gjitha, kjo kontratë është përsëri “FULL-RISK” dhe jo siç pretendon komisioni i nxjerrjes së fondit

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

limit pra një kontratë që nuk është “FULL-RISK”. Ky kusht, është i përcaktuar tek neni 12, paragrafi i dytë i kontratës me nr.1627, Prot-datë 25.08.2014 ku citohet se: *“I porositori do të kryejë shërbimin “Full-Risk” për të gjitha paisjet mjekësore në listën e aneksit bashkangjitur”* dhe lista përmban 14 zëra të shërbimit. Gjithashtu, konstatohet se vendosja e kriterëve dhe specifikimeve teknike, është e pa argumentuar. Nuk ka asnjë dokument zyrtar ku të vërtetohet se këto kërkesa bazohen tek defektet e ndodhura në paisjet përkatëse. Nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur mbi defektet e ndodhura. Nuk ka asnjë dokument të protokolluar pranë SRSH mbi historikun e defekteve të makinerive mjekësore. Nuk ka asnjë relacion mbi ndonjë përpjekje të mundshme nga sektori i mirëmbajtjes, nga sektori i inxhinierisë klinike apo sektori i menaxhimit të teknologjisë për mirëmbajtjen e këtyre paisjeve.

-Me shkresën nr.572, Prot-datë 09.03.2015, Titullari i SRSH-së, z.T.M., nxjerr urdhrin e prokurimit nr.07, datë 09.03.2015 me objekt “Riparim i Aparaturave Mjekësore” të ndarë në 2 lote. Loti i I me objekt “Mirëmbajtje të paisjeve të Dializës” me vlerë 1,500,000 lekë pa tvsh dhe loti i II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” me vlerë 2,635,500 lekë pa tvsh.

-Procesverbali për miratimin e dokumentave të tenderit, është mbajtur me shkresën nr.39, Prot datë 13.03.2015 dhe është i firmosur nga njësia e prokurimit e cila në të njëjtën datë, me shkresën nr.40, Prot, autorizon zj.Xh.H., të ngarkojë në sistemin e APP-së, dosjen e prokurimit.

-Me shkresën nr.700, Prot-datë 24.03.2015, drejtori i SRSH, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.M., B.K. dhe A.M.i.

-Në datën 30.03.2015, me shkresën nr.50, komisioni i vlerësimit të ofertave kryen verifikimin e ofertave të ardhura. Në datën 09.04.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave me anë të procesverbalit të mbajtur nr.791, vërteton se është paraqitur një ofertë për secilin lot dhe konkretish: Për Lotin I me objekt “Mirëmbajtje e paisjeve të Dializës” nga “B.A.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 1,499,000 lekë pa tvsh dhe për Lotin II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” nga “M.” sh.p.k. me ofertën me vlerë 2,612,400 lekë pa tvsh. Të dyja ofertat janë kualifikuar.

-Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 915, Prot-datë 24.04.2015 midis SRSH dhe operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k për Lotin I me objekt “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës” në vlerën 1,499,000 lekë pa tvsh dhe me afat ekzekutimi deri më 31.12.2015 sipas nenit 8 të kontratës.

-Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 973, Prot-datë 04.05.2015 midis SRSH dhe operatorit ekonomik “M.” sh.p.k për lotin II me objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” në vlerën 2,612,400 lekë pa tvsh dhe me afat ekzekutimi deri më 31.12.2015 sipas nenit 8 të kontratës.

-Në vazhdim, trajtohet Loti I me objekt “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës” sipas kontratës midis SRSH dhe “B.A.” sh.p.k. në vlerën e 1,499,000 lekë pa tvsh, e lidhur më 24.04.2015 me afat deri më 31.12.2015.

**-Zbatimi i kontratës LOT I.**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Lot-1 “Mirëmbajtje të paisjeve të dializës”.

-Urdhër-shpenzimi nr.246, datë 03.08.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.24, datë 24.06.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.333, datë 22.09.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.29, datë 25.08.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.409, datë 13.11.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.41, datë 26.10.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Urdhër-shpenzimi nr.502, datë 22.12.2015 me vlerë 449,700.00 lekë me tvsh për mirëmbajtje, është i shoqëruar me faturën nr.515, datë 22.12.2015 dhe me situacionin bashkangjitur.

-Vlera totale e likuiduar është 1,798,800 lekë me tvsh.

-Sa më sipër, konstatohet se nuk ka asnjë kërkesë ose njoftim me shkrim nga SRSH-ja, drejtuar operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k. ku të kërkohej nga operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k. të paraqitej pranë SRSH-së për të riparuar defektin konform nenit 11-të të kontratës së lidhur ku citohet tek paragrafi i IV se: *“I Porosituri është i detyruar të dërgojë personelin teknik dhe të japë asistencën e nevojshme për riparimin e defektit **brenda 48 orëve nga momenti i njoftimit**”*. Në këtë mënyrë është e pa mundur të vlerësohet nëse është plotësuar kushti sipas paragrafit të V-të të së njëjtit nen të kontratës së lidhur ku citohet se: *“I porosituri është i detyruar të lëvrojë pjesët e këmbimit të nevojshme për riparimin e paisjes **jo më pak se 7 ditë pune nga marrja e njoftimit**”*. Mos kryerja e njoftimit kundrejt operatorit ekonomik, është në kundërshtim edhe me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, kapitulli III, pika 3.5.14 ku tek gërma b) citohet se për të ndjekur shërbimet e kryera ose riparimit të një paisjeje, duhet regjistruar edhe: *“Emri i personit që ka raportuar një problem me paisjen mjekësore”*. Pra, nuk ka asnjë shkresë ose dokument zyrtar ku të vërtetohet se është raportuar për një problem referuar procesverbaleve të mbajtura, akteve të ndryshme, të firmosura nga punonjësit e institucionit ose nuk ka asnjë formular raportimi sipas shtojcës 6.3, të formularit të raportimit të ngjarjeve të padëshiruara lidhur me paisjet, të urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të nxjerr nga Ministri i Shëndetësisë, ku përcaktohen hapat që duhen ndjekur në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të paparashikuar.

-Gjithsesi, në asnjë nga procesverbalet e mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer, nuk përmendet fakti që pjesët e ndërruara ose të riparuarra janë brenda garancisë ose që të paktën janë të vlefshme deri më 31.12.2015, kusht i kërkuar ky tek neni 13 i kontratës së lidhur midis palëve, paragrafi i III. Nuk u konstatua asnjë dokument zyrtar ku të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u konstatua nga asnjë akt apo procesverbal i mbajtur se pjesët e sjella dhe të vendosura si të reja, janë ose kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet europiane mbi aparaturat mjekësore dhe janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese. Sipas kontratës së lidhur midis palëve, dhe konkretisht të nenit 13, faqja 6 e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

kontratës, citohet se: *“Organizimi, realizimi, dokumentacioni i blerjes së pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve për aparaturat/paisjet mjekësore, do të realizohet në përputhje me urdhërin nr.3272, Prot-datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, me objekt Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri”*. Si rrjedhojë, më poshtë do të pasqyrohet hap pas hapi se si duhej të kryhej kjo procedurë por edhe se si do të duhej të dokumentohej kryerja e saj.

-Tek urdhri i mësipërm, nr.3272, Prot-datë 11.09.2007, Përcaktohen Politikat Kombëtare për Menaxhimin e Paisjeve Mjekësore në Shqipëri. Konkretisht, tek kapitulli i II, 2.2, Njësitë e Inxhinierisë Klinike (NJIK), citohet *“Me qëllim që spitalet të kenë në dispozicion këto kapacitete profesionale, në nivel spitali ngrihen dhe funksionojnë Njësitë e Inxhinierisë Klinike”*. Tek pika 2.2.3, objektivat, përcaktohet objektivi kryesor i njësisë së inxhinierisë klinike që është *“Mbështetja e cila përfshin kontributin e drejtpërdrejtë në procesin e blerjes, përdorimit, shërbimit, mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së paisjeve mjekësore”*.

**Tek pika 2.2.4, Përgjegjësitë e NJIK (Njësia e inxhinierisë klinike), pëcakton:**

-*“Në shërbimet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore përfshihen”*:

- *“Mirëmbajtja periodike e planifikuar (parandaluese)”*
- *“Kontrollet e sigurisë”*
- *“Kontrollet e cilësisë lidhur me performancën dhe funksionimin e tyre”*
- *“Shërbimet dhe riparimet”*
- *“Kontaktet me kompanitë e jashtme dhe menaxhimi i kontratave të shërbimit”*
- *“Modifikime dhe përshtatje të pajisjeve mjekësore”*

-Tek pika 2.2.5, Detyrat e NJIK, citohet:

**a.** *NJIK përfaqëson njësinë kompetente të pajisjeve mjekësore brenda spitalit dhe konsultohet nga personeli tjetër i spitalit për gjithçka lidhet me përdorimin, blerjen si dhe me shpërndarjen e pajisjeve mjekësore.*

**b.** *NJIK mbështet procesin e prokurimit të pajisjeve mjekësore për çështje lidhur me specifikime teknike; vlerësimin e kostos gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës; vlerësimin e ofertave të pjesëmarrësve në tender për blerjen e pajisjeve mjekësore.*

**c.** *NJIK për pajisjet e reja mjekësore zbaton testet e pranimit, bën verifikimet e sigurisë, të funksionimit të tyre dhe përputhjen me kërkesat e blerjes.*

**d.** *NJIK zotëron, përditëson dhe forcon njohuritë e nevojshme lidhur me kuadrin rregullator (ligjet, rregulloret, standardet) si dhe ruan dhe zhvillon aftësitë për të dhënë këshilla dhe zhvilluar rekomandime në fushën e inxhinierisë klinike për të funksionuar si një burim këshillimi për çështjet e lidhura me pajisjet mjekësore.*

**e.** *NJIK kujdeset për të gjitha pajisjet mjekësore që janë në përdorim në spital dhe të regjistruara në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

ë. NJIK merret në mënyrë aktive me trajtimin e aksidenteve dhe incidenteve me pajisjet mjekësore. Përgjegjësi i NJIK raporton tek autoriteti përkatës në përputhje me procedurën e miratuar të raportimit të këtyre ngjarjeve.

f. NJIK është përgjegjëse për trainimin në punë të personelit mjekësor mbi përdorimin dhe sigurinë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore. Kjo kërkon që personeli i NJIK të ketë marrë trainimin e përgjithshëm në fushën e inxhinierisë klinike si dhe kualifikimet dhe trajnimet e duhura për disa pajisje të veçanta për të rritur në mënyrë të vazhdueshme njohuritë dhe aftësitë brenda njësisë.

g. NJIK është përgjegjëse për administrimin e Sistemit të Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (sistemit të inventarit të pajisjeve mjekësore si dhe të regjistrit të ngjarjeve të padëshërueshme me pajisjet mjekësore). Sistemi i inventarit është baza për planifikimin e riinvestimeve, për planifikimin e mirëmbajtjes periodike si dhe për krijimin e dosjeve të historisë së pajisjeve mjekësore.

-Tek pika 2.3, faqja 12, Agjencia Shtetërore e Paisjeve Mjekësore, citohet: Aktualisht në Shqipëri ekziston Qendra Kombëtare Biomjekësore (QKB), e cila është një punishte kombëtare për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Ajo mbështet të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. **Kur një spital nuk arrin të riparojë një pajisje mjekësore me specialistët e vet atëherë pajisja dërgohet në këtë qendër për riparim ose një specialist i kësaj qendre dërgohet të riparojë pajisjen në vend.** Shumica e të punësuarëve në sektorin e mirëmbajtjes në spitale nuk janë të trajnuar në inxhinieri klinike dhe kanë nevojë të mbështeten nga QKB. Në Shqipëri kanë hyrë dhe vazhdojnë të hyjnë në shumë rrugë pajisje mjekësore të llojeve e markave të ndryshme. Në spitalet tona mund të gjinden pajisje të reja të nënpërdorura, të papërdorura ose që përdoren në mënyrë të papërshtatshme për shkak të shumë faktorëve si mungesa e materialeve të konsumit, mungesa e mirëmbajtjes dhe mungesa e kompetencës nga ana e përdoruesve.

-Sa më sipër, SRSH, përpara se të fillonte një procedurë prokurimi me objekt Mirëmbajtjen e Paisjeve Mjekësore, duhet ti dërgonte një kërkesë, Agjencisë Shtetërore të Paisjeve Mjekësore (ASHPM), pasi të konkludonte se vet SRSH, nuk ishte në gjendje të riparonte vetë defektet, dhe në të njëjtën kohë, ASHPM, duhet të dërgonte pranë SRSH një specialist të fushës ose të udhëzonte për kryerjen e procedurës së prokurimit, gjithmonë konform ligjit dhe këtij urdhëri. Gjithashtu, fakti që është paracaktuar vlera e fondit limit të një procedure mirëmbajtjeje dhe për më tepër, faturimet apo situacionet nuk janë bërë sipas zërave të mirëmbajtjes ose të pjesëve të ndërruara duke faturuar vlerën e prokuruar të ndarë në 4 pjesë fikse përkatësisht 449,700 lekë, pa specifikuar se cilat janë vlerat e pjesëve të sjella dhe se sa është vlera e riparimit ose ndërrimit, është në kundërshtim me kapitullin 3 të urdhrit nr.3272, datë 11.09.2007, ku citohet se: “**Prokurimi i pjesëve të këmbimit duhet të shihet si diçka e paplanifikuar, pasi nuk mund të parashikohet se çfarë pjese këmbimi mund të prishet në të ardhmen**”. Pra paracaktimi i fondit limit për mirëmbajtje në të njëjtën kohë që nuk dihetin defektet që mund të ndodhnin

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

është i dyshimte aq më tepër që SRSH, njësia e inxhinierisë klinike, nuk ka një historik defektesh ose më saktë nuk ka respektuar as pikën 3.5.13 të udhrit të mësipërm mbi të dhënat që duhen regjistruar ku citohet midis të tjerash se “Çdo spital, duhet të regjistrojë ose në letër ose në kompjuter historinë e plotë të paisjes, përfshirë:...g) Të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes”. Gjithashtu, nuk është respektuar as pika 3.8.5 e kapitullit III të urdhrimit të mësipërm, mbi Rregullat për raportimin në nivel spitali lidhur me ndodhjen e defekteve. Konkretisht, midis të tjerash, citohet se “Është e detyrueshme për të raportuar gjithashtu çdo incident tjetër të lidhur me paisjet mjekësore, defektet e vogla dhe mospërputhje me SIPM (Sistemi i Informacionit të Paisjeve Mjekësore), përderisa ato incidente mund të marrin një domethënie më të madhe të bashkuara me ngjarje të tjera të ngjashme duke shprehur prirje ose duke përcaktuar një sistem sigurie të përshtatshëm nga ana e prodhuesit apo furnizuesit”. Njëkohësisht, tek shtojca 6 e urdhrimit nr.3272, datë 11.09.2007, Sistemi i raportimit të ngjarjeve të padëshiruara, shpjegohet qartazi mënyra e raportimit nga çdo i punësuar në institucionet e kujdesit shëndetësor (publik apo privat) i cili ka përgjegjësinë për të raportuar me shkrim tek shefi/përgjegjësi i drejtëpërdrejtë i tij”. Në vazhdim, tek pika 3.8.9, Si të veprohet me pjesët me defekt ose të kontaminuara, citohet qartazi se: : **“Pjesët me defekt duhet të izolohen kur është e mundur dhe nuk duhet të riparohen (në spital ose me kontraktim) ose t’i kthehen prodhuesit pa marrë paraprakisht miratimin nga SMPM (Sektorit të Menaxhimit të Paisjeve Mjekësore). Gjithashtu ato nuk duhet të hidhen përpara se t’i jepet mundësia SMPM t’i përdorë për hetim të mëtejshëm. Prodhuesi ose furnizuesi duhet të informohen menjëherë dhe të lejohen të kqyrin pjesët vetëm nën mbikqyrjen e një personi të përshtatshëm. Për të lehtësuar hetimin mundet që prodhuesit t’i vihet në dispozicion një mostër e pajisjes me defekt e papërdorur (nga grupi i rezervës). Nëse spitali këshillohet nga SMPM për të kundërtën e asaj që është thënë më sipër, prodhuesi nuk duhet lejuar të këmbëjë, ndërhyjë ose të heqë ndonjë pjesë nga pajisja e përfshirë në aksident nëse kjo do të paragjykonte hetimin e SMPM ose të ndonjë organizmi tjetër. Kur SMPM ka përcaktuar që pjesa me defekt mund t’i kthehet prodhuesit, ky i fundit duhet kontaktuar për t’u siguruar që dokumentacioni dhe transporti janë organizuar siç duhet. Nëse pajisja kërkohet për përdorim, hiqet pjesa me defekt dhe pajisja mund të riparohet. Cdo pjesë e hequr në të tilla rrethana duhet të mbahet e vecuar në një ambient të posaçëm dhe të ruhet për t’u përdorur për hetimet e mëvonshme. ..”**

-Sa më sipër, argumentimi i fondit limit është i pa bazuar e i pa mbështetur në rregulla dhe urdhra por dhe prokurimi i procedurës, është bërë në kundërshtim me urdhrin e mësipërm pasi nuk janë ndjekur hapat e duhur përpara fillimit të procedurës. Gjithashtu, fakti i mos argumentimit me dokumenta zyrtare dhe procedura ligjore ku të vërtetohej kryerja e shërbimit duke dokumentuar dhe pjesët rezervë të dëmtuara, tregojnë se likuidimi i operatorit ekonomik “B.A.” sh.p.k., është bërë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi. Fakti që, shërbimet e deklaruara si të ekzekutuara, vërtetësia e të cilave, nuk justifikohet me dokumentacion ligjor dhe me procedura të ndjekura sipas urdhrimit nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë, sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave për Menaxhimin e Aktiveve në

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Njësitë e Sektorit Publik por edhe konform kushteve të kontratës së lidhur midis palëve, përbën shkas për aludime mbi shërbimet reale të kryera dhe ato të pa kryera.

-Për veprimet e mësipërme:

-Për mos respektim të urdhrin nr.3237, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, mban përgjegjësi, A.B. me detyrë Inxhinieri Klinike.

-Gjithashtu, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Paisjeve Mjekësore), konform urdhrin të mësipërm, kapitulli II, pika 2.3.1. Pa pasur më parë një informacion të detajuar sipas kapitullit III të urdhrin të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6, por edhe duke filluar një procedurë prokurimi me fond limit të paracaktuar kur faktikisht nuk mund të parashikohen se sa defekte do të ndodhin, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, ku citohet se: “*Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet se diçka e paplanifikuar*”. Sa më sipër, mban përgjegjësi, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, z.Sh.Y.

-Për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera; Në kundërshtim me nenin 11, nenin 12 dhe nenin 13 të kontratës së lidhur me nr.915, Prot-datë 24.04.2015. Në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, pikat 6,7,8,10 dhe 14, por mbi të gjitha, në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrit të Shëndetësisë, pika 3.4.5, faqe 24, pika 3.8.9, faqe 41, duke mos përshkruar me detaje pjesët e zëvendësuara, duke mos cituar kodet apo numrat serial të pjesëve të vendosura si të reja, duke e bërë të pamundur evidentimin nëse këto pjesë janë origjinale të kompanisë prodhuese të makinerive mjekësore të Hemo-Dializës, duke mos evidentuar dhe saktësuar vendndodhjen e pjesëve të dëmtuara ose të hequra, duke mos cituar në procesverbalin e mbajtur, afatin e skadimit të pjesës së re të vendosur, mban përgjegjësi, sektorit i inxhinierisë klinike.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1577, Prot-datë 04.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/3, Prot-datë 07.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së, sipas shkresës me nr.1753/2, Prot-datë 16.05.2018:

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Ju zj.B., jeni atakuar në akt-konstatim lidhur me procedurën e prokurimit dhe shkeljet që kanë të bëjnë vetëm me nxjerrjen e specifikimeve teknike dhe jo me marrjen në dorëzim. Është reflektuar periudha që keni qenë me leje lindjeje pasi përgjegjësia për marrjen në dorëzim i kalon sektorit ku ju jeni përgjegjëse. Fakti që keni sjellë një urdhër zëvendësimi nuk do të thotë se zëvendësuesi merr atributet apo detyrimet e pozicionit tuaj pasi një gjë e tillë nuk është e shprehur në asnjë rresht të urdhrin që ju zëvendësoheni. Ju duhej të monitoronit zbatimin duke udhëzuar mënyrën e marrjes në dorëzim edhe pa qenë prezente.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sa më sipër, observacioni juaj, nuk merret në konsideratë.

**5.19 Tenderi me objekt “Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër, rezultoi si më poshtë vijon:**

***Objekti i këtij akt konstatimi është:***

Auditimi i kontratës së lidhur me nr. 1672 prot, datë 25.08.2014 me objekt “*Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës*” midis SRSH dhe operatorit ekonomik “*B.A.*” sh.p.k., me afat deri 31.12.2014 dhe vlerë 1,197,360 lekë me tvsh. Më poshtë, paraqitet kontrata shtesë me nr.248, datë 05.02.2015, dhe vlerë 236,400 lekë me tvsh.

-Përsa i përket kontratës shtesë me nr.248, Prot-datë 05.02.2015, me vlerë më pak se 20% e vlerës së kontratës bazë, pra 236,400 lekë me tvsh, midis “*B.A.*” sh.p.k. dhe SRSH-së dhe me afat nga data e lidhjes deri më 31.03.2015, konstatohet si vijon:

-Kontrata shtesë, nuk i referohet as numrit të protokollit dhe as datës së kontratës bazë. I referohet objektit i cili është i njëjtë për çdo vit që është prokuruar për mirëmbajtjen e paisjeve të Hemo-Dializës. Aneksi i kontratës, përshkruan zërat e pajisjeve ose pjesëve që do të mirëmbahen. Konstatohet se zërat e këtij aneksi, janë njëkohësisht tek aneksi i kontratës bazë dhe jepen më poshtë:

1. Reduktor presioni (H) PI/PO.
2. Motor pompe dumpers.
3. Motor pompe.
4. Bord Kontrolli motorrash.
5. Tuba specono.
6. Filtra për aparatit.
7. Dedektor nivel sensori.
8. Fluksimetër.

-Sa më sipër, zërat e prokuruar në shtesën e kontratës, janë zëra për të cilat është kryer shërbimi njëherë sipas kontratës me nr.1672, Prot-datë 25.08.2014 me objekt “*Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës*” midis SRSH dhe operatorit ekonomik “*B.A.*” sh.p.k., me afat deri 31.12.2014 dhe vlerë 1,197,360 lekë me tvsh. Këto zëra, janë brenda garancisë 1 vjeçare të parashikuar tek neni.13 i kontratës bazë. Si të tilla, nuk kishin përse të përfshiheshin tek kontrata shtesë. **Kontrata shtesë, është lidhur për zëra të cilat janë prokuruar njëherë tek kontrata bazë.** Gjithashtu, konstatohet se nuk ka asnjë dokumentacion zyrtar të protokolluar pranë SRSH, mbi ndonjë ngjarje të paparashikuar ose mbi ndonjë defekt të mundshëm. Nuk ka asnjë relacion nga sektori i menaxhimit të teknologjisë ose nga sektori i inxhinierisë klinike, i cili të

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

kërkojë riparimin ose vazhdimin e kontratës bazë duke specifikuar defektet e mundshme ose arsyen se përse duhej lidhur një kontratë shtesë nga momenti që nuk kemi defekte ose nga momenti që nuk janë parashikuar zëra shtesë që të paktën të mos jenë identik me zërat e shërbimeve të kontratës bazë. Si e tillë, kjo shtesë kontrate, është bërë për të njëjtat zëra që është bërë dhe kontrata bazë duke bërë mbivendosje të shërbimit ose në rastin më të keq, duke e kryer atë dy herë në të njëjtën kohë që ekzekutimi i çdo zëri në kontratën bazë, ka 1 vit garanci. Pra, kontrata shtesë, nuk është e specifikuar bazuar tek makineritë që do të mirëmbahen sipas numrave të tyre serial. Veçanërisht, nëse i referohemi zbatimit të kësaj kontrate, konstatohet se tek procesverbalet e mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit, nuk specifikohet në asnjë rresht lloji i shërbimit të kryer, pjesa e zëvendësuar (nëse ka patur) apo edhe orët e punës së makinerisë duke e bërë të pamundur të paktën vërtetësinë e kryerjes së shërbimit bazuar edhe tek urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 i Ministrit të Shëndetësisë. Konkludojmë se vlera e shpenzuar është e pa justifikuar, e pa argumentuar që në nisje pasi nuk ka asnjë kërkesë ose relacion nga sektori përkatës për nevoja për shërbime shtesë aq më tepër duke mos specifikuar zërat e shërbimeve e vërtetuar kjo me procesverbalet e pa sakta dhe të pa detajuara, e si e tillë, vlera e kontratës shtesë prej **236,400 lekë, përbën dëm ekonomik** për SRSH-në dhe ngarkon me përgjegjësi, Titullarin e SRSH-së, z.T.M.

*Komente dhe shpjegime të subjektit*

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1577, Prot-datë 04.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/3, Prot-datë 07.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së sipas shkresës me nr.1753/3, Prot-datë 16.05.2018, nga zj.A.B.:

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Në akt-konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, konstatimet e kontratës që ju pretendoni se është jashtë periudhës së auditimit, nëse do ti kishit lexuar me qetësi, do të kuptonit se është përshkruar fenomeni dhe pasojat me zbatimin e saj dhe jo vlera e investuar si në rastet e viteve pasardhëse. Për më tepër, efektet kjo kontratë që pretendoni se është jashtë periudhës së auditimit i ka në vazhdim për shkak të garancisë së pjesëve të ndërrimit që vazhdon deri në fund të vitit 2015 pra brenda periudhës së auditimit. Gjithashtu, në akt-konstatim, është trajtuar kontrata shtesë e kontratës bazë. Pra, në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka analizuar objekte që i përkasin periudhave jashtë periudhës së audituar por gjithmonë ato kanë pasur lidhje me periudhat e mëvonshme.

**5.20 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

***Objekti i këtij akt konstatimi është:***

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”.

**k. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Evadim i mbeturinave spitalore”.**

1.Urdhër Prokurimi Nr.06 datë	3.Hartuesit e	Dokumenteve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
-------------------------------	---------------	-------------	-----------------------------------

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

05.03.2015	<b>Tenderit</b>	L.Gj.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.	G.B. E.H. P.N.	E. K. J.ZH.
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,500,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>Anulluar.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 27.03.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>FSDKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë</b> <b>pjesëmarrës në tender: R-94. sh.p.k.</b>

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit nr.48, Prot të datës 27.03.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, ka tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 1 operator ekonomik i cili , sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO, nuk ka paraqitur ofertën ekonomike sipas preventivit të kërkuar për konkurim. Sa më sipër, nga kontrolli elektronik, u konstatua se operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k, ka paraqitur formularin e ofertës sipas preventivit të kërkuar nga F.P. e cila tek preventivi i parashikuar, liston sasi të e mbetjeve që duhen hequr për 296 ditë, sasi të cilat janë të njëjta me ofertën e dhënë nga operatori ekonomik. Gjithsesi, arsyetimi i vendimit të anulimit të kësaj procedure, paraqitet më poshtë.

-Me shkresën nr.461, Prot-datë 23.02.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin nr.34, mbi ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”. Komisioni përbëhet nga F.P., H.G. dhe K.M.

-Me shkresën nr.485, Prot-datë 26.02.2015, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, dërgon vlerën e fondit limit 1,498,438 lekë pa tvsh, tek drejtorja e SRSH-së.

-Sa më sipër, konstatohet se specifikimet teknike përsa i përket sasive të mbetjeve, nuk i referohen llogaritjeve mbi bazën e ndonjë eksperience ose mbi bazën e ndonjë kalkulimi lidhur me peshën e tyre. Sasi të vendosura të mbeturinave, nuk kanë ardhur si rezultat i ndonjë matjeje faktike ditore por është paracaktuar se në ditë do të evadohen 3 m<sup>3</sup> mbeturina. Komisioni citon se i është referuar çmimeve të tregut edhe pse në fakt nuk disponon asnjë shkresë zyrtare ku të vërtetohet marrja e çmimeve të tregut. Gjithashtu, preventivimi i 888 m<sup>3</sup> mbetje, si mbetje vjetore, nuk ka asnjë bazë teknike llogaritjeje. Komisioni, duhej që të paktën të llogariste sasinë e mbetjeve, mbi bazën e volumit ose më saktë të peshës së koshave të mbeturinave me qëllim që edhe marrja në dorëzim e shërbimit, të bëhej mbi bazën e peshës së mbeturinave të larguara dhe jo mbi bazën e volumeve të paracaktuara. Mungojnë të dhëna teknike si harta/skica ku të dukej ose specifikohet sipërfaqja që do të pastrohet, vendndodhja e koshave apo edhe e ambienteve përkatëse ku do të kryhej procesi i dizefektimit. Sa më sipër, për nxjerrjen e specifikimeve teknike jo të detajuara, konfuze dhe pa asnjë analizë të mirëfilltë teknike, mban përgjegjësi komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga F.B., H.G. dhe K.M. pasi kanë vepruar në kundërshtim me

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, neni 23, specifikimet teknike, pika 1, pika 2, pika 3 dhe pika 4 por dhe në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, neni 28, kontratat e shërbimeve, pika 1.

-Me shkresën nr.550, Prot-datë 05.03.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.06, për fillimin e procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga G.B., P.N. dhe E.H. Fondi limit i përcaktuar sipas këtij urdhri është 1,500,000 lekë pa tvsh dhe jo aq sa e ka përlllogaritur komisioni i përlllogaritjes. Fondi limit sipas urdhrin të prokurimit, është rritur me 1,562 lekë. Sa më sipër, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit me fond limit të ndryshëm nga ai i miratuari nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, mban përgjegjësi Titullari i SRSH-së, z.T.M. pasi ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr.914, datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 60, ku specifikohet se çfarë përmban urdhri i prokurimit dhe konkretisht për fondin limit, urdhri i prokurimit midis të tjerash, duhet të përmbajë vlerën e përlllogaritur por edhe në kundërshtim me nenin 9, llogaritja e vlerës së kontratës.

-Me shkresën nr 608/1, Prot-datë 11.03.2015, titullari i SRSH, miraton njoftimin e kontratës, publikuar në APP më 16.03.2015.

-Me shkresën nr.37, Prot-datë 09.03.2015, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe në vazhdim, me shkresën nr.38, autorizohet nëpunësja G.B. për të krijuar dosjen elektronike.

-Me shkresën nr.647, Prot-datë 17.03.2015, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, ridërgon specifikimet teknike tek drejtoria e spitalit rajonal Shkodër.

-Me shkresën nr.650, Prot-datë 17.03.2015, njësia e prokurimit, bën ndryshimet e nevojshme tek DST-ja elektronike pasi specifikimet teknike të krijuara elektronikisht, kishin gabime përsa i përket sasive të mbeturinave në krahasim me ato të miratuara.

-Me shkresën nr.702, Prot-datë 25.03.2015, drejtori i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga L.Gj., E. K. dhe J.Zh.

-Me shkresën nr.719, Prot-datë 27.03.2015, operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k, dërgon një kërkesë tek SRSH tek e cila kërkon informacion mbi ecurinë e vlerësimit të ofertave.

-Me shkresën nr.48, Prot-datë 27.03.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, kryen procesin e verifikimit të ofertave të ardhura dhe konstaton një ofertë nga operatori ekonomik “R-94.” për të cilën shprehet se të vetmen mangësi që ka, është se formulari i çmimit të ofertës nuk është plotësuar sipas preventivit. Nga kontrolli i dokumentacionit të dorëzuar tek faqja e APP nga ky operator, u kostatua se formulari i çmimit të ofertës, është plotësuar sipas preventivit në kundërshtim me pretendimin e KVO-së.

-Me shkresën nr.49, Prot-datë 27.03.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin përmbledhës së procedurës së prokurimit dhe justifikon anulimin e procedurës me faktin se sistemi elektronik i APP-së, nuk ka funksionuar

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

duke cituar se: *Operatori ekonomik ka pretenduar se në sistem dilte sikur tenderi ishte duke u vlerësuar dhe nuk mund të ngarkonte asnjë dokument.* Si rrjedhojë, asnjë dokument zyrtar nuk ekziston pranë SRSH-së për të vërtetuar pretendimin e KVO-së se operatori ekonomik ka pasur probleme me ngarkimin e dokumentacionit të tenderit aq më tepër (sqaruar më lart) që pretendimi se mungon formulari i ofertës sipas zërave të preventivit, nuk është i saktë. Sa më sipër, propozimi për anulimin e procedurës së prokurimit, është i pa bazuar në dokumenta ligjorë dhe është bërë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 66, shqyrtimi i ofertave, pika 4, 5 dhe pika 6.

-Me shkresën nr.738/1, Prot-datë 31.03.2015, titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e anulimit të procedurës së prokurimit.

-Në vazhdim, paraqitet procedura e prokurimit me objektin e mësipërm e cila rihidhet në sistem pasi është anuluar me shkresën e mësipërme me nr.738/1, Prot-datë 31.03.2015.

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Evadim i mbeturinave spitalore”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.11 datë 15.04.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.	G.B. H.G. P.N.	G.N. E. K. J.ZH.
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,353,400 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>1,275,280 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>78.120 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 29.04.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>FSDKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës në tender: R-94. sh.p.k. dhe Sh. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së shërbimit</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>11.05.2015.</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,530,336 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.63, Prot të datës 29.04.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 2 operatorë ekonomik të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe konkretisht operatori ekonomik “Sh. ” sh.p.k me ofertën me vlerë 1,333,560 lekë me tvsh dhe operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k me ofertën me vlerë 1,593,990 lekë me tvsh.

-Me shkresën nr.776, Prot-datë 08.04.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin nr.64 për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga A.D., S.K. dhe F.P.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.817, Prot-datë 10.04.2015, komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit, dërgon pranë drejtorisë së SRSH-së, argumentimin e vlerës së fondit limit. Vlera e fondit limit e përllogaritur është 1,353,450 lekë pa tvsh. Konstatohet se në krahasim me procedurën e anuluar, komisioni ka ndryshuar sasi të mbetjeve që duhen hequr dhe ka ulur çmimet për njësi. Sa më sipër, komisioni, nuk ka asnjë shkresë apo dokument zyrtar ku të vërtetojë pretendimin se i është referuar çmimeve të tregut. Gjithashtu, nuk ka asnjë argumentim apo trajtim në relacionin e mbajtur ku të sqarohet se përse ka ndryshuar sasia e mbetjeve që duhen hequr përderisa në procedurën e mëparshme, kjo sasi e përllogaritur për gjatë gjithë vitit ka qenë më e vogël dhe konkretisht për 296 ditë, duheshin hequr 888 m<sup>3</sup> mbetje kurse për 245 ditë duhen hequr 980 m<sup>3</sup> mbetje. Nga kalkulimet e grupit të auditimit rezulton se:

**a)** Për 245 ditë, nëse grumbullohen 3m<sup>3</sup> në ditë, rezulton se për zërin “*Grumbullim e sistemim i mbetjeve urbane e spitalore jo të rrezikshme (3m<sup>3</sup>/ditë)*” sasia e mbetjeve në total duhet të ishte 735 m<sup>3</sup> dhe jo 980 m<sup>3</sup>. Si rezultat, vlera e fondit limit për këtë zë, duhet të ishte 735 m<sup>3</sup> x 291 lekë/m<sup>3</sup> = 213,885 lekë ose **71.295 lekë** më pak se ai i përllogaritur nga komisioni.

**b)** Për 245 ditë, nëse evadohen 3m<sup>3</sup> në ditë, rezulton se për zërin “*Evadim i mbetjeve urbane (3m<sup>3</sup>/ditë)*” sasia e mbetjeve në total duhet të ishte 735 m<sup>3</sup> dhe jo 980 m<sup>3</sup>. Si rezultat, vlera e fondit limit për këtë zë, duhet të ishte 735 m<sup>3</sup> x 580 lekë/m<sup>3</sup> = 426,300 lekë ose **142,100 lekë** më pak se ai i përllogaritur nga komisioni.

-Me shkresën nr.845, Prot-datë 15.04.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.11, ku përcakton njësinë e prokurimit të përbërë nga G.B., P.N. dhe H.G. Vlera e fondit limit është 1,353,400 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.846, Prot-datë 15.04.2015, Titullari i SRSH-së, miraton njoftimin e kontratës i cili është publikuar në APP më 20.04.2015.

-Me shkresën nr.56, Prot-datë 15.04.2015, njësia e prokurimit miraton dokumentat standarde të tenderit dhe në vazhdim me shkresën nr.57, Prot-datë 15.04.2015, autorizohet nëpunësja G.B. për krijimin e dosjes elektronike.

-Me shkresën nr.879, Prot-datë 21.04.2015, Titullari i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga G.N., E. K. dhe J.ZH.

-Me shkresën nr.63, Prot-datë 29.04.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e hapjes së ofertave dhe konstaton dy oferta të ardhura dhe konkretisht nga operatori ekonomik “Sh. ” sh.p.k me ofertë 1,111,300 lekë pa tvsh dhe operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k me ofertë 1,328,325 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.986, Prot-datë 06.05.2015, mban raportin përmbledhës dhe propozon që fitues i procedurës të shpallet operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.987, Prot-datë 06.05.2015, Titullari i SRSH-së, miraton formularin e njoftimit të fituesit dhe shpall fitues operatorin ekonomik “R-94.” sh.p.k., me ofertën me vlerë 1,593,990 lekë me tvsh. Ky formular është publikuar në faqen e APP-së më 11.05.2015.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Kontrata e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “R-94.” sh.p.k, mban datën 11.05.2015 dhe nr.Prot 1004. Afati i ekzekutimit është deri në fund të vitit 2015 ose 235 ditë.

**Zbatimi i kontratës:**

-Gjatë zbatimit të kontratës, janë mbajtur akt-rakordimet për çdo pagesë vlerat e të cilave me tvsh, jepen më poshtë:

-Urdhër-shpenzimi nr.192 datë 16.06.2015 me vlerë 136,794 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.18, datë 31.05.2015.

-Urdhër-shpenzimi nr.260 datë 05.08.2015 me vlerë 264,540 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.28, datë 30.06.2015 me vlerë 119,088 lekë dhe me fatutën nr.37, datë 31.07.2015 me vlerë 145,452 lekë.

-Urdhër-shpenzimi nr.334 datë 22.09.2015 me vlerë 145,452 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.45, datë 02.09.2015.

-Urdhër-shpenzimi nr.366 datë 21.10.2015 me vlerë 140,760 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.50, datë 30.09.2015.

-Urdhër-shpenzimi nr.407 datë 13.11.2015 me vlerë 145,452 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.57, datë 31.10.2015.

-Urdhër-shpenzimi nr.483 datë 21.12.2015 me vlerë 140,760 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.61, datë 30.11.2015.

-Urdhër-shpenzimi nr.509 datë 28.12.2015 me vlerë 314,058 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.79, datë 24.12.2015.

-Sa më sipër, konstatohet se operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k., është likuiduar në vlerën e 1,287,816 lekë dhe jo në vlerën e kontratës së lidhur pra 1,530,336 lekë. Ky likuidim, vjen nga fakti se operatori ekonomik, ka evaduar 705 m<sup>3</sup> mbetje dhe jo 940 m<sup>3</sup> siç ishte preventivuar.

-Konstatohet se sasi të mbeturina që janë evaduar dhe situacionuar, janë të pa verifikueshme ose më saktë të pa argumentuara. Grupi i marrjes në dorëzim, nuk i referohet asnjë procedure teknike për matjen e vëllimit të mbeturinave por vetëm shprehet për sasinë e tyre.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

Në observacionin e ardhur nga z.T.M. me nr.40/5, Prot-datë 21.05.2018, lidhur me kundërshtimin se nuk ka ndonjë shkelje pasi anulimi ka ardhur si pasojë e mangësive në ofertën e dhënë, sqarojmë: Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH<sup>-së</sup> :

Në akt-konstatim është i detajuar argumentimi se nuk duhej të miratohej anulimi pasi operatori ekonomik i kishte plotësuar kriteret.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

**5.21 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

**Objekti i këtij akt konstatimi është:**

Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt **“Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës”**.

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo Dializës”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.01 datë 09.02.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> E hapur.	G.B. P.N. A.V.	Dh.G. A.M. H.G.
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 37,500,000 lekë.	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> B.A. sh.p.k me ofertë: 37,470,250 lekë.	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 29,750 lekë.
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 09.03.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit, FSDKSH.	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës në tender.</b> B.A. sh.p.k
<b>b.Zbatimi i Kontratës së Mallrave</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> Dt.20.03.2015.	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 44,964,300 lekë.	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.36, Prot të datës 09.03.2015 mbajtur nga KVO e SRSR, ka tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 1 operatorë ekonomikë “B.A.” sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertën me vlerë 37,470,250 lekë pa tvsh. Me raportin përmledhës të mbajtur nga KVO me nr.657, Prot-datë 18.03.2015, i propozohet Autoritetit Kontraktor, të shpalli fitues, operatorin ekonomik të vetëm të kualifikuar “B.A.” sh.p.k.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan si më poshtë vijon:

-Me shkresën nr.30/4, Prot-datë 07.01.2015 (protokolluar pranë repartit të Dializës), shefja e shërbimit, zj.Dh.G., liston sasinë e paisjeve të konsumit për dializën e vitit 2015.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Me shkresën pa numër protokollit dhe pa datë, punonjësja e farmacisë M.K., paraqet listën e paisjeve të konsumit sipas të dhënave të vitit 2014. Po në këtë listë, jepen njësitë, sasi të dhe çmimi total sipas sasive që janë konsumuar në vitin 2014. Sasi të e nxjerra, i referohen të dhënave nga fletë-daljet e farmacisë të kërkuara nga k/infermierja e repartit të dializës së SRSH-së. Nga verifikimi me zgjedhje i këtyre fletë-daljeve, në datën 31/01/2018, u konstatua se pranë magazinës së medikamenteve të SRSH-së, ishin listat e detajuara sipas numrit të kartelës së pacientit, pavionit dhe ilaçit apo medikamentit përkatës sipas rastit. Totali i vlerës së nxjerrë nga zj.M.K. sipas sasisë dhe çmimit, është 1,806,957.67 lekë.
- Me shkresën nr.296, Prot-datë.05.02.2015, drejtori i SRSH, z.T.M., nxjerr urdhrin e brendshëm nr.13, datë 05.02.2015, mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit.
- Me shkresën nr.316, Prot-datë 09.02.2015, drejtori i SRSH-së, z.T.M., nxjerr urdhrin e prokurimit të procedurës së mësipërme me fond limit 37,500,000 lekë.
- Me shkresën nr.321, Prot-datë 09.02.2015, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga K.K., M.H. dhe A. Sh., përlllogarisin fondin limit në vlerën e 37,497,500 lekë pa tvsh.
- Sa më sipër, konstatohet se urdhri i prokurimit, është nxjerr përpara përlllogaritjes së fondit limit, e vërtetuar kjo me numrat e protokollit pasi urdhri i prokurimit mban numër protokollit 316 kurse shkresa për përlllogaritjen e fondit limit, mban numër protokollit 321. Gjithsesi, nëse do merrej e mirëqenë se urdhri i prokurimit, është nxjerr pas nxjerrjes së fondit limit, konstatohet se fondi limit tek urdhri i prokurimit, është rritur me 2,500 lekë.
- Sa më sipër, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit përpara përlllogaritjes së vlerës së kontratës por mbi të gjitha, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit me vlerë më të lartë se vlera e përlllogaritjes, mban përgjegjësi Titullari i SRSH-së z.T.M. pasi ka vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të SRSH-së dhe në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 28, metodat e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 59.
- Me shkresën nr.1, Prot-datë 11.02.2015, njësia e prokurimit, miraton DST dhe me shkresën nr.2, Prot-datë 11.02.2015, autorizon zj.G.B. për krijimin e dosjes në mënyrë elektronike tek faqja e APP-së.
- Konstatohet se në mënyrë elektronike, dokumentet standarde të tenderit, nuk janë identike me ato të miratuara nga njësia dhe konkretisht pika 2.3, kapaciteti teknik i miratuar paraprakisht nga njësia e prokurimit, pika 1, në fund të saj, citohet : *“të shoqëruara me dokumentin nga dega e tatim taksave që vërteton deklarinimin dhe realizimin e shitjeve”* Kjo shprehje, tek DST në mënyrë elektronike, është hequr nga personi i autorizuar zj.G.B.
- Me shkresën nr.527, Prot-datë 04.03.2015, ndryshuar me shkresën nr.559, Prot-datë 06.03.2015, drejtori i SRSH-së, T.M., ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga Dh.G., Amanda Matlia dhe H.G.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.36, Prot-datë 09.03.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin e hapjes së ofertave dhe në vazhdim me shkresën nr.675, Prot-datë 18.03.2015, raport përmbledhës, komisioni i vlerësimit të ofertave, propozon që të shpallet fitues i procedurës së prokurimit, operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k me ofertën me vlerë 37,470,250 lekë pa tvsh.  
-Kontrata e lidhur me nr.687, Prot-datë 20.03.2015 midis SRSH dhe “B.A.” sh.p.k. me vlerë 37,470,250 lekë pa tvsh, ka afat ekzekutimi deri më 31.12.2015.

**Zbatimi i kontratës.**

-Urdhër-shpenzimi nr.125, datë 20.04.2015.2015 me vlerë 12,173,100 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me:

a) Faturën nr.88, datë 24.03.2015, fletë-hyrjen nr.85, datë 24.03.2015, me vlerë 108,000 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

b) Faturën nr.89, datë 24.03.2015, me fletë-hyrjen nr.86, datë 24.03.2015, me vlerë 4,652,640 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

c) Faturën nr.106, datë 03.04.2015, me fletë-hyrjen nr.90, datë 03.04.2015, me vlerë 7,412,460 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.162, datë 15.05.2015.2015 me vlerë 3,007,440.00 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.140, datë 24.04.2015, fletë-hyrjen nr.96, datë 24.04.2015, me vlerë 3,007,440 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.182, datë 05.06.2015 me vlerë 3,195,840.00 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.175, datë 15.05.2015, fletë-hyrjen nr.103, datë 15.05.2015, me vlerë 3,159,840 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.200, datë 16.06.2015 me vlerë 6,696,000.00 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.190, datë 21.05.2015, fletë-hyrjen nr.104, datë 21.05.2015, me vlerë 6,696,000 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.220, datë 03.07.2015 me vlerë 7,243,200 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.224, datë 03.06.2015, fletë-hyrjen nr.115, datë 03.06.2015, me vlerë 7,243,200 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudimit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Urdhër-shpenzimi nr.289, datë 24.08.2015 me vlerë 1,399,680 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.319, datë 12.08.2015, fletë-hyrjen datë 12.08.2015, me vlerë 1,399,680 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.371, datë 21.10.2015 me vlerë 4,737,840 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.368, datë 06.10.2015, fletë-hyrjen nr.181, datë 06.10.2015, me vlerë 4,737,840 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.437, datë 01.12.2015 me vlerë 3,928,752 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.393, datë 03.11.2015, fletë-hyrjen nr.212, datë 03.11.2015, me vlerë 3,928,752 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Urdhër-shpenzimi nr.502, datë 22.12.2015 me vlerë 2,582,448 lekë me tvsh për blerje materiale për hemodializën, është i shoqëruar me faturën nr.441, datë 22.12.2015, fletë-hyrjen nr.239, datë 22.12.2015, me vlerë 2,582,448 lekë me tvsh dhe me procesverbalin e marrjes në dorëzim, të firmosur nga komisioni i kolaudit, i cili ka zërat e paisjeve të konsumit të blera.

-Sa më sipër, konstatohet se tek asnjë nga procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të materialeve mjekësore, nuk specifikohet ose nuk citohet data e prodhimit të materialeve mjekësore. Duke mos ditur datën e prodhimit të këtyre materialeve, është e pamundur të verifikohet nëse plotësohet një nga kushtet kryesore të kontratës dhe pikërisht pika 8 e nenit 3 të kontratës së lidhur, kushtet e furnizimit ku citohet se: *“Data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës së mallit”*. Pra, materialet mjekësore të marra në dorëzim, nuk dihet nëse e plotësojnë këtë kusht të kontratës. Gjithsesi, edhe nga verifikimet në depon farmaceutike të Spitalit të Shkodrës, tek asnjë nga paketimet e materialeve mjekësore nuk u evidentua data e prodhimit të tyre. Në këto kushte, është e pamundur të gjykohet nëse materialet mjekësore janë brenda kushteve të kontratës.

**5.22 Procedura e prokurimit me objekt “Blerje paisje për kirurgjinë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Blerje paisje për kirurgjinë” ku rezultoi që:*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje paisje për kirurgjinë”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.23 datë 21.08.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> G.N.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> A.K.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.	E.H. A.D.	E. K. B.T.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,662,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>1,659,000 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>3000 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 10.09.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>FSDKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomik pjesëmarrës</b> <b>në tender: “F.” sh.p.k. “O.E.S DisT.”</b> <b>sh.p.k. “M.” sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së mallrave.</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>28.09.2015.</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,990,800 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.100, Prot të datës 10.09.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 3 operator ekonomik nga të cilët, janë skualifikuar dy prej tyre dhe është kualifikuar operatori ekonomik “M.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.1331, Prot-datë 24.06.2015, shefi i kirurgjisë, G.G., dërgon një kërkesë mbi nevojat e sallës së operacionit. Tek kjo kërkesë, citohen nevojat për materiale dhe konkretisht për paisjen e sallës së operacionit me sistemin Ligasure bashkë me aksesorët përkatës por dhe për autoklavën, kërkohet shërbim periodik dhe pjesë këmbimi.

-Me shkresën nr.1367, Prot-datë 30.06.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin nr.117, mbi ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje paisje për kirurgjinë”. Komisioni përbëhet nga R.K., A.M. dhe G.G.

-Me shkresën nr.1409, Prot-datë 03.07.2015, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, dërgon vlerën e fondit limit 1,662,000 lekë pa tvsh, tek drejtorja e SRSH-së.

-Sa më sipër, sipas pretendimeve të komisionit të përllogaritjes së fondit limit, fondi limit është nxjerrë nga studimi i tregut dhe nga vlera më e ulët. Nga auditimi i dosjes së prokurimit, nuk u konstatua asnjë dokumentacion zyrtar i protokolluar pranë SRSH-së, tek i cili të pasqyrohej mënyra e komunikimit të komisionit me tregun për të nxjerrë fondin limit. Nuk ka asnjë shkresë zyrtare, drejtuar INSTAT apo dhe ndonjë subjekti privat ose dhe ndonjë dokument ku të citohet të paktën se komisioni i është referuar kontratave të mëparshme të ngjashme, veprime këto, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 9, pika 1 dhe neni 59, pika 1 dhe pika 2.

-Me shkresën nr.1677, Prot-datë 21.08.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.23, për fillimin e procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga G.N., E.H. dhe A.D.

-Me shkresën nr.1678, Prot-datë 21.08.2015, titullari i SRSH, miraton njoftimin e kontratës.

-Me shkresën nr.94, Prot-datë 24.08.2015, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe në vazhdim, me shkresën nr.95, autorizohet nëpunësja G.N. për të krijuar dosjen elektronike.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Me shkresën nr.1703/1, Prot-datë 27.08.2015, R.K. dhe G.G. përkatësisht, tekniku i aparaturave dhe shefi i kirurgjisë, kërkojnë një ndryshim në DST dhe konkretisht përsa i përket specifikimeve teknike. Bazuar tek kjo shkresë, shtohen disa sqarime teknike të cilat e bëjnë më të qartë procedurën e prokurimit.
- Me shkresën nr.1714, Prot-datë 28.08.2015, Drejtori i SRSH, nxjerr urdhrin për pezullimin e vazhdimin të procedurës deri në momentin e ndryshimit në DST të specifikimeve.
- Me shkresën nr.1715, Prot-datë 28.08.2015, Drejtori i SRSH, miraton ndryshimet e kërkuara.
- Me shkresën nr.1748, Prot-datë 07.09.2015, drejtori i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga A.K., E. K. dhe B.T.
- Me shkresën nr.100, Prot-datë 10.09.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, kryen procesin e verifikimit të ofertave të ardhura dhe konstaton tre oferta duke kualifikuar vetëm ofertën e operatorit ekonomik “M.” sh.p.k.
- Me shkresën nr.1815, Prot-datë 18.09.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin përmbledhës së procedurës së prokurimit dhe propozon që të shpallet fitues operatorit ekonomik “M.” sh.p.k., me ofertën me vlerë 1,659,000 lekë pa tvsh.
- Me shkresën nr.1815/1, Prot-datë 18.09.2015, Titullari i SRSH-së, miraton formularin e njoftimit të fituesit dhe shpall fitues operatorin ekonomik “M.” sh.p.k., me ofertën me vlerë 1,659,000 lekë pa tvsh. Ky formular është publikuar në faqen e APP-së më 28.09.2015.
- Kontrata e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “M.” sh.p.k., mban datën 28.09.2015 dhe nr.Prot 1856. Afati i ekzekutimit është deri më 31.12.2015.
- Njoftimi i kontratës së nënshkruar me nr.1868, Prot-datë 29.09.2015, është publikuar në faqen e APP-së, më 05.10.2015.
- Sa më sipër, konstatohet se:
  - Tek kontrata e lidhur, neni 4, Specifikimet Teknike, pika 2, citohet : *“Kontraktuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike për një periudhë jo më pak se 1 vit nga furnizimi me këtë aparaturë”*. Tek procesverbali i njësisë së prokurimit mbi hartimin dhe miratimin e DST-së me nr.94, Prot-datë 24.08.2015, tek kapitulli 2.3, Kapaciteti Teknik, pika 7, citohet: *“Deklaratë për periudhën e garancisë së paisjes, gjatë .për një periudhë jo më pak se 2 vite nga instalimi i aparaturave”*. Tek DST-ja elektronike, konstatohet se tek faqja nr.29, Kapitulli 2, kriteret e veçanta të kualifikimit, nënkaptulli 2.3, kapaciteti teknik, pika 8 e faqes 30, citohet se : *“Deklaratë për periudhën e garancisë së paisjes, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike për një periudhë jo më pak se 2 vite nga instalimi i aparaturave”*.
  - Si rrjedhojë, Drejtori i SRSH-së, zj.Dh.U., ka lidhur një kontratë me operatorin ekonomik “M.” sh.p.k., duke devijuar kushtet e saj dhe duke ulur periudhën e garancisë së mirëmbajtjes së shërbimit nga 2 vite që ishte e parashikuar edhe tek specifikimet teknike nga njësia e prokurimit por edhe tek DST-ja elektronike, në 1 vit pra në favor të operatorit ekonomik

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

dhe jo në favor të institucionit që përfaqëson. Veprimet e mësipërme, nuk janë aspak në interesin ekonomik të SRSH, pasi në rast defekti, do të duhet të prokurohet për mirëmbajtjen e paisjeve pas 1 viti kur në fakt mund të prokurohej pas 2 vitesh.

-Sa më sipër, për këto veprime, mban përgjegjësi drejtori i SRSH-së, zj.Dh.U.

**Zbatimi i kontratës:**

-Urdhër-shpenzimi nr.389, datë 03.11.2015 me vlerë 1,990,800 lekë, për blerje paisje për kirurgjinë, shoqëruar me faturën nr.8109, datë 23.10.2015 dhe me fletë-hyrjen nr.16, datë 23.10.2015, vërteton se furnizimi është bërë brenda afateve ligjore.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u konstatua asnjë manual ose të paktën fotokopje të manualit të përdorimit për gjeneratorin. Nuk u konstatua asnjë relacion mbi kontrollin që duhej të ushtrohej për të verifikuar përputhjen e paisjes ose të pjesëve të saj me ato që kërkohen në dokumentacionin teknik. Nuk është cituar nëse është kontrolluar shenja CE pra nëse paisja plotëson standardet e zbatuara dhe qëllimin e përdorimit. Nuk citohet nëse është verifikuar se manuali i përdorimit është në gjuhën shqipe dhe konform specifikimeve të paisjes. Nuk është cituar nëse dokumentacioni teknik është i përshtatshëm. Nuk është verifikuar nëse etiketimi është bërë në përputhje me standardet përkatëse dhe në mënyrë të përshtatshme. Grupi i marrjes në dorëzim, nuk ka kryer ndonjë kontroll për sigurinë e paisjes si elektriciteti ose rrjedhje të ndryshme gazi, etj. Nuk është kryer regjistrim në sistemin e informacionit të paisjeve mjekësore pasi nuk është specifikuar etiketa e inventarit të paisjes mjekësore. Raporti i testimit të paisjes, nuk citon se është kryer ndonjë kontroll funksionimi duke përshkruar dhe parametrat e paisjes. Nuk është cituar nëse janë kryer trajnimet e mundshme për përdorimin e paisjes. Nuk ka ndonjë të dhënë nëse janë planifikuar pjesët e ndërrimit apo edhe mirëmbajtja parandaluese.

-Sa më sipër, Sektori i Inxhinierisë Klinike të SRSH, ka vepruar në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007, të Ministrisë të Shëndetësisë mbi Politikat e menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore dhe konkretisht në kundërshtim me pikën 2.2.5, në kundërshtim me pikën 3.1.4, strategjitë, në kundërshtim me pikën 3.4.2, testet e pranimit dhe në kundërshtim me pikën 3.4.4, regjistrimi i pajisjeve mjekësore.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:*

*Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 1577, Prot-datë 04.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së, dhe me nr.40/3, Prot-datë 07.05.2018, protokolluar pranë KLSH-së nga z.G.G. sipas shkresës me nr.1754, Prot-datë 16.05.2018, protokolluar pranë SRSH-së.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

*-z.G., të gjitha pretendimet e ngritura nga ana juaj, janë pretendime verbale pra të pabazuara me dokumentacion mbështetës. Pretendoni thjesht se keni qenë prezent dhe keni asistuar gjatë gjithë kohës për riparimin e pajisjeve mjekësore dhe nuk keni sjellë asnjë dokument i cili të vërtetojë këtë pretendim. Gjithsesi, është paradoksal fakti që ju personalisht nuk*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*prekeni tek akti i mbajtur dhe njëkohësisht dërgoni observacion për shkelje që i përkasin sektorit të inxhinierisë klinike dhe jo repartit të kirurgjisë.*

Sa më lart, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

-Lidhur me observacionin e zj.A.B. me nr.1753/1, Prot-datë 16.05.2018, ku pretendon se ka qenë me leje lindjeje dhe se nuk ka asnjë lidhje me këtë procedurë, sqarojmë si vijon:

-Observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë.

**5.23 Procedura e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

Objekti i këtij akt verifikimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”, ku rezultoi që:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Evadim i mbeturinave spitalore”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.20 datë 02.03.2016	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H. P.N. A.B.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> A.M. B.B. K.M.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>1,082,600 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>1,042,710 lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>39.890 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 27.03.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>FSDKSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomike pjesëmarrës në tender: R-94. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së shërbimit</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>24.03.2016.</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,251,252 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.17, Prot të datës 15.03.2016 mbajtur nga KVO e SRSH, ka tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 1 operator ekonomik i cili, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO, ka paraqitur ofertën ekonomike sipas preventivit të kërkuar për konkurim.

-Me shkresën pa numër protokollit dhe pa datë, A.D., dërgon një kërkesë drejtpërdrejt drejtorisë së spitalit Shkodër për evadimin e mbetjeve urbane ku citon sasinë e mbetjeve.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.274, Prot-datë 23.02.2016, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin nr.12, mbi ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore”. Komisioni përbëhet nga A.D., D.M. dhe B.H.

-Me shkresën nr.295, Prot-datë 26.02.2016, komisioni i përllogaritjes së fondit limit, dërgon vlerën e fondit limit 1,082,600 lekë pa tvsh, tek drejtorja e SRSH-së.

-Me shkresën nr.339, Prot-datë 02.03.2016, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit me nr.20, për fillimin e procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm dhe cakton njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., P.N. dhe A.B.

-Me shkresën nr.340, Prot-datë 02.03.2016, titullari i SRSH, miraton njoftimin e kontratës, publikuar në APP më 07.03.2016.

-Me shkresën nr.10, Prot-datë 02.03.2016, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe në vazhdim, me shkresën nr.11, autorizohet nëpunësja Xh.H. për të krijuar dosjen elektronike.

-Me shkresën nr.408, Prot-datë 11.03.2016, drejtori i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave, të përbërë nga A.M., B.B. dhe K.M.

-Me shkresën nr.17, Prot-datë 15.03.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave, kryen procesin e verifikimit të ofertave të ardhura dhe konstaton një ofertë nga operatori ekonomik “R-94.”.

-Me shkresën nr.444, Prot-datë 21.03.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban procesverbalin përmbledhës së procedurës së prokurimit dhe propozon që të shpallet fitues operatori ekonomik i vetëm “R-94.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.526, Prot-datë 23.03.2016, Titullari i SRSH-së, miraton formularin e njoftimit të fituesit dhe shpall fitues operatorin ekonomik “R-94.” sh.p.k., me ofertën me vlerë 1,251,252 lekë me tvsh. Ky formular është publikuar në faqen e APP-së më 29.03.2016.

-Kontrata e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “R-94.” sh.p.k, mban datën 24.03.2016 dhe nr.Prot 539. Afati i ekzekutimit është deri në fund të vitit 2016 ose 282 ditë.

**Zbatimi i kontratës:**

-Gjatë zbatimit të kontratës, janë mbajtur akt-rakordimet për çdo pagesë vlerat e të cilave me tvsh, jepen më poshtë:

-Urdhër-shpenzimi nr.112 datë 19.04.2016 me vlerë 31.824 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.13, datë 31.03.2016.

-Urdhër-shpenzimi nr.157 datë 25.05.2016 me vlerë 119,340 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.16, datë 30.04.2016.

-Urdhër-shpenzimi nr.185 datë 14.06.2016 me vlerë 123,318 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.21, datë 31.05.2016.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Urdhër-shpenzimi nr.241 datë 21.07.2016 me vlerë 119,340 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.29, datë 30.06.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.288 datë 23.08.2016 me vlerë 123,318 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.33, datë 31.07.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.326 datë 20.09.2016 me vlerë 123,318 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.40, datë 31.08.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.362 datë 12.10.2016 me vlerë 119,340 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.45, datë 30.09.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.420 datë 23.11.2016 me vlerë 123,318 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.52, datë 31.10.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.464 datë 13.12.2016 me vlerë 119,340 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.60, datë 30.11.2016.
- Urdhër-shpenzimi nr.510 datë 29.12.2016 me vlerë 214,686 lekë, për evadim mbeturinash shoqëruar me faturën nr.73, datë 25.12.2016.
- Sa më sipër, konstatohet se operatori ekonomik “R-94.” sh.p.k., është likuiduar në vlerën e 1,217,142 lekë dhe jo në vlerën e kontratës së lidhur pra 1,251,252 lekë.

**6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.**

**6.1 Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje karburant për automjete”.**

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me objekt “Blerje karburanti për automjetet” rezultoi si më poshtë vijon:**

Tenderi me objekt “Blerje karburant për automjete 2017” është zhvilluar në Ministrinë e Brendshme. Auditimi u krye vetëm për lidhjen dhe zbatimin e kontratës, lëvrinim e karburantit pranë spitalit rajonal dhe likuidimin e operatorit ekonomik “K.” nga autoriteti kontraktor. Kontrata është lidhur mbi bazën e procedurës së prokurimit të përqendruar realizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me Urdhër Prokurimi Nr. 09 prot, datë 23.03.2017, me objekt “Furnizime me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”.

***Lidhja e kontratës dhe zbatimi.***

Është hartuar kontrata nr. 1586/1 prot, datë 04.07.2017 me vlerën e kontratës **17,499,919 lekë me TVSH** për Gazoil D1, nga BOE “K.” sh.p.k përfaqësuar nga administratori Z. Sh. K. dhe “K.” sh.a përfaqësuar nga Z. G.K. dhe Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga Z. P.Ç., në cilësinë e titullarit të SRSH. BOE është përfaqësuar nga OE “K.” sh.p.k me NIPT J6181329P. Nënshkrimi i kontratës është bërë me datë 08.07.2017. Afati i kësaj kontrate është nga data e lidhjes deri me datë 31.12.2019.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Shoqëria “K.” sh.p.k ka lëvruar sasinë prej 27,150 litra gjithsej (6000 +21150) Gazoil (10ppm) me çmimin 174.53 lekë për sasinë 6000 litër dhe çmimin 160.36 lekë për sasinë 21150 litër. Paraqitja tabelore jepet sipas tabelës nr. 1.

Sipas nenit 2 të kontratës, lëvrimi do të realizohet si vijon:

Për vitin 2017, në shumën 4,999,999 lekë me TVSH.

Për vitin 2018, në shumën 6,000,000 lekë me TVSH.

Për vitin 2019, në shumën 6,499,920 lekë me TVSH.

Nr.	Datat	Karburanti	Nr. Fletë Hyrje	Faturë tatimore	Nr. Urdhër shpenzimi	Sasia (Litër)	Çmimi me tvsh (lekë/litër)	Vlera (Lekë)
1	10.07.2017	Gazoil D1	6	86	328 18.07.2017	5,000	161.41	807,050
2	04.08.2017	Gazoil D1	7	05	378 09.08.2017	6,000	161.38	968,280
3	05.10.2017		8	94	490 09.10.2017	5,000	171.21	856,050
4	31.10.2017		9	61	527 06.11.2017	6,000	169.68	1,018,080
5	12.12.2017		10	76	605 22.12.2017	783	172.36	1,350,440. 6
<b>Shuma me t.v.sh</b>								<b>4,999,900</b>

**6.2 Mbi zbatimin e procedurave në zbatimin e kontratave me objekt “Blerje lëndë djegëse”, rezultoi si më poshtë vijon:**

Tenderi me objekt Lot II “ Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial” (Solar) është zhvilluar në Ministrinë e Brendshme. Auditimi u krye vetëm për zbatimin e kontratës, lëvrimin e solarit pranë spitalit rajonal dhe likuidimin e operatorit ekonomik “R-E.” nga autoriteti kontraktor. Kontrata është lidhur mbi bazën e procedurës së prokurimit të përqendruar realizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me Urdhër Prokurimi Nr. 09 prot, datë 23.03.2017, me objekt Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial” (Solar).

***Lidhja e kontratës dhe zbatimi.***

Është hartuar kontrata nr. 1954 prot, datë 28.08.2017 me vlerën e kontratës **13,499,919.6 lekë me TVSH** për Lëndë djegëse Solar, nga OE “R-E.” sh.p.k përfaqësuar nga administratori Z. E.R. dhe Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Shkodër, përfaqësuar nga Z. P.Ç., në cilësinë e titullarit të SRSH. Nënshkrimi i kontratës është bërë me datë 08.07.2017. Afati i kësaj kontrate është nga data e lidhjes deri me datë 31.12.2019.

Shoqëria “K.” sh.p.k ka lëvruar sasinë prej 27,150 litra gjithsej (6000 +21150) Gazoil (10ppm) me çmimin 174.53 lekë për sasinë 6000 litër dhe çmimin 160.36 lekë për sasinë 21150 litër. Paraqitja tabelore jepet sipas tabelës nr. 1.

Sipas nenit 2 të kontratës, lëvrimi është realizohet si vijon:

Për vitin 2017, në shumën 3,999,999.6 lekë me TVSH.

Për vitin 2018, në shumën 4,500,000 lekë me TVSH.

Për vitin 2019, në shumën 4,999,920 lekë me TVSH.

Nr.	Datat	Karburanti	Nr. Fletë Hyrje	Faturë tatimore	Nr. Urdhër shpenzimi	Sasia (kg)	Çmimi me tvsh (lekë/litër)	Vlera (Lekë me TVSH)
1	16.11.2017	Solar	1	737	599 0.12.2017	12,880	110,93	1,428,817
2	21.12.2017	Solar	2	744	599 0.12.2017	3,460	108.014	373,728
3	20.12.2017	Solar	3	786	623 27.12.2017	7,040	106.79	751,802
4	28.12.2017	Solar	4	804	643 28.12.2017	13360	108.161	1,445,031
<b>Shuma me t.v.sh</b>								<b>3,999,378</b>

Marrja në dorëzim e lëndës djegëse solar është bërë me procesverbal bazuar në urdhrin e titullarit për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit.

### **6.3 Kontrata me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër”**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi:

#### **a. Mbi nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e grafikut të punimeve.**

Kontrata e sipërmarrjes me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër” është lidhur me datë 21.11.2016 dhe nr. prot. 2826, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe nga Kontraktuesi shoqëria “Gj.” shpk, përfaqësuar nga administratori z. M. Gj. Vlera e kontratës është 27,372,487 lekë pa TVSH ose **32,846,985 lekë me TVSH**. Sigurimi i kontratës në masën 10 % është bërë me datë 01.11.2017 në Kompaninë “A.” sh.a.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Afati maksimal i realizimit të punimeve do të jetë 4(katër) muaj kalendarik nga data e lidhjes së kontratës (21.03.2017).

- Për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër” është lidhur kontratë mbikëqyrje me datë 21.11.2016 dhe nr. prot. 2827 midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Operatorit Ekonomik “D.” sh.p.k me NIPT L52013020H, përfaqësuar nga z. V.T dhe me vlerë 57,600 lekë me TVSH. Për përcaktimin e OE fitues për mbikëqyrjen e punimeve është zhvilluar tender me prokurim me vlerë të vogël sipas urdhrimit të prokurimit me nr. 85, datë 03.11.2016 dhe nr. prot. 2656. Bazuar në nenin 3 të kësaj kontrate afati fillon nga data e lidhjes së kontratës e deri në përfundimin e punimeve në objekt (data e përfundimit të punimeve e deklaruar nga mbikëqyrësi është 21.03.2017). Konstatohet se për shtesën e kontratës nuk është rinovuar kontrata për mbikëqyrjen e punimeve.

- Operatori Ekonomik “Gj.” sh.p.k. me shkresën nr. prot. 2503, data 24.11.2017 i drejtohet mbikëqyrësit të punimeve shoqërisë “D.” sh.p.k. dhe për dijeni AK me kërkesë për shtesë kontrate.

- Mbikëqyrësi i punimeve “D.” sh.p.k. me shkresën nr. prot. 2503/1, data 24.11.2017 (theksojmë se në këtë shkresë nuk është përcaktuar viti) i drejtohet Spitalit Rajonal Shkodër dhe për dijeni autoritetit kontraktor për shtesë kontrate. Vlera e kontratës 6,456,354 lekë me TVSH.

- Kontrata shtesë mbi ri K.in e ambienteve të reaminacionit të spitalit Shkodër, është lidhur me datë 04.12.2017 (Nr. prot. 2556) midis Spitalit Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe shoqërisë “GJ.” sh.p.k., përfaqësuar nga z. F. Gj. me vlerë 6,456,354 lekë me TVSH. Afati maksimal i realizimit të punimeve është 1 (një) muaj kalendarik nga data e lidhjes së kontratës (03.01.2018), sipas nenit 3 të kontratës. Kontrata shtesë është lidhur sipas urdhrimit të prokurimit me nr. prot. 2505, datë 24.11.2017. Kërkesa për shtesë kontrate është bërë me datë 24.11.2017. sipas urdhrimit të prokurimit, vonesa e lidhjes së kontratës shtesë justifikohet në zbatim të VKM Nr. 482, datë 05.07.2017 për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017.

- Dokumentet si: Projekt-preventivi zbatimimi për ri K.in e ambienteve të repartit të Reaminacionit; specifikimet teknike; relacioni teknik; preventivi; analiza çmimi janë hartuar nga shoqëria projektuese “T.” sh.p.k. me përfaqësues znj. D.Q.

- Me datë 21.11.2016 është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit të objektit.

- Me datë 21.11.2016 është hartuar procesverbal mbi fillimin e punimeve si dhe akti i piketimit të ndërtimit të objektit “Ri K.i i ambienteve të repartit të Reaminacionit të Spitalit Shkodër”.

**Sa më sipër konstatojmë se:**

1. Akti i piketimit nuk është nënshkruar nga Projektuesi i projektit, veprim ky në kundërshtim me udhëzim nr. 1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të këshillit të ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

2. Kopja e aktit të piketimit për investitorin është e pa protokolluar në SR Shkodër. Pra komunikimi nuk është bërë në mënyrë zyrtare, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

- Më datë 19.01.2017 mbikëqyrësi i punimeve “D.” sh.p.k i kërkon Autoritetit Kontraktor miratimin e Preventivit të ripunuar për objektin “Ri K.i i ambienteve të repartit të Reaminacionit të Spitalit Shkodër” pasi ka lindur e nevojshme përdorimi i fondit rezervë 5%.

- Më datë 30.01.2017, Titullari i AK miraton procesverbalin për miratim të ndryshimit të volumeve; ku vlera e punimeve që zbriten është 2,421,125 lekë pa TVSH dhe vlera e punimeve që shtohen është 2,349,306.5 lekë pa TVSH. Pas ndryshimeve, vlera e preventivit të ndryshuar është 32,846,598 lekë me TVSH dhe vlera e fondit rezervë bëhet zero.

- Ditari i objektit pasqyron proceset e punëve të kryera që i përkasin periudhës 21.11.2016 deri më datë 21.03.2017 si dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve dhe nga mbikëqyrësi i punimeve.

- Nga sipërmarrësi i punimeve dhe nga mbikëqyrësi i punimeve është plotësuar Libreza e masave, por konstatojmë se librezat nuk është e shoqëruar me skicat dhe vizatimet përkatëse.

- Janë mbajtur 45 procesverbale për punime të maskuara dhe 11 akte kontrolli. Konstatojmë se aktet e kontrollit nuk janë nënshkruar Drejtuesi teknik i shoqërisë zbatuese si dhe nga investitori, veprim ky në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- Sipërmarrësi i punimeve “Gj.” sh.p.k përfaqësuar nga z. F. Gj., me datë 21.03.2017 njofton mbikëqyrësin e punimeve dhe Drejtorinë e Spitalit Rajonal Shkodër për përfundimin e punimeve.

- Mbikëqyrësi i punimeve “D.” sh.p.k përfaqësuar nga z. V.T, me datë 21.03.2017 njofton Drejtorinë e Spitalit Rajonal Shkodër për përfundimin e punimeve.

Sa më sipër konstatojmë se, shkresa e sipërmarrësit të punimeve “Gj.” sh.p.k dhe e mbikëqyrësit të punimeve për përfundimin e punimeve, është e pa protokolluar në SR Shkodër. Pra komunikimi nuk është bërë në mënyrë zyrtare, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

- Kopja e procesverbalit për përfundimin e punimeve drejtuar investitorit “Spitalit Rajonal Shkodër” rezulton të jetë e pa protokolluar në SRSB dhe si pasojë komunikimi nuk është bërë në rrugë zyrtare, veprim ky në kundërshtim me kushtet e kontratës.

- Mbikëqyrësi i punimeve “D.” sh.p.k në përfundimin e punimeve me datë 21.03.2017 ka hartuar Relacionin përfundimtar mbi zbatimin e punimeve, sipas projektit të zbatimit, KTZ në fuqi dhe grafikut të punimeve.

- Sipërmarrësi i punimeve “Gj.” sh.p.k në përfundimin e punimeve ka hartuar Deklaratën e Sipërmarrësit, i cili mban përgjegjësi për sa deklorohet nëse shfaqen defekte. Konstatohet se kopja për investitorin, është e pa protokolluar në SR Shkodër. Pra komunikimi nuk është bërë në mënyrë zyrtare, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Për kolaudimin e punimeve të objektit “Ri K. i ambienteve të repartit të Reaminacionit të Spitalit Rajonal Shkodër” me datë 25.07.2017 dhe nr. prot. 1732 është lidhur kontrata ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, i përfaqësuar nga Drejtori z. P.Ç. dhe Operatorit Ekonomik “P.C.” sh.p.k përfaqësuar nga znj. V.G., me vlerë 11,760 lekë me TVSH. Afati i kësaj kontrate fillon nga data e lidhjes së kontratës e deri me datën 01.08.2017. Kontrata për kolaudimin e punimeve, është bazuar në urdhrin e prokurimit sipas procedurës “Prokurim me Vlerë të Vogël” me nr. prot. 1620, datë 10.07.2017, me objekt “Kolaudim punimesh ndërtimi” i ri K.it të ambienteve të Reaminacionit të Spitalit Rajonal Shkodër me fond limit 23,447 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nuk është rinovuar kontrata me OE “P.C.” sh.p.k.

Nga Kolaudatori “P.C.” sh.p.k është mbajtur procesverbali i kolaudit të objektit “Ri K. i ambienteve të repartit të Reaminacionit të Spitalit Rajonal Shkodër”. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga verifikimi i librit të protokollit të spitalit rajonal Shkodër, rezulton se Procesverbali i i Kolaudit Tekniko-Ekonomik, nuk është i protokolluar. Në procesverbalin e kolaudit nuk ka, numër protokollit, si dhe datën e mbajtjes së procesverbalit, nuk ka datën e fillimit dhe të mbarimit të kolaudit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, me Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Për shërbimin e kolaudit nga Autoriteti Kontraktor është bërë likuidimi në vlerën 11,760 lekë me TVSH, sipas Faturës Tatimore me nr. 16, datë 31.07.2017 dhe Urdhër Shpenzimit me nr. 399, datë 16.08.2017.

Nga auditimi i Libri të protokollit, u konstatua se me datë 31.07.2017 dhe nr. prot. 1803 është mbajtur certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve të objektit i nënshkruar nga kontraktuesi “Gj.” sh.p.k, nga mbikëqyrësi i punimeve “D.” sh.p.k, nga kolaudatori shoqëria “P.C.” sh.p.k dhe nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

**b. Nga auditimi mbi likuidimet rezulton.**

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se punimet e projektit të kontratës bazë janë likuiduar me 3(tre) situacione në vlerën 32,846,598 lekë me TVSH ose në masën 99.999 % dhe për punimet e shtesës së kontratës janë likuiduar me 1(një) situacion në vlerën 6,456,354 lekë me TVSH ose në masën 100 %, të detajuara si më poshtë vijon:

Situacioni nr. 1.

Urdhër shpenzimi nr. 483, datë 22.12.2016 me vlerë 14,222,078 lekë me TVSH (ku është mbajtur 5% me USH nr. 484 në shumën 748530 lekë).

Situacioni nr. 2.

Urdhër shërbimi nr. 152, datë 02.05.2017 me vlerë 12,091,585 lekë me TVSH (ku është mbajtur 5% me USH nr. 153 në shumën 636399 lekë).

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Situacioni nr. 3 dhe përfundimtar për kontratën bazë.

Urdhër shpenzimi nr. 369, datë 04.08.2017 me vlerë 4,890,605 lekë me TVSH (ku është mbajtur 5% me USH nr. 368 në shumën 257,401 lekë).

Situacioni për kontratën shtesë.

Urdhër shpenzimi nr. 638, datë 28.12.2017 me vlerë 6.133.537 lekë me TVSH (ku është mbajtur 5% me USH nr. 639 në shumën 322,817 lekë).

**c. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren mbi verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se pajisjet e kondicionim/ventilim për reaminacionin dhe konkretisht: Ciller (Pompë nxehtësie) me gjithë kitin hidraulik Ft 80 kË/Ng 90kË dhe AHU (Transportuesi i ajrit me kapacitet 7600 m<sup>3</sup>/orë presioni i punës 400 Pa me lagështues me avull) nuk punojnë me kapacitet të plotë sidomos në kohën me temperatura të ulta.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se **pajisjet janë llogaritur me TVSH**, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve.

Kjo lloj strukture e preventiv – ofertës dhe situacionit përfundimtar në këtë formë bie ndesh me legjislacionin në fuqi, konkretisht me:

i) UKM Nr. 2, datë 08.05.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparatat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se: “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparatat”;

ii) VKM Nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, ku përcaktohet se: “Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave, .”.

iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit, ku përcaktohet se: “Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet. Pra nuk ka më TVSH për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSH-së. Po

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

me këtë udhëzim është miratuar edhe paraqitja e zërave të punimeve dhe pajisjeve në miratimin e strukturës së situacionit që paraqitet për likuidim.

- Për kontratën bazë, si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSH-së janë likuiduar tepër në vlerën 1,887,620 lekë [9,438,100 x 20 % TVSH-ja], dhe

- Për kontratën shtesë, si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSH-së janë likuiduar tepër në vlerën 446,280 lekë [2,231,400 x 20 % TVSH-ja].

Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 2,333,900 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë dhe shtesën e kontratës, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. *Grupi i auditimit arrin në përfundimin se:*

- Vlera 2,333,900 lekë është shkelje financiare me dëm efektiv ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal Shkodër dhe duhet të zhdëmtohet nga shoqëria “Gj.” SHPK.

Sa më sipër janë në papajtueshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, dhe nenin 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve.

- Kontrata e sipërmarrjes me nr. prot. 2826, datë 21.1.2016 midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër dhe Kontraktorit “Gj.” sh.p.k, nuk është e plotësuar me shtojcën 18 (Kushtet e veçanta) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Juristi i Njësisë së Prokurimit dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Ngritja e grupit të kolaudimit për kontratën bazë është bërë rreth 4 (katër) muaj me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit. bëhet brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit. Theksojmë se punimet e ndërtimit kanë përfunduar me date 21.03.2017 dhe kjo është deklaruar nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “Gj.” sh.p.k dhe nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “D.” sh.p.k.

#### **6.4 Kontrata me objekt “Furnizim Vendorsje e një aparature Rezonance për Spitalin Rajonal Shkodër”**

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me objekt “Furnizim Vendorsje e një aparature Rezonance për Spitalin Rajonal Shkodër” rezultoi si më poshtë vijon:

Bazuar në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” nga Ministria e Shëndetësisë është zhvilluar tenderi me objekt: “Furnizim dhe Vendorsje e një aparature Rezonance për Spitalin Rajonal Shkodër”. Vlera e Fondit Limit 83,333,333 lekë pa TVSH. Vlera e kontratës **95,520,000 lekë me TVSH**. Burimi i financimit, buxheti i shtetit.

Kontrata është lidhur me datë 04.11.2015 midis Spitalit Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga **znj. Dh. U.** dhe shoqërisë “M.” sh.p.k me objekt “**Furnizim Vendorsje e një aparature Rezonance për Spitalin Rajonal Shkodër**”.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Afati i lëvrimet, 20.12.2016. garancia e punimeve sipas nenit 7 të kontratës, është 1 (një) vit ku përfshihen të gjithë defektet e mundshme, duke filluar nga data e instalimit.

Bashkëlidhur kontratës janë:

- Ankes kontrate me ofertën ekonomike.
- Formularin e sigurimit të kontratës në masën 10 %, kryer tek kompania S.U.G.A.

Likuidimi:

Me USH nr. 486, datë 21.12.2016 është bërë likuidimi në vlerën 90,744,000 lekë me TVSH.

Me USH nr. 487, datë 21.12.2016 është bërë likuidimi i 5% në vlerën 4,776,000 lekë me TVSH.

Më datë 17.12.2015 (nr. prot. 2374) Titullari i AK, ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 170, datë 17.12.2015, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim sipas kontratës me nr. 2132 prot, datë 04.11.2015.

Më datë 17.12.2015, shoqëria “M.” sh.p.k., ka lëshuar fletë garanci për 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim.

Më datë 17.12.2015, komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim sipas kontratës nr, prot, 2132, datë 04.11.2015

Grupi i auditimit, pasi verifikoi procedurën e ndjekur bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, konstaton si më poshtë vijon:

Kontrata e shërbimit me nr. prot. 2132, datë 04.11.2015 midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga znj. Dh.U. dhe shoqërisë “M.” sh.p.k, përfaqësuar nga z. Sh.V. nuk është e plotësuar me shtojcën 17 (Kushtet e veçanta) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit.

Specifikimet teknike nuk janë plotësuar në shtojcën 10 të DST, por janë përfshirë në kushtet e kontratës, neni 5. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. Dh.U. dhe Juristi znj. Xh.H.

#### **6.5 Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips”.**

Mbështetur në shkresën e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 4351/ prot, datë **20.08.2014**, Drejtorja e SRSH, ka marrë dokumentacionin për lidhje kontrate me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me Fond Limit 161,707,824 lekë pa TVSH, parashikuar për 24 muaj (vitet 2014 – 2015 – 2016). Në përfundim të kësaj procedure është dërguar dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratës me OE “**S M**” sh.p.k të shpallur fitues.

- Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner (Për Spitalin Rajonal Shkodër) e prodhuesit Philips/16sl” është lidhur me datë 15.09.2014 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. **T.M.** dhe Operatorit Ekonomik “**S M**” sh.p.k përfaqësuar nga z. **R.C.** Vlera e kontratës është **12,299,880 lekë me TVSH**. Sigurimi i kontratës në masën 10% është bërë me datë 05.09.2014 në Kompaninë S.U.G.A.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**Afati i realizimit është 24 muaj** (vitet 2014-2015-2016). Shërbimet objekt i kësaj kontrate do të jenë në përputhje me planin e mirëmbajtjes Aneksi nr. 2 të kontratës dhe përfshijnë:

1. Shërbimet e Mirëmbajtjes parandaluese;
2. Shërbimet e Mirëmbajtjes korigjuese;
3. Shërbimet e Kalibrimit;
4. Shërbimet e Testimit periodik të sigurisë elektrike dhe mekanike;
5. Zëvendësimin e pjesëve përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit (Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë 12 muaj) pas datës së vendosjes së saj në pajisjet përkatëse.

Likuidimet për shërbimet objekt të kësaj kontratë paraqiten në rregull dhe janë realizuar brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

***Nga verifikimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës rezulton që:***

1. Kontrata e shërbimit me nr. prot. 1766, datë 15.09.2014 midis Autoritetit Kontraktor SRSB, përfaqësuar nga Z. T.M. dhe shoqërisë “S M” sh.p.k, nuk është e plotësuar me shtojcën 20 (Kushtet e veçanta) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Në rast se ka mospërputhje midis kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK) dhe kushteve të veçanta të kontratës (KVK) do të mbizotërojnë kushtet e veçanta të kontratës. Sa më sipër ngarkohet me për Juristen konceptuese të kontratës **znj. N.A.J.** dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor **z. T.M.**
2. Referuar faturës tatimore, procesverbaleve si dhe urdhër shpenzimeve , janë kryer 12 muaj shërbime në vlerën **12,299,880 lekë me TVSH**. Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se, *nuk është kryer asnjë njoftim i defekteve nga Autoriteti Kontraktor në rrugë elektronike (me e-mail)*, në kundërshtim me nenin 6, ku citon “. Njoftimi për defektet do të kryhet rrugë elektronike” dhe ***“Kontraktuesi do të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje”*** të kontratës së nënshkruar.
3. Sipas nenit 9 (Detyrimet e Autoritetit Kontraktor) të kontratës së nënshkruar është cituar se: Pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra , pas zëvendësimit me të reja, do t’i kthehen Kontraktuesit. Grupi i auditimit konstaton se citimi i mësipërm nuk është parashikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në kushtet e hartimit të kontratës, neni 9, paragrafi 4 është favorizuar operatorin ekonomik. Ky veprim është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik (DST), dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit dhe Titullarin e AK.

Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka autorizuar një person i cili ka si detyrë, Ndjekjen e realizimit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me Nenin 5 (Personi i autorizuar) të kontratës së nënshkruar nga dy palët dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Komente dhe shpjegime të subjektit:* Mbi observacionin e bërë nga ish drejtori i SR Shkodër z. T.M. me datë 08.05.2018 në lidhje me mirëmbajtjen e pajisjes skaner sipas akt konstatimit nr. 11, datë 30.03.2018 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në observacionin e paraqitur thuhet:” . Se kjo ka qenë një procedurë e kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga ana jonë është bërë lidhja e kontratës duke u nënshkruar në të gjitha komponentët e saj me pretendimin se është zbatuar ligji në realizimin e kësaj procedure .”.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes këtë observacion sqaron se: 4 (katër) problematikat e konstatuara nuk janë zbatuar nga ana Juaj si titullarë i spitalit. Pra kontrata nuk është e plotësuar me shtojcën 20; nuk ka dokumentacion ku të vertëtohet se është kryer njoftimi i defekteve nga Autoriteti Kontraktor në rrugë elektronike; pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra, pas zëvendësimit me të reja do ti ktheheshin Autoritetit Kontraktor dhe jo ti merrte OE “S.M.” sepse kjo nuk është përcaktuar në DST. Pra në kontratë sipas nenit 9, është trajtuar ndryshe nga DST. Për sa më sipër nga ana juaj nuk janë paraqitur argumente dhe prova që vërtetojnë të kundërtën. Observacioni nuk merret në konsideratë.

#### **6.6 Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips”.**

Mbështetur në shkresën e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 631/6 prot, datë **23.03.2017**, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, ka marrë dokumentacionin për lidhje kontrate me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me Fond Limit 188,846,802 lekë pa TVSH, parashikuar për 24 muaj për vitet 2017-2018-2019. Në përfundim të kësaj procedure është dërguar dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratës me BOE “S.M.” sh.p.k & “H&L. ” sh.p.k të shpallur fitues.

- Kontrata me objekt “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner (Për Spitalin Rajonal Shkodër) e prodhuesit Philips/16sl” është lidhur me datë 31.03.2017 dhe nr. prot. 895, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSB, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik “S.M.” sh.p.k dhe “H&L. ” sh.p.k përfaqësuar me prokurë të posaçme nga OE “S.M.” sh.p.k përfaqësuar nga z. R.Ç. Vlera e kontratës është 12,241,200 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10% është bërë me datë 31.03.2017 në Kompaninë S.U.G.A. Data e hyrjes në fuqi e kontratës është data 01.04.2017.

Afati i realizimit është 24 muaj(vitet 2017-2018-2019). Shërbimet objekt i kësaj kontrate do të jenë në përputhje me planin e mirëmbajtjes Aneksi nr. 2 të kontratës dhe përfshijnë:

1. Shërbimet e Mirëmbajtjes parandaluese;
2. Shërbimet e Mirëmbajtjes korigjuese;
3. Shërbimet e Kalibrimit;
4. Shërbimet e Testimit periodik të sigurisë elektrike dhe mekanike;

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

5. Zëvendësimin e pjesëve përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit (Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë 12 muaj) pas datës së vendosjes së saj në pajisjet përkatëse.

Likuidimet për shërbimet objekt të kësaj kontratë janë bërë në rregull dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë: *Nga verifikimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës rezultojnë që:*

1. Kontrata e shërbimit me nr. prot. 895, datë 31.03.2017 midis Autoritetit Kontraktor SRSB, përfaqësuar nga Z. P.Ç. dhe dhe Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik “S.M.” sh.p.k dhe “H&L. ” sh.p.k përfaqësuar me prokurë të posaçme nga OE “S.M.” sh.p.k përfaqësuar nga z. R.Ç., nuk është e plotësuar me shtojcën 17 (Kushtet e veçanta të kontratës) veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Juristja znj. Xh.H. si konceptuese e kontratës dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P.Ç.
2. Referuar faturës tatimore, procesverbaleve si dhe urdhër shpenzimeve , janë kryer 12 muaj shërbime në vlerën 12,241,200 lekë me TVSH. Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion rezultojnë se, *nuk është kryer asnjë njoftim i defekteve nga Autoriteti Kontraktor në rrugë elektronike (me e-mail), në kundërshtim me kontratën, ku citon “ Njoftimi për defektet do të kryhet rrugë elektronike” dhe “Kontraktuesi do të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje” të kontratës së nënshkruar.*
3. Sipas nenit 11 (Detyrimet e Autoritetit Kontraktor) të kontratës së nënshkruar është cituar se: Pjesët e këmbimit të difektuara apo të vjetra , pas zëvendësimit me të reja, do t’i kthehen Kontraktuesit. Grupi i auditimit konstaton se citimi i mësipërm nuk është parashikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në kushtet e hartimit të kontratës, neni 11, paragrafi 4 është favorizuar operatorin ekonomik. Ky veprim është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik (DST), dhe ngarkon me përgjegjësi Konceptuesin e kontratës dhe Titullarin e AK.

**6.7 Kontrata me objekt “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” për Spitalin Rajonal Shkodër me të dhënat sipas tabelës, rezultoi si më poshtë vijon:**

*Objekti i këtij akt konstatimi është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” ku rezultoi që:*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”.</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> Nr.1741 datë 03.09.2015	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Xh.H. E.H. F.B.	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr.1765, dt.10.09.2015 A.K. A.B. E.S.
<b>2. Procedura e Prokurimit</b> Kërkesë për propozim.		

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>9,934,000 lekë.</b>	<b>6. Oferta Fituese pa tvsh.</b> <b>K.G. K. sh.p.k me ofertë: 5,937,273</b> <b>lekë.</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> <b>3,996,727 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave</b> 14.09.2015.	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Shtetit, MSH.</b>	<b>10.Operatoret ekonomikë pjesëmarrës</b> <b>në tender: D.I., N. dhe K.G. K. sh.p.k.</b>
<b>b.Zbatimi i Kontratës së punimeve</b>		
<b>11.Lidhja e kontratës</b> <b>Dt.13.10.2015</b>	<b>12.Vlera e kontratës (me tvsh) 7,098,628 lekë.</b>	

U konstatuan:

-Nga kontrolli elektronik dhe sipas procesverbalit Nr.101, Prot të datës 14.09.2015 mbajtur nga KVO e SRSH, kanë tërhequr dokumentet në mënyrë elektronike 3 operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat për konkurim. Të kualifikuar janë: K.G. K. me ofertën me vlerë 5,937,273 lekë, Delia me ofertën me vlerë 6,029,424 lekë dhe N. me ofertën me vlerë 6,293,540 lekë.

-Raporti përmbledhës është mbajtur më 23.09.2015, nr. 1837 prot.

-Nga rillogaritja që bëri grupi i auditimit, nëse oferta e kualifikuar është apo jo anomalisht e ulët, referuar DST, rezultoi se vlera e ofertës së operatorit ekonomik të kualifikuar 5,937,273 lekë, është më e lartë sesa vlera që i përket ofertës anomalisht të ulët. Pra, vlerësimi i KVO-së është i drejtë.

-Formulari i njoftimit të fituesit K.G. K. sh.p.k, mban datën 23.09.2015.

-Kontrata e lidhur me nr.1990, Prot-datë 13.10.2015, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “K.G. K.” sh.p.k, me vlerë 7,098,628 lekë me tvsh, ka afat të kryerjes së punimeve deri më 13.11.2015.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatuan tre urdhra prokurimi për të njëjtin objekt nga të cilat është kryer një procedurë dhe konkretisht procedura e pasqyruar në tabelën e mësipërme dhe janë anuluar dy procedurat e mëparshme, zhvillimi i të cilave paraqitet në vijim:

-Procedura e prokurimit me objekt **“Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”** zhvilluar në datën 19.03.2015.

-Me shkresën nr.669, Prot-datë 19.03.2015, urdhër prokurimi, Titullari i SRSH-së, z.T.M., urdhëron kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt : **“Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”** dhe me fond limit 9,934,000 lekë pa tvsh dhe autorizon njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe F.P. për vazhdimin e procedurës së prokurimit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me shkresën nr.1512, Prot-datë 24.03.2015, Ministria e Shëndetësisë, dërgon listën mbi limitet e angazhimeve të shpenzimeve kapitale të brendshme. Tek kjo shkresë, bashkangjitur, është lista e projekteve të përfshira në limitet e angazhimeve dhe konkretisht projekti “*Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e Angiografisë në Spitalin e Shkodrës*”.

Sa më sipër, konstatohet se fillimi ose nxjerrja e urdhrin të prokurimit me datë 19.03.2015 për objektin e mësipërm, është bërë përpara shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë me nr.1512, Prot-datë 24.03.2015, shkresë e cila, lejon SRSH-në, të kryejë procedurën e prokurimit për ri K.in e ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë. Si rrjedhojë, për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa autorizimin përkatës, mban përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor z.T.M. pasi ka vepruar në kundërshtim me: nenin 60 të vendimit nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

-Me shkresën nr.670, Prot-datë 19.03.2015, Titullari i Autoritetit Kontraktor, miraton njoftimin e kontratës.

-Me shkresën nr.44/1, Prot-datë 23.03.2015, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe me shkresën nr.44/2, njësia e prokurimit autorizon nëpunësen Xh.H. për krijimin e dosjes elektronike.

-Me shkresën nr.720, Prot-datë 30.03.2015, operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., dërgon një ankesë drejtuar SRSH-së, tek e cila sqaron pikat tek të cilat nuk është dakort përsa i përket DST-së, kapacitetit teknik.

-Me shkresën nr.722, Prot-datë 31.03.2015, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin për pezullimin e procedurës së prokurimit për arsye të paraqitjes së ankesës nga operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.725, Prot-datë 31.03.2015, titullari i SRSH-së, z.T.M., ngre komisionin e shqyrtimit të ankesës të përbërë nga G.B., P.M. dhe A. Sh.

-Me shkresën nr.749, Prot-datë 02.04.2015, komisioni i shqyrtimit të ankesës, dërgon informacion tek drejtori i SRSH-së, lidhur me ankesën.

-Me shkresën nr.755, Prot-datë 03.04.2015, Titullari i SRSH-së, i dërgon operatorit ekonomik ankimues, përgjigje për ankesën e tij duke shpjeguar arsyet e marrjes në konsideratë ose jo të pikave të ankesës.

-Me shkresën nr.756, Prot-datë 03.04.2015, Titullari i SRSH-së, miraton ndryshimin e dokumentave standarde të tenderit.

-Me shkresën nr.763, Prot-datë 07.04.2015, operatori ekonomik “E.” sh.p.k., drëgon ankesën drejtuar SRSH-së.

-Me shkresën nr.774, Prot-datë 08.04.2015, drejtori i SRSH-së, z.Sh.Y., nxjerr urdhrin për pezullimin e procedurës së prokurimit për arsye të paraqitjes së ankesës nga operatori ekonomik “E.” sh.p.k.

-Me shkresën nr.775, Prot-datë 08.14.2015, titullari i SRSH-së, z.Sh.Y., ngre komisionin e shqyrtimit të ankesës të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe Dh.K.

-Me shkresën nr.797, Prot-datë 09.04.2015, komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës, mban procesverbalin përkatës.

-Me shkresën nr.799, Prot-datë 09.04.2015, Titullari i SRSH-së, i dërgon operatorit ekonomik ankimues, përgjigje për ankesën e tij duke shpjeguar arsyet e marrjes në konsideratë ose jo të pikave të ankesës.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Me shkresën nr.864, Prot-datë 16.04.2015, Titullari i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga N.Gj., G.N. dhe L.B.
- Me shkresën nr.64, Prot-datë 29.04.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave mban procesverbalin e hapjes së ofertave dhe konstaton katër oferta të ardhura dhe konkretisht nga “Andi – A” sh.p.k., “N.” sh.p.k., “D.I.” sh.p.k. dhe “E.” sh.p.k.
- Me shkresën nr.985, Prot-datë 06.05.2015, operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., dërgon ankesë lidhur me s’kualifikimin e komunikuar nga SRSH.
- Me shkresën nr.989, Prot-datë 06.05.2015, operatori ekonomik “E.” sh.p.k., dërgon ankesë lidhur me s’kualifikimin e komunikuar nga SRSH.
- Me shkresën nr.991, Prot-datë 06.05.2015, Titullari i SRSH-së, urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesave të ardhura.
- Me shkresën nr.992, Prot-datë 06.05.2015, Titullari i SRSH-së, ngre komisionin e shqyrtimit të ankesave të ardhura të përbërë nga B.B., E. K. dhe V.F.
- Me shkresën nr.1002/1, Prot-datë 08.05.2015, komisioni i shqyrtimit të ankesave, i dërgon një realcion drejtorit të SRSH-së tek i cili i sqaron arsyet e mos pranimit të ankesave të ardhura.
- Me shkresat me nr.1005 dhe me nr.1006, Prot-datë 11.05.2015, drejtori i SRSH-së, z.Sh.Y., u dërgon operatorëve ekonomik ankimes, përgjigjet për ankesat e dërguara.
- Me shkresën nr.1010, Prot-datë 13.05.2015, operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., kërkon ti vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni ligjor mbi të cilin është kryer s’kualifikimi.
- Me shkresën nr.1070, Prot-datë 22.05.2015, operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., i drejtohet me një ankesë, KPP-së, duke sqaruar kundërshtimet mbi vlerësimet e bëra nga SRSH.
- Me shkresën nr.1071/1, Prot-datë 22.05.2015, Titullari i SRSH-së zj.Dh.U., urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës nga KPP.
- Me shkresën nr.1276, Prot-datë 17.06.2015, KPP, dërgon përgjigjen tek SRSH dhe sqaron se ankesa nuk është marrë në konsideratë. Në këto kushte, SRSH, me shkresën nr.1281, Prot-datë 19.06.2015, urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit dhe fillimin e një procedure të re. Ky pezullim, është publikuar në APP më 22.06.2015.
- Procedura e prokurimit me objekt **“Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”** zhvilluar në datën 06.07.2015.
- Me shkresën nr.1430, Prot-datë 06.07.2015, urdhër prokurimi, Titullari i SRSH-së, zj.Dh.U., urdhëron kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt : **“Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”** dhe me fond limit 9,934,000 lekë pa tvsh dhe autorizon njësinë e prokurimit të përbërë nga Xh.H., E.H. dhe F.B. për vazhdimin e procedurës së prokurimit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Me shkresën nr.1431, Prot-datë 06.07.2015, Titullari i Autoritetit Kontraktor, miraton njoftimin e kontratës.
- Me shkresën nr.80, Prot-datë 06.07.2015, njësia e prokurimit, miraton dokumentat standarde të tenderit dhe me shkresën nr.81, njësia e prokurimit autorizon nëpunësen Xh.H. për krijimin e dosjes elektronike.
- Me shkresën nr.1453, Prot-datë 13.07.2015, operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k., dërgon një ankesë drejtuar SRSH-së, tek e cila sqaron pikat tek të cilat nuk është dakort përsa i përket DST-së, kapacitetit teknik.
- Me shkresën nr.1466, Prot-datë 13.07.2015, drejtori i SRSH-së, nxjerr urdhrin për pezullimin e procedurës së prokurimit për arsye të paraqitjes së ankesës nga operatori ekonomik “D.I.” sh.p.k.
- Me shkresën nr.1469, Prot-datë 14.07.2015, titullari i SRSH-së, zj.Dh.U., ngre komisionin e shqyrtimit të ankesës të përbërë nga G.B., P.M. dhe J.ZH.
- Me shkresën nr.1475, Prot-datë 14.07.2015, komisioni i shqyrtimit të ankesës, dërgon informacion tek drejtori i SRSH-së, lidhur me ankesën.
- Me shkresën nr.1482, Prot-datë 15.07.2015, Titullari i SRSH-së, i dërgon operatorit ekonomik ankimues, përgjigje për ankesën e tij duke shpjeguar arsyet e marrjes në konsideratë ose jo të pikave të ankesës.
- Me shkresën nr.1526, Prot-datë 24.07.2015, protokolluar pranë SRSH-së ose me shkresën nr.1289/1, Prot-datë 23.07.2015, vendim, KPP, i kërkon SRSH, sqarime për procedurën e prokurimit të mësipërme dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit ligjor për fillimin e shqyrtimit të ankesës.
- Me shkresën nr.1539, Prot-datë 29.07.2015, Titullari i SRSH-së, i dërgon përgjigje KPP-së ku e informon mbi ecurinë e procesit të procedurës së prokurimit.
- Me shkresën nr.1673, Prot-datë 20.08.2015, KPP, vendos të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “D.I.” sh.p.k. dhe urdhëron SRSH-në që të modifikojë DST-në në përputhje me arsyetimet e operatorit ekonomik ankimues të miratuara nga KPP.
- Me shkresën nr.1679, Prot-datë 21.08.2015, Titullari i SRSH-së, zj.Dh.U., urdhëron heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit pas shqyrtimit të ankesës nga KPP.
- Me shkresën nr.1680, Prot-datë 21.08.2015, Titullari i SRSH-së, miraton ndryshimet në DST dhe vendos datën e kryerjes së procedurës së prokurimit më 26.08.2015, ora 10:00.
- Me shkresën nr.1692, Prot-datë 25.08.2015, Titullari i SRSH-së, i kërkon KPP, udhëzime për vazhdimin e procedurës së prokurimit pas një gabimi që ka të bëjë me ndryshimet e DST por që nuk është reflektuar në APP dhe njësia e prokurimit ka hequr pezullimin.
- Me shkresën nr.1698, Prot-datë 25.08.2015, Titullari i SRSH-së, informon KPP se njësia e prokurimit të SRSH-së hyri në sistemin elektronik të APP dhe ngarkoi shtojcën me ndryshimet e reflektuara sipas vendimit të KPP-së me nr.544/2015, datë 18.08.2015.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Me vendimin nr.544/3/2015, dhe nr.544/2, Prot-datë 28.08.2015, KPP, vendos heqjen e pezullimit të procedurës së mësipërme me objekt “*Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë*”. Konstatohet se shkresa e gjendur në dosjen e prokurimit, nuk është e protokolluar pranë SRSH-së. Si e tillë, do të trajtohet si njoftim nga ana jonë dhe jo si dokument zyrtar. Gjithsesi, edhe nëse merret ose jo në konsideratë, shkresa e ardhur nga KPP, nuk ka sjellë asnjë efekt në vendim-marrjen e drejtorit të SRSH-së. Kjo, pasi shkresa citon se data e marrjes së vendimit është data 03.09.2015 kur në fakt, drejtori i SRSH-së, zj.Dh.U., ka nxjerr urdhrin e anulimit të procedurës së prokurimit me objektin e mësipërm.

-Me shkresën nr.1725, Prot-datë 31.08.2015, Titullari i SRSH-së, nxjerr urdhrin e prokurimit të procedurës me objekt “***Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë***”, me fond limit 9,934,000 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.1727, Prot-datë 31.08.2015, Titullari i SRSH-së, miraton njoftimin e kontratës.

-Me shkresën nr.96, Prot-datë 03.09.2015, njësia e prokurimit mban procesverbalin e hartimit dhe miratimit të dokumentave të tenderit dhe me shkresën nr.97, autorizon nëpunësen e njësisë së prokurimit Xh.H., të krijojë dosjen elektronike të procedurës së prokurimit.

-Me shkresën nr.1765, Prot-datë 10.09.2015, urdhër administrativ, Titullari i SRSH-së, ngre komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.K., A.B. dhe E.S.

-Me shkresën nr.1790, Prot-datë 14.09.2015, kryetari i KVO-së, kërkon sqarime nga operatori ekonomik që ka marrë pjesë në tender për të vënë në dispozicion të KVO-së, një pjesë të dokumentacionit të dorëzuar pasi në sistem nuk është e qartë.

-Me shkresën nr.101, Prot-datë 14.09.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, kryen procesin e hapjes së ofertave dhe konstaton tre oferta të ardhura dhe konkretisht nga “K.G. K.” sh.p.k. me vlerën 5,937,273 lekë pa tvsh, “D.I.” sh.p.k. me vlerën 6,029,424 lekë pa tvsh dhe “N.” sh.p.k. me vlerën 6,293,540 lekë pa tvsh.

-Me shkresën nr.1808, Prot-datë 16.09.2015, Titullari i SRSH-së, miraton klasifikim përfundimtar të procedurës së prokurimit.

-Me shkresën nr.1837, Prot-datë 23.09.2015, komisioni i vlerësimit të ofertave, mban raportin përmbledhës së procedurës së prokurimit dhe bën klasifikimin duke propozuar që fitues i procedurës së prokurimit të shpallet operatori ekonomik “K.G. K.” sh.p.k. me ofertën me vlerë më të ulët nga tre ofertat e ardhura.

-Kontrata e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “K.G. K.” sh.p.k. me objekt “*Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë*” me vlerë 5,937,273 lekë pa tvsh dhe afat ekzekutimi nga data e lidhjes së kontratës pra 13.10.2015 deri më 13.11.2015 pra 1 muaj, është me nr.1990 prot, datë 13.10.2015.

**-Zbatimi i kontratës:**

-Urdhër-shpenzimi nr.426 dhe nr.427 datë 25.11.2015 me vlerë 1,143,819 lekë me tvsh për ri K.in e ambienteve të angiografisë, është i shoqëruar me faturën nr.19, datë 04.11.2015 dhe me situacionin pjesor nr.1 i cili ka zërat e punimeve që duhen likuiduar dhe të miratuara nga mbikqyrësi punimeve dhe drejtori i SRSH-së zj.Dh.U.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Urdhër-shpenzimi nr.453 dhe nr.454 datë 11.12.2015 me vlerë 1,686,949 lekë me tvsh për ri K.in e ambienteve të angiografisë, është i shoqëruar me faturën nr.23, datë 13.11.2015 dhe me situacionin pjesor nr.2 i cili ka zërat e punimeve që duhen likuiduar dhe të miratuara nga mbikqyrësi punimeve dhe drejtori i SRSH-së zj.Dh.U.

-Urdhër-shpenzimi nr.120 dhe nr.121 datë 03.05.2016 me vlerë 3,356,037 lekë me tvsh për ri K.in e ambienteve të angiografisë, është i shoqëruar me faturën nr.4, datë 22.02.2016 dhe me situacionin pjesor nr.3 i cili ka zërat e punimeve që duhen likuiduar dhe të miratuara nga mbikqyrësi punimeve dhe drejtori i SRSH-së zj.Dh.U.

-Sa më sipër, operatori ekonomik “K.G.” sh.p.k., është likuiduar në vlerën 6,186,805 lekë dhe jo në vlerën e kontratës që është 7,124,908.8 lekë. Pra, është likuiduar 938,103.8 lekë më pak.

-Nuk ka asnjë situacion përfundimtar të protokolluar pranë SRSH-së dhe aq më tepër nuk ka asnjë akt të marrjes në dorëzim të punimeve të kryera nga operatori ekonomik “K.G. K.” sh.p.k. Të gjitha situacionet pjesore të dorëzuara dhe të likuiduara nga SRSH-ja, nuk kanë bashkangjitur asnjë relacion ose dokument zyrtar të protokolluar dhe për më tepër nuk u gjet asnjë librezë masash apo ditar punimesh duke e bërë të pa mundur auditimin e zbatimit të kontratës. Kontrata shitesë e lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik për zgjatje të afatit të punimeve me afro 6 muaj edhe pse afati i kontratës bazë është vetëm një muaj, është e pa justifikuar jo vetëm për arsye të zgjatjes jashtë kufijve llogjike të afateve të ekzekutimit por për më tepër, arsyet e zgjatjes së këtyre afateve, nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratës. Objekti i kontratës është “Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” kurse zgjatja ka si arsye, mos vendosjen e kabinës tip BOX dhe të transformatorit kur në të njëjtën kohë, të vetmet zëra punimesh që kanë të bëjnë me transformatorin apo kabinën tip BOX sipas preventivit të punimeve, janë zërat që i përkasin punimeve të ndërtimit lidhur me bazamentin e gjeneratorit dhe jo ato që pretendohen tek kontrata shitesë. Rrjedhimisht, zgjatja ose amendamenti kontratës, është bërë në kundërshtim me nenin 38 të kontratës së lidhur, pika 38.2 pasi kjo zgjatje nuk i referohet objektit të kontratës bazë. Pra, në asnjë zë të preventivit dhe të aneksit të kontratës së lidhur midis palëve, nuk citohet se operatori ekonomik ka si detyrim *“Lidhjen e paisjes së Angiografisë me transformatorin, gjeneratorin dhe me burimin e energjisë elektrike”*. Gjithsesi, edhe nëse do të ishte kjo pengesë, operatori ekonomik nuk kishte asnjë arsye pse të mos përfundonte të gjitha punimet e specifikuara në kontratë dhe madje të dorëzonte situacionin përfundimtar dhe deklaratën e përfundimit të punimeve duke qëndruar në pritje deri në momentin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të objektit. Fakti që nuk ka dorëzuar një situacion përfundimtar konform nenit 41 të kontratës së lidhur por mbi të gjitha, fakti që nuk ka një datë ekzakte të përfundimit të punimeve, e penalizon operatorin ekonomik “K.G. K.” sh.p.k., me 25% të vlerës së kontratës pasi nuk gjen zbatim asnjë penalizim tjetër sipas nenit 37, të kontratës së lidhur, gërma “a”, “b” dhe “c” ku në të gjitha rastet nuk ka asnjë referencë të datës së përfundimit të kontratës dhe si e tillë nuk mund të kalkulohej ditët vonesë.

-Sa më sipër, penaliteti që i duhej mbajtur operatorit ekonomik “K.G. K.” sh.p.k., për mos ekzekutim të afateve të kontratës, është 25% e 7,098,628 lekë = **1,774,657 lekë**.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

## **7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël.**

Nga auditimi me zgjedhje për blerjet me vlere të vogël rezultoi që:

**Për vitin 2015:** Blerje e vogël, janë realizuar 34 procedura në shumën e fondit limit 9,093,991 lekë pa TVSH, me vlerë kontratash të lidhura në vlerën 7,059,940 lekë pa tvsh, nga të cilat janë audituar 8 procedura me vlerë fondi limit 4,997,970 lekë pa tvsh, dhe me vlerë kontrate të lidhura 4,506,164 lekë pa tvsh, ose 55% e tyre.

**Për vitin 2016:** Blerje e vogël, janë realizuar 19 procedura në shumën e fondit limit 9,267,432 lekë pa TVSH, me vlerë kontratash të lidhura në vlerën 7,578,417 lekë pa tvsh, nga të cilat janë audituar 9 procedura me vlerë fondi limit 5,326,300 lekë pa tvsh, dhe me vlerë kontrate të lidhura 3,400,520 lekë pa tvsh, ose 42% e tyre.

**Për vitin 2017:** Blerje e vogël, janë realizuar 59 procedura në shumën e fondit limit 18,654,046 lekë pa TVSH, me vlerë kontratash të lidhura në vlerën 16,517,800 lekë pa tvsh, nga të cilat janë audituar 9 procedura me vlerë fondi limit 4,527,250 lekë pa tvsh, dhe me vlerë kontrate të lidhura 3,950,720 lekë pa tvsh, ose 24 % e tyre.

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2015
- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2016
- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2017.
- Procedurat me zgjedhje sipas anekseve bashkëlidhur këtij akt-konstatimi të blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi.

***Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:***

**Për vitin 2015** nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.T.M. me urdhërin nr. 12, dt. 05.02.2015 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: B.B., P.N. dhe E.H., ku më pas ky komision është ndryshuar pasi B.B. është zëvendësuar me G.B. me urdhërin nr. 40, datë 03.03.2015. Me urdhërin e titullarit z.Sh.Y. është krijuar komisioni me urdhërin nr. 87, datë 07.05.2015 me përbërje G.N., P.N. dhe E.H. Me urdhërin e titullarit znj.Dh.U. nr. 98, datë 04.06.2015 është krijuar komisioni me përbërje G.B., P.N. dhe E.H. dhe më pas me urdhërin nr. 127, datë 21.08.2015 është zëvendësuar G.B. me Xh.H. i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**Për vitin 2016** nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) znj.Dh.U. me urdhërin nr. 08, dt. 09.02.2016 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: D.H., A.M. dhe A.M. Me urdhërin e titullarit z.P.Ç. nr. 78, datë 06.06.2016 është krijuar komisioni me M.K., N.Gj. dhe L.M. i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

**Për vitin 2017** nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.P.Ç. me urdhërin nr. 01, dt. 11.01.2017 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: M.K., N.Gj. dhe L.M. Me urdhërin e titullarit z.P.Ç. nr. 13, datë 26.01.2017 është krijuar komisioni me përbërje E.M., M.N.j dhe P.N. dhe më pas me urdhërin nr. 130, datë 01.12.2017 është bërë ndryshimi ku është zëvendësuar E.M. me Xh.H. i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Sipas urdhërit nr. 13 prot, datë 26.01.2017 nga Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër është krijuar komisioni i blerjeve me vlera të vogla në të cilin është caktuar znj.M.N. si anëtare e komisionit, ndërkohë që është dhe në pozicionin e nëpunësit zbatues, me detyrë shefe e Financës. *Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22, pika 5, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 52.*

***Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi drejtorin e SRSH z. P.Ç.***

Për vitin 2015 janë kryer 3 procedura me vlerë të vogël për “Riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, blerje goma, vajra, filtra etj.” **në shumën totale 1,633,300 lekë duke e copëzuar fondin**, dhe konkretisht është kryer procedura “Riparim mirëmbajtje automjetesh”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, procedura “Blerje goma”, me fond limit në shumën 583,300 lekë dhe, procedura “FV filtra, vaj, alkol makinash dhe gjeneratori”, me fond limit në shumën 250,000 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

***Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.T.M., ish,drejtoresh znj.Dh. U. dhe anëtarët e Komisionit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.***

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 1528, datë 27.07.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Riparim mirëmbajtje automjetesh”, me fond limit 800,000lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 07.08.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “V.D.”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 73, datë 14.12.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 505, me datë 22.12.2015 në shumën 664,000 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 43, datë 16.12.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje goma” me fond limit 583,300lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 10.12.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “K. 06”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 901, datë 14.12.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 490, me datë 21.12.2015 në shumën 588,000 lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 23, datë 30.06.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “FV filtra, vaj, alkol makinash dhe gjeneratori” me fond limit 250,000lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 03.07.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “V.D.”. Është kryer likujdimi i faturës nr. 39, datë 23.07.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 285, me datë 18.08.2015 në shumën 159,500 lekë.

Për vitin 2016 janë kryer 2 procedura me vlerë të vogël **në shumën totale 1,594,973 lekë duke e copëzuar fondin**, dhe konkretisht është kryer procedura “FV Aksesit elektronik me karta për personelin dhe admin e Sp Rajonal Shkoder”, me fond limit në shumën 799,973 lekë, dhe procedura “FV Mbajtje e sistemit për mbajtjen e radhes për pacientet e Sp Rajonal Shkoder”, me fond limit në shumën 795,000 lekë procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

***Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.Dh. U., dhe anëtarët e Komisionit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.***

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 32/1, datë 20.04.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “FV Aksesit elektronik me karta për personelin dhe admin e SRSH ” me fond limit 799,300lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 25.05.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “O. Shpk.”. Është kryer likujdimi i faturës nr. 980, datë 10.06.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 225, me datë 08.07.2017 në shumën 959,880 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 33, datë 20.04.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “FV Mbajtja e sistemit për radhën e pacientëve të SRSH ” me fond limit 795,000lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 25.05.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “O. Shpk.”. Është kryer likujdimi i faturës nr. 981, datë 10.06.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 252, me datë 02.08.2016 në shumën 954,000 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 63, datë 15.08.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje Kancelarie” me fond limit 700,000lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 16.08.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “I.O.”. Është kryer likujdimi i faturës nr. 119862006, datë 26.08.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 334, me datë 03.10.2016 në shumën 655,200 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 67, datë 01.09.2016, bazuar në kërkesën me nr. 1569 prot, datë 01.07.2016, të bërë nga përgjegjësi i zyrës teknike për gjendjen e rrugëve të brendshme të SRSH të cilat kanë nevojë për riparime të ndryshme

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

dhe asfaltime, kërkesë e cila është miratuar me shkresën nr. 1581 prot, datë 04.07.2016, ka filluar procedura e prokurimit, dhe titullari ka caktuar z.F.Sh. për hartimin e preventivit të punimeve që do të kryhen. Me Komisioni ka hartuar ftesën për ofertë me nr. 2133 prot, datë 01.09.2016, me fond limit 799,824 lekë pa tvsh, me objekt “Riparim, Asfaltim i rrugëve të brendshme të Spitalit Rajonal Shkodër”. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 01.09.2016 duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “K.M K.”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 45, datë 07.10.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 365, me datë 21.10.2016 në shumën 645,720 lekë. Konstatohet se në kërkesën dhe preventivin për kryerjen e procedurës së mësipërme në lidhje me punimet që do të kryhen nga ana e degës teknike dhe nga preventivuesi, nuk ka asnjë dokumentacion mbi planimetrinë, skicat apo vizatime për kryerjen e këtyre punimeve, nga të cilat dalin sasitë dhe volumet e punimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5 dhe ngarkon me përgjegjësi KPBBV.

Për vitin 2017 janë kryer 2 procedura me vlerë të vogël për “Blerje kompjutera, printera dhe laptop” **në shumën totale 1,600,000 lekë duke e copëzuar fondin**, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje kompjutera dhe printera”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, dhe procedura “Blerje laptop për recetat elektronike”, me fond limit në shumën 800,000 lekë procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1. *Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.P.Ç., dhe anëtarët e Komisionit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.*

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 1576, datë 04.07.2017, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje kompjutera dhe printera”, me fond limit 795,000 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 10.08.2017, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “C.C.C.” me vlerë oferte 917,520 lekë me tvsh. Është kryer likuidimi i faturës nr. 154, datë 10.08.2017 ndaj këtij operatori me UXH nr. 400, me datë 16.08.2017 në shumën 917,520 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 5, datë 02.02.2017, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje laptop për recetat elektronike”, me fond limit 753,500 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 17.02.2017, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “M.A.” me vlerë oferte 756,000 lekë me tvsh lekë me tvsh. Është kryer likuidimi i faturës nr. 15, datë 22.02.2017 ndaj këtij operatori me UXH nr. 85, me datë 10.03.2017 në shumën 756,000 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 2046, datë 18.09.2017, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogëla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje Kancelarie” me fond limit 292,250lekë. Komisioni përcaktuar si ofertë fituese subjektin “I.O.”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 228924975, datë 21.09.2017 ndaj këtij operatori me UXH nr. 465, me datë 26.09.2017 në shumën 241,200 lekë.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Gjithashtu konstatohet se në të gjitha rastet e audituara për blerjet me vlera të vogla për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nuk dokumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VII, neni 59, paragrafi i fundit e cila citon se:

*“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.”*

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Prokurimit për periudhat respektive.

***Sa më sipër sipas konstatimeve përkatëse arrihet në konkluzionin që veprimet e kryera bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

- 7) Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- 8) VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- 9) Udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, pika 3, paragrafi i dytë.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

- 9) Z. T.M. me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 10) Znj.Dh.U. me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.
- 11) Z.P.Ç. me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër.

*Komente dhe shpjegime të subjektit:* Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 40/5 prot, datë 21.05.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Shkodër, nga ish-drejtori i SRSH z.T.M.

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :*

Në lidhje me observacionin e bërë në lidhje me këtë akt-konstatim, mbi pretendimin e kryerjes së blerjeve me vlera të vogla, se janë kryer brenda kuadrit ligjor, sqarojmë se:

Përgjigje; Përsa i përket observimit të bërë, risqarojmë se nga ana juaj nuk është vënë asnjë dokumentacion apo bazë ligjore i cili bie ndesh me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit.

*Argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.*

## **8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.**

*Nga auditimi u konstatua se:*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Në lidhje me të ardhurat dytësore që SRSH përfiton nga kryerja e shërbimeve, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, SRSH për dhënien e ambienteve me qera, ka funksionuar në bazë të VKM nr. 315, datë 24.04.2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, në VKM Nr. 54, datë 05.02.2011 “Për përcaktimin e kritereve , të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë sipas shkresës nr. 4550/2 prot, datë 16.01.2017.

Të ardhurat e përfituara nga SRSH për shërbimet e kryera, janë për vitin 2015 në vlerën 18,603,601 lekë, për vitin 2016 në vlerën 35,475,694 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 33,823,320 lekë.

**Ambiente të dhëna me qira**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se janë dhënë ambientet me qira si më poshtë:

**Ambiente në katin e tretë të Spitalit Rajonal Shkodër 343.43 m<sup>2</sup>.**

Kontrata e qirasë me nr. prot. 1080, datë 18.05.2016 (Nr. rep 905; Nr. kol 392), është nënshkruar për Qiradhënësin SRSH z. P.Ç. dhe për Qiramarrësin shoqërinë “D.V.” SHPK përfaqësuar nga Administratorja znj. M. A.H., mbështetur në Kontratën e Koncesionit midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kompanisë “D.V.” sh.p.k. Kjo kontratë është e shoqëruar me planimetrinë ekzistuese.

- Me datë 31.05.2016, palët Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër në cilësinë e qira dhënësit dhe pala shoqëria “D.V.” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit deklarojnë se revokojnë kontratën e qirasë me nr. rep 905 kol 392 datë 18.05.2016, për arsye të rishikimit të kushteve të kontratës dhe ekzaktesisht të afatit kohor të vendosur në marrëveshje mes palëve.

- Pas revokimit është lidhur Kontrata e qirasë nr. prot. 1225, datë 31.05.2016 (Nr. rep 1014 dhe nr. kol 444), është nënshkruar për Qiradhënësin SRSH z. P.Ç. dhe për Qiramarrësin shoqërinë “D.V.” SHPK përfaqësuar nga Administratorja znj. M. A.H., mbështetur në Kontratën e Koncesionit midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kompanisë “D.V.” sh.p.k nënshkruar me datë 08.02.2016 sipas përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, si fituese e koncesionit të shërbimit të Dializës.

Sipas kontratës objekti jepet me qira me qëllim “Kryerjen e Shërbimit të Dializës” sipas plan biznesit të paraqitur në kontratën e koncesionit.

-Ambiente në katin e tretë të SRSH me sipërfaqe 343.43 m<sup>2</sup>.

-Kohëzgjatja e qiradhënies do jetë për një periudhë 8 (tetë) vjet dhe hyn në fuqi nga data 01.06.2016 deri 31.05.2024.

-Çmimi i kontratës do jetë 160 lekë/m<sup>2</sup>, ose në vlerën 54,948.8 lekë/muaj.

Në lidhje me këtë kontratë qiraje, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Është paraqitur dokumentacioni për marrjen me qira, i cili përmban: (Preventiv punimesh me vlerë 8,212,259.10 lekë; Relacioni dhe specifikimet teknike; Projekt ri K.i; Projekti arkitektonik; Projekti elektrik; Projekti i sistemit të kondicionimit dhe projekti hidro-sanitar).

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Në dosje mungon dokumentacioni për marrjen me qira, i cili përmban:

- a. Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore,
  - b. Planin biznesin, të detajuar për vënien me funksionim të objektit, ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen,
  - c. Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë,
  - ç. Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR.
  - d. NUIS-i dhe vërtetimin nga Dega e Tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore.
- dh. Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin. Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Ambient me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>.**

**Instalimi i 6 Distributorëve Automatikë Bianchi për Snack dhe 6 Distributorëve Automatikë Bianchi për kafe.**

Kontrata e qirasë nr. prot. 1598, datë 06.07.2017 (pa noteruar), është nënshkruar për Qiradhënësin SRSH z. P.Ç. në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit “A.N.” person fizik, përfaqësuar nga z. A.N., në cilësinë e qiramarrësit, bazuar: Miratimi i dhënies me qira të Ministrisë të Shëndetësisë sipas shkresës nr. prot. 4550/2, datë 02.11.2016, protokolluar në SRSH me nr. prot. 120, datë 16.01.2017.

Dhënia e këtij ambienti ka për destinacion instalimin e 6 Distributorëve Automatikë Bianchi për Snack dhe 6 Distributorëve Automatikë Bianchi për kafe, gjithsej 12 Distributorë.

Kontrata ka afat 1 (një) vjeçar dhe përfundon me datë 10.07.2018.

-Kuota e qirasë për sipërfaqen 12 m<sup>2</sup> do jetë në vlerën 2,400 lekë në muaj dhe duke llogaritur konsumin e energjisë elektrike të konsumuar nga pajisjet e instaluar për 30 ditë në vlerën 11,280 lekë me TVSH.

Në lidhje me këtë kontratë qiraje, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se,

është paraqitur dokumentacioni për marrjen me qira, i cili përmban:

- kërkesë për marrje me qira 12 m<sup>2</sup> brenda ambienteve të SRSH (datë 13.03.2017 dhe nr. prot. 768).
- akt konkluzion, për verifikimin dhe përlllogaritjen e konsumit mesatar të energjisë elektrike për pajisjet e tipit distributor automatikë për kafe dhe Snack të markës Bianchi të cilat do të instalohen në ambientet e SRSH.
- urdhër i brendshëm nr. 26, datë 10.03.2017 (nr. prot. 734) nga titullari i SRSH z. P.Ç., për verifikim fizik dhe përlllogaritjen e konsumit mesatar mujor të energjisë elektrike për distributorët automatik me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- shkresa me datë 10.03.2017 dhe nr. prot. 735 nga ing. I.Ç., mbi konsumin fizik dhe përllogaritjen e shpenzimit të energjisë elektrike të Distributorëve Automatikë.
- specifikime, përshkrime teknike mbi distributorët automatikë.
- vërtetim nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër.
- certifikatë regjistrimi i personit fizik në QKB (e noterizuar)
- kartë identiteti (e noterizuar)

- vërtetim nga Drejtoria e shërbimit ndaj Tatimpaguesve

*Nga auditimi mbi likuidimin e pagesës u konstatua se nuk ishte përfshirë vlera e sipërfaqes  $12\text{ m}^2 \times 200\text{ lekë/m}^2 = 2400\text{ lekë}$  në muaj. Në llogaritje ishte përfshirë vetëm konsumi i energjisë elektrike nga pajisjet e instaluara për distributorët automatikë, Bianchi për Snack si dhe për distributorët automatikë, Bianchi për Kafe në shumën 11,280 lekë me TVSH.*

*Pagesa e pashlyer u likuiduar gjatë periudhës së auditimit në vlerën prej 16.320 lekë, vërtetuar kjo me faturën e lëshuar nga Alpha Bank me datë 20.03.2018.*

**Ish punti i gjakut-Arka- Pranimi, spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>.**

Kontrata e qirasë nr. prot. 368/1, datë 07.08.2002 (e pa noteruar), është nënshkruar për Qiradhënësin Spitalin Shkodër z. M.Ç. në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga “N.D.” person fizik, Bazuar në VKM Nr. 430, datë 09.07.1998 “Për dhëniem me qira të objekteve Ndëmmarrjeve, shoqërive a Institucioneve Shtetërore” pika 1, germa (a) dhe pika 3, germa (a): Dhënia e këtij ambienti ka për destinacion “Ish punti i gjakut-Arka- Rrethimi spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>”. Kontrata ka afat 20 (njëzet) vjeçar dhe përfundon me datë 10.07.2022.

-Kuota e qirasë për sipërfaqen 70 m<sup>2</sup> është përcaktuar në vlerën 1 USD/m<sup>2</sup> në muaj/m<sup>2</sup>, pa përfshirë pagesën për ujin, energjinë elektrike, etj.,

Pagesa do të bëhet në lekë pas konvertimit që do ti bëhet në bazë të kursit të USD brenda datës 5 të fillimit të çdo muaji.

Afati i kësaj kontratë është prej datës 01.12.2002 deri me datë 01.12.2022.

Sipas nenit 5, pika 2, kjo kontratë përtrihet në mes të palëve çdo 5 (pesë) vjet.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si:

Raportit të vlerësimit për ndërtesën 1KT (Ri K. + ndërtim i ri shtesë) me destinacion për llogari të Gjykatës së Rrethit Shkodër, vlerësuar nga ing. G.S. (me Lic Vp 0418 Shkalla II).

Certifikatës për vërtetim pronësie nr. 1257832, lëshuar nga Zyra e regjistrimit Z.V.R.P.P. Shkodër,

Konstatohet se sipërfaqja e objektit është shtuar me 138.7 m<sup>2</sup>. Nga rillogaritja e objektit me sipërfaqe të shtuar, vlera e pagesës është  $138.7\text{ m}^2 \times 1\$ = 138.7\ \$$  në muaj. Llogaritja e vlerës së qerasë për periudhën e shtesës nga viti 2008 deri me 14.04.2016 (ku pronësia truall dhe ndërtesë prej 138.7 m<sup>2</sup> rezulton me certifikatë pronësie) është  $138.7\text{ m}^2 \times 1\ \$/\text{m}^2 \times 96.44 = 13,376\ \$$ .

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Nga neglizhenca e Drejtorisë së SRSH për periudhën e shtesës së sipërfaqes 138.7 m<sup>2</sup> nga viti 2008 deri me 14.04.2016 nuk është arkëtuar vlera prej 13,376 \$, e cila konsiderohet si e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 54, datë 05.02.2011 “Për përcaktimin e kriterëve , të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfitozoë apo kontrata të tjera apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore ”. Vlera prej **13,376 \$**, konsiderohet **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorët e Spitalit Rajonal Shkodër sipas periudhës së ushtrimit të detyrës; znj. A.K.; z. N.K.; z. S.H.; z. A.Y.; z. T.M. dhe znj. Dh.U.*

*- Në zbatim të Urdhrit të brendshëm nr. 105, datë 28.08.2014 me nr. prot. 1674 nga Drejtori z. T.M., me objekt për ngritjen e komisionit për listimin dhe matjen e të gjitha objekteve të dhëna me qera, janë konstatuar subjekte/persona fizik pa kontratë të cilët kanë objekte brenda teritorit të Spitalit Rajonal Shkodër, por bazuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë z. I.B., me Nr. 506, datë 18.09.2013 me objekt “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, pika 3, subjektet ushtrojnë aktivitetin e tyre pa kontrata.*

*Komente dhe shpjegime të subjektit, mbi observacionin e bërë nga ish Drejtori i SR Shkodër, z. T.M. me datë 08.05.2018 në lidhje me të ardhurat dytësore mbi projekt raportin.*

*Në observacion keni paraqitur shpjegimet si më poshtë vijon: “ . gjatë periudhës që Ju keni qenë Drejtor i SR Shkodër, të ardhurat dytësore janë dy ose tre fishuar. përse i përket dhënies së ambienteve me qira, të ardhurave nga ana e tyre janë dy ose tre fishuar, dhe se Ju keni kërkuar me urdhër që të verifikohen këto sipërfaqe. Pasi është bërë konstatimi nga grupi i punës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ka dalë urdhëri për mos dhënien me qira të këtyre ambienteve dhe nga ana Juaj keni qenë të detyruar për zbatimin e këtij urdhëri. Përse më sipër pretendoni se ligji dhe urdhëri janë zbatuar dhe nuk keni shkelje.”*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:*

**Së pari:** Pretendemi se të ardhurat dytësore janë dy ose tre fishuar është jashtë objektivit të gjetjes.

**Së dyti:** Ju kujtojmë se jeni emëruar Drejtor i SR Shkodër për periudhën 14.01.2014 deri me 31.03.2015, dhe ndërkohë Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2018 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucioneve shëndetësore” nuk parashikon pengesa për kontratat e lidhura që janë në vazhdim dhe aq më tepër për rastin konkret të kontratës së qirasë me nr. prot. 368/1, datë 07.08.2002 me afat deri me datë 01.12.2022. Pra sipërfaqja shtesë prej 138.7 m<sup>2</sup> i përket periudhës 2008 deri 14.04.2016. Për periudhën (14.01.2014 – 31.03.2015) në të cilën Ju keni Drejtuar SR Shkodër duhet të kishit arkëtuar qiranë për sipërfaqen shtesë aq më tepër që është konstatuar edhe nga grupi i punës në zbatim të UB nr. 105, datë 28.08.2014. ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2011.

#### **9. Auditim mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

SRSJ ju dorëzua një pyetësor, sipas ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK) dhe Manualit të MFK-së. Edhe pse përgjigja erdhi përtej afateve të përcaktuara në ligjin për KLSH, u mor në konsideratë, për të vlerësuar drejt problemet e shfaqura në SRSJ lidhur me MFK-në dhe adresuar përgjegjshmërinë mbi to.

Nëpunësi autorizues është Drejtori Ekzekutiv i SRSJ, përgjatë gjithë periudhës audituese 01.01.2015 - 31.12.2017 specifikisht:

- Z. T.M., në detyrë 01.01.2015 – 31.03.2015 (emëruar 14.01.2014).
- Z. Sh.Y., në detyrë 01.04.2015 – 18.05.2015.
- Znj. Dh.U., në detyrë 18.05.2015 – 05.05.2016.
- Z. P.Ç., në detyrë 05.05.2016 – 06.12.2017.
- Z. V.M., në detyrë 06.12.2017 – 31.12.2017 (e në vazhdim).

Përgjatë gjithë periudhës nën auditim, Drejtorat Ekzekutiv nuk kanë deleguar kompetencës e vet të nëpunësit autorizues, duke ruajtur njëherazi edhe pozicionin e koordinatorit të riskut specifikuar në Ligjin për MFK-në, neni 10, pika 1, e personit në ngarkim me menaxhimin financiar të SRSJ sipas ligjit për MFK-në, neni 5.

Nëpunësi zbatues në SRSJ, sipas MFK duhet të jetë punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike. Kjo specifikuar në MFK, neni 12, pika 1. Në nivel menaxherial të njësisë publike, është Drejtoria e SRSJ e cila përbëhet nga:

- Drejtori Ekzekutiv.
- Zëvendës Drejtori Ekonomik.
- Zëvendës Drejtori Teknik.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Kryeinfermieri i Përgjithshëm.

Sipas strukturës së SRSH. Kjo strukturë objekt auditimi, mbi terminologjinë e pozicioneve është trajtuar në raport. Për rrjedhojë, punonjës i lartë menaxherial është Zëvendës Drejtori Teknik.

Sipas Manualit të MFK, njësia për vitin 2015, nuk ka hartuar dhe dërguar në Ministri **deklaratën dhe raportin vjetor** “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Deklarata, sipas Manualit, duhet të depozitohet tek Nëpunësi i Parë Autorizues (NPA) në fund të muajit Shkurt si dhe duhet të jetë një element i raportit vjetor të performancës dhe objekt i shqyrtimit nga ana e Auditit të Brendshëm (AB) të SRSH dhe nga KLSH.

Raporti i pretenduar se është dërguar në materialin vetëdeklarues të SRSH, është raport i auditit të brendshëm, i firmosur nga Audituesi i Brendshëm, por jo nga titullari si përgjegjës për këtë raport.

Referuar planit të punës të vitit 2014, realizimi dhe risqet për vitin pasardhës, i cili specifikohet deri në Shkurt 2015, manuali i MFK përcakton përgjegjësitë. Sipas pikës 2.2.5 të Manualit të MFK, **Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave, identifikimin në të gjitha nivelet e njësisë të risqeve që kanë ndikim në përmbushjen e tyre, dhe për krijimin e një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të MFK-së në përputhje me kërkesat e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve. Titullarët e njësive (NA) janë përgjegjës përpara NPA për monitorimin dhe vlerësimin në kohën e duhur të sistemit të MFK-së, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për MFK-në.** Pra, nuk rezultojnë të jetë nisur raport vjetor në ministri në shkurt 2015, për vitin 2014, por as në Shkurt 2016, për llogari të vitit 2015. Gjithashtu ky raport, duhet të përmbante plane pune për vitin në vazhdim. Pra sipas formularit të vetëvlerësimit të SRSH, ky institucion ka nisur në Shkurt 2016, raportin në MF, por përgjatë viteve 2015 dhe 2016, por edhe vetë 2017-ën nuk ka plan pune të detajuar së çfarë dhe si planifikon SRSH të realizojë për përmbushjen e detyrimeve për MFK-në si Plani i veprimeve, Rregjisti i Riskut mbi të cilin do të ndërtohej plani i Kontrollit të Brendshëm, Indikatorët e performancës, Mashtrimi dhe korrupsioni.

-Për vitin 2015, SRSH, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Manualin për MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 54, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2, “Pyetësori i vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së”.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa “a”, dhe Manualin për MFK, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive të sektorit publik”, germa “a”, SRSH nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

Manuali i MFK Kap. IV, pika 4.2.8 specifikon përgjegjësitë e Titullarit.

- Hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë.
- Ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik të njësisë publike.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit që garantojnë qarkullimin eficient të informacionit përgjatë gjithë strukturës së njësive publike dhe shkëmbimin efektiv të informacionit me institucionet e jashtme.
- Në SRSH, për periudhën nën auditim, nuk rezulton që ndonjë Drejtor Ekzekutiv të ketë shqyrtuar rezultatet e Auditit të Brendshëm, apo të jashtëm për shkaqet dhe pasojat që kanë prurë dëmin, apo parregullsinë. Pra, Mungesa e Koordinatorit të Riskut, i cili do të përcaktonte riskun për kontrollin e Auditit të Brendshëm, nuk shman nga përgjegjësia Drejtorat Ekzekutiv i cili duke qenë nëpunës autorizuar sipas MFK, neni 10, pika 1, në kushtet e mungesës së delegimit është automatikisht ai vetë Koordinator Risku. Pra, Drejtorat Ekzekutiv, duhej të përcaktonin Planin Vjetor të Auditit të brendshëm në bazë të regjistrimit të riskut që ato vetë do të hartonin, së bashku me 5 komponentët e MFK-së të lidhur me njëri-tjetrin.
- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualin për MFK, të hartuar dhe miratuar nga MF, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”. SRSH nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, Rregullore apo, Udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.
- Për Spitalin Rajonal Shkodër, nëpunësi autorizues është Drejtori Ekzekutiv, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik.
- Të gjitha angazhimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i institucionit, në përputhje me MFK.
- Për periudhën objekt auditimi në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Kap. III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për MFK, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK”, Kreu II, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 2 dhe 8. b dhe neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, germa “ç”, njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK” dhe Manualit për MFK, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, nuk ka të përcaktuar Koordinatorin e Riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.
- Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk ka rregullore të brendshme funksionale ku janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe linjat e raportimit. Nuk ka miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësi në nivel shef sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përsëkrime detyrash individuale, e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesa lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka vlerësime

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga Drejtori Ekzekutiv nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

-Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK” dhe Manualit për MFK, Kap. II, “Monitorimi”, njësia nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

-Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë SRSH nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për MFK, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit, që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

-Të gjitha transaksionet janë të dokumentuara dhe për dokumentimin e tyre veprohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. SRSH ka patur rregullore të brendshme për vitin 1998, miratuar me vendim të ministrit. Aktualisht nuk funksionon me rregulloren të brendshme të re, e cila është e pamiruar nga Ministri i MSHMS. Nuk funksionon Këshilli Administrativ i cili kryen kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës.

Nuk kanë ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin e një Rregullore ku të materializohet ligji nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku duhet përcaktuar qartë përgjegjësitë e nëpunësit autorizues dhe zbatues.

-Mungesa e rregullores, pengon mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat e qarkullimit të informacionit, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, si edhe funksionimin sipas nivelit të hierarkisë në mënyrën shkresore dhe elektronike

-Titullari informohet në mënyrë të vazhdueshme nga Zyra e Financës për gjendjen financiare në çdo kohë. Në bazë të këtij informacioni menaxheri i institucionit shtron domosdoshmërinë e realizimit të prioritetëve që ka institucioni.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

*Lidhur me observacionin e SRSH, prot. Nr 40/5 datë 21.05.2018, mbi Projekt-Raportin e KLSH, të Z. T.M., ish-Drejtor i SRSH:*

*“Në lidhje me Menaxhimin Financiar.*

*Përsa i përket gjetjeve nga ana juaj, sqaroj se nga ana ime janë marrë masa të vazhdueshme, gjatë periudhës që kam punuar në SRSH, në mënyrë që ky spital të ketë një menaxhim të mirë financiar, duke orjentuar Zyrën e Financës që të rishikojë ligjet, ndryshimet e tyre dhe si dhe aktet ligjore e nënligjore në mënyrë që të menaxhohet sa më mirë dhe në përputhje me ligjin. Kam bindjen se Zyra e Financës gjatë kësaj periudhe, dhe jo vetëm, ka kryer një punë të mirë, duke zbatuar ligjin dhe kryer detyrat e saj. Sa më sipër kërkoj që të mbahen parasysh nga ana juaj në Raportin Përfundimtar.”*

*Grupi i Auditimit çmon se elementët e trajtuar në Projekt-Raport, nuk janë observuar në detajet e tyre konkrete, por në përgjithësi. Sipas MFK-së, janë një seri detyrash, të cilat nuk janë kompetencë e Zyrës së Financës, por Titullarit. Ato janë “Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm”, “Pyetësor i Vetëvlerësimit për Komponentët e MFK-së”, “Miratim i Planit që përmban objektivat strategjik, prioritetet e SRSH dhe planet e veprimit”, “Mungesa e Kodit të Brendshëm Etik dhe Kodit të Sjelljes”, “Caktimi i Nëpunësit Zbatues”, “Rregulla të Brendshme të miratuara për delegim kompetencash”, “Krijimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik”, “Caktimi i Koordinatorit të Riskut”, “Mungesa e Vlerësimeve periodike e punonjësve lidhur me detyrat që mbulojnë”, “Mungesa e Sistemit për monitorim dhe vlerësim të aktivitetit të SRSH”, “Mungesa e një procedure për mbledhjen, dokumentimin e gabimeve e ankesave dhe analizimin e tyre”, “Mungesa e programeve specifike për trainime të vetë SRSH, mbi punonjësit sipas pozicioneve të punës”, “Mungesa e Gjurmës së Auditimit të Brendshëm mbi operacionet kyç që ka SRSH”, “Mungesa e një Rregullore të Funksionimit të Brendshëm, të aprovuar”. Për këtë arsye, observacioni nuk merret në konsideratë, pasi nuk sjell asnjë dokument provues, që të kundërshtoj Gjetjet e evidentuara nga Grupi i Auditimit të KLSH.*

#### **10. Të tjera që mund të dalin gjatë procesit të auditimit.**

Gjatë auditimit nuk u konstatuan problematika të cilat nuk ishin pasqyruar në drejtimet kryesore të auditimit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje aparaturash mjekësore”, në vite, midis SRSH dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues, lidhur me funksionimin e sektorit të inxhinierisë klinike ose të sektorit të menaxhimit të teknologjisë së SRSH, rezultoi si vijon:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Për të gjitha defektet e ndodhura, mirëmbajtjet dhe riparimet e pajisjeve mjekësore që ka në përdorim Spitali Rajonal Shkodër, nga grupi i auditimit, nuk u evidentua regjistri i historikut të defekteve. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, lidhur me funksionimin e Sektorit të Inxhinierisë Klinike, nuk u konstatua asnjë shkresë ku të vihej në pah se ky sektor ka funksionuar në zbatim të urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore” ku midis të tjerash, citohet se ky sektor, ka si detyrë primare mirëmbajtjen dhe riparimin apo raportimin tek ASHPM, të defekteve të pajisjeve mjekësore. SRSH, në të gjitha rastet, mirëmbajtjen ose riparimin e pajisjeve mjekësore e ka kryer me të tretë duke lidhur kontrata mirëmbajtjeje. Veprime këto jo në konformitet me Ligjin nr.84/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” dhe Urdhrin nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i strukturave drejtuese në SRSH dhe vendimeve të marra, rezulton se:

-Nuk ka Këshill Administrativ, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 13, 14 dhe 15.

-Nuk ka Komision Mjekësor. Përbërja dhe kompetencat e tij përcaktohen sipas ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 dhe neni 21.

-Nuk ka Komision të Planifikimit Spitalor të Qarkut Shkodër. Përbërja dhe kompetencat e tij përcaktohen sipas ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, neni 40.

-Nuk ka Rregullore të Funksionimit të Brendshëm të SRSH. Mënyra e hartimit dhe miratimit të rregullores, përcaktohen sipas ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, pika “c” dhe neni 23, pika “2”.

-Spitali Rajonal Shkodër, nuk ka rregullore të funksionimit të Komisionit Mjekësor. Miratimi i kësaj rregullore bëhet sipas ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 19, pika “g”. Emërtesa e Nëndrejtorëve të SRSH, nuk përputhet me kërkesat e ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18 pika “b” dhe “c”. Konkretisht, Zv.Drejtori Teknik, rezulton në emërtesë si Zv. Drejtor i Shërbimeve Klinike dhe Zv. Drejtori Ekonomik rezulton në emërtesë si Zv. Drejtor i Shërbimeve Administrative. Këto ndryshime në

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

emërtesë, kanë impakt në emërimin e nëpunësit zbatues të SRSH, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 8-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:**

-Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, Drejtori Ekonomik, të marrin masa për të ngritur Këshillin Administrativ, në zbatim të rregullave të përcaktuara në ligjin për funksionimin e SRSH.

**1.2 Rekomandimi:**

-Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masa për thirrjen e Komisionit Mjekësor dhe Komitetit të Planifikimit, për të siguruar këshillimin për problematikat spitalore dhe hartimin sa më shpejt të rregullores së brendshme të funksionimit të SRSH, për të garantuar funksionalitetin e shërbimeve spitalore.

**1.3 Rekomandimi:**

-Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, të njoftojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për emërtesat e Nëndrejtorëve të SRSH dhe ndryshimet përkatëse, në zbatim të rregullave të përcaktuara në ligj.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**2. Gjetje nga auditimi:**

Të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin “Excel” pasi insitucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij në kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:**

Nga Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, të merren masat, për pajisjen me sistem të informatizuar financiar për mbajtjen e kontabilitetit, për të ruajtur dhe garantuar këtë informacion.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative marrëdhëniet e punës dhe pagave, u konstatua se:

-Në lidhje me emërimet e reja të nëpunësve për periudhën objekt auditimi, u audituan me zgjedhje 23 praktika dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatuan të meta dhe mangësi për 19 punonjës të punësuar rishtazi, pasi dokumentacioni në dosjen e personelit nuk është i rregullt dhe i plotë dhe për procedurën e marrjes në punë, nuk figuron miratimi i Ministrit të linjës. U evidentuan mangësi të theksuara të dokumentacionit në dosjet personelit, si mospërputhja e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

arsimit me pozicionin e punës, dëshmitë e penalitetit, raportet mjekoligjore, diplomat dhe listë notash, fotokopje të pa noterizuara etj. Nga ana e burimeve njerëzore, nuk janë marrë masat e duhura për plotësimin e dosjes së personelit për punonjësit. Të gjitha këto veprime nuk i përmbahen Urdhrit nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, si dhe kritereve të vendosura për plotësimin e dokumenteve që duhet të dorëzojnë punëkërkuuesit pranë SRSH.

-Gjatë vitit 2016 janë kryer gjithsej, ndërprerje të mardhënieve të punës, për 62 punonjës, ndërkohë janë punësuar 26 punonjës. Konkretisht janë kryer ndërprerje e mardhënieve të punës për 4 punonjës në muajin prill, 11 punonjës në muajin maj dhe 47 punonjës në muajin qershor 2016 (*vlen të theksohet se 43 punonjës janë larguar në datë 25.06.2016*), pra brenda 90 ditëve, është kryer ndërprerje e mardhënieve të punës, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015, datë 05.12.2015, neni 148, pika 1, ku përcaktohet se mbi 20 punonjës konsiderohet pushim kolektiv dhe nuk janë zbatuar procedurat e njoftimit me shkrim të organizatave përfaqësuese për pushim kolektiv nga puna të këtyre punonjësve si dhe nuk është marrë miratimi i Ministrit të linjës për procedurat e largimit.

-Referuar të dhënave nga SRSH, konstatohet, se është tejkuluar numri i punonjësve në periudhën Shkurt-Korrik të vitit 2016 me një numër mesatarisht mbi 62 punonjës, si pasojë e moszbatimit të strukturës së re të miratuar me Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 244 prot., datë 15.01.2016, strukturë e cila është miratuar në numrin total prej 711 punonjësish. Gjatë kësaj periudhe janë kryer ndërprerje të marrëdhënieve të punës, por janë marrë njëkohësisht, punonjës të rinj, duke tejkuluar strukturën e miratuar me 8 punonjës gjatë muajve shkurt – korrik 2016, pra edhe pse struktura ka ardhur më pak se struktura faktike, nga ana e Drejtuesve të Spitalit janë kryer emërimet të reja. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **3.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që rekrutimi në punë i punonjësve, të bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duke ndjekur etapat e duhura deri në shpalljen fitues të konkurrentit si dhe të plotësohen dosjet personale të punonjësve në detyrë. Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Burimeve njerëzore, të merren masat në të ardhmen, që në lidhje me marrjen në punë të punonjësve, të respektohet struktura organizative e miratuar.

**Menjëherë**

### **4. Gjetje nga auditimi:**

Në lidhje me zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit të SRSH, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie. Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për t'i

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

regjistruar këto prona, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se nuk është kryer asnjëherë inventari fizik në lidhje me to, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të merren të gjitha masat e nevojshme, për identifikimin, inventarizimin fizik dhe regjistrimin e aseteve në ZVRPP Shkodër, si dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i bilancit të vitit 2016, rezulton se paraqiten debitorë në vlerën 3,484,083 lekë, nga persona, të cilët kanë një detyrim të caktuar ndaj institucionit, të krijuara nga kontrollet e ushtruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetsor. Gjithsej, janë 16 persona/subjekte debitorë ndaj SRSH, dhe në lidhje me këto detyrime institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin dhe menaxhimin e debitorëve dhe nuk ka mundur të arkëtojë detyrimin e krijuar ndër vite. Institucioni u ka dërguar personave debitorë urdhër për arkëtim por nuk ka vazhduar më tej me ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, ashtu siç e kërkon Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, Pika IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, dhe shuma prej **3,484,083 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, Sektori Juridik, të marrin masa, të analizojnë situatën e debitorëve, të hartojnë një planveprim, nga ku të dalin përfundime për zgjidhjen e situatave të krijuara dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin tek organet gjyqësore.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:**

Në ambientet e Spitalit Rajonal Shkodër, u konstatuan 5 autoambulanca të cilat nuk përdoren dhe janë në gjendje të amortizuar, por nga SRSH nuk është marrë asnjë masë për vlerësimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, dhe më pas të behet nxjerrja nga bilanci si dhe shitjen e tyre për skrap nëpërmjet ankandit, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masat e duhura për vlerësimin e gjendjes së autoambulancave duke ndjekur procedurat ligjore për heqjen nga bilanci i institucionit të automjete, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit, rezultoi se gjatë vitit 2015, janë nxjerrë jashtë përdorimit, aktive të imëta, të cilat kanë përbërje material metalik, si reflektor me gaz, kazanë alumini, stativ serumi, tuba dhe rekorde bakri, kondiconerë, peshore analitike, shtretër vizite, shtrat metalik, etj., materiale të cilat mund të vlerësoheshin dhe të nxirreshin në ankand për shitje skrap, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 102 dhe 109. *(Më hollësisht trajtua në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masat, që të ndiqet procesi i inventarizimit dhe në rastet kur konstatohen materiale për nxjerrje jashtë përdorimit dhe çmohet se mund të shiten për skrap, të veprohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nxjerrjen në ankand të tyre.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:**

Me shkresën nr. 2634 prot., urdhri nr. 137, datë 18.12.2017, të drejtorit të SRSH, janë ngritur komisionet për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të institucionit, me kryetare zj. A.M., zj. S.K. dhe z. L.M. anëtar me afat përfundimi me datë 20.01.2018. Nga grupi i auditimit, u konstatua se inventarizimi i aktiveve për vitin 2017, nuk ka përfunduar duke tejkaluar afatet ligjore. Në komisionin qëndror të inventarizimit, nuk është përcaktuar nëpunësi zbatues për ndjekjen e këtij procesi, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 87 dhe pika 93. Gjithashtu, në urdhrin e ri të ngritur nga Titullari i SRSH-së, është ngarkuar specialistja e Auditit të Brendshëm të Spitalit Rajonal Shkodër, si anëtare e komisionit të inventarizimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 17, gërma “a”. Komisioni i inventarizimit, nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arsyet e gjendjes së tyre, si dhe për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, në kundërshtim nenin 85 gërma “c”, të

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e SRSH-së, Titullari, të evidentojë përgjegjësitë për tejkalimin e afatit të inventarizimeve, si dhe të marrin masat që në të ardhmen të përfundojnë procedurat e inventarizimit brenda afateve të përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtoria e SRSH-së, Titullari, të marrin masat që në të ardhmen, përbërja e anëtarëve të komisioneve të inventarizimit, të jetë sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimet dhe aktet ligjore.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procesit të inventarizimit konstatohet se nga Spitali Rajonal Shkodër, nuk janë hartuar regjistrat kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet), si dhe të gjitha objektet që ka në kontabilitet, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.

Nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrat të aktiveve të njësisë. Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të merren masat e duhura për hartimin e regjistër të kontabël të përditësuar të aktiveve, të kryhet inventarizimi fizik i të gjitha asetëve në administrim të SRSH.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:**

Për automjetet në dispozicion të SRSH, të cilat referuar kontabilitetit janë 19 mjete, rezultoi se disa prej tyre nuk kanë paguar taksat vjetore si dhe kolaudimin e tyre, çka përbën përveç gjenerimit të gjobave në sistemin e Drejtorive Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, dhe një rrezik për drejtimin e tyre pasi nuk janë certifikuar për të qarkulluar nga kompania e cila verifikon, teston dhe kolaudon fizikisht/teknikisht automjetet. Nga ana e institucionit nuk janë marrë masat e duhura çdo vit për përmbushjen e këtyre detyrimeve, pra ç’rregjistrimin e mjeteve të cilat nuk janë në përdorim, çka ka sjellë si pasojë dhe pengesë për automjetet e tjera, pasi për kryerjen e taksave të automjeteve duhet që të mos ketë detyrime të automjeteve të tjera në dispozicion të të njëjtit Subjekt/Pronar, situatë e cila rrezikon të sjellë dhe penalitete për SRSH-në

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

nga moslikujtimi i taksave të automjeteve në kohë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 8, dhe shuma prej 50,524 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:**

Nga Drejtoria e SRSH, të merren masat e duhura për të evidentuar përgjegjësitë e situatës së krijuar, si dhe paisjen me dokumentacionin e nevojshëm të automjeteve, kryerjen e kontroleve teknike të tyre, ç’regjistrimin e mjeteve të cilat nuk mund të përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi në Spitalin Rajonal Shkodër (SRSH), rezultoi se caktimi i pozicionit Nëpunësit Zbatues nuk është sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), neni 12, pika 1. Në këtë pozicion nuk është Zëvendës drejtori Ekonomik (Zëvendës drejtor i Shërbimeve Administrative), por Përgjegjësja e Financës. Këtë pozicion Përgjegjësja e Financës e ka mbajtur për periudhën nën auditim nga data 01.01.2015 deri në 22.04.2015 dhe e ka rimarrë nga data 19.12.2016 deri në fund të periudhës audituese nga data 31.12.2017. Mungon plani vjetor i punës në SRSH. Nuk mbulohet e gjithë periudha e auditimit me shembuj të gjurmëve të Auditit, sipas Manualit të MFK-së dhe Ligjit të MFK, neni 16. SRSH, nuk ka hartuar Regjistër të Riskut sipas kërkesave të Manualit të MFK dhe Ligjit të MFK, Neni 11 dhe Neni 12. Nga Nëpunësi Autorizues nuk është dorëzuar në Ministrinë e Financave Pyetësori i vetëvlerësimit për Komponentët e MFK-së. Nuk është vlerësuar mjedisi i kontrollit të brendshëm. Nuk është bërë menaxhimi i riskut, sipas objektivave SMART. Nuk ka një plan për kontrollin e brendshëm dhe për aktivitetet e kryera të pasqyruara sipas riskut që ato shfaqin. Nuk ka një Metodologji dhe listë për kontrollet e vizitat në terren. Nga Nëpunësi Autorizues nuk është dorëzuar në Ministrinë e Financave Deklarata e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm sipas Manualit të MFK dhe Ligjit të MFK, Neni 18. Nuk ka Plan të Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Nuk ka hartim të politikave për monitorim dhe ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, Rregullore apo Udhëzim për zbatimin e etikës si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Nuk ka të përcaktuar Koordinatorin e Riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Titullari i njësisë duhet të tregojë se gjurmët e auditimit kryhen për operacionet më të rëndësishme që ndodhin në njësi, veçanërisht të atyre proceseve që lidhen me arritjen e objektivave të njësisë dhe me menaxhimin e fondeve publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 167-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:**

Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masa që në vazhdimësi, të kryhet procesi i informimit të stafit drejtues mbi ligjin e MFK dhe komponentëve të tij, mbi hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

**Menjëherë dhe vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, u konstatua se në dy raste, “Blerje shtypshkrime” dhe “F.V Trarë rrugorë për Spitalin Rajonal Shkodër”, kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka qenë midis zyrtarëve të lartë drejtues të Autoritetit Kontraktor, veprime këto në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 58-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:**

Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që në vazhdimësi në ngritjen e KVO, kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të jetë ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të Autoritetit Kontraktor, me qëllim shmangien e praktikave jo në përputhje me LPP.

**Menjëherë dhe vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Ri K.i i ambienteve të reanimacionit të Spitalit Shkodër” të lidhur me datë 21.11.2016 dhe nr. prot. 2826, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSR dhe Kontraktuesit shoqëria “Gj.” SHPK, me vlerë 27,372,487 lekë pa TVSH, u konstatua se zerat e punimeve janë kryer konform kontratës, ndersa për sa i perket dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kete kontratën u konstatua se, komunikimi ndërmjet palëve nuk është bërë në rrugë zyrtare me shkresa të protokolluar, konkretisht:

- Kopja e aktit të piktimit për autoritetin kontraktor është e pa protokolluar në SR Shkodër.
- Libreza e masave nuk është e shoqëruar me skicat dhe vizatimet përkatëse.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

- Aktet e kontrollit nuk janë nënshkruar nga Drejtuesi teknik si dhe nga investitori.
- Procesverbali për përfundimin e punimeve, është i pa protokolluar në SRSH.
- Procesverbali i Kolaudimit Tekniko-Ekonomik, nuk është i protokolluar, si dhe nuk është përcaktuar data e fillimit dhe të mbarimit të kolaudimit.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimet Nr. 1 dhe 2, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, ngritja e grupit të kolaudimit për kontratën bazë është bërë rreth 4 (katër) muaj me vonesë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 145-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **13.1 Rekomandimi:**

Autoriteti Kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër, të marrë masa që në vazhdimësi për realizimin e kontratave publike për punë civile t’i kërkojnë operatorëve ekonomik, supervizorëve të mbikëqyrjes së shërbimev/punimeve si dhe kolaudatorëve, që i gjithë dokumentacioni teknik i zbatimit të punimeve të hartohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore dhe korrespondenca mes palëve të bëhet në mënyrë zyrtare. SR Shkodër për zbatimin e kontratave, në vazhdimësi të marrë masa që me deklarinimin e përfundimit të punimeve të bëjë ngritjen e grupit të kolaudimit brenda 30 ditëve nga përfundimi i tyre.

**Menjëherë**

### **14. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave dhe konkretisht për:

- a) “Mirëmbajtje e pajisjes së Rezonancës” lidhur nr. 580 prot, datë 20.02.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK.
- b) “F.V e një aparature Rezonance për SRSH”, lidhur me nr. 2132 prot, datë 04.11.2015, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga zj. Dh.U. dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK.
- c) “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner, për Spitalin Rajonal Shkodër e prodhuesit Philips/16sl” vitet 2014-2015-15.09.2016, lidhur me nr. 1766 prot, datë 15.09.2014, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. T.M. dhe Operatorit Ekonomik “S.M.” SHPK.
- d) “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner, për Spitalin Rajonal Shkodër e prodhuesit Philips/16sl” viti 2017, lidhur me nr. 233 prot, atë 24.01.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Operatorit Ekonomik “H&L.” SHPK.
- e) “Mirëmbajtje e pajisjes Skaner, për Spitalin Rajonal Shkodër e prodhuesit Philips/16sl” të lidhur me nr. 895 prot, datë 31.03.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH, përfaqësuar nga z. P.Ç. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “S.M.” SHPK. & “H&L.” SHPK përfaqësuar nga OE “S.M.” SHPK. u konstatuan si vijon:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Në kontratat e mësipërme është përcaktuar se: *Pjesët e këmbimit të defektuara apo të vjetra , pas zëvendësimit me të reja, do t'i kthehen Kontraktuesit.* Grupi i auditimit konstaton se përcaktimi i mësipërm, është në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit, sepse në DST është parashikuar që pjesët e këmbimit të defektuara apo të vjetra, pas zëvendësimit me të reja, duhet të mbahen nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në kontratë përcaktohet se: “. *Njoftimi për defektet do të kryhet në rrugë elektronike*” dhe se “*Kontraktuesi do të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrjeje*”, ndërkohë që nga auditimi i dokumentacionit teknik të vënë në dispozicion dhe konkretisht, fatura tatimore, procesverbaleve të mbajtura si dhe raporte teknike, rezulton se për shërbimet e kryera, Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer asnjë njoftim (me e mail). Ky veprim është në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ngarkon me përgjegjësi konceptuesit e kontratave (juristët sipas periudhës) dhe Titullarët e Autoritetit Kontraktor sipas periudhës së ushtrimit të detyrës. Kontratat e shërbimit nuk janë plotësuar me shtojcën e cila trajton Kushtet e Veçanta, veprim ky në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit. *(Më hollësisht trajtuar në pikë 5 dhe 6, faqe 58-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Njësia e Prokurimit dhe Juristi i SRSH, të marrin masa që në vazhdimësi, në procedurën e lidhjes së kontratës të hartojnë kontratën ashtu siç është përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit duke e plotësuar atë me kushtet e veçanta, pa devijuar nga përcaktimet fillestare. Gjithashtu gjatë zbatimit të kontratës së shërbimit për rastet konkrete por edhe në vazhdimësi të shërbimeve për pajisjet që përdoren në SRSH, pjesët e këmbimit të defektuara apo të vjetra, pas zëvendësimit me të reja nga operatori ekonomik fitues, duhet t'i kthehen Spitalit Rajonal Shkodër dhe jo të merren nga Operatorët Ekonomik. Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të autorizojë një person i cili të realizojë ndjekjen të kontratës.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave me objekt “Evadim i mbeturinave spitalore” për vitet 2015-2017 të lidhura ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “R.” SHPK., u konstatua se:

-Në të gjitha rastet, hartimi i specifikimeve teknike është bërë jo konform VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, “*Kontratat e Shërbimeve*”. Mungojnë skicat dhe hartat për ambientet e SRSH, duke bërë të pa mundur kalkulimin e saktë të sipërfaqes që do të pastrohet. Nuk jepen të dhëna për pozicionin e koshave të mbeturinave. Sasitë e mbeturinave që do të evadohen jepen në m<sup>3</sup>/ditë dhe janë të paracaktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 dhe 6, faqe 88-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa, që në vazhdimësi, specififikimet teknike të procedurave të prokurimit, të jenë të qarta e transparente duke respektuar kërkesat e LPP.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo-Dializës”, për një periudhë 1 mujore, Qershor 2016, u konstatua se:

-Urdhri i prokurimit i nxjerrë nga drejtori i SRSH, mban datën 08.06.2016. Përgjigja nga Ministria e Shëndetësisë për lejimin e SRSH që të procedojë me fillimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo-Dializës”, mban datën 14.06.2016. Si rrjedhojë, konstatohet se urdhri i prokurimit është nxjerrë pa marrë më parë miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.20, faqe 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e SRSH, Sektori i prokurimeve, të marrin masa, që në vazhdimësi, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, të ndjekin hapat ligjorë për nxjerrjen e fondit limit ose marrjen e miratimeve paraprake për fillimin e procedurave të prokurimit, konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Kite dhe Reagente për ekzaminime specifike”, të lidhur në datën 15.11.2016 me vlerë 2,686,992 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “S.” SHPK., u konstatua si vijon:

-Me shkresën me nr.2497, Prot-datë 10.10.2016, shefi i shërbimit laboratorik, B.B., formulon një kërkesë drejtuar drejtorisë së spitalit rajonal Shkodër, ku citon: “Duke parë gjendjen e vështirë përsa i përket furnizimit me kite-reagente si në laboratorin e spitalit edhe atë të poliklinikës, ju lutemi të na krijoni mundësinë të na furnizoni me materialet e poshtë shënuara. Nëpërmjet kësaj, ne do të mund të realizonim ekzaminime mjaft të domosdoshme dhe specifike si matja e gazeve në gjak, dozimi i hormoneve, markuesit tumoral, dozimi i disa medikamenteve apo dhe realizimi brenda të gjithë parametrave bashkëkohorë i analizës së gjakut komplet për laboratorin e poliklinikës. Në këtë mënyrë do na krijoni mundësinë që të rrisim si nga ana sasiore ashtu edhe ajo cilësore gamën dhe cilësinë e analizave në raport me kohën dhe kërkesat në rritje që ka spitali”. Nga verifikimi i “Pasqyrave të aktivitetit mjekësor për shërbimet e ofruara për pacientët e shtruar në spital” për vitin 2014, konstatohet se tek evidenca e ekzaminimeve klinike lidhur me analizat e laboratorit klinik-biokimik, janë kryer në total 32,117 ekzaminime. Nga kontrolli i pasqyrave të vitit 2015, konstatohet se numri i ekzaminimeve për të njëjtin laborator, është ulur në 29,883 ekzaminime. Më tej, nga kontrolli i pasqyrave të vitit 2016,

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

konstatohet se numri i ekzaminimeve është 1,934 ekzaminime. Pra, deri këtu, duket qartazi se kërkesa e Sh. të shërbimit laboratorik është e pa bazuar në argumente dhe fakte. Pra, numri i ekzaminimeve ka qenë në ulje nga viti në vit. Si rrjedhojë, grupi i auditimit, në pamundësi të kalkulimeve të sasisë së materialeve mjekësore që janë prokuruar më tepër se nevojat, konkludon se SRSH, nuk ka bërë një analizë përpara nxjerrjes së vlerës së fondit limit duke mos investiguar më parë, pasqyrat e aktivitetit mjekësor të SRSH në bashkëpunim me Sektorin e Kostos.

-Gjithashtu, tek specifikimet teknike, cilësohet se operatori ekonomik i shpallur fitues, duhet të sjellë dhe pajisje mjekësore si “analizator hematologjik” apo “analizator hormonal-imunologjik” ose dhe ai i “gazeve”, pa marrë në konsideratë Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 3272, datë 11.09.2007, tek i cili specifikohet qartazi se makineritë mjekësore që përdoren në Spital, duhet të plotësojnë standardet për tu përdorur dhe nuk mund të kërkohen nga një operator që shpallet fitues pa u çertifikuar më parë nga Agjencia Shqiptare e Pajisjeve Mjekësore.

-Urdhri i prokurimit i nxjerr nga drejtori i SRSH, është me fond limit 2,243,000 lekë pa tvsh. Komisioni i përlogaritjes së vlerës së fondit limit, e ka përcaktuar fondin limit në vlerën e 2,242,700 lekë pa tvsh. Pra, urdhri i prokurimit, ka të cituar një fond limit të rritur në vlerën e 300 lekë duke anashkaluar nenin 57 dhe nenin 61 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.15, faqe 103-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:**

-Drejtorja e SRSH, Sektori i Kostos, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në vazhdimësi, përpara miratimit të vlerës së fondit limit për blerje materiale mjekimi, të krahasojnë nevojat reale të Spitalit Rajonal Shkodër, me gjendjen e magazinës apo të depos farmaceutike për të shmangur në këtë mënyrë, prokurimin e sasive të tepërta që në fund mund të sjellin efekte negative financiare ose dëm ekonomik për buxhetin e Shtetit.

**Menjëherë**

**17.2 Rekomandimi:**

-Drejtorja e SRSH, Sektori i Inxhinierisë Klinike, të marrin masa që në të ardhmen, në të gjitha procedurat e prokurimit, të mos të kërkohen të sillen në Spital nga operatorët ekonomik të shpallur fitues, makineri ose pajisje mjekësore që nuk plotësojnë standardet Evropiane dhe mjekësore sipas urdhrave dhe rregullave në fuqi lidhur me “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**Menjëherë**

**17.3 Rekomandimi:**

-Drejtorja e SRSH, Sektori i Prokurimeve, të marrin masat që në të ardhmen, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, të argumentojnë vlerën e fondit limit, konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratës së nënshkruar me datë 20.03.2015, me objekt “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo-Dializës”, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK., me vlerë 44,964,300 lekë me tvsh, konstatohet se:

-Nga procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të materialeve mjekësore, nuk specifikohet ose nuk citohet data e prodhimit të materialeve mjekësore. Nga verifikimet në depon farmaceutike të Spitalit të Shkodrës, tek etiketat/paketimet e materialeve mjekësore nuk u evidentua data e prodhimit të tyre. Duke mos ditur datën e prodhimit të këtyre materialeve, është e pamundur të verifikohet nëse plotësohet një nga kushtet kryesore të kontratës dhe pikërisht pika 8 e nenit 3 të kontratës së lidhur, kushtet e furnizimit ku citohet se: *“Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës së mallit”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.21, faqe 135-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Prokurimeve, Komisionet e marrjes në dorëzim, të marrin masa që në vazhdimësi, për marrjen në dorëzim të materialeve mjekësore, ti referohen kushteve të kontratës së lidhur dhe në respekt të tyre, të kërkojnë çertifikata të prodhuesit ku të vërtetohet data e prodhimit e materialeve mjekësore por njëkohësisht kjo datë, të jetë e shënuar tek etiketat ose paketimet e këtyre materialeve në konformitet me ligjin e barnave në Republikën e Shqipërisë.

**Vazhdimisht**

**19. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratës me objekt “Blerje pajisje për kirurgjinë”, të lidhur në datën 28.09.2015 me vlerë 1,990,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK., u konstatua si vijon:

-Tek kontrata e lidhur, neni 4, Specifikimet Teknike, pika 2, citohet : *“Kontraktuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike për një periudhë jo më pak se 1 vit nga furnizimi me këtë aparaturë”*. Nga procesverbali i njësisë së prokurimit mbi hartimin dhe miratimin e DST-së me nr.94, Prot-datë 24.08.2015, tek kapitulli 2.3, Kapaciteti Teknik, pika 7, citohet: *“Deklaratë për periudhën e garancisë së pajisjes, gjatë për një periudhë jo më pak se 2 vite nga instalimi i aparaturave”*. Nga DST-ja elektronike, u konstatua se tek, Kapitulli 2, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 8, citohet: *“Deklaratë për periudhën e garancisë së pajisjes, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike për një periudhë jo më pak se 2 vite nga instalimi i aparaturave”*. Si rrjedhojë, Drejtori i SRSH-së, zj.Dh.U., ka lidhur një

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

kontratë me operatorin ekonomik “M.” SHPK., duke devijuar kushtet e saj dhe duke ulur periudhën e garancisë së mirëmbajtjes së shërbimit nga 2 vite që ishte e parashikuar edhe tek specifikimet teknike nga njësia e prokurimit por edhe tek DST-ja elektronike, në 1 vit pra në favor të operatorit ekonomik dhe jo në favor të institucionit që përfaqëson. Veprimet e mësipërme, nuk janë aspak në interesin ekonomik të SRSH, pasi edhe pse për dy vjet pas datës së lidhjes së kontratës nuk ka pasur defekte apo kontrata për mirëmbajtjen e pajisjes së kirurgjisë, nëse do të kishte ndodhur defekt, do të duhej të prokurohej për mirëmbajtjen e pajisjeve pas afatit 1 vjeçar të garancisë kur në fakt mund të prokurohej pas 2 vitesh.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit, lidhur me zbatimin e kontratës, nuk u evidentua manuali i përdorimit të pajisjes në gjuhën shqipe. Nuk u konstatua relacioni mbi kontrollin që duhej të ushtrohej për të verifikuar përputhjen e pajisjes ose të pjesëve të saj me ato që kërkohen në dokumentacionin teknik. Nuk është kontrolluar shenja CE nëse pajisja plotëson standardet e zbatuara dhe qëllimin e përdorimit. Nuk është kontrolluar nëse ka dokumentacion teknik dhe nëse është i përshtatshëm me pajisjen. Nuk është verifikuar nëse etiketimi është bërë në përputhje me standardet përkatëse dhe në mënyrë të përshtatshme. Sektori i Inxhinierisë Klinike, nuk ka kryer ndonjë kontroll për sigurinë e pajisjes si elektriciteti ose rrjedhje të ndryshme gazi, etj. Nuk është kryer rregjistrim në sistemin e informacionit të pajisjeve mjekësore pasi nuk është specifikuar etiketa e inventarit të pajisjes mjekësore. Nga raporti i testimit të pajisjes, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë kontroll funksionimi duke përshkruar dhe parametrat teknik të pajisjes. Nuk janë kryer trajnimet e mundshme për përdorimin e pajisjes. Nuk ka ndonjë të dhënë nëse janë planifikuar pjesët e ndërrimit apo edhe mirëmbajtja parandaluese. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.22, faqe 138-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në vazhdimësi, të hartohen kontratat me kushtet e njëjta që përshkruhen tek DST kushte mbi të cilat është bërë vlerësimi dhe shpallja fitues i operatorit ekonomik për procedurën e prokurimit.

**Menjëherë**

**19.2 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Inxhinierisë Klinike, të marrin masa që në vazhdimësi, për miratimin e shërbimeve apo riparimeve të kryera nga operatorët ekonomik përsa i përket pajisjeve mjekësore, të procedojnë konform urdhrave dhe rregullave në fuqi mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**Menjëherë**

**20. Gjetje nga auditimi:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve të Dializës”, të lidhura përkatësisht në datën 25.08.2014 me vlerë 1,197,360 lekë me tvsh dhe në datën 24.04.2015 me vlerë 1,798,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “B.A.” SHPK., u konstatua si vijon:

Mungonte dokumentacioni teknik tek i cili ku duhej të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u konstatua nga asnjë akt apo procesverbal të mbajtur se pjesët e furnizuara dhe të vendosura si të reja, kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet evropiane mbi aparaturat mjekësore dhe janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese. Sektori i Inxhinierisë Klinike të Spitalit Rajonal Shkodër, nuk i është përmbajtur kontratës së lidhur midis palëve, dhe konkretisht kushtit se: *“Organizimi, realizimi, dokumentacioni i blerjes së pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve për aparaturat/pajisjet mjekësore, do të realizohet në përputhje me urdhrin nr. 3272, Prot-datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, me objekt Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri”*.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.9 dhe 5.18, faqe 83-86 dhe 120-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Inxhinierisë Klinike, të marrin masa që në vazhdimësi, për miratimin e shërbimeve apo riparimeve të kryera nga operatorët ekonomik përsa i përket pajisjeve mjekësore, të procedojnë konform urdhrave dhe rregullave në fuqi mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i 4 procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt:

**a)** “Riparim dhe Mirëmbajtje aparatrash (Laparoskopi–Orologji)”, të lidhura përkatësisht në datën 15.07.2016 me vlerë 3,655,800 lekë me tvsh dhe në datë 27.12.2017 me vlerë 1,930,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK.

**b)** “Mirëmbajtje e pajisjeve të Dializës”, sipas kontratave të lidhura përkatësisht në datën 25.08.2014 me vlerë 1,197,360 lekë me tvsh dhe në datën 24.04.2015 me vlerë 1,798,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “B.A.” SHPK.,

**c)** “Riparim dhe shërbim i aparatrave anestezi-ventilator”, sipas kontratës së lidhur në datën 04.05.2015 me vlerë 3,134,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK., u konstatua si vijon:

-Procedurat e mësipërme të prokurimit, janë iniciuar në kundërshtim me ligjin nr.89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”, në kundërshtim me Urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Pajisjeve Mjekësore), sipas kapitullit

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

II, pika 2.3.1 të urdhrat të mësipërm. Drejtori i SRSH-së, ka nxjerr urdhrat e prokurimit, pa pasur më parë një informacion të detajuar nga Sektori i Inxhinierisë Klinike të SRSH-së, konform kapitullit III të urdhrat të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6. Gjithashtu është paracaktuar fondi limit i procedurave të prokurimit për defektet që mund të ndodhin në të ardhmen, veprim ky në kundërshtim me pikën 3.4.5, të urdhrat të mësipërm, ku citohet se: “.Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet si diçka e paplanifikuar”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.13, faqe 93-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandimi:**

Drejtorja e SRSH, Sektori i Inxhinierisë Klinike, Sektori i Menaxhimit të Teknologjisë, Sektori Juridik, Sektori i Prokurimeve, Sektori i Kostos, të marrin masa që në vazhdimësi, të bashkërendojnë punën midis njëri-tjetrit, dhe përpara se të kryejnë një procedurë prokurimi për mirëmbajtje/riparim paisjeje mjekësore, të komunikojnë me Agjencinë Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore ose Qendrën Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore pranë Ministrisë së Shëndetësisë, konform rregullave dhe urdhrave në fuqi, mbi “Politikat kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**Vazhdimisht**

**22. Gjetje nga auditimi:**

**a)** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të kontratave shtesë me objekt “Mirëmbajtje të pajisjeve të Dializës”, përkatësisht me nr. 248 prot, datë 05.02.2015, me vlerë 236,400 lekë dhe me nr. 378 prot, datë 07.03.2016, me vlerë 360,000 lekë, të lidhura midis SRSH dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.19, faqe 129-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**b)** Nga auditimi i procedurës së prokurimit dhe zbatimit të kontratës së lidhur në datën 04.05.2015, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “M.”SHPK., me vlerë 2,612,400 lekë pa tvsh dhe objekt “Riparim dhe shërbim i aparaturave anestezi-ventilator” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.17, faqe 111-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**c)** Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje aparaturash (Laparoskopi–Orologji)”, të lidhura përkatësisht në datën 15.07.2016 me vlerë 3,655,800 lekë me tvsh dhe në datë 27.12.2017 me vlerë 1,930,800 lekë me tvsh ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.10, faqe 80-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Konstatohet si vijon:

-Për procedurat e mësipërme, në dosjet e zbatimit të kontratave, nga procesverbalet e mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimeve të kryera, nuk përmendet fakti që pjesët e ndërruara ose të riparuar janë brenda garancisë konform kushteve të kontratave. Nuk u konstatua ndonjë dokument ku të vërtetohej se pjesët e hequra si të dëmtuara/kontaminuara janë magazinuar pranë SRSH-së, në ruajtje si pjesë që duhen analizuar për gjetjen e shkakut të dëmtimit të tyre. Nuk u

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

konstatua ndonjë akt apo procesverbal i mbajtur se pjesët e furnizuara dhe të vendosura si të reja, kanë kodet përkatëse që përputhen me standardet europiane mbi aparaturat mjekësore dhe janë të reja dhe origjinale të firmës prodhuese. Sektori i Inxhinierisë Klinike të Spitalit Rajonal Shkodër, nuk i është përmbajtur kushteve të kontratave të lidhura midis palëve, dhe konkretisht kushtit se: *“Organizimi, realizimi, dokumentacioni i blerjes së pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve për aparaturat/pajisjet mjekësore, do të realizohet në përputhje me urdhrin nr.3272, Prot-datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë, me objekt Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri”.* (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.10, faqe 81-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Tek kontrata shtesë, me nr. prot. 378, datë 07.03.2016, u konstatua se kjo kontratë, nuk përputhet me kontratën bazë. Vlera e kontratës bazë, është 1,798,800 lekë. Vlera e shtesës së miratuar, është 360,000 lekë. Si rrjedhojë, bazuar tek neni 20 i kontratës bazë, me nr.915, Prot-datë 24.04.2015, shërbimet shtesë, nuk duhet të tejkalojnë 20% të vlerës së kontratës bazë. Nga kalkulimet, konstatohet se 20% e vlerës së kontratës bazë, është 359,760 lekë dhe jo 360,000 lekë sa është në fakt vlera e shtesës së lidhur. Është vepruar në kundërshtim me nenin 20, të kontratës bazë ose në kundërshtim me nenin 22 të DST, duke lidhur kontratën shtesë në një vlerë më të lartë se 20% e vlerës së kontratës bazë. Sa më sipër, mban përgjegjësi, Titullari i SRSH, zj. Dh.U.

**22.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Inxhinierisë Klinike, të marrin masa që në vazhdimësi, për miratimin e shërbimeve apo riparimeve të kryera nga operatorët ekonomik përsa i përket pajisjeve mjekësore, të procedojnë konform urdhrave dhe rregullave të përcaktuara mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”.

**22.2 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në vazhdimësi, të argumentojnë arsyet e lidhjes së kontratave shtesë dhe njëkohësisht, objekti dhe kushtet e tyre, tu referohen objektit dhe kushteve të kontratave bazë.

**Vazhdimisht**

**23. Gjetje nga auditimi:**

Referuar urdhrin nr. 13 prot, datë 26.01.2017 nga Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër është krijuar komisioni i blerjeve me vlera të vogla në të cilin është caktuar znj. M.N. si anëtare e komisionit, ndërkohë që është dhe në pozicionin e nëpunësit zbatues, me detyrë shefe e Financës. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, pika 5, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 52, dhe me Rregulloren e Brendshme të Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori Ekonomiko Financiar, Seksioni II, Detyrat e Sektorit të Financës, Kryetari i Degës së Financës, pika 13.

Për vitin 2015 janë kryer 3 procedura me vlerë të vogël për “Riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, blerje goma, vajra, filtra etj.” në shumën totale 1,633,300 lekë duke e copëzuar fondin, dhe konkretisht është kryer procedura “Riparim

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

mirëmbajtje automjetesh”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, procedura “Blerje goma”, me fond limit në shumën 583,300 lekë dhe, procedura “FV filtra, vaj, alkol makinash dhe gjeneratori”, me fond limit në shumën 250,000 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla.

Për vitin 2017 janë kryer 2 procedura me vlerë të vogël në shumën totale 1,594,973 lekë duke e copëzuar fondin, dhe konkretisht është kryer procedura “FV Aksesit elektronik me karta për personelin dhe administratën e Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit në shumën 799,973 lekë, dhe procedura “FV Mbjajtje e sistemit për mbajtjen e radhes për pacientet e Sp Rajonal Shkodër”, me fond limit në shumën 795,000 lekë procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla.

Për vitin 2017 janë kryer 2 procedura me vlerë të vogël për “Blerje kompjutera, printera dhe laptop” në shumën totale 1,600,000 lekë duke e copëzuar fondin, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje kompjutera dhe printera”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, dhe procedura “Blerje laptop për recetat elektronike”, me fond limit në shumën 800,000 lekë procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi dhe jo me procedurën blerje me vlera të vogla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 159-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **23.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e SRSH dhe Sektori i prokurimeve, të marrin masa, për të ngritur Komisionin për blerjet me vlera të vogla në përputhje me përcaktimin e LPP. Gjithashtu të merren masa, për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga titullari.

Të merren masat për të mos përsëritur shkeljet e konstatuara në këtë material auditimi dhe të nxirren përgjegjësitë për copëzimin e fondeve.

**Menjëherë**

### **24. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje aparaturash mjekësore”, në vite, midis SRSH dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues, lidhur me funksionimin e sektorit të inxhinierisë klinike ose të sektorit të menaxhimit të teknologjisë së SRSH, rezultoi si vijon:

-Për të gjitha defektet e ndodhura, mirëmbajtjet dhe riparimet e pajisjeve mjekësore që ka në përdorim Spitali Rajonal Shkodër, nga grupi i auditimit, nuk u evidentua regjistri i historikut të defekteve. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, lidhur me funksionimin e Sektorit të Inxhinierisë Klinike, nuk u konstatua asnjë shkresë ku të vihej në pah se ky sektor ka funksionuar në zbatim të urdhrat të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore” ku midis të tjerash, citohet se ky sektor, ka si detyrë primare mirëmbajtjen dhe

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

riparimin apo raportimin tek ASHPM, të defekteve të pajisjeve mjekësore. SRSH, në të gjitha rastet, mirëmbajtjen ose riparimin e pajisjeve mjekësore e ka kryer me të tretë duke lidhur kontrata mirëmbajtjeje. Veprime këto jo në konformitet me Ligjin nr.84/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” dhe Urdhrin nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 171-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, të marri masa që në të ardhmen:

-Të analizojë punën e Sektorit të Inxhinierisë Klinike, duke vlerësuar rendimentin dhe arritjet e objektivave të këtij Sektori dhe në çdo rast, të marrë vendimet e duhura për rritjen e kapaciteteve teknike me qëllim shmangien e kryerjes së procedurave të prokurimit për mirëmbajtje ose zëvendësim pjesësh rezervë të pajisjeve mjekësore të cilat mund dhe duhet të administrohen nga Sektori i Inxhinierisë Klinike, duke ulur në këtë mënyrë, shpenzimet e tepërta, me efekte financiare negative, që mund të rezultojnë në dëme ekonomike për buxhetin e Shtetit.

**24.2 Rekomandimi:**

-Për mirëmbajtjen apo riparimin e pajisjeve mjekësore të Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Inxhinierisë Klinike, ti përmbahet rigorozisht, duke kryer në fillim kontrollin dhe evidentimin e problemit/defektit të pajisjeve mjekësore dhe pasi të konkludojnë se ky sektor, nuk ka kapacitete për të mirëmbajtur apo riparuar pajisjet mjekësore, pas komunikimit dhe miratimit të ASHPM-së, vetëm atëherë të fillojnë procedurat e prokurimit për mirëmbajtje ose riparim.

**Menjëherë**

**B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “b”, Spitali Rajonal Shkodër, të kontabilizojë dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **19,114,812 lekë** dhe **13,376 \$** në mënyrë analitike si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:**

-Spitali Rajonal Shkodër, që prej vitit 2005, ka pas në funksionim repartin e Hemo-Dializës me 9 makineri mjekësore. Në fillim të vitit 2016, MSH, me një sër shkresash, ka njoftuar SRSH se duhet të transferojë të sëmuret që do të marrin shërbimin e dializës në Qendrën e re të dializës në Spitalin e Shkodrës, në zbatim të kontratës së koncesionit të lidhur

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

ndërmjet MSH dhe shoqërisë D. shpk me datë 10.02.2016, për ofrimin e shërbimit të dializës në Vlorë, Shkodër, Lezhë, Korçë dhe Elbasan. Për qytetin e Shkodrës, funksionimi i Qendrës së re të dializës, do të fillojë me datë 01.07.2016.

Nga auditimi, u konstatua se për periudhën nga muaji shkurt 2016 kur është lidhur kontrata për shërbimin e hemodializës nga MSH dhe deri në muajin qershor 2016 kur ka filluar të funksionojë qendra e re e dializës, rezulton se në Spitalin Rajonal Shkodër, funksiononte dhe ofrohej shërbimi pa ndërprerje i dializës nga 9 makineri. Regjistri i pacientëve që merrnin shërbimin e Hemo-Dializës (së vjetër) në Spitalin Rajonal të Shkodrës që prej vitit 2005 deri në Qershor të vitit 2016, ishte i plotësuar deri më datë 02.07.2016.

Pajisjet ekzistuese të hemodializës, rezultojnë se janë lënë të mbyllur tek reparti i vjetër i Hemo-Dializës dhe janë jashtë funksionit, kjo për arsye të abandonimit dhe jo për arsye të mosfunksionimit të tyre. Nga inspektimi dhe verifikimi u konstatua se ekranet e pajisjeve, funksiononin normalisht, në gjendje pune rezulton edhe impianti i ujit të dializës së vjetër. Makineritë e Hemo-Dializës së vjetër, kishin numrat e tyre të inventarit dhe u identifikuan lehtësisht duke u bazuar edhe tek procesverbali i mbajtur në periudhën e investimit viti 2005.

Përpara ose në kohën që Ministria e Shëndetësisë vendosi të kryejë një investim për një repart Hemo-Dialize në Spitalin Rajonal Shkodër, drejtori i Spitalit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të vënë në dijeni MSH për ekzistencën e repartit të hemodializës i cili funksiononte në këtë spital që në vitin 2005.

Në fakt, drejtori i SRSH, duhej të informonte Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrën Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, se Spitali Rajonal Shkodër, kishte një repart Hemo-Dialize në funksion të plotë e madje me kontrata mirëmbajtjeje që prej investimit fillestar, me 9 makineri të markës Innova Hospal. Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, duhet të kërkonte nga Ministria e Shëndetësisë dhe specialistët e Agjencisë Shqiptare të Pajisjeve Mjekësore, që të inspektonin ambientet e Hemo-Dializës ekzistuese, për të gjykuar nëse pajisjet e Hemo-Dializës ekzistuese do të vazhdonin të funksiononin për SR Shkodër apo do të dhuroheshin në një Spital tjetër p.sh tek Spitali i Kukësit, që nuk e ka pasur komoditetin e këtij shërbimi. Për sa më lart, veprimet dhe mosveprimet e drejtorit të SRSH, janë në kundërshtim me urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë “Mbi politikat kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri”. Vlera fillestare e investimit të kryer në vitin 2005, për repartin e Hemo-Dializës së Spitalit Rajonal Shkodër, është **22,308,195 lekë** (sipas pasqyrave financiare të vitit 2005) dhe njëkohësisht duke ditur se norma e amortizimit vjetor të makinerive e pajisjeve operationale është 5.8 % referuar UMF nr.14 datë 28.12.2006, konkludojmë se vlera e makinerive mjekësore të Hemo-Dializës së vjetër, **në momentin e abandonimit të tyre**, deri në fund të muajit Qershor 2016, (koha kur u vendos në funksion repartit i Hemo-Dializës së re me koncesion nga Ministria e Shëndetësisë) **pa llogaritur vlerat e investuara në vite për mirëmbajtjen e makinerive**, është **11,629,695 lekë**. Lënia në mëshirë të fatit, e 9 makinerive mjekësore të markës Innova - Hospal të repartit të Hemo-Dializës ekzistuese të SRSH, me rëndësi jetike për shëndetin

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

publik, ka ndikuar negativisht në shëndetin publik dhe mbi të gjitha është veprim në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit të fondeve publike. Vlera e makinerive të repartit të Hemo-Dializës ekzistuese të SRSH-së, prej **11,629,695 lekë** (e llogaritur deri në Qershor 2016), **përbën dëm ekonomik të parikuperueshëm duke ngarkuar me përgjegjësi, drejtorin e SR Shkodër, z. P.C. për periudhën nga data 05.05.2016 deri në datën 06.12.2017.**

**Kjo vlerë, do të konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin që 9 makineritë e markës Innova-Hospital të Hemo-Dializës së vjetër, do të përdoren nga SR Shkodër duke u shërbyer pacientëve, ose do të transferohen në një Spital tjetër (p.sh SR Kukës) për tu shërbyer pacientëve të atij Spitali.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.11, faqe 84-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:**

Spitali Rajonal Shkodër të insistojë tek Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Pajisjeve Mjekësore, që 9 makineritë/pajisjet e dializës, të vendosen në efijencë për nevojat e pacientëve të SR Shkodër ose dhurimin e këtyre pajisjeve tek një Spital tjetër (p.sh Spitalit të Kukësit) që nuk e ka këtë shërbim, konform rregullave dhe urdhrave në fuqi mbi “Politikat kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”, me qëllim ofrimin e shërbimit jetik të dializës tek një numër më i lartë pacientësh.

*Menjëherë*

**1.2 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për mos vendosjen në funksion të 9 pajisjeve dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **11,629,695 lekë**, nga z. P.Ç., në rast të mos përmbushjes së ***rekomandimit 1.1 pika B***(Më sipër).

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kontratën e punimeve civile me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër” të lidhur me datë 21.11.2016 dhe nr. prot. 2826, ndërmjet Autoritetit Kontraktor SRSH dhe Kontraktuesit shoqëria “Gj.” SHPK, me vlerë 27,372,487 lekë pa TVSH u konstatua se: janë likuiduar më tepër në shumën 2,333,900 lekë si pasojë e përfshirjes në situacionin e punimeve të vlerës së TVSH-së së pajisjeve në kundërshtim me UKM Nr. 2, datë 08.05.2003, me VKM Nr. 514, datë 15.08.2007, me UKM Nr. 1, datë 16.06.2011, ku përcaktohet se formati i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet. Si rrjedhojë, vlera

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**2,333,900 lekë, përbën dëm ekonomik** dhe i duhet kërkuar operatorit ekonomik “Gj.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.3, faqe 145-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:**

Të merren masa nga Spitali Rajonal Shkodër, që t’i kërkojë operatorit ekonomik “Gj.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **2,333,900 lekë**, të përfituar më tepër për përfshirjen e vlerës së TVSH-së për pajisjet e situacionuara në zbatimin e kontratës me objekt “Ri K.i i ambienteve të reaminacionit të Spitalit Shkodër”.

*Deri më datë 31.07.2018*

**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi mbi të ardhurat dytësore të kontratës së qirasë me objektit “Ish punti i gjakut-Arka e pranimit, spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>”, lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër, përfaqësuar nga z. M.Ç. dhe qiramarrësit z. N.D., person fizik u konstatua se:

Sipërfaqja e objektit është shtuar me 138.7 m<sup>2</sup>. Nga rillogaritja e objektit me sipërfaqe të shtuar, vlera e pagesës është 138.7 m<sup>2</sup> x 1 \$ = 138.7 \$ në muaj. Llogaritja e vlerës së qirasë për periudhën e shtesës nga viti 2008 deri me datë 14.04.2016 (ku pronësia truall dhe ndërtesë prej 138.7 m<sup>2</sup> rezulton me certifikatë pronësie) është 138.7 m<sup>2</sup> x 1 \$/m<sup>2</sup> x 96.44= 13,376 \$. Nga neglizhenca e Drejtorisë së SRSH për shtesën e sipërfaqes prej 138.7 m<sup>2</sup> nga viti 2008 deri më datë 14.04.2016 nuk është arkëtuar vlera prej 13,376 \$. Këto veprime, janë në kundërshtim me VKM Nr. 54, datë 05.02.2014, kapitulli III, tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë Shtetërore, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Vlera prej **13,376 \$**, përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** dhe ngarkon me përgjegjësi administrative ish Drejtorët e Spitalit Rajonal Shkodër sipas periudhës së ushtrimit të detyrës; zj. A.K.; z. N.K.; z. A.Y.; z. T.M. dhe zj. Dh.U. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 163-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:**

Nga Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të merren masa, që të rinovojnë kontratën e nënshkruar midis palëve, e cila të pasqyrojë sipërfaqen reale të shfrytëzimit dhe vlerën koresponduese konform rregullave të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

*Deri më datë 31.07.2018*

**3.2 Rekomandimi:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Nga Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financave, të merren masa, që t’i kërkojnë personit përfitues qiramarrës, vlerën e qirasë prej **13,376 \$**, nga mos arkëtimi i të ardhurave për sipërfaqen e shtuar nga viti 2008 deri më datë 14.04.2016.

*Deri më datë 31.07.2018*

**4. Gjetje nga auditimi:**

Gjatë auditimit është konstatuar se nga mos ndjekja e procedurave për likuidim vullnetar të vendimeve gjyqësore, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përmbarimore për 9 punonjësit e larguar, në shumën **485,698 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 485,698 lekë, konkretisht nga z.T.M. shuma prej 38,600 lekë, nga znj. Dh.U. shuma prej **136,929 lekë** dhe nga z. P.Ç. shuma prej 310,169 lekë, sipas njohjes së vendimeve të Gjykatës së Apelit, për kohën që kanë qenë në detyrë.

*Deri më datë 30.06.2018*

**5. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje medikamente për kimioterapinë”, e ndarë në lote, është lidhur kontrata nr. 2973 prot, datë 06.12.2016, për lotin e 4 për medikamentin Oxaliplatine 20 ml, për lotin e 7 për medikamentin Trastuzumab dhe lotin e 9 për medikamentin Oxaliplatine 10ml, me vlerë 3,273,128 lekë midis SRSH-së përfaqësuar nga drejtori P.Ç. dhe operatorit ekonomik “R.F.” SHPK. me afat deri më 15.12.2016, rezulton se:

-Nga auditimi i dokumentacionit financiar të dosjes së zbatimit të kontratës, u konstatua një vlerë e pa likuiduar që i përket lotit të 9 për medikamentin Oxaliplatine (5mg/ml-10ml). Vlera e palikuiduar është 92,200 lekë, që i përket medikamentit Oxaliplatine (5mg/ml-10ml). Bazuar tek neni 8 i kontratës së lidhur midis palëve, operatori ekonomik “R.F.” SHPK., duhej të penalizohej me 25% të vlerës së kontratës pasi nuk ka sjellë të gjitha medikamentet sipas listës referuar kontratës së lidhur. Vlera e penalitetit që i duhej mbajtur operatorit ekonomik “R.F.” SHPK., është **818,282 lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.14, faqe 100-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të marrin masa, që t’i kërkojnë operatorit ekonomik “R.F.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës **818,282 lekë**, si shumë që i përket penalitetit për mos plotësim ose mos ekzekutim të kontratës.

*Deri më datë 31.07.2018*

#### **6. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Ri K.i i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë”, të lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “K.G. K.” SHPK., në datën 13.10.2015, me vlerë 7,098,628 lekë me TVSH, konstatohet si vijon:

-Nuk ka situacion përfundimtar të punimeve të protokolluar pranë SRSH-së dhe as ndonjë akt të marrjes në dorëzim nga SRSH, të punimeve të kryera nga operatori ekonomik “K.G. K.” SHPK. Të gjitha situacionet pjesore të dorëzuara dhe të likuiduara nga SRSH, nuk kanë bashkangjitur asnjë relacion dhe për më tepër nuk u gjet librezë masash apo ditar punimesh duke e bërë të pamundur auditimin e zbatimit të kontratës. Është lidhur një kontratë shtesë (në kohë) midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik për zgjatje të afatit të punimeve me afërsisht 6 muaj edhe pse afati i kontratës bazë është vetëm një muaj. Shtesa e kontratës në kohë, është e pa justifikuar jo vetëm për arsye të zgjatjes jashtë kufijve logjike të afateve të ekzekutimit por për më tepër, arsyet e zgjatjes së këtyre afateve, nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratës. Objekti i kontratës është “Ri K. i ambienteve ku do të instalohet aparatura e angiografisë” kurse zgjatja ka si arsye, mos vendosjen e kabinës tip BOX dhe të transformatorit kur në të njëjtën kohë, të vetmet zëra punimesh që kanë të bëjnë me transformatorin apo kabinën tip BOX sipas preventivit të punimeve, janë zërat që i përkasin punimeve të ndërtimit lidhur me bazamentin e gjeneratorit dhe jo ato që pretendohen tek kontrata shtesë. Rrjedhimisht, zgjatja ose amendamenti i kontratës, është bërë në kundërshtim me nenin 38 të kontratës së lidhur, pika 38.2 pasi kjo zgjatje nuk i referohet objektit të kontratës bazë. Pra, në asnjë zë të preventivit dhe të aneksit të kontratës së lidhur midis palëve, nuk citohet se operatori ekonomik ka si detyrim *“Lidhjen e pajisjes së Angiografisë me transformatorin, gjeneratorin dhe me burimin e energjisë elektrike”*. Gjithsesi, fakti që nuk ka një situacion përfundimtar konform nenit 41 të kontratës së lidhur por mbi të gjitha, fakti që nuk ka një datë ekzakte të përfundimit të punimeve, operatorin ekonomik “K.G. K.” SHPK., duhej të penalizohej me 25 % të vlerës së kontratës bazë, pasi nuk gjen zbatim asnjë penalizim tjetër sipas nenit 37, të kontratës së lidhur, gërma “a”, “b”, dhe “c” ku në të gjitha rastet nuk ka asnjë referencë të datës së përfundimit të kontratës dhe si e tillë nuk mund të kalkulohej ditët vonesë. Si rrjedhojë, vlera e penalitetit që i duhet mbajtur operatorit ekonomik “K.G. K.” SHPK, është **1,774,657 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.7, faqe 153-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **6.1 Rekomandimi:**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të marrin masa, që t’i kërkojnë operatorit ekonomik “K.G. K.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,774,657 lekë**, si shumë që i përket penalitetit për mos plotësim në afat të kontratës.

*Deri më datë 31.07.2018*

**7. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Mirëmbajtje të pajisjeve të Dializës”, Full Risk, të lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK., me nr. 915 prot, datë 24.04.2015, me vlerë 1,798,800 lekë me TVSH, konstatohet si vijon:

-Nga kontrolli i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit të kontratës, të dorëzuar pranë grupit të auditimit dhe konkretisht nga verifikimi i procesverbaleve të mbajtura nga SRSH, lidhur me zërat e kryerjes së shërbimit/zëvendësimit të pjesëve rezervë, u evidentuan zëra shërbimesh/zëvendësimesh të kryera më shumë se një herë në më shumë se një makineri mjekësore brenda periudhës së garancisë. Pra, ka pasur faturime në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur dhe konkretisht me nenin ku përcaktohet periudha e garancisë së pjesës rezervë të vendosur e cila nuk duhej të faturuhej nga operatori ekonomik “B.A.” SHPK., pa u ezauruar më periudha e garancisë. Vlera që i përket zërave të pjesëve rezervë të zëvendësuar dy ose dhe tre herë, brenda periudhës së garancisë, është **1,281,300 lekë dhe përbën dëm ekonomik** e si e tillë i duhet kërkuar operatorit ekonomik “B.A.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.9, faqe 77-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:**

Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të marrin masa, që t’i kërkojnë operatorit ekonomik “B.A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,281,300 lekë**, si shumë që është përfituar pa të drejtë nga operatori ekonomik në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur.

*Deri më datë 31.07.2018*

**8. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratës shtesë me objekt “**Mirëmbajtje të pajisjeve të Dializës**”, të lidhur midis SRSH-së dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK., me nr. 378 prot, datë 07.03.2016, me vlerë 360,000 lekë, konstatohet si vijon:

-Kontrata shtesë e lidhur, ka në preventivin e saj, pjesët rezervë që duhen mirëmbajtur/ndërruar. Nga auditimi i listës së pjesëve rezervë që duhen mirëmbajtur/ndërruar, u konstatua një listë me 8 zëra pjesësh rezervë. Këta zëra ose këto pjesë, janë ndërruar/riparuar tek kontrata bazë dhe nuk kishte përse të ndërroheshin/riparoheshin përsëri pasi pjesët e prokuruar tek kontrata bazë, kanë qenë brenda garancisë 1 vjeçare që mbulonte periudhën e kontratës shtesë. Si rrjedhojë, vlera e kontratës

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

shtesë prej **360,000 lekë, përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër zj. Dh.U. dhe kryetarin e njësisë së prokurimit, njëkohësisht konceptues të kontratës, juristin z. D.H. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.9, faqe 77-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:**

-Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **360,000 lekë**, konkretisht nga zj. Dh.U. dhe z. D.H., vlerë që i përket zërave të prokuruar për herë të dytë tek kontrata shtesë pasi ishin ekzekutuar njëherë tek kontrata bazë.

*Deri më datë 31.07.2018*

**9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, me objekt “Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës”, sipas kontratës së lidhur me nr. 248 prot, datë 05.02.2015, midis SRSH dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK., me vlerë 236,400 lekë, konstatohet si vijon:

-Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e aparaturave të Hemo-Dializës”, është iniciuar në kundërshtim me ligjin nr.89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”, në kundërshtim me Urdhrin nr.3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë mbi “Politikat Kombëtare të Menaxhimit të Pajisjeve Mjekësore”, pa marrë më parë miratimin e ASHPM (Agjencisë Shqiptare të Pajisjeve Mjekësore), sipas kapitullit II, pika 2.3.1 të urdhrit të mësipërm. Drejtori i SRSH-së, ka lidhur një kontratë shtesë, pa pasur më parë një informacion të detajuar nga Sektori i Inxhinierisë Klinike të SRSH-së, sipas kapitullit III të urdhrit të mësipërm, pika 3.8.3, pika 3.8.4, pika 3.8.5 dhe pika 3.8.6. Gjithashtu është paracaktuar vlera e shërbimit/defekteve që mund të ndodhin në të ardhmen, veprim ky në kundërshtim me pikën 3.4.5, të urdhrit të mësipërm, ku citohet se: “Prokurimi i pjesëve të këmbimit, duhet të shihet si diçka e paplanifikuar Si rrjedhojë, vlera e kontratës shtesë prej **236,400 lekë, përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër z. T.M. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.19, faqe 129-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi**

-Drejtoria e SRSH, Sektori Juridik, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **236,400 lekë**, nga z. T.M., vlerë që i përket zërave të prokuruar për herë të dytë tek kontrata shtesë pasi ishin ekzekutuar njëherë tek kontrata bazë.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i procedurës së zbatimit të kontratës me objekt “Blerje e materialeve mjekësore për shërbimin e Hemo-Dializës”, për një periudhë 1 mujore, të lidhur me nr. 1357, Prot-datë 13.06.2016, midis SRSH-së me përfaqësues z. P.Ç. dhe operatorit ekonomik “B.A.” SHPK., me vlerë 1,382,904 lekë me TVSH, u konstatua se:

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

-Nga analiza e sasive të materialeve mjekësore të prokuruar nga SRSH për muajin Qershor 2016, për nevojat e repartit të Hemo-Dializës, rezulton se: Për muajin Qershor 2016, reparti i Hemo-Dializës, i ka shërbyer 59 pacientëve dhe janë bërë 627 seanca. Janë nevojitur, për këto seanca, 525 copë Solucion Acidi, pra vetëm për një muaj. Tek kontrata e vitit 2015, me objekt “Blerje materiale mjekësore për repartin e Hemo-Dializës, janë prokuruar 8100 copë Solucion Acidi. Sipas kalkulimeve, rezulton se sasia e prokuruar, mbulon një periudhë prej 15 muaj e 4 ditë dhe konkretisht:  $8100 \text{ copë(vit)} / 525 \text{ copë(muaj)} = 15.4 \text{ muaj ose } 15 \text{ muaj e } 4 \text{ ditë}$ . Nëse llogarisim 15 muaj e 4 ditë nga muaji që SRSH ka marrë furnizimin e parë të kontratës së vitit 2015, pra nga muaji Prill-2015 deri në muajin Qershor-2016, konkludojmë se janë plot 15 muaj. Pra materiali mjekësor Solucion Acidi, ka qenë gjendje në farmacinë e SRSH-së, nga kontrata e mëparshme dhe nuk kishte përse të prokurohej në muajin Qershor 2016. Vlera e prokuruar tepër që i përket materialit Solucion Acidi, është **194,880 lekë** dhe **përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Shtetit duke ngarkuar me përgjegjësi drejtorin e SRSH, z. P.Ç. dhe juristin z. D.H. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.15, faqe 103-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:**

-Drejtorja e SRSH, Sektori Juridik, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **194,880 lekë**, nga z. P.Ç. dhe z. D.H., si vlerë që i përket zërave të likuiduar tepër mbi nevojat reale të SR Shkodër.

*Menjëherë*

**C- MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:**

Në lidhje me auditimin e inventarëve konstatohet se deri në fund të vitit 2017 janë akumuluar një sasi e konsiderueshme medikamentesh të skaduara në shumën totale prej 49,775,343 lekë, Sa i përket medikamenteve të skaduara dhe të akumuluar ndër vite rezulton se nga ana e drejtuesve të SRSH nuk janë marrë masat e duhura për analizimin e rritjes ndër vite të kësaj sasive, shkaqet e skadimit dhe mospërdorimit të tyre, si dhe nuk janë marrë masat për evadimin/asgjësimin e tyre, pasi mbeturinat farmaceutike përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut, dhe ky rrezik vjen si rezultat i materieve të ndryshme helmuese që përmbajnë ato dhe që përbejnë një rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut por edhe për ambientin në tërësi, pasi si rrjedhojë e ekspozimit ato mund të sjellin pasojat alergjike, efekte anësore, ndotje të ambientit dhe rezistencë ndaj antibiotikëve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Funksionimit Teknik të Spitalit Rajonal Shkodër.

*Shuma totale prej 49,775,343 lekë, përbën një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe si pasojë e përdorimi dhe një menaxhimin të fondeve në mospërputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efektivitetit në kundërshtim me Ligjin nr.*

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:**

Nga ana e Drejtorisë së Spitalit Shkodër, të merren masat e duhura për analizimin e shkaqeve dhe faktorëve të cilët kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme dhe akumulimin e medikamenteve të skaduara, të dalin personat përgjegjës dhe të mos përsëriten në të ardhmen këto problematika, duke synuar një menaxhim ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike. Gjithashtu të hartohet një planveprimi me afate të përcaktuara dhe të ngrihet komision i specializuar për të bërë të mundur evadimin/asgjësimin e këtyre medikamenteve në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe aktet e dala në funksion të tij, duke kryer në vijim dhe veprimet përkatëse kontabile.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën objekt auditimi janë larguar punonjës pa shkaqe të përligjura duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur SRSH në Gjykatë, nga të cilat 9 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit duke e detyruar Spitalin Rajonal Shkodër të paguajë vlerën **6,262,422 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit**. Gjithashtu nga largimet e punonjësve dhe nga mos ndjekja e procedurave ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish-punonjësit, Spitali Rajonal Shkodër është paditur në Gjykatë nga 7 punonjës të cilët janë në proces gjykimi dhe referuar Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër pretendohet se e kanë fituar këtë shkallë të gjykimit duke kërkuar nga SRSH një dëmshpërblim në vlerë totale **4,539,827 lekë, shumë e cila do të sjellë një efekt negative financiar të pritshëm për buxhetin e shtetit**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:**

Nga Drejtori i Spitalit, Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë individuale dhe të merren vendimet përkatëse, pasi shumat e mësipërme janë në vlera të konsiderueshme për institucionin dhe buxhetin e shtetit.

Gjithashtu në lidhje me largimet nga puna të punonjësve të merren masat që, në të ardhmen të respektohen procedurat e largimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke synuar një përdorim të fondeve publike me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet.

Shënim: Spitali Rajonal Shkodër të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për të gjitha rastet që zbatimi i rekomandimeve të dhëna kalon në procese gjyqësore, në cilësinë e palës së tretë që ka dijeni për çështjen.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**RAPORT AUDITIMI “MBI PËRPUTHSHMËRINË E RREGULLSHMËRINË MBI**  
**VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE, LIGJSHMËRINË FINANCIARE” NË**  
**SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

**Opinion i kualifikuar**

*Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000<sup>1</sup>). Dhe rregullshmërinë financiare. Nga auditimi i përputhshmërisë<sup>2</sup>, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet aktiviteti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Spitalin Rajonal Shkodër, gjatë auditimit janë konstatuar mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, duke justifikuar dhënien e **një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë<sup>3</sup>**.*

***Baza për kualifikimin e Opinionit***

*Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) dhe konkretisht ISSAI 4000 “Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.*

*Ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.*

*Ne sjellim në vëmendje, se në të gjitha procedurat e prokurimit, grupet e punës të ngritura nga titullarët e institucionit, nuk kanë analizuar dhe nuk kanë dokumentuar drejt përlllogaritjen e fondit limit, duke lenë vend për devijime nga fondi limit real. U konstatua se janë vendosur kritere në kundërshtim me objektin e prokurimit, të cilat kanë ndikuar në mospjesëmarrjen e gjerë në tenderët e hapur “Riparim dhe mirëmbajtje aparaturash mjekësore Laparoskopji-Orologji” dhe “Mirëmbajtje riparim të aparaturave mjekësore”.*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

<sup>1</sup>**ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

<sup>2</sup>Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

<sup>3</sup>**ISSAI 4000 - 4200** - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.